




**KOMUNA HANI I ELEZIT**

**2010-2025+**

# *Plani Zhvillimor Urban*



**Komuna e Hani i Elezit**

Komuna Hani i Elezit

## **Plani Zhvillimor Urban**

I miratuar nga Kuvendi Komunal i Hanit të Elezit

Më 26/09/2011

Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis, Hani i Elezit,

Ky dokument është përgatitur nga Komuna e Hanit të Elezit (Drejtoria për Urbanizëm Kadastër dhe Mjedis), me ndihmën Programit për Mbështetje të Komunave në Planifikim Hapësinor (MuSPP), i financuar nga Sida dhe implementuar nga UN-HABITAT-i

**Hani i Elezit, Prill 2011**



## Fjala e kryetarit

---

**Rufki Suma**  
*Kryetar*  
*Komuna Hani i Elezit*



## **Grupi Punues**

**Miqail Vila/Nexhmedin Daci**  
Drejtor i për UKM Hani i Elezit

**Durim Dernjani**, *inxh I ndërtimtarisë*  
Menaxher i projekteve, K. Hani I Elezit

**Masayuki Yokota**  
*Këshilltar për planifikimit, Udhëheqës i zyrës së Regjionit*  
Juglindor MuSPP/UN-HABITAT

**Ishaku Maitumbi**  
*Këshilltar për planifikim, Udhëheqës i zyrës së Regjionit*  
jugor dhe juglindor MuSPP/UN-HABITAT

**Pren Domgjoni**,  
*Zyrtar i Planifikimit Hapësinor*  
Udhëheqës i projektit, MuSPP/UN-HABITAT

**Sami Stagova**,  
*Zyrtar Planifikimi Hapësinor*  
MuSPP/UN-HABITAT

**Nazim Laçi**- Drejtorja për Arsime Kulture dhe sport- Hani I Elezit

**Fari Kalisi**- Drejtorja e Administratës  
Hani i Elezit

**Safet Bushi**, Shëndetësia dhe mirëqenia sociale-  
Hani I Elezit

**Shabi Rexhallari**- Drejtorja për Ekonomi dhe  
Financa

**Rufat Shkreta**- Drejtorja Shërbimeve Publike

**Zekrija Krivanjeva**, Udhëheqës I sektorit te  
kadastrit-Hani i Elezit

**Remzi Bushi**, zyrtar i Kadastrit -Hani i Elezit

**Nadire Minci**, zyrtare për Mjedis  
Hani i Elezit

**Keshilltar**  
**Hasse Ericsson**  
MuSPP/UN-HABITAT

**Mallzum Qajani**  
Këshilltar i kryetarit për planifikim  
Hani i Elezit

**Ekipa mbeshtetese**  
**Lumnije Gashi**,  
Zyrtar Planifikimi, MuSPP/UN-HABITAT

**Joachim Bergerhoff**,  
Ekspert i mobilitetit, MuSPP/UN-HABITAT

**Arijeta Himaduna**,  
Zyrtare për çështje gjinore, qeverisje  
dhe ndërlidhje  
MuSPP/-UN-HABITAT

**Gloriosa Hisari**,  
zyrtare ligjore MuSPP/-UN-HABITAT

**Konsu**  
**lente e jashtme**  
Catarina Teles Ferreira Camarinhas,  
hartuese e VSM

## PËRMBAJTJA

<b>I Parathënje</b> .....	11
ii. Rëndësia e planifikimit hapësinor .....	11
iii. Dokumentet e planifikimit për komunën .....	11
iv. Qëllimet e PZHU-së .....	12
v. Qeverisja .....	13
vi Historia administrative .....	13
vii. Struktura administrative .....	14
<b>1. PROFILI URBAN</b> .....	15
1.1.1 Historia .....	15
1.1.2 Kushtet fizike dhe gjeografike të Hanit të Elezit .....	15
1.1.2a Gjeografia e Hanit të Elezit .....	15
1.1.2b Hidrografia dhe klima .....	16
1.1.3 Shfrytëzimi tokës dhe pronësia .....	17
1.1.4 Trashëgimia kulturore dhe natyrore .....	23
1.2 KUSHTET SOCIO EKONOMIKE .....	23
1.2.1 Popullsia dhe ekonomitë familjare .....	23
1.2.2 Mundësitë e biznesit .....	29
1.2.2 Resurset natyrore (nëntokësore) .....	31
1.3 INFRASTRUKTURA FIZIKE DHE URBANE .....	31
1.3.1 Infrastruktura urbane .....	31
1.3.2 Rrugët, transporti dhe lëvizshmëria .....	35
1.4 MJEDISI .....	38
1.4.1 Mbrotjtja e mjedisit dhe degradimi .....	38
1.4.2 Fatkeqësitë natyrore dhe të shkaktuara nga njerëzit .....	42
1.5 INFRASTRUKTURA SOCIALE .....	44
1.5.1 Shëndetësia dhe shërbimet .....	44
1.5.2 Edukimi .....	45
1.5.3 Kultura dhe sporti .....	48
1.5.4 Hapësirat publike .....	48
1.6. BANIMI DHE KUSHTET E JETESËS .....	49
1.6.1 Fondi i banesave dhe ambienti i jetës .....	49
1.6.2 Vendbanimet joformale .....	49
1.7. ANALIZA E GJENDJES URBANE .....	49
1.7.1a Morfologjia terrenit .....	49
1.7.1b Tipologjia hapësirave .....	50
1.7.1c Tipologjia e ndërtimeve .....	53
1.7.1d Ndarja e tokës, nëndarja dhe standardet e shfrytëzuara për ndarje .....	54
1.7.1e Sistemi i rrjetit rrugor dhe klasifikimi i tij .....	68
1.7.2 Analiza përmes teknikës SWOT .....	69
1.7.2a Identifikimi i përparësive dhe mundësive .....	69

1.7.2b Identifikimi i dobësive dhe rreziqeve .....	70
1.8. Sfidat e zhvillimit urban .....	71
1.9. Vlerësimi i kapaciteteve investuese .....	73
<b>2. VIZIONI, PARIMET DHE CAQET .....</b>	<b>75</b>
2.1. Deklarata e vizionit .....	75
2.2. Parimet e përgjithshme të zhvillimit .....	75
2.2.1 Parimet kryesore për zhvillimin e Hani të Elezit.....	75
2.3. Qëllimet zhvillimore afatgjate .....	76
2.4. Prioritetet strategjike .....	79
<b>3. KORNIZA ZHVILLIMORE URBANE .....</b>	<b>79</b>
3.1. Koncepti kryesor zhvillimor .....	79
3.1.1. Skenarët zhvillimor dhe vlerësimi i tyre .....	79
3.1.2. Elementet kryesore strukturore .....	87
3.1.3. Koncepti i formimit/zgjerimit urban dhe hapësinor.....	88
3.1.4. Përkufizimi dhe ndarja e zonës urbane .....	90
3.2. Struktura e zhvillimit hapësinor të Qytetit .....	91
3.2.1 Struktura e planifikuar hapësinore/zonimi i shfrytëzimit të tokës .....	91
3.2.2 Zhvillimi social .....	96
3.2.3 Ekonomia .....	99
3.2.4 Infrastruktura urbane .....	105
3.2.5 Rrugët dhe transporti .....	106
3.2.6 Mjedis, peizazhi urban dhe trashëgimia.....	115
3.2.7 Fatkeqësitë natyrore dhe të shkaktuara nga njerëzit .....	116
3.2.8 Banimi .....	119
3.3. Zona ekzistuese urbane dhe zgjerimi i propozuar i zonës ndërtimore jashtë zonës urbane .....	124
3.4. Shënjimi i ndërtimeve të rëndësishme, projekteve strategjike ose zonës së veçantë e cila veç është aprovuar në Planin Hapësinorë të Kosovës ose Planet e Zonave të Veçanta .....	124
3.5. Vlerësimi i ndikimit socio-ekonomik dhe mjedisor i kornizës së propozuar .....	124
<b>4. STRATEGJITË DHE VEPRIMET .....</b>	<b>126</b>
4.1. Zbatimi i strategjive dhe veprimeve për zbatim .....	126
4.1.1 Strategjitë dhe veprimet për zhvillimin e tokës .....	126
4.1.2 Strategjitë dhe veprimet për zhvillimin social .....	126
4.1.3 Strategjitë dhe veprimet për zhvillimin ekonomik .....	127
4.1.4 Strategjitë dhe veprimet për zhvillimin e infrastrukturës urbane.....	128
4.1.5 Strategjitë dhe veprimet për zhvillimin e infrastrukturës rrugore dhe transportit .....	129
4.1.6 Strategjitë dhe veprimet për mbrojtjen e mjedisit, trashëgimisë dhe peizazhit urban .	130
4.1.7 Strategjitë dhe veprimet për vlerësimin, zvogëlimin dhe zbutjen e fatkeqësive .....	131
4.1.8 Strategjitë dhe veprimet për zhvillimin e banimit .....	131
4.2. Vlerësimi i strategjive .....	132
4.3. Afatet kohore, implikimet financiare dhe korniza institucionale .....	134
<b>5. DISPOZITAT PËR ZBATIM .....</b>	<b>148</b>

5.1. Udhëzime mbi çështjet e interpretimit të PZHK-së dhe PZHU-së gjatë hartimit të PRRU-ve dhe planeve tjera .....	148
5.2. Kushte të përcaktuara nga qeveria lokale mbi çështjet të rëndësishme për zhvillimin dhe shfrytëzimin e tokës ne zonë urbane .....	148
5.2.1. Kushtet për përkufizimin e sipërfaqeve publike si dhe atyre me destinime tjera .....	148
5.2.2. Kushtet për rregullimin e hapësirës për objektet me rëndësi për Kosovën dhe Komunën e Hanit të Elezit .....	149
5.2.3. Kushtet për vendosjen e veprimtarive ekonomike .....	151
5.2.4. Kushtet për vendosjen e objekteve të veprimtarive publike .....	152
5.2.5. Kushtet dhe mënyrat për ndërtimin e objekteve të banimit .....	153
5.2.6. Kushtet për përcaktimin e rrjeteve të sipërfaqeve të korridoreve apo traseve të telekomunikimit dhe rrjetit të infrastrukturës komunale .....	153
5.2.7. Kushtet për rregullimin e zonave dhe tërësive me vlera të veçanta për komunën .....	154
5.2.8. Masat për mbrojtjen e peizazheve, vlerave natyrore dhe tërësive kulturo-historike .....	154
5.2.9. Mënyra e trajtimit të mbeturinave (përpunimi, deponimi, bartja) .....	156
5.2.10. Masat për pengimin e ndikimeve të dëmshme në mjedis .....	157
5.2.11. Masat për parandalimin e ndikimit negativ social .....	162
5.2.12. Masat për zbatimin e planit .....	163
5.3. Dispozitat lidhur me bashkëpunimin .....	164
5.4. Dispozitat mbi rendin kronologjik apo etapat e implementimit .....	164
5.5. Elementet dhe udhëzimet për hulumtim të mëtutjeshëm .....	164
5.6. Dispozitat përfundimtare .....	165

## LISTA E FIGURAVE

Fig 1. Qendra e qytetit .....	12
Fig 2. Zona industriale (fabrika e çimentos) .....	13
Fig 3. Ndotja e ajrit (fabrika e çimentos) .....	39
Fig 4. Derdhja e ujërave të zeza në Lumin Lepenc .....	40
Fig 5. Mbeturinat e azbestit përgjatë bregut të Lumit Lepenc .....	40
Fig 6. Lumi Lepenc .....	42

## LISTA E HARTAVE

### *Hartat tematike*

Harta 1. Pozita gjeografike e qytezës së Hanit të Elezit .....	16
Harta 2. Harta e shfrytëzimit të tokës .....	18
Harta 3. Harta e pronësisë.....	22
Harta 4. Dendësia e popullsisë .....	26
Harta 5. Harta e shpërndarjes së popullsisë.....	28
Harta 6. Harta e infrastrukturës urbane .....	34
Harta 7. Harta e infrastrukturës fizike .....	36
Harta 8. Mjedi dhe vlerësimi i rreziqeve .....	41

### *Analiza gjendjes ekzistuese*

Harta 9. Harta e analizave të parcelave sipas madhësisë .....	52
Harta 10. Nënndarja e zonës urbane në njësi .....	55
Harta 11. Njësia 1 (Qendra) .....	57
Harta 12. Njësia 2 (Parku i qytetit) .....	59
Harta 13. Njësia 3 (Zona industriale) .....	61
Harta 14. Njësia 4 (Anëlum) .....	63
Harta 15. Njësia 5 (Lagja e Re) .....	65

Harta 16. Njësia 6 (Lagja te kufiri) .....	67
--	----

### **Korniza zhvillimore**

Harta 17. Skenari A .....	81
Harta 18. Skenari B .....	83
Harta 19. Skenari C .....	86
Harta 20. Shfrytëzimi i tokës .....	95
Harta 21. Zhvillimi ekonomik.....	104
Harta 22. Infrastruktura/transporti/mobiliteti .....	114
Harta 23. Mjedisi/reduktimi i ndotjeve dhe vërshimeve .....	118
Harta 24. Lartësia e objekteve/etazhiteti.....	122
Harta 25. Harta e integruar .....	123

### **LISTA E TABELAVE**

Tabela 1. Struktura administrative .....	14
Tabela 2. Shfrytëzimi i tokës në zonën urbane.....	17
Tabela 3. Ndarja e zonës së banimit .....	19
Tabela 4. Ndarja e zonës ekonomike.....	19
Tabela 5. Ndarja e zonës së gjelbër .....	20
Tabela 6. Ndarja e zonës së shërbimeve sociale .....	20
Tabela 7. Ndarja e hapësirave tjera .....	20
Tabela 8. Pronësia .....	21
Tabela 9. Numri i popullsisë për çdo vendbanim dhe viti i regjistrimit .....	24
Tabela 10. Struktura e bizneseve ne zonën urbane .....	31
Tabela 11. Resurset natyrore (nëntokësore) .....	31
Tabela 12. Infrastruktura fizike në km.....	35
Tabela 13. Orari i transportit publik/lokal .....	37-38
Tabela 14. Ndotja e ajrit .....	39
Tabela 15. Dizajni sizmik dhe periudha e ndërtimit .....	43
Tabela 16. Numri dhe struktura aktuale e stafit në QKMF.....	44
Tabela 17. Të dhënat për shkollat brenda zonës urbane .....	46
Tabela 18. Analizat përmes teknikës SWOT .....	69-71
Tabela 19. Buxheti 2006-2013.....	73
Tabela 20. Buxheti për 2009 .....	73
Tabela 21. Projektet e investimeve kapitale për vitet 2008 dhe 2009.....	74
Tabela 22. Parimet kryesore për zhvillimin e Hanit të Elezit .....	75-76
Tabela 23. Ndarja e zonës urbane të Hanit të Elezit .....	91
Tabela 24. Zonimi i shfrytëzimit të tokës/kategoritë kryesore të tokës urbane .....	92-94
Tabela 25. Gjerësitë e nevojshme të propozuara për rrugët e Hanit të Elezit .....	111
Tabela 26. Distanca e propozuar e vijës ndërtimore nga aksi i skajshëm rrugor .....	111
Tabela 27. Orari i trenit në Han të Elezit .....	111
Tabela 28. Përfitimet nga dendësia e lartë .....	119
Tabela 29. Strategjitë dhe veprimet për zbatim.....	126-131
Tabela 30. Vlerësimi i strategjive.....	132-133
Tabela 31. Afatet kohore, implikimet financiare dhe korniza institucionale.....	134-147

### **Lista e grafikave**

Graf 1. Shfrytëzimi i tokës në % .....	17
Graf 2. Ndarja e zonës së banimit .....	19
Graf 3. Ndarja e zonës ekonomike .....	19
Graf 4. Ndarja e zonës së gjelbër.....	20
Graf 5. Ndarja e zonës së shërbimeve .....	20
Graf 6. Ndarja e hapësirave tjera .....	20
Graf 7. Pronësia .....	21
Graf 8. Shtimi i popullsisë gjatë viteve .....	23
Graf 9. Struktura e popullsisë sipas grupmoshave .....	24
Graf 10. Shkalla e punësimit/Punësimi sipas sektorëve.....	25
Graf 11. Shkalla e varfërisë.....	25
Graf 12. Popullsia sipas vendbanimeve dhe viteve të regjistrimit .....	27
Graf 13. Struktura e bizneseve .....	31
Graf 14. Infrastruktura fizike .....	35
Graf 15. Raporti mjek/infermier për banor .....	45
Graf 16. Ndarja e hapësirave në Njësinë 1 (Qendra) .....	56
Graf 17. Ndarja e hapësirave në Njësinë 2 (Parku i Qytetit).....	58
Graf 18. Ndarja e hapësirave në Njësinë 3 (Industria) .....	60
Graf 19. Ndarja e hapësirave në Njësinë 4 (Anëlum) .....	62
Graf 20. Ndarja e hapësirave në Njësinë 5 (Lagja e Re).....	64
Graf 21. Ndarja e hapësirave në Njësinë 6 (Lagja te kufiri) .....	66
Graf 22. Prerja tërthore e propozuar e magjistrales .....	107
Graf 23. Prerja tërthore e propozuar e korridorit kryesore lokal .....	108
Graf 24. Prerja tërthore e propozuar e rrugës kryesore të lagjes .....	109
Graf 25. Prerjet tërthore të propozuara të Bulevardeve të Qytezës.....	109-110
Graf 26. Prerja tërthore e propozuar e rrugës pa fund .....	110

#### Lista e shkurtesave

PZHK	Plani Zhvillimor Komunal
PZHU	Plani Zhvillimor Urban
PRrU	Plani Rregullues Urban
MMPH	Ministria Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MEF	Ministria Ekonomisë dhe Financave
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MEM	Ministria Energjetikes dhe Minerave
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
ESK	Enti Statistikave të Kosovës
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
PTK	Post Telekomunikacioni i Kosovës

## I. Parathënie

### ii. Rëndësia e planifikimit urban

Struktura e Planeve Hapësinore në Kosovë është e përcaktuar nga legjislacioni në fuqi për planifikimin hapësinor. Plani Zhvillimor Urban (PZHU) duhet të promovojë zhvillimin e ekuilibruar dhe të qëndrueshëm hapësinor të zonave urbane. Planet e zhvillimit janë plane shumë-sektoriale që përcaktojnë qëllimet afatgjata të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor.

Është me rëndësi të theksohet se qasjet e reja në planifikimin strategjik dhe hapësinor përfshijnë më shumë se vetëm rregullat për përdorimin e tokës. Kjo kërkon një qasje të integruar për rregullimin e tokës, duke pasuar vizionin e qartë në pajtim me të gjitha grupet e interesit dhe me angazhimet për të punuar drejt arritjes së qëllimeve të përcaktuara nga procesi i vizionimit.

PZHU e Hanit të Elezit, si një plan strategjik multi-sektorial, duhet të paraqes qëllimet ekonomike, sociale dhe hapësinore afatshkurta deri afatgjata për këtë komunë të paktën për një periudhë 5 (pesë) vjeçare. Përveç kësaj, qasjet e reja të planifikimit për sa i përket ndaljes së ndryshimeve klimatike, shfrytëzimit të tokës, transportit dhe përshtatja për një mënyrë të re të jetesës, janë shumë të rëndësishme për krijimin e një qyteti të qëndrueshëm dhe kompakt. PZHU duhet të jetë në përputhje me Planin Zhvillimor Komunal të Hanit të Elezit dhe me Planin Hapësinor të Kosovës. PZHU do të jetë bazë për Planet rregulluese Urbane (PRRU) PZHU përbën elemente të planeve rregulluese urbane në mënyrë që të përballojë zhvillimet në zonën urbane.

### iii. Dokumentet e planifikimit për komunën

Gjatë shekullit të fundit (që nga viti 1960) vendbanimi i Hanit të Elezit i ishte pjesë e komunës së Kaçanikut. Edhe pse ky vendbanim ishte pjesë e territorit të Kaçanikut deri në vitin 2005, asnjëherë nuk ishte përfshirë në planin zhvillimor ose në plane tjera përkatëse pasi që administrata e Kaçanikut nuk ka pasur një PZHK me tematika që janë të përcaktuara dhe të detyrueshme me ligjet e sotme. Dokumenti i vetëm i zhvilluar nga Komuna e Kaçanikut ishte një Plan Urban që ka adresuar çështjet e rregullimit të qendrës së Kaçanikut por jo edhe vendbanimet rurale siç ishte në atë kohë Hani i Elezit.

Pas luftës, komuna e Kaçanikut ka përgatitur një Agjendë për Zhvillim Komunal në vitin 2003 dhe një Strategji për Zhvillim Komunal që mbuloi një periudhë katër vjeçare (2003-2006). Hani i Elezit ishte i integruar në këtë strategji. Në mes të vitit 2005 Hani i Elezit u promovua në një Pilot Njësi Komunale. Pas konsolidimit fillestar në fillim të vitit 2007 administrata e përkohshme lokale propozoi dhe Kuvendi miratoi propozimin për hartimin e Strategjisë për Zhvillimin Social-Ekonomik të Hanit të Elezit. Ky vendim ishte bërë nga ana e administratës komunale për të përmirësuar funksionet e saj duke zhvilluar më tutje Komunën me hartimin e planeve hapësinore dhe zhvillimore. Ky dokument ishte parashikuar të mbulojë periudhën pesë vjeçare (2008-2012) dhe ishte i përbërë nga profili komunal, vizioni, objektivat dhe projektet e detajuara si komponentë kryesore. Një nga synimet ishte trajtimi sa më sakte i faktit të ndryshimit të qendrës nga rurale në atë urbane dhe hartimi i ideve për ndarjen e zonave urbane. Dokumenti ka paraqitur një analizë të konsoliduar të profilit dhe projekteve të detajuara. Megjithatë, një dobësi e dokumentit ishte mungesa e komponentëve grafike që ishte pasojë e mungesës së stafit.

Komunat fqinje janë përpara në procesin e bërjes së planeve zhvillimore. Komuna e Kaçanikut është në proces të përgatitjes së Planit Zhvillimor Komunal/Urban. Ferizaj dhe Gjlani kanë përfunduar planet e tyre

zhvillimore dhe kanë lëvizur edhe më tutje drejt hartimit të Planeve Rregulluese Urbane për zonat e parapara urbane.



Fig-1 foto e qendrës së qytetit

#### iv. Qëllimet e PZHU-së

Qëllimet e Planit Zhvillimor Urban të Hanit të Elezit janë udhëheqja e zhvillimit të ardhshëm drejt shfrytëzimit të tokës, rritjes, zhvillimit dhe konservimit. Ky dokument ofron një mundësi për të shprehur vizionin dhe vlerat për një pasqyrim të qartë të pritjeve të komunitetit të Hanit të Elezit. PZHU përcakton mundësitë e komunës, duke udhëhequr zhvillimin, duke informuar pronarët e pronave, zyrtarët publikë dhe zhvilluesit për procesin të zhvillimit, lejimit dhe zbatimit të projekteve. PZHU i Hanit të Elezit ka për qëllim të inkurajojë shfrytëzimin dhe zhvillimin e përshtatshëm të gjitha tokave brenda territorit të qytezes së Hanit të Elezit, të promovojë zhvillimin, shëndetin, sigurinë, efikasitetin dhe ekonominë, të mbrojë dhe ruajë trashëgimisë ekzistuese natyrore dhe kulturore.

PZHU është plan strategjik multi-sektorial i cili përcakton objektivat afatgjatë zhvillimor ekonomik, social dhe hapësinor të Komunës. Ky është një udhëzues i cili i shërben liderëve lokal, komunitetit të biznesit dhe qytetarëve si një orientim për qëllimet e mëposhtme:

- Për të kontrolluar zhvillimin në një mënyrë të qëndrueshme, duke promovuar interesat e përbashkëta të banorëve në fushat e zhvillimit social, mjedisit dhe përdorimin të tokës, zhvillimit ekonomik dhe të infrastrukturës brenda Hani i Elezit.
- Për të identifikuar një strategji për shfrytëzimin efikas dhe efektiv të burimeve potenciale natyrore dhe shoqërore.
- Për të identifikuar lokacionet dhe burimet potenciale për zhvillimin e qytetit dhe komunës në përgjithësi.
- Për të mbështetur zhvillimin e ekuilibruar të zonave brenda zonës urbane
- Për të identifikuar rolin e zonave kryesore për zhvillimin ekonomik dhe social
- Për të identifikuar prioritetet për zbatimin e projekteve.



- Për të mbrojtur dhe shfrytëzuar elementet e trashëgimisë natyrore dhe kulturore për zhvillimin e turizmit dhe ekonomisë.
- Për të udhëhequr përgatitjen e planeve rregulluese urbane.
- Për të lehtësuar shfrytëzimin dhe mbrojtur zhvillimin industrial, bizneset, banimin dhe sektorin të shërbimeve, si dhe trashëgiminë natyrore dhe kulturore.



Fig-2 Fabrika e çimentos “Sharr” që gjendet afër qendrës së qytetit

## v. Qeverisja

### Vi. Historia Administrative


Pilot Njësia Komunale e Hanit të Elezit është themeluar në shtator të vitit 2005 si pjesë e procesit të decentralizimit, në bazë të Udhëzimit Administrativ të UNMIK-ut nr. 2005/11 për krijimin e Pilot Njësive Komunale, e cila u nënshkrua më 22 korrik, 2005. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) kishte rekomanduar përcaktimin e strukturës territoriale për Pilot Njësitë Komunale (PNJK) në bazë të vendimeve ekzekutive të UNMIK-ut (2005/17 dhe 2005/21) për përcaktimin e territorit të secilës PNJK, të nënshkruara më 12 gusht 2005.

Për strukturimin dhe organizimin e brendshëm të PNJK-së, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ndërmori Udhëzimin Administrativ nr. 2006/2 për strukturimin dhe organizimin e brendshëm të gjitha PNJK-ve. Më 1 qershor 2006 në një proces të rregullt dhe pas një interviste u punësua drejtori ekzekutiv. Si rezultat i kësaj, me 12 qershor 2006 administrata komunale në Han të Elezit u organizua në këto seksione: Administrata, Buxheti dhe Financat, Edukimi dhe Shëndetësia, Planifikimi, Urbanizmi dhe Inspeksioni.

Ministria e APL emëroi një administrator të përkohshëm që të merret me çështjet financiare të PNJK-së deri te certifikimi në nivelin komunal.

Me shkresën e njoftuese nr. 02-527, Ministria e APL më 13 gusht 2009 njoftoi se Komuna e Hanit të Elezit është certifikuar në të njëjtin nivel të kompetencave dhe përgjegjësi si edhe komunat tjera në Republikën e Kosovës. Administrata e Hanit të Elezit ka tani 39 punonjës civil dhe 8 staf politik.

vii. Struktura administrative



## **1. Profili Urban**

### **1.1.1 Historia**

Nuk ka fakte të njohura për atë se si është quajtur Hani i Elezit gjatë lashtësisë. Emërtimi i parë i këtij vendbanimi SAR (Sharr) daton nga shekulli i gjashtëmbëdhjetë (dhe vazhdon në vitet 1564, 1589, 1689, 1690, 1730, 1775, 1788, 1812, 1822, etj.). Duke u bazuar në hartat e vjetra ka ekzistuar një vendbanim afër Maleve të Sharrit dhe studiuesit besojnë se ky është Hani i Elezit i sotëm. Vendbanimit ju la emri Hani i Elezit në shekullin e nëntëmbëdhjetë, sipas Elez Dimçës, i cili kishte ndërtuar një Han. Udhëtimi dhe transporti i mallrave gjatë natës përmes Grykës së Kaçanikut ishte gjithmonë i rrezikshëm. Rrjedhimisht, Hani ofroi një vend për njerëzit që të qëndrojnë për një natë. Ky emër është përdorur deri në vitin 1912, kur regjimi serb e quajti atë Gjeneral Jankovic, që kurrë nuk u pranua nga ana e popullatës. Fshatrat janë përmendur edhe në arkivat osmane më 1452, 1455, 1468, 1544, 1568, 1893, 1896 dhe 1900. Ekziston edhe një hartë austriake nga viti 1689 që i referohet Hanit të Elezit dhe fshatrave të tij.

Është e rëndësishme të përmendet se Hani i Elezit nuk ishte regjistruar si një vendbanim i populluar nga administrata në vitin 1914, për shkak të faktit se Hani i Elezit ishte i njohur vetëm si një vend ku njerëzit janë ndalur për ushqim dhe pushim duke udhëtuar në veri ose në jug. Prova e kësaj daton që në vitin 1920, ku në atë kohë Han të Elezit kishte vetëm një stacion treni (1873), dy kafene, një bakallhane dhe një han. Rreth kësaj kohe edhe familjet shqiptare nga fshatrat përreth kanë filluar të vendosen në Han të Elezit. Numri i të ardhurve në këtë zonë është rritur në numër, kur në vitin 1936 u ndërtua fabrika e çimentos.

Pas Luftës së Dytë Botërore (dhe pas rindërtimit dhe zgjerimit të fabrikës së çimentos), Hani i Elezit ka evoluar në një vendbanim, ku shumica e punonjësve të fabrikës së çimentos kanë ndërtuar shtëpitë e tyre në mënyrë që të jetë më afër punës. Edhe pse Hani i Elezit dhe rrethinat e saj kanë pasur statusin e një komune që nga viti 1913, një ndarje e re administrative e miratuar në vitin 1961, ka themeluar komunat më të mëdha, dhe ka shkrirë territorin e Hanit të Elezit me komunën e Kaçanikut.

### **1.1.2 Kushtet fizike dhe gjeografike të Hani i Elezit**

#### **1.1.2 a Gjeografia e Hani të Elezit**

Hani i Elezit ndodhet në pjesën jug lindore të Kosovës afër kufirit me Maqedoninë. Gjendet në mes të bjeshkëve të Sharrit dhe Bjeshkëve të Karadakut. Hapësira e zonës urbane është 159.88 ha, 1.59.8.km<sup>2</sup>. Dendësia e popullsisë në zonën urbane është 2,527.67 banorë në 1 km<sup>2</sup> ose 25.27 banorë në hektarë.

Qyteti ka lidhje rrugore me fshatrat përreth, me komunat tjera ne region dhe me Maqedoninë. Qyteza e Hanit të Elezit është duke u rritur në mënyrë rapide, pasi që mundësitë e punësimit janë më të mëdha se sa në zonën rurale. Qyteza e Hanit të Elezit shtrihet në luginën e Lepencit me gjatësi rreth 2,372m.


Vendbanimi i qytetës së Hanit të Elezit është në një vend ideal gjeografik pasi që prek rrugën kryesore nga Prishtina në Shkup. Është pikë kufitare dhe industria është shumë e zhvilluar dhe e njohur jo vetëm në Kosovë por edhe jashtë vendit. Në pjesën jugore të Hanit të Elezit është një pikë kufitare që ndan territorin e Kosovës me Maqedoninë. Kjo është një pikë kyçe për rajonin dhe Kosovën, pasi që shumica e transportit të mallrave dhe tjerave, kryhet nëpërmjet kësaj pike kufitare.

Rruga e planifikuar që do të lidhë dy pikat kufitare (Hani i Elezit dhe Gllloboçicë) gjithashtu kalon përmes territorit të qytezës.

Prania e bjeshkëve në lindje dhe perëndim të komunës do të thotë se lidhjet kryesore me rajonet tjera janë realizuar nëpërmjet luginës së Lepencit. Lumi Lepenc kalon përmes luginës përmes qytezës së Hanit të Elezit. Rruga magjistrale Prishtinë-Shkup po ashtu kalon përmes qytezës më gjatësi 2.1km. Më në Jug të Luginës së Lepencit është pika kufitare që lidh Kosovën me shtetet tjera të Ballkanit dhe Evropës.

### *Harta 1*





### 1.1.2 b Hidrografia dhe klima

#### Hidrografia

Të dhënat hidro-geologjike për territorin e Hanit të Elezit janë shumë të kufizuara për shkak të mungesës së studimeve. Lumi Lepenci që kalon nëpër territor është i tipit të hapur me një rrjedhje në drejtim të juglindjes, dhe formon pellgun e saj ujor në rajon, që përfshin Hanin e Elezit.

Territori është gjithashtu plot me përranj që kalojnë nëpër zonën e qytezës: përroi i Rezhancës dhe përroi i Dimcës.

## Klima


Klima është tipike kontinentale, me dimër të ashpër dhe temperatura minimale nga  $-10^{\circ}\text{C}$  deri  $5^{\circ}\text{C}$ , dhe verë të nxehtë me temperatura maksimale që arrijnë  $40^{\circ}\text{C}$ . Ka një ndikim të fuqishëm nga lugina e Vardarit (klima e butë me ndikim të fortë gjatë dimrit që pasohet nga sasi të vogla të reshurave të borës) dhe Gryka e Kaçanikut (klimë tipike kontinentale me ndikim të fuqishëm gjatë verës).

Zona është e karakterizuar nga reshje të dobëta. Ata janë matur me rreth  $500\text{ml}/\text{m}^2$ ; mesatarja prej 1992 deri 1996 ishte  $476\text{ ml}/\text{m}^2$  çdo vit. Për fat të keq reshjet janë të dobëta gjatë verës dhe janë të forta në dhjetor dhe janar. Lagështia mesatare është rreth 65% (minimumi 51% dhe maksimumi 87%). Drejtimi kryesor i erës është veri - jug. Nuk ka asnjë stacion lokal klimatik këtu, që është edhe arsyeja pse nuk bëhen matje të përhershme klimatike. Ekzistojnë plane për ngritjen e një stacion lokal klimatik këtu në të ardhmen e afërt.

### 1.1.3 Shfrytëzimi i tokës dhe pronësia

#### -Shfrytëzimi tokës

Bazuar ne informatat (raportet) nga zyrtaret e kadastral, hartat kadastrale fotot areale dhe nga te dhënat e mbledhura ne terren shfrytëzimi I tokës në Han të Elezit është paraqitur në grafikun dhe hartën me poshtë.




Shfrytëzimi tokës	Ha
Zonë e banimit	30.35
Zonë e shërbimeve sociale	4.66
Zonë ekonomike	33.13
Zonë e gjelbër	57.49
Zonë doganore	8.61
Zonë tjetër	25.64
Gjithsej	159.88

## Harta 2



Harta e shfrytimit te tokes  
Land use map



Legend/Legjenda

- |   |  |
|---|--|
| Kufi shtetror_State border                            | Tarran sportiv-Sports terrain                                  |
| Kufi urban_Town border                                | Hapsire doganore_Customs area                                  |
| Objektet_Buildings                                    | Hapsire e administrates lokale_Local administration area       |
| Autostrada e planifikuar_Planned motorway             | Hapsire e minjeres_Mine area                                   |
| Hekurudha_Railroad                                    | Hapsire e shtrallit lumi_River bed area                        |
| Lumi_River/Lepenc                                     | Hapsire e hekurudhes_Railroad area                             |
| Magjistrale_Highway                                   | Zone e shërbimesve sociale_Social services area                |
| Rruge shpërndarëse kryesore_Primary distributor roads | Zone industriale_Industrial area                               |
| Përfaqet_Streams                                      | Hapsire rrugore_Road area                                      |
| Rruge për këmbësorë_Pedestrian path                   | Parkim transportit malltrave_Freight transport parking         |
| Rruge për qeje (tundore)_Access roads (dead end road) | Hapsire me shfrytëzim të përzier_Mixed use area                |
| Rrugat lidhëse_Connecting roads                       | Hapsire e gjelberte shoqërore_Green open spaces (social owned) |
| Hapsire komerciale_Comercial area                     | Zone e banimit_Housing area                                    |
| Xhami/Mosque  | Hapsire e gjelberte private_Green private land                 |
| Hapsire arsimore_Education Area                       | Hapsire për shëndetësi_Health care area                        |


- **Ndarja në zona sipas shfrytëzimit**

Sipas shfrytëzimit zonat janë ndarë në 5 kategori:

- Zona Banimit
- Zona ekonomike
- Zona e gjelber
- Zona e shërbimeve dhe
- Zona tjera (rruget, lum/perroje, hekurudhë)

**Zona e banimit**


Zona e banimit ka 30.35 hektarë, karakterizohet me dominim të banimit individual. Rreth 91% është banim individual dhe 7% është banim individual i kombinuar me komercial dhe vetëm rreth 2% është banim kolektiv. Me hollësihtë është paraqitur në tabelle e ndara në hektarë.



Zona banimit	Ha
Banim kolektiv	0.5
Banim individual	27.64
Banim dhe komercial	2.11
Hapësirë parkimi	0.1
Gjithsej	30.35

**Zona ekonomike**

Zona e ekonomike ka 30 hektarë, karakterizohet me dominim të industrisë. Rreth 55% është industri dhe 36% është miniera e hapur (llapori); rreth 6% është hapësirë banimi dhe komerciale; 3% është parkim të transportit të mallrave dhe shpediton. Me hollësihtë është paraqitur në tabelle e ndara në hektarë.




Zona ekonomike	Ha
Industria	18.23
Miniera (llapori)	11.83
Banim dhe komerciale	2.14
Parkim privat për transport mallrash	0.93
Gjithsej	33.13

**Zona e gjelber**

Zona e gjelbër karakterizohet me dominim të hapësirës së gjelbër private që kryesisht shfrytëzohet për kopshte dhe livadhe. Rreth 28% është hapësirë e gjelbër shtetërore apo akoma e pa definuar sepse është hapësirë e ish armatës që akoma prona nuk është e definuar por shfrytëzohet nga komuna. Këto hapësirakryesisht janë të pashfrytëzuara dhe pjesa më e madhe është e mbuluar me drunjtë. Pjesa poshte shfrytëzohet nga policia, zjarrfiksit dhe një pjesë shfrytëzohet për dreg të gjelbërt. Pjesa ku gjenden cisternat




eshte e rrethuar dhe vlersohët si o e shfrytzueshme pa u bërë ndonjë hulumtim për rrezikshmerinë dhe rivalizimin e sdaj për rifshryzim. Pjesa e te kazerma „Parku i qytetit“ është e mirembajtur dhe konsiderohët si mushkritë e qytetit të Hanit të Elezit dhe duhët të ruhët si e tille. Me hollesisht është hapsirat e paraqitura ne tabele të ndara ne hektarë.



Zona gjelbër	Ha
Hapësire e gjelbër private	41.67
Hapësire e gjelbër e padefinuar/AKP	15.82
Gjithsej	57.49

#### Zona sherbimeve


Zona e e sherbimeve ka hapsirë totale 4.66 hektarë; karakterizohet me dominim të hapsirës sportive rrëth 38%. Rreth 95% është hapsirë shkollore; 17 % zë hapsira e administratës lokale dhe 17% hapsirë kulti (xhamia) dhe vetem 3% është hapsirë shëndetsore. Me hollesisht është paraqitur ne tabele e ndare ne hektarë.



Zona e shërbimeve sociale	Ha
Shëndetësia	0.13
Arsimi	1.15
Administrata lokale	0.82
Religjioze (xhami)	0.8
Sportive	1.76
Gjithsej	4.66

#### Zonat tjera

Në hapsirën e ndarë si zona tjera janë ndarë hapsirat e lumit dhe perrojeve, hapsirat e rrugëve dhe hapsira e hekurudhës. Kjo zonët karakterizohet me dominim të hapsirës së lumit 45%. Rreth 35% është janë hapsirë e rrugëve duke përfshirë edhe magjstralen dhe 20 % është hapsirë e hekurudhës. Me hollesisht është paraqitur ne tabele e ndare ne hektarë.




Hapësira tjera	Ha
Lum	11.68
Hekurudhë	5.04
Rrugë	8.92
Gjithsej	25.64


## -Pronësia

Pronësia ne zonën urbane në Hani i Elezit grupohet në 4 kategori

- Prona private
- Prona komunale
- Prona shoqërore
- Prona e padefinuar e ish armates



Prona private	11348
Prona komunale	943
Prona shoqërore	2115
Prona nen AKP	1582
Gjithsej	15988



### 1.1.4 Trashëgimia kulturore dhe natyrore

Qyteza e Hanit të Elezit është krijuar vonë si vendbanim dhe nuk ka ndonjë trashëgimi shumë të vjetër, megjithatë janë disa ndërtesa të vjetra të cilat janë ndërtuar në kohën kur është ndërtuar fabrika. Këto ndërtesa shënojnë themelimin e vendbanimit dhe kanë vlerë për t'u konsideruar si trashëgimi e qytetës që duhet mbrojtur dhe përmirësuar gjendja e tyre. Gjithashtu edhe pjesa e vjetër e fabrikës së çimentos ka vlera të veçanta që duhet ruajtur dhe konservuar si trashëgimi industriale.

Për shkak të karakteristikave gjeografike të Hanit të Elezit, përveç trashëgimisë kulturore, trashëgimia natyrore reflekton bukurinë e Kosovës. Konfigurimi i terrenit, lumi Lepenc dhe peizazhet natyrore të kombinuara me ndërtesat tradicionale të banimit përfaqësojnë një vlerë të madhe që duhet trajtuar dhe mbrojtur.

## 1.2 Kushtet Socio Ekonomike


### 1.2.1 Popullsia dhe ekonomitë familjare

#### **Popullsia**

- Numri popullsisë

Sipas të dhënave të mbledhura<sup>1</sup> në terren për nevoja të planifikimit, popullata është vlerësuar të jetë 4019 banorë, të cilët janë 100% shqiptarë të Kosovës. Që nga themelimi i fabrikës së çimentos në vitin 1936, numri i popullsisë në Hanin e Elezit është rritur vazhdimisht. Pra zhvillimi industrial ka ndikuar në rritjen e popullsisë në zonën urbane (ardhjen nga komunat tjera si dhe në migrimin nga zona rurale në atë urbane).

Tabela në vijim paraqet rritjen e popullsisë gjatë viteve.




Grafika e më sipërme tregon numrin e banoreve për zonën kadatsrale të Hanit të Elezit nga viti 1948-1991 dhe gjithashtu numrin e popullsisë së zonës urbane pas themelimit të Hanit të Elezit si komunë. Pra zona

<sup>1</sup> Të dhënat në terren janë mbledhur në vitin 2009 nga komuna dhe UN-HABITAT-i saktësia e numrit mund të jetë 5% më e lartë apo më ulët

urbane përbehet nga zona kadastrale e Hanit të Elezit dhe një pjesë e zonës kadastrale të Seqishtes (Lagja e re) me rreth 1200 banorë e cila është përfshirë në zonën urbane pas caktimit të kufirit urban.

	Numri i popullsisë për çdo vendbanim dhe viti i regjistrimit						
	1948	1953	1961	1971	1981	1991	2009
<b>Zona Urbane</b>	<b>154</b>	<b>369</b>	<b>724</b>	<b>1324</b>	<b>2024</b>	<b>2374</b>	<b>4019</b>
<b>Gjithsej Komuna</b>	<b>3321</b>	<b>3722</b>	<b>4001</b>	<b>4693</b>	<b>6044</b>	<b>7029</b>	<b>10065</b>

- Shpërndarja e popullsisë neper grup moshë  
Shpërndarja e moshave në zonën urbane të Hanit e Elezit<sup>2</sup> është si në vijim: 30% e popullsisë është 0-5 vjeç; 7% janë 06-14 janë 22%; 15-18 vj. janë 10%; 19-64 janë 56% dhe vetëm 5% janë mbi moshën 65 vjeç.



- Dendësia e popullsisë  
Dendësia e popullsisë në zonën urbane është 2,527.67 banorë në 1 km<sup>2</sup> ose 25.27 banorë në hektarë. Dendësia më e madhe e popullsisë është në qendër të qytetës dhe përreth rrugëve kryesore në qytetë. Harta e dendësisë në popullsisë tregon koncentrimin e popullsisë dhe harta e shpërndarjes së popullsisë në hapësirën urbane tregon objektet me madhësinë e familjeve. Kjo duhet marrë parasysh gjatë planifikimit, zonimit të hapësirave të banimit sepse sipas traditës shumica e tyre ndërtojnë objekte në të ardhmen në parcelat përreth.



### **Papunësia dhe varfëria**

- Papunësia  
Papunësia është një nga çështjet më problematike me të cilat ballafaqohet shoqëria e Kosovës. Shkalla e papunësisë në Kosovë është 44,4%<sup>3</sup>. Nuk ka të dhëna në Han të Elezit që tregojnë statistikat e papunësisë pasi që nuk ka zyrë të punësimit, e cila ishte dashur të tregojë personat e papunë.

<sup>2</sup> Sondazhi i bërë në vitin 2009 nga Komuna e Hanit të Elezit dhe UN-HABITATI


<sup>3</sup> UNDP- Raporti i Zhvillimit Njerëzor 2004

Sipas sondazhit në terren dhe të dhënave nga ndërmarrjet në Hanin e Elezit, përqindja e papunësisë është 67%. Ka një numër të vogël të punësuarve në sektorin jo formal ekonomik. Megjithatë, nuk ka të dhëna të sakta pasi që të punësuarit në bizneset jo formale nuk janë të regjistruar.



**Shkalla e varfërisë** Burimi: Raporte komunale 2009

Duke u bazuar në të dhënat nga sondazhi në terren, 17% e popullsisë jeton në varfëri ekstreme merr të ardhura më pak se 60 cent për një ditë. 56 % e popullsisë merr të ardhura vetem 1 euro në ditë që është nën nivelin e varfërisë. Vlerësimi i varfërisë i Bankës Botërore thotë se 37 për qind e popullatës është klasifikuar si "e varfër", që merr të ardhura me më pak se 1.42 € në ditë. 15 % janë nën linjën e skajshme (ushqimore) varfërisë prej 0,93 € në ditë.<sup>4</sup>




Burimi: Plani Zhvillimor Komunal i Hanit te Elezit

<sup>4</sup><http://ëeb.ëorlbank.org/ËBSITE/EXTERNAL/COUNTRIES/ECAEXT/KOSOVOEXTN/0,,contentMDK:20665819~menuPK:297788~pagePK:141137~piPK:141127~theSitePK:297770,00.html>




Harta 4



- Migrimi popullore

Migrimi i popullsisë është një nga sfidat e që ka ndikim në çështjet demografike, kulturore, socio-ekonomike dhe politike.


Sipas të dhënave nga anketat në terren, në Han të Elezit ka një tendencë të migrimit nga zonat rurale ne zonën urbane. Grafiku i mëposhtëm tregon se si vendbanimet kanë ndryshuar për shkak të migrimit nga zonat rurale në zonën urbane.



Sipas të dhënave në terren del se ka edhe një tendencë e migrimit jashtë komunë apo edhe jashtë vendi nëse ju jepet rasti. Rreth 30% të rinjve të intervistuar përgjigjen se do të migrojnë po t'u jepet rasti



Harta 5



### 1.2.2 Mundësitë e biznesit

Janë gjithsej **tri kategori** të bizneseve në Han të Elezit. **Kategoria e parë** përbëhet nga fabrikat/ndërmarrjet të cilat më parë ishin shoqërore dhe tashmë janë privatizuar. Ekonomia e Hanit të Elezit është ende e bazuar kryesisht në këto tri kompani/ndërmarrje:

1. Kompania private Sharr Holding për prodhimin e çimentos
2. Kompania private për prodhimin e stiroporit - Kosovaplast;
3. Kompania private Sharr Sallonit – që ka prodhuar artikuj nga asbest çimentoja, por aktualisht ambientet e saj janë duke u përdorur si terminal doganor

Këto kompani janë shtylla kryesore e zhvillimit ekonomik të komunës dhe përfaqësojnë burimet kryesore për gjenerimin e fondeve për të kënaqur nevojat e banorëve.

Fabrika kryesore që ka bërë që Hani i Elezit të identifikohet si një vend industrial është **fabrika e çimentos "Sharri"**. Ajo është themeluar në vitin 1936 dhe kishte një zhvillim serioz të kapaciteteve në vitet 70 dhe 80 të shekullit të kaluar. Kjo është e vetmja në Kosovë në llojin e vet. Edhe pse kishte një proces të vazhdueshëm të punës që nga themelimi i saj deri më tani, duhet të përmendet se gjatë viteve 90 ajo ka pësuar rënie në prodhim dhe mirëmbajtje. Gjithashtu mirëmbajtja e dobët pas luftës ka rezultuar në probleme me makineri. Kjo ishte një nga arsytet që fabrika i ishte dhënë me koncesion një kompanie zvicerane Holcim dhe ju ndryshua emri në "Sharrcem". Ky gjendje e kësaj ndërmarrje vazhdoi deri më 2010 dhe rezultoi me investime të shumta përfshirë makineritë e linjës së prodhimit dhe objektet. Në dhjetor të vitit 2010 u bë edhe privatizimi i kësaj fabrike nga prodhuesi rajonal i çimentos "Titan Group", proces ky i cili ishte jo transparent dhe është ende i kontestuar nga qeveria lokale.

Gjatë gjithë periudhës së punës që nga themelimi, kapacitetet prodhuese kanë pasur një rritje serioze derisa ajo arriti maksimumin në vitin 1982, duke prodhuar më shumë se 550,000 ton çimento në vit. Deri pas luftës shkalla e prodhimit asnjëherë nuk ka arritur atë nivel përsëri. Por pas investimeve dhe aplikimit të teknologjive më të mira, në vitin 2009 ajo arriti nivelin e 600,000 ton në vit.

Nga të dhënat e marra nga "Sharrcem" mund të konkludohet se në Kosovë në vitin 2009 ishin shitur diçka më pak se 1.000.000 ton çimento (vlerat e përafërta: 300,000 ton janë importuar nga IRJM, 70,000 ton nga Serbia dhe 10,000 ton nga Shqipëria) dhe kjo do të thotë se vetëm 60% e nevojave të Kosovës për çimento janë plotësuar nga "Sharrcem".

Duke marrë në konsideratë që në Han të Elezit ka mjaft burime të vërtetuara natyrore të mergeles (lëndë e parë për prodhimin e çimentos), ngritja e kapaciteteve ekzistuese industriale për të përbushur të paktën e nevojat e Kosovës do të ishte një mundësi e mirë për zhvillim të mëtejshëm ekonomik dhe do të zvogëlonte seriozisht papunësinë. Programet dhe politikat më të mira zhvillimore, duke përfshirë doganat dhe dhënie të një hapësire më të madhe prodhimeve vendore, do të ndihmonte me të vërtetë në përballimin e këtyre sfidave.

Zhvillimi i industrive të tjera, si industria e ndërtimit, duhet të merret në konsideratë për shkak të faktit se Hani i Elezit dhe rajoni janë të njohura në lëmin e prodhimit të materialeve të ndërtimit. Një kompani serioze e ndërtimit e bazuar diku në rajon do të ndikonte në zhvillimin e përgjithshëm.

**Kosovaplast** është një rast i privatizimit të një fabrike relativisht të vogël që nuk e ka arritur ende kapacitetin maksimal prodhues. Aty prodhimi i materialit termoizolues vazhdon bëhet në mënyrë të ndërrprerje të kohë pas kohshme dhe pronarët e rinë janë duke planifikuar që në të ardhmen të arrijnë kapacitetin prodhues maksimal.

Hapësirat (dhe disa ndërtesa) të **Sharr Salonitit** janë duke u shfrytëzuar nga Doganat e Kosovës. Të gjitha ngarkesat që hyjnë në Kosovë nga kjo pikë kufitare ndalojnë aty derisa t'i përfundojnë të gjitha procedurat doganore në mënyrë që pastaj të shpërndahen mallrat nëpër Kosovë. Të punësuarit janë gjithashtu të përfshirë në shërbime të ndryshme për nevojat të Doganave të Kosovës si shkarkim/ngarkim i mallrave nga kamionët përderisa ato të kontrollohen nga shërbimi doganor, marrja e tarifave të parkimit për secilin kamion që ndalon aty, etj.

Është gjithashtu edhe një biznes i vogël i suksesshëm i prodhimeve të mishit në Lagjen e Re të Hani të Elezit.

**Kategoria e dytë** e bizneseve është e lidhur ngushtë me doganën dhe pikën kufitare. Këto biznese janë të vendosura në terminalin doganor ose afër pikës kufitare. Kryesori është laboratorit "Derivati" që bën kontrollin dhe analizat e të gjitha llojeve të karburanteve që hyjnë në Kosovë. Kjo bëhet për nevoja të nivelit qendror qeverisës. Janë gjithashtu edhe 49 firma shpedituese dhe 6 degë të bankave të ndryshme të cilat iu asistojnë importuesve që zhvillojnë biznesin e tyre dikund tjetër në Kosovë në kryerjen më të lehtë të punëve lidhur me protokollin doganor. Pra këto janë biznese që Hani i Elezit përfiton në mënyrë indirekte nga ta përmes tatimit në pronë ose mënyrave tjera (punësimi, shërbimet hotelierike, taxi, etj).

**Kategoria e tretë** ndahet në tri nënkategori.


**E para** përbëhet nga biznese lokale të cilat ofrojnë shërbime për njerëzit të cilët kalojnë nëpër magjistrale, ndalojnë në pikën kufitare dhe hyjnë në Kosovë. E gjithë kjo filloi me hapjen e pikës kufitare më 1991. Posaçërisht prej vitit 1999 shërbimet hotelierike (restorantet dhe kafenetë), shërbimet e taksive, tregtitë e vogla si dhe pompat e benzinës e intensifikuan aktivitetin e tyre si asnjëherë më parë.

**Grupi i dytë** përbëhet nga bizneset lokale që bëjnë tregtimin dhe transportin e çimentos dhe prodhimeve tjera të hanit të Elezit. Bizneset transportuese të hanit të Elezit kryesojnë me një zhvillim shumë të mirë. Firmat transportuese si "Ramuka", "Luri Trans", "Bajramaliu", "Alba Oil" dhe disa të tjera më të vogla posedojnë rreth 200 kamionë të ndryshëm. Puna e tyre kryesore ka të bëjë me transportin dhe shpërndarjen e çimentos dhe stiroporit nëpër Kosovë. Ato gjithashtu janë të përfshira edhe në transportin e çimentos dhe materialeve të ndryshme ndërtimore nga IRJM në Kosovë. Me një mbështetje të vogël këto firma mund të zhvillohen edhe në fushën e mundshme të ndërtimit ose tregtimin me materiale të ndërtimit, sepse ata janë në kontakt me shumë prodhues dhe kompani tregtare në rajon.

Dhe **grupi i tretë** përbëhet në të shumtën e rasteve nga biznese të vogla që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në qendrën e Qytetit ose te ura e Seçishtes në Lagjen e Re. Shumica e tyre janë biznese tregtare (shitore ushqimore, shitore këpucësh, shitore veshjesh, farmaci, shitore plaçkash, etj), biznese hotelierike (restorante, kuzhinë popullore, qebaptore, kafene, kafe çaji, internet kafe, etj), zeytari (zdrukthëtar, mekanik, floktar, artar/argjendar, furrë), biznese ndërtimi, shërbime të ndryshme (menaxhim i mbeturinave, kompani sigurimi, banka, auto shkollë, dentist, etj), etj. Këto biznese janë pronë dhe udhëhiqen nga qytetarë të Hanit të Elezit dhe kanë ndikim direkt në jetën e qytetarëve. Marrë në përgjithësi, bizneset e tanishme po përballen me shumë vështirësi. Burimet e financimit të tyre janë të hyrat e tyre vetanake, dhe një pjesë e tyre nga bankat kombëtare dhe ato që menaxhohen nga mbajtësit e aksioneve ndërkombëtare, me norma shumë të larta të interesit vjetor që sillen prej 12% deri 15%.

Por sfida më e madhe për zhvillim ekonomik të Hanit të Elezit është joshja e trafikut që kalon nëpër magjistralen Prishtinë-Shkup, hekurudhën Fushë Kosovë-Shkup dhe autostradën e re të planifikuar. Përmirësimi i trashëgimisë industriale dhe hapësirave publike në qytetin e Hanit të Elezit mund të jetë një mundësi për prezantimin e vlerave lokale në mënyrë që të bëjë dikë të ndalojë dhe të kalojë ca kohë në Han të Elezit.

**Bizneset joformale** – Pavarësisht nga struktura zyrtare e bizneseve e treguar më poshtë, ekzistojnë edhe një numër i bizneseve private që operojnë pa licencë regjistrimi si: elektrikistë, kompani të ndërtimit, floktarë, robaqepës, etj.



### 1.2.3.7 Resurset natyrore (nëntokësore)

Hani i Elezit është e pasur me burime natyrore, në veçanti me ato që përdoren për prodhimin e materialeve ndërtimore. Rezervat e verifikuara dhe të pa verifikuara të burimeve natyrore të lëndëve të para janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Emri	Lokacioni	Rezervat (ton)	Vërejtje
1	Mergelë për çimento	Hani i Elezit	13.438.260	Vërtetuar

## 1.3 Infrastruktura Fizike dhe urbane

### 1.3.1 Infrastruktura urbane

#### UJËSJELLËSI

Burimet e ujit të komunës së Hanit të Elezit janë të shumta, por mungesa e studimeve, planifikimit dhe financimit të mirë ka rezultuar me përdorim minimal të këtyre burimeve dhe ka shkaktuar një mungesë serioze në furnizimin me ujë të pijshëm për banorët.

Hani i Elezit, ka të instaluar një sistem të ujësjellësi nga burimet Gllloboqicës, i cili u ndërtua pas luftës. USAID-i ndihmoi në hartimin e projektit, ndërsa Sharrcem, UNHCR, Sharr-Sallonit dhe Kosovoplast kanë mbështetur zbatimin e projektit. Ky projekt kishte parashikuar furnizimin me maksimalisht 12L/sec ujë të pijshëm për qytetarët. Ky sistem furnizimi me ujë është i pari i këtij lloji në këtë zonë, i përdorur kryesisht nga banorët e Hanit të Elezit për qëllime përdorimi për amvisëri. Si rezultat i disa defekteve teknike dhe

keqadministrimit apo dështimit për të menaxhuar sistemin, në vitin 2006 u paraqit një ndotje e rëndë e sistemit të furnizimit me ujë. Kjo është treguar me analizat dhe rezultatet e bëra nga Instituti Rajonal për Shëndet Publik në Ferizaj.

Ekziston gjithashtu edhe një sistem i vjetër i furnizimit me ujë që funksionon në Han të Elezit. Ky sistem furnizimi me ujë ishte ndërtuar vetëm për përdorim nga Sharrcem dhe industritë e tjera. Por për shkak të urbanizimit të shpejtë të kësaj pjese dhe për shkak të mungesës së një sistemi alternativ të furnizimit me ujë për banorët, janë bërë lidhje të paligjshme të ekonomi familjareve në sistem. Këto lidhje u bënë të zakonshme me kalimin e kohës. Me ndërtimin e sistemit të furnizimit me ujë nga Gllloboçica, shumica e banorëve kanë bërë lidhje alternative në të dy sistemet. Si të tilla, dy sisteme të furnizimit me ujë funksionojnë për shërbim të banorëve në Han të Elezit. Në ndërkohë sistemi i vjetër nuk është mirëmbajtur si duhet dhe uji i përrrenjve hyn në tuba pa u trajtuar, sepse pajisjet e trajtimit janë dëmtuar. Duke u bazuar në këto fakte mund të konkludojmë se ndotja e sistemit të furnizimit me ujë në Han të Elezit kanë qenë në mënyrë të konsiderueshme për shkak të përzierjes fizike të dy sistemeve të furnizimit me ujë.

Gjatë çdo vere ka mungesë të sasisë së ujit të pijshëm, i cili është një aspekt shtesë që planifikimi i sistemit të furnizimit me ujë nuk ka kaluar nëpër të gjitha fazat e studimit të fizibilitetit. Keqpërdorimi i ujit është i dukshëm sidomos gjatë stinëve me mungesë uji.

Ne vitin 2010 është realizuar një projekt për rikonstruktimin e sistemit të vjetër të ujit të Dimcës. Është planifikuar që Hani i Elezit do të ketë një sasi prej 16L/sec të ujit shtesë nga ky projekt. Zona industriale do të ketë një sistem të veçantë me një sasi prej 2.0L/sec. Uji do të trajtohet në mënyrë të duhur dhe do të shpërndahet për ekonomi familjare nëpërmjet një rezervuari prej 250 m<sup>2</sup> dhe tubave të ujit prej 1700m. Tubacionet e ujit nga azbesti që kanë shpërndarë ujin e pijes janë zëvendësuar së fundmi gjatë shtrimit të rrugës së qytetit. Këta faktorë tregojnë se Hani i Elezit nuk do të ketë probleme të furnizimit me ujë në një të ardhme e afërt. Mirëmbajtja duhet të jetë detyra kryesore e administratës lokale duke përfshirë edhe Hanin e Elezit në Kompaninë e Ujësjellësit Rajonal ose duke gjetur zgjidhje të tjera për të plotësuar më mirë nevojat e banorëve.

Zona urbane është tërësisht e mbuluar me rrjetin e ujësjellësit por edhe pas përfundimit të projektit ne vitin 2010 akoma ka probleme me sasinë e ujit dhe kjo konsiderohet se vjen si rezultat i keqpërdorimit të ujit, mungesës së matësve të ujit dhe mungesës së mirëmbajtjes në përgjithësi. Gjithashtu ka edhe ankesa për prishjet e shpeshta të pompave të ujit. Ne janar të vitit 2011 Komuna ka bërë një hulumtim të burimeve ujore me qëllim të përmirësimit të gjendjes në të ardhmen.

#### KANALIZIMI

Ekziston një sistem i përbashkët i kanalizimit për pjesën më të madhe të qytetit të Hanit të Elezit. Mirëpo akoma ekziston një pjesë që kanë kanalizime individuale në lagjen Parku i qytetit përreth përroit të Dimcës në lagjen Ana e lumit dhe një pjesë të Lagjes afër kufirit. Këto lagje kanë kanalizime individuale dhe derdhin ujrën e zeza përgjatë lumit dhe përrrenjve. Edhe në pjesën ku ka kanalizim, rrjeti është i ndërtuar pjesë-pjesë dhe nuk është i studiuar siç duhet dhe po ashtu edhe ky kanalizim derdhet në lumin Lepenc pa asnjë lloj trajtimi. Nuk ekziston asnjë kompani publike apo private për të mirëmbajtur sistemin e ujërave të zeza në Hanin e Elezit. Është nevojë imediate themelimi i kompanisë dhe ndërtimi i sistemit të kanalizimit kolektiv për fshatrat dhe rinovimi i sistemit të ujërave të zeza në qytet..

#### MBETURINAT

Mbledhja e mbeturinave të ngurta paraqet një nga problemet më të mëdha në zonë. Ekzistojnë deponi ilegale në disa zona të qytetit. Një kompani lokale grumbullon mbeturinat, por performanca e saj varet nga shkalla e mbledhjes së pagesës nga qytetarët për këtë shërbim. Kjo është për shkak të faktit se administrata lokale është e kufizuar në bërjen e marrëveshjeve të kësaj natyre të shërbimeve, të cilat

mbesin shërbimet e vetme operacionale të licencuara nga niveli qendror i administratës e cila nuk e ka përfshirë Hanin e Elezit në fushat e saj të përgjegjësisë.

Kompania që ofron shërbimin e pjesshëm të këtij lloji është "Higjiena". Kompania filloi shërbimet e tyre në mars të vitit 2000 dhe ka qenë e licencuar nga administrata komunale e UNMIK-ut në tetor të vitit 2000 (Hani i Elezit ishte ende një pjesë e komunës së Kaçanikut). Edhe pse kompania ka ushtruar veprimtarinë e saj, asnjë pagesë nuk është bërë për këtë shërbim edhe pse shërbimi i grumbullimit të mbeturinave është ofruar për gati dhjetë vjet tashmë dhe vazhdon edhe më tutje në ndërtesën e administratës, qendrën kryesore të mjekësisë familjare, katër shkolla dhe te zjarrfikësit. Vetë kompania ka dy kamionë për mbeturina, një kamion për pastrim të rrugës dhe një kamion-cisternë të veçantë për zhblokimin e ujërave të zeza (vetëm për raste emergjente). Ka gjashtë punëtorë, duke përfshirë edhe pronarin.

Çmimi për mbledhjen e mbeturinave është 3 € / muaj ose 36 € / vit (në këtë rast ekonomitë familjare pajisen falas me kontenierë plastik me vëllim 120 litra). Shumica e qytetarëve përdorin qese plastike. Mbeturinat mblidhen katër herë në javë në qytet, pranë rrugës magjistrale dhe në lagjen afër lumit, dy herë në javë në Lagjen e Re dhe Secishtë, dhe vetëm një herë në javë në Paldenicë. Në vendbanimet tjera nuk ka mbledhje të mbeturinave nga kompania. Sipas raporteve të kompanisë, niveli i pagesave të mbledhura vlerësohet në 30%. Institucioneve tjera, si terminalit doganor, pikës doganore kufitare, stacionit të policisë kufitare, nënstationit të qytetit dhe fabrikës Sharrcem u janë ofruar vazhdimisht këto shërbime, duke filluar që nga fillimi i veprimtarisë së tyre pas luftës.

Mbeturinat e grumbulluara transportohen në depon rajonale të mbeturinave në Gjilan. Depoja faturon 6,5 euro për një ton mbeturina. Kompania ndërhyr në menaxhimin e ujërave të zeza vetëm kur paraqitet ndonjë një bllokim apo ndonjë problem tjetër.

#### FURNIZIMI ME ENERGJI ELEKTRIKE


Hani i Elezit dhe rrethina e saj merr furnizimin e saj me energji elektrike drejtpërdrejtë nga Bibaj-Ferizaj nëpërmjet një linje 110/6 kë. Gjendja e furnizimit me rrymë elektrike është më mirë se sa në komunat tjera të Kosovës. Rrjeti i shpërndarjes së energjisë elektrike është relativisht i vjetër dhe paraqet një problem të madh gjatë sezonit të dimrit.

#### TELEKOMUNIKACIONI

Sistemi i telekomunikacionit nuk ka funksionuar për banorët e Hanit të Elezit. Në të kaluarën linjat telefonike kanë qenë në dispozicion vetëm për ish-ndërmarrjet në pronësi shoqërore. Sinjalet e telefonisë mobile të dy kompanive ekzistuese mbulojnë territorin e Hanit të Elezit. Çmimet nuk janë konkurruese, por janë e vetmja mundësi ekzistuese për banorët e Kosovës. Sistemi i telefonisë mobile të IRJM-së është duke u përdorur për shkak të afërsisë të territorit me kufirin. Së fundi, në Han të Elezit janë kryer punë për instalimin e një sistemi telefonik digjital dhe të internetit. Qendra e qytetit, industria dhe doganat janë aktualisht të përfshira me këtë shërbim.



Harta 6



### 1.3.2 Rrugët, transporti dhe lëvizshmëria


#### INFRASTRUKTURA E RRUGORE (RRJETI)

Në qytezen e Hanit të Elezit ekzistojnë dy linja rrugore të rëndësishme. E para dhe më me rëndësi për Kosovën dhe sidomos për Hanin e Elezit është rruga magjistrale Prishtinë-Shkup. Linja tjetër është hekurudha Fushë Kosovë-Shkup. Këto dy rrugë kanë një rëndësi të madhe dhe e bëjnë Hanin e Elezit një vend kyç që lidh Kosovën dhe Maqedoninë. Rruga që lidh qytezën e Hanit të Elezit dhe vendbanimin e Gllloboçicë është gjithashtu me rëndësi të madhe, dhe pasi që ajo lidh dy vendkalimet kryesore kufitare midis Kosovës dhe Maqedonisë.

Në vetë Hanin e Elezit, rrugët kryesore që kalojnë nëpër qendër të qytetit janë relativisht të gjera dhe në gjendje të mirë. Këto rrugë kanë trotuare të duhura për këmbësorë dhe kanalizime atmosferike. Janë edhe disa rrugë tjera të ngushta në rrethinë që kërkojnë zgjerim dhe përmirësime tjera thelbësore. Rruga kryesore që kalon nëpër Hanin e Elezit është rruga magjistrale, me një gjatësi prej **2.1km**.

Në qytezën e Hanit të Elezit kemi një total prej 13.56 km, të cilat janë të menaxhuara nga komuna, 4.8 km rrugë janë të asfaltuara ose të shtruara me kubza betoni. Të gjitha rrugët tjera ekzistuese janë të pashtuara. Gjithashtu ekziston edhe një rrugë që shfrytëzohet vetëm për këmbësorë, e lidh lagjen e me shkollën fillore dhe të mesme. Gjendja e saj është e mirë e shtruar me kubza betoni. Rruga ka gardh të sigurisë përgjatë hekurudhës por vende gardhi është i dëmtuar. Kalimi i hekurudhës për këmbësorë behët me mbi kalim që ekziston afër stacionit të trenit. Në dimër ka vështirësi për shkak të borës dhe akullit që krijohet në shkallët e mbikalimit.


Para dy vitesh në gjithë qendrën e qytetit është instaluar ndriçimi i rrugës. Megjithatë, të gjitha rrugët tjera nuk kanë ndriçim rrugor.



Infrastruktura fizike	Km
Autostrade e planifikuar	2.329
Hekurudhe	2.404
Magjistrale	2.112
Rruge kryesore shpërndarëse	7.294
Rruge lidhëse	0.68
Rruge fundore	4.98
Rruge për këmbësore	0.61



Harta 7



## Transporti dhe mobiliteti

Distancat e Hanit të Elezit me qytetet tjera më të afërta dhe kryeqytetin janë: Prishtina 72km, Kaçaniku 12km, Shkupi 20 km.

### - Transporti hekurudhor i ushtarëve

Linja e hekurudhës tani është pjesë e hekurudhës Fushë Kosovë - Shkup. Kjo trase është shumë e rëndësishme për zhvillimin e transportit të njerëzve dhe të mallrave për komunën dhe rajonin. Hekurudha brenda territorit i Hanit të Elezit është e gjatë **2.4 km**. Për momentin oraret e trenave janë organizuar në mënyrë të tillë që treni udhëton vetëm një herë në ditë në Shkup dhe anasjelltas. Dy vjet më parë treni ka udhëtuar dy herë në ditë, por për shkak se numri i udhëtarëve ka qenë i vogël, Hekurudhat e Kosovës vendosën që të zvogëlojë frekuencën e shërbimit. Por shërbimet e trenit nga Fushë Kosova në Han të Elezit dhe anasjelltas janë tri herë në ditë. Treni arrin herët në mëngjes në Han të Elezit në ora 05:40 dhe kthehet në ora 06:00. Treni i ardhshëm arrin në 07:14 dhe pasi kontrollohet vazhdon për në Shkup. Kur kthehet, nga Hani i Elezit nisat në ora 11:00. Treni i pasdites arrin në Han të Elezit në ora 15:25 dhe prej aty nisat në ora 16:50. Treni i fundit arrin në Han të Elezit në 20:27 dhe prej aty nisat në ora 20:45. Zyrtarisht shërbimet e trenit janë mënyra e vetme e transportit publik në Han të Elezit. Qytetarët që punojnë apo studiojnë jashtë Hanit të Elezit përdorin linjat e transportit të përmendura më lartë

### - Transporti Hekurudhor i mallrave

Stacioni i trenit në Hanin e Elezit është stacioni kryesor për shkarkimin e mallrave që vijnë nga jashtë Kosovës, të destinuara për rajonet e Ferizajit, Gjilanit dhe një pjese të Prishtinës. Kjo hekurudhë është e vetmja që lidh Kosovën me Maqedoninë dhe fakti që dy të tretat e të ardhurave të Kosovës janë nga Maqedonia e tregon rëndësinë e tij. Rajonet tjera shfrytëzojnë stacionin e trenit në Fushë Kosovë. Pasi që Doganat dhe Policia Kufitare e Kosovës ndërtoan ndërtesën e tyre administrative afër stacionit të trenit në Han të Elezit, ka plane që çdo gjë, duke filluar nga shërbimet doganore, kontrolli policor, shërbimet e shpeditonit, shkarkimit nga vagonët, ngarkimi në kamion, deri te shpërndarja e mallrave në tërë Kosovën, do të kryhet në këtë pikë. Planifikimi i ardhshëm na tregon se Kosova së shpejti do të fillojë të eksportojë mallrat jashtë Kosovës, me Hanin e Elezit si pikë kryesore kufitare.

### - Transporti rrugor i udhëtarëve

Hani i Elezit është një vend i lidhur mirë përmes transportit rajonal kalon nëpër qendër të qytetit. Autobusët që udhëtojnë nga Prishtina në Shkup, nga Prizreni në Shkup dhe anasjelltas janë një mundësi e mirë për transportin e udhëtarëve, por jo të gjithë këta autobusë ndalojnë për të marrë qytetarët që dëshirojnë të shkojnë në destinimi e përmendura dhe më tej.

Bashkëpunimi në mes të ndërmarrjeve të transportit, ministrisë së transportit dhe komunës është shumë i rëndësishëm për të siguruar që disa nga këta autobusë që udhëtojnë nëpër komunë të ketë të paktën një ndalesë në Hanin e Elezit. Transporti për ne vendbanimet rurale bëhet me minibus (furgonë) për nxënës dhe qytetarët, por kjo nuk është e mjaftueshme. Gjithashtu për nxënësit që shkojnë në shkollë në Kaçanik është një problematikë pasi që në orarin e mëngjesit nuk ka asnjë autobus me orar të përshtatshëm për ta.

Në vijim është paraqitur orari i furgonëve:

Nisja nga Goranca	06.00	07.30	09.00	12.00	14.15	16.00	18.10	22.00
Nisja nga Hani i Elezit	07.00		11.15	13.30	15.15	16.30	19.30	23.00

- Kjo firmë transporti ka tre furgonë për nevojat e mësipërme.

### **Tabela e orarit të furgonëve – Fatlumi Tours**

Nisja nga Kriveniku	07.30	09.30
Nisja nga Hani i Elezit	14.00	12.30

- kjo firmë transporti ka vetëm një furgon për nevojat e mësipërme.
- kolona e hijezuar është vetëm për të mërkurën - dita e tregut në Han të Elezit
  - Shërbimet e taksive

Shërbimet e taksive janë shumë të zhvilluara në këtë zonë për shkak të afërsisë me pikën kufitare. Ka 28 taksistë të regjistruar në Han të Elezit dhe ata përdorin hapësirën e parkingut afër pikës kufitare. Çmimet e shërbimeve të taksive nuk janë të caktuara dhe ato mund të ndryshojnë nga koha në kohë. Qytetarët gjithashtu përdorin automjetet private për transport. Ka gjithsej 534 automjete të regjistruara nga Hani i Elezit.

- Lidhjet ajrore

Aeroporti i Prishtinës është 95 km larg nga Hani i Elezit kurse ai i Shkupit në Maqedoni, është 54 km larg nga Hani i Elezit

- Parkingjet

Në qendër të qytetit ka hapësira parkimi, por nuk janë të mjaftueshme për të plotësuar nevojat e banorëve, sidomos pasi që Hani i Elezit u shndërrua në një zonë urbane.

## 1.4 Mjedisi

### 1.4.1 Mbrojtja e mjedisit dhe degradimi

Hani i Elezit është një vend me zhvillim të shquar industrial. Dy fabrika të njohura në këtë zonë janë fabrika e çimentos "Sharrcem", fabrika e Stiroporit "Kosovaplast" si dhe fabrika e asbest çimentos "Sharr Salanit" e cila ka vepruar deri në vitet e 90ta, që ka ndikuar në ndotjen e mjedisit. Tani për tani objektet e fabrikës së asbest çimentos janë duke u përdorur si terminal doganor, derisa dy fabrikat tjera ende punojnë me kapacitetet e tyre normale.

Pasojat negative të Hanit të Elezit, si vend i zhvilluar industrial, është se ka ndotje të gjerë. Ndotja është e pranishme në tokë, ajër, ujë, zhurmë (në sasi më të vogël) dhe ndikimin në peizazh për shkak të shfrytëzimit të pasurive natyrore. Me faktin që Hani i Elezit kishte interes ekonomik dhe social, që nga hapja e fabrikës së çimentos në vitin 1936, u konsiderua si "pikë të nxehtë" e Kosovës nga aspekti i ndotjes. Përkundër përmirësimit të teknologjisë në fabrikën e çimentos, ndotja është ende evidente dhe efektet e viteve të rënda të ndotjes janë ende shihen në mjedis. Ekzistenca e fabrikës për prodhimin e asbest çimentos ka kontribuar shumë në ndotje, gjë që është e dukshme në të gjitha fushat. Asbest çimentoja është përdorur shumë në të gjitha format e saj, për mbulimin e çative, tuba të ujit dhe elemente tjera në të gjitha llojet e ndërtesave dhe vende tjera publike. Çështje tjetër është popullata, që ishte në kontakt të drejtpërdrejtë me asbestin e palidhur.

Ndikimi i industrisë në mjedis mund të tregohet përmes ndikimit në ajër, ujë dhe sipërfaqen e tokës, ndikimit nga zhurma, mbetjet industriale dhe ndikimi në peizazh nga mineralet e përdorura.

### Ndotja e ajrit

Ajri ishte dhe është ende dukshëm i ndotur në Han të Elezit, me gjithë përmirësimeve të vogla që janë bërë që nga viti 1999. Nuk ekzistojnë të dhëna të monitorimit për periudhën e paraluftës ashtu që të mund të krahasohen me të dhënat e sotme. KFOR-i grek mori disa të dhëna të ndotjes së ajrit në vitin 2000 në atë kohë kur Fabrika Sharrcem ishte në kulmin e rindërtimit të saj. Të dhënat tregojnë një për qëndrim të lartë të depozitave të pluhurit me 700mg/m<sup>2</sup> në ditë, një vlerë që është shumë më e lartë se sa vlera e lejuar në zonat industriale si ajo është Hani i Elezit (360mg/m<sup>2</sup> në ditë).

Përveç pluhurit, veprimtaritë industriale (më së shumti fabrika e çimentos) lëshojnë dioksid karbonit (CO<sub>2</sub>), dioksid squfuri (SO<sub>2</sub>) dhe dioksid azoti (NO<sub>x</sub>). Këta ndotës në Han të Elezit kontrollohen vetëm nëpërmjet matjeve të vetë Fabrikës Sharrcem, e cila është edhe ndotësi kryesor në këtë aspekt. Ndotja e ajrit me veçoritë e gazrave të lartpërmendura për vitet 2003-2007, tregon standardet vijuese të zbatuara në Kosovë si është treguar më poshtë

Ndotës	Njesia	2003	2004	2005	2006	2007	2008	Vlera lejuar
--------	--------	------	------	------	------	------	------	--------------

<b>Pluhur</b>	MG/Nm <sub>3</sub>	250	108	120	100	60	78	<b>50</b>
<b>SO<sub>2</sub></b>	MG/Nm <sub>3</sub>	470	420	350	350	182	235	<b>400</b>
<b>NO<sub>x</sub></b>	MG/Nm <sub>3</sub>	820	548	590	580	564	608	<b>800</b>



Fig-3 Fabrika e çimentos

### Ndotja e ujit

Ndotja e ujit në lumin Lepenc dhe rrjedhat e saj nga mbeturinat e pa trajtuara të sistemit të ujërave të zeza, e kombinuar me ndotjen kimike nga industria e rëndë në këtë regjion, ndikon në ndotjen e përgjithshme në Han të Elezit. Në Planin Hapësinor të Kosovës, ndotja e lumit Lepenc rangohet në kategorinë "IIa" nga "IV" kategoritë. Bazuar në studimet e fundit dhe të dhënat nga aspekti kimik dhe bakteriologjik, cilësia e lumit Lepenc bie nën kategorinë e katërt të ujit, bazuar në standardet e cilësisë së ujit. Natyrisht që Hani i Elezit ka ndikimin e saj në këtë proces të ndotjes.





Fig-4 Derdhja e ujerave të zeza në lumin Lepenc

### **Ndotja e dheut**

Ekziston një rrezik i madh i shkaktuar nga grumbullimi i mbeturinave të ngurta dhe mbetjet toksike kancerogjene nga prodhimet e asbest çimentos, të cilat mund të shihen përgjatë brigjeve të lumit në gjithë zonën. Hedhja e pakontrolluar e mbetjeve të ngurta, shfrytëzimi i paligjshëm i lëndëve të para për prodhimin e çimentos, mosmirëmbajtja e rrjedhave të përrenjve, mungesa e zonës së gjelbër në mes të zonës industriale dhe pjesëve tjera të qytetit etj, gjithashtu kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme në ndotjen e përgjithshme në Han të Elezit.




Fig-5. Mbetja e mbeturinave të azbestit përgjatë bregut të lumit Lepenc

### **Ndotja akustike**

Hani i Elezit gjendet ngjitur rrugës kryesore Prishtinë-Shkup dhe hekurudhës Fushë Kosovës-Shkup, e cila kalon përmes qytetit. Gjithashtu edhe fabrika e çimentos me minierën e saj, prej ku lëndët e para eksploatohen për prodhim, gurorja afër vendbanimit në Kashan, (lagja e Paldenicës) dhe gurorja në Seçishtë janë ndotës me zhurmë.



Harta 8



## 1.4.2 Fatkeqësitë natyrore dhe të shkaktuara nga njerëzit

### Vërshimet

Komuna e Hani i Elezit shtrihet përgjatë lumit Lepenc. Në hartën e Kosovës për sa i përket vërshimeve, Hani i Elezit nuk është konsideruar si një zonë me vërshime; në Planin Hapësinor të Kosovës, drafti i vitit 2005, dëmet më të mëdha të shkaktuara nga vërshimet përgjatë pellgut të Lepencit janë 20%<sup>5</sup>. Sipas një hulumtimi në terren, ka informacione se në vitin 1979 ka pasur vërshime në "Lagja e Ranave". Gjithashtu kemi vërshime çdo vjet në lagjen e re në Seqishtë. Këto vërshime vjetore janë shkaktuar si rezultat i shkrirjes së borës dhe shiu i madh gjatë stinëve me të reshura. Kapaciteti i kanaleve nëntokësore (uji i përroit të Rezhancës që kalon përmes Lagjes së Re është i futur ne gypa) është shumë e ulët në mënyrë që të përballen me sasinë e ujit gjatë shkrirjes borë dhe sezonet e me shi.



Fig-6 Lumi Lepenc

### Rrëshqitja e dheut

Në përgjithësi rrëshqitja e tokës nuk konsiderohet rrezik i lartë, pasi që shumica e zonës është e mbuluar me pyje; dhe përbërja e tokës nuk është e ndjeshme ndaj rrëshqitjes të tokës. Megjithatë, analiza nga hulumtimi në terren tregon se ka pasur rrëshqitje toke përgjatë rrugës magjistrale. Këto zona kanë nevojë për ndërhyrje në mënyrë që të zvogëlohet rreziku i rrëshqitjes së tokës.

Për më tepër, ekziston rreziku potencial i rrëshqitjes së tokës në Paldenicë, përgjatë rrugës magjistrale, kjo rrëshqitje toke është shkaktuar nga ndërhyrjet e njeriut me gërmime në rastin e ndërtimeve të objekteve.

### Tërmetet, tektonika dhe sizmika

Kosova gjendet në një rajon me aktivitete të lartë sizmike, pra brenda zonës aktive në pikëpamje sizmike të brezit orogjenik Alpine-Himalaja. Regjistrimet nga e kaluara tregojnë se Kosova i është ekspozuar aktiviteteve tektonike vertikale në strukturat e rendit të parë dhe të dytë dhe ka përjetuar afërsisht 82 tërmete që kalojnë intensitetin prej 5 gradë të shkallës së Mercali-Cancani-Siebergut (MCS). Nga këto, 25 kanë qenë me intensitet 7 apo më shumë, 13 me intensitet 8 apo më shumë, 3 me intensitet 9 apo më

<sup>5</sup> Plani Hapësinor i Kosovës, Draft 2005 f65

shumë<sup>6</sup>. Seizmika e këtij regjioni është e kontrolluar nga tërmetet që kanë origjinën nga Vardari (Ferizaj: Kaçanik-Viti-Gjilan, Shkup/MK dhe Kumanovë/MK). Tërmetet më të forta nga burimet autoktone seizmike që kanë ndodhur në zonën sizmike të Ferizajt janë ai i Kaçanikut (1755,  $I_0 = IX^0$  MSK-64), Vitisë (1921,  $M = 6,2$ ,  $I_0 = IX^0$  MSK-64) dhe Gjilanit (Zhegër, 1921,  $V = 5,3$ ,  $I_0 = VIII^0$  MSK-64).

Sipas të dhënave historike, tërmeti në Kaçanik i vitit 1755 solli shkatërrim me përhapje të gjerë në vendbanimet e Kosovës dhe jugut të Serbisë, duke përfshirë edhe vendbanimet në veri të Maqedonisë.

Tërmeti në Viti i vitit 1921 ( $M = 6.2$ ), solli shkatërrim me përhapje të gjerë në rajonin e Vitisë dhe rajonin në veri të Shkupit (ku është manifestuar me intensitet  $I = IX^0$  MSK-64). U shkatërruan shumë shtëpi dhe prona tjera materiale. Janë regjistruar çarje në sipërfaqe, disa nga burimet ekzistuese të ujit janë tharë dhe janë shfaqur burime të reja të ujit. Shembje të pjesshme dhe dëme të rënda janë raportuar në Gjilan dhe Kaçanik ( $I_0 = VIII^0$  MSK-64)

Sipas hartave sizmike të Kosovës, territori i Hanit të Elezit gjendet në shkallën VII dhe VIII të MSK-së. Prandaj është shumë me rëndësi të merret parasysh struktura e ndërtesave, të cilat janë ndërtuar para zbatimit të kodit të ndërtimit. Prandaj, që nga viti 1945 kemi tre periudha karakteristike në zbatimin e kodeve të ndryshme të ndërtimit dhe dizajnit sizmik (KDS), të cilat janë paraqitur në tabelën vijuese:

**Dizajni sizmik dhe periudha ndërtimit**

Periudha ndërtimit		Kodi ndërtimit
	para 1948	Nr i kodit
I	(1948 - 1964)	Dispozitat teknike të përkohshme për objektet publike (Kodi PTP-2)
II	(1964 - 1981)	Dispozitat teknike të përkohshme për objektet për regjionet sizmike (Kodi SDC-1964)
III	1981 – deri tani	Rregulloret teknike për projektim dhe konstruktim të objekteve në regjionet sizmike (Kodi SDC-1981)

Burimi: Raporti per UN-HABITAT, M. Milutinovic, IZIIS Skopje

## Zjarret

Territori i qytezës së Hanit të elezit është luginë më jo shumë pyje përveç dy zonave të gjelbra: Parku i qytetit dhe zona te cisternat mbi magjistrale.

## Erozioni

Zona e qytezës nuk është kodrinore dhe nuk gjendet në zonën me intenzitet të dobët në Harten e erozionit të Kosovës<sup>7</sup>

<sup>6</sup> Elezaj & Hasani, 2002

<sup>7</sup> Plani Hapsinor i Kosovës (draft 2010-2020)



## 1.5 Infrastruktura sociale

### 1.5.1 Shëndetësia dhe shërbimet

Sektori i shëndetit publik dhe i objekteve shëndetësore në komunë ka qenë i menaxhuar nga Departamenti i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale që nga janari i vitit 2009<sup>8</sup>. Më parë, objekti i Qendrës së Mjekësisë Familjare i Hanit të Elezit ishte nën menaxhimin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Kaçanik dhe ka funksionuar si degë e saj. Banorët e komunës është dashur të udhëtojnë në Kaçanik në mënyrë që të marrin disa nga shërbimet shëndetësore të kujdesit familjar posaçërisht në rastet emergjente. Kur Hani i Elezit u bë komunë pilot në vitin 2005 dhe pas përpjekjeve të shumta të Qeverisë Lokale, në korrik të vitit 2009 QMF-ja e atëhershme u ngrit në kapacitetet e QKMF-së, në të cilat kapacitete vazhdon të operojë edhe tani dhe është në përpjekje të ngritë edhe më.

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare e Hanit të Elezit aktualisht menaxhohet nga 28 të punësuar. Qendra ka dhjetë dhoma në të cilën ka një recepcion/njësi për menaxhim, dy ordinanca (njëra përdoret vetëm për dokumente), një dentist, një njësi të kujdesit emergjent, një dhomë për infuzion me dy krevate, një njësi për vaksinim, një njësi për kujdesin e lëndimeve dhe një kuzhinë të vogël për stafin. Përveç kësaj, ajo ka aneksin që përbëhet nga dy dhoma e cila shërben si laborator dhe një aneks tjetër të adoptuar në kabinet rëntgeni. Rreth 147 pacientë vizitojnë qendrën brenda 24 orëve. Qendra ofron shërbimet e përgjithshme mjekësore, shërbimet e dentistit, shërbimet e vaksinimit, shërbimet e laboratorike dhe shërbimet emergjente (referohu tabelës vijuese të personelit mjekësor dhe organogramit).

E vetmja ambulancë në dispozicion (Gorancë) është duke punuar për momentin vetëm tre ditë në javë, dhe komuna është duke shikuar mundësinë që ta vejë objektin në dispozicion të përditshëm. Sikur të komunat e tjera, qendra shërben si objekt i kujdesit primar shëndetësor. Përveç sektorit publik, ka qendra mjekësore private, ku kemi në dispozicion shërbimet primare në fusha të specializuara.

Qendra e kujdesit primar shëndetësor furnizohet çdo muaj nga Ministria e Shëndetësisë me barna dhe pajisjet e nevojshme.


Gjendja aktuale e Qendrës Primare të mjekësisë familjare

No	Pozita	Nr I personelit
1	Drejtor	1
2	Doktor i mjekësisë	5
3	Dentist	1
4	Infermier	1
5	Infermierë/shoferë	4
6	Infermierë/teknik	10
7	Teknik laborator	1
8	Teknik vaksinues	2
9	Shofer	1
10	Mirëmbajtës	2

<sup>8</sup> Drejtorati i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale është themeluar në janar të vitit 2009. Para kësaj periudhe, ky sektor ishte nën administrimin e Drejtorisë së Arsimit dhe Shëndetësisë

Numri mesatar i pacientëve në vit në Han të Elezit është 53,724 ose 147 në 24 orë. Raporti i mjekëve në dispozicion në 1000 banorë është 0.59; për infermiere është 1.49 në 1000 banorë, dentistë 0.099 në 1000 banorë, teknik laborantë 0.099 në 1000 banorë dhe teknikë të vaksinimit 0,19 në 1000 banorë. Janë vetëm 7 shtretër apo 0.69 shtretër në 1000 banorë.<sup>9</sup>

Në Kosovë, raporti mesatar i mjekëve është 0.94 në 1000 banorë, 2.61 infermiere dhe 0.06 dentistë në 1000 banorë. Numri i shtretërve në 1000 banorë është 1.43. Ky raport konsiderohet shumë i ulët në krahasim me vendet fqinje sidomos çka i përket numrit të mjekëve dhe shtretërve<sup>10</sup>.



(Tabela tregon raportin mjek/infermiere për numer banori në nivel komunal)

\*Burimi: Plani zhvillimor komunal, Hani i Elezit

Në bazë të Ligjit për Shëndetësi nr. 2004/4 kujdesi primar shëndetësor duhet të jetë i përbërë nga personeli vijues: mjeku, dentisti, specialisti për kujdes të shëndetit familjar, magjstri i farmacisë, pediatri, gjinekologu, specialisti i bio-kimisë klinike dhe infermieret dhe teknikët mjekësor. Në pajtim me kërkesat e ligjit, qendrës së kujdesit primar shëndetësor në Han të Elezit i mungon ky staf profesional: specialisti për kujdesin e shëndetit familjar, magjstri i farmacisë, pediatri, gjinekologu, specialisti i bio-kimisë klinike.

Madhësia e ndërtesës së QKMF-së është vetëm 400m<sup>2</sup>. Nuk ka hapësirë të mjaftueshme për dhomë e urgjencës. Duke u bazuar në nevojat e qytetarëve, komuna ka planifikuar të ndërtojë 350m<sup>2</sup> hapësira shtesë ngjitur me ndërtesën ekzistuese, e cila do të shërbejë për nevoja emergjente dhe të tjera.

### 1.5.2 Edukimi

Në qytezen e Hanit të Elezit është vetëm një shkollë fillore dhe një shkollë e mesme.

Shkolla fillore "Ilaz Thaçi" në Han të Elezit është shkolla kryesore dhe më e madhe. Ky institucion ka filluar aktivitetin në vitin 1946. Bazuar në dokumentacionin e vjetër, në vitin 1949/50 ka pasur 16 nxënës në klasën e dytë. Gjithë mësimdhënësit e asaj kohe ishin nga vendet tjera. Analfabetizmi ishte në nivelin më të lartë. Janë organizuar klasa të veçanta dhe trajnime në mënyrë që ti mësojnë shkrim-lexim njerëzit që ishin të moshës madhore por që nuk mund të shkonin në shkollë në proces të rregullt. Procesi i mësimor u mbajt madje edhe në xhami. Në vitin 1957 shkolla përfshiu në procesin e të mësuarit edhe klasat 5 - 8. Para kësaj, shkolla kishte vetëm klasat 1 - 4. Nga viti 1985 aktiviteti filloi në objektin e sotëm (të ri) të shkollës.

<sup>9</sup> Drejtorati për shëndetësi, Hani i Elezit

<sup>10</sup> Strategjia për shëndetësi e vitit 2009

Aktualisht objekti i shkollës është në gjendje relativisht të mirë. Ka një oborr me dimensione të kënaqshme dhe është plotësisht i rrethuar. Fusha e jashtme sportive ka nevojë për tu shtruar dhe për disa ulëse për spektatorë. Problemi kryesor është mungesa e një palestre të shkollës. Ndërtimi i një objekti për këto nevoja nuk duhet të jetë problem duke pasur parasysh faktin se oborri ka hapësirë të mjaftueshme për të akomoduar atë.

Shkolla kryesore punon me dy ndërrime (paralelet e ndara punojnë në një ndërrim). Nxënësit e klasave të para të këtij institucioni mësojnë brenda hapësirave të shkollës së mesme. Kjo shkollë është qendrore për paralelet e ndara në Seçishte, Krivenik, Pustenic dhe lagjen Laç. Nevojiten edhe përmirësime të fushave të jashtme sportive.

Shkolla e mesme në Han të Elezit është relativisht e re. E njëjta ishte pjesë e shkollës së mesme të Kaçanikut deri në vitin 1996, kur u bë e pavarur dhe u quajt "Dardania" në vitin 1997. Para luftës, aktiviteti arsimor u zhvillua nëpër "shkolla-shtëpi" dhe që nga viti 1999 u vendosën në disa baraka. Kushtet nuk ishin as afër optimale. Përfundimisht në vitin 2005 u zhvendos në një ndërtesë të re të ndërtuar. Edhe pse ndërtesa është e re, nuk ka palestër sportive. Procesi arsimor zhvillohet vetëm në një turn. Struktura e mësimi është e ndarë në katër degë. Ka degën e shkencave natyrore, shkencave sociale, matematikë-informatikë dhe instalimeve elektrike. Oborri është i vogël për nga madhësia. Ka një fushë të shtruar të volejbollit dhe një shteg të shtruar për këmbësorë, me një fushë futbollit në pjesën e pasme. Oborr i është i rrethuar me një gardh metalik. Ka 457 nxënës, 19 mësues dhe 3 punëtorë të stafit.

Tabela e mëposhtme tregon të dhënat për shkollën fillore dhe të mesme të ulët si dhe për shkollën e mesme që gjenden në zonën urbane:

Shkolla	Parafillore	Nr nx	Nr arsimtarëve	Stafi ndihmës	Klasët	Fushë sporti	Gardh rrethues
Shkolla fillore "Ilaz Thaci" Hani i Elezit	2	1093	45	10	14	po	po
Shkolla mesme "Dardania" Hani i Elezit	0	457	19	3	14	po	po
<b>Gjithsej</b>	<b>2</b>	<b>1,145</b>	<b>64</b>	<b>13</b>	<b>28</b>		

#### Arsimi parashkollor

##### Kopshtet (mosha 0-3)

Sipas standardeve ndërkombëtare, në 400-700 banorë duhet të ketë 1 grup me 7-10 fëmijë. Qyteza e Hanit të Elezit ka 4,019 banorë, por nuk ka ndonjë kopsht /çerdhe për fëmijë.

##### Arsimi parashkollor për fëmijët e moshës 3-6

Në Han të Elezit ka vetëm 4 klasa për nxënësit parashkollor. Sipas Ligjit për arsimin parashkollor neni 2.4 i njëjti nuk është i detyruar. Ky nivel mund të organizohet së bashku me shkollën fillore.

##### Shkollat fillore dhe të mesme të nivelit të ultë (klasa 1-9)

Tabela e mësipërme tregon se 3 shkollat kryesore fillore dhe shkolla e mesme e kanë hapësirën e jashtme për aktivitete sportive, por nuk kanë asnjë lloj hapësire/objekti të brendshëm për aktivitetet sportive.

Raporti nxënës-mësimdhënës në Han të Elezit është 22.40<sup>11</sup>, derisa në Kosovë niveli është 18.34 nxënës për një mësues. Sipas raportit të arsimit nga statistikat e Kosovës, Hani i Elezit ka vendin e parë me raportin më të lartë të nxënësve për mësues në Kosovë. Raporti është mbi mesataren e vendosur nga formula e shtetit për përcaktimin e granteve të arsimit. Numri mesatar i nxënësve për një klasë në shkollat fillore është 30.15, derisa në nivel të Kosovës është 23.97. Hapësira shkollore për një nxënës në shkollën fillore në Han të Elezit është 2.19m<sup>2</sup>. Standardi i Kosovës është 2m<sup>2</sup> për një nxënës në klasë. Zona e mbulimit për shkollën fillore është brenda standardeve.

#### Shkolla e mesme (10-12)

Në shkollë të mesme raporti i nxënësve për një mësues në Han të Elezit është 21.2, derisa në nivel të Kosovës janë 20.1 nxënës për një mësues.

Numri mesatar i nxënësve në një klasë në shkollën e mesme në Han të Elezit është 33.50, derisa mesatarja e Kosovës është 31.65 dhe sipas udhëzimit administrativ nr 18/2009 numri mesatar i nxënësve në një klasë duhet të jetë 32 nxënës. Numri i nxënësve për një klasë në bazë të formulës së shtetit duhet të jetë 32 nxënës në një klasë për gjimnaz, ndërsa 17 nxënës në klasë për shkollat profesionale.

Sipas anketës dhe raporteve të shqyrtuara, Hani i Elezit mban vendin e parë me raportin më të madh të nxënësve për një mësues dhe gjithashtu raportin më të lartë të nxënësve për një klasë në krahasim me komunat tjera në Kosovë dhe kjo është mbi mesataren e Kosovës. Hapësira shkollore për një nxënës në shkollën e mesme është 4.30m<sup>2</sup><sup>12</sup>. Standardi i Kosovës është 2m<sup>2</sup> për nxënës në klasë.

Raporti i mësuesve i ndarë sipas gjinisë në nivel të Kosovës është 39% femra dhe 61% meshkuj derisa në Han të Elezit kemi 34% femra dhe 66% meshkuj. Këto të dhëna tregojnë se përqindja e mësuesve femra në Han të Elezit është më e ulët se sa në nivel të Kosovës.

61% e mësimdhënësve janë të kualifikuar derisa 13% janë mësues me diploma me kualifikim të ndryshëm, të cilat konsiderohen jo adekuate për mësimdhënien e lëndëve të veçanta. 26% nuk janë të kualifikuar (janë pa diplomë universitare)

Në të gjitha shkollat hapësirat sportive kanë nevojë për përmirësim. Gjithashtu në të gjitha shkollat ekziston një mungesë e kabineteve.

#### - Siguria e nxënësve ne trafik dhe lëvizshmëria

Shkolla fillore e mesme e ulet dhe mesme e lartë gjendet ne qendër të zonës urbane. Shumica e lagjeve përreth nga zona Lagja e Parkut, Lagja te kufiri dhe nga zonat rurale të anës së lindore të magjistrales kalojnë për çdo ditë kalojnë magjistralen. Pjesa nga zona rurale Pustenic uji i tharte dhe lagja Ranave udhëtojnë nga shtëpia ne shkollë dhe anasjelltas përgjatë magjistrales. Nga Lagja uji i thartë deri te shkolla është trotuari për këmbësorë por gjatë dimrit dhe ne kohërat me shi mblidhet uji në ndërmjet magjistrales dhe trotuarit gje qe paraqet rrezik për këmbësoret. Gjithashtu edhe vendkalimet nuk janë të mirëmbajtura rralle ka vendkalime te shënuara. Fëmijët që vijnë nga Lagja e re dhe zona rurale ne pjesën perëndimore të hekurudhës kalojnë hekurudhën me një mbikalim shumë të pa përshtatshëm.

Shënimi i vendkalimeve ne magjistrale, drenazhimi për largimin e ujit përgjatë magjistrales dhe krijimi i barrierave do të zvogëlonte rrezikshmërinë potenciale për nxënësit ne trafik gjate udhëtimit. Një nënkallim do të përmirësonte sigurinë e nxënësve dhe qytetarëve në përgjithësi.

<sup>11</sup> Statistika e arsimit në Kosovë 2008-2009

<sup>12</sup> Drejtoria e arsimit në Han të Elezit

### 1.5.3 Kultura dhe sporti

Hani i Elezit, me karakteristikat e një vendbanimi të vogël, nuk ka pasur zhvillime autentike kulturore dhe sportive deri në vitin 1974. Ka pasur një ndërtesë të ndërtuar gjatë viteve pesëdhjetë të shekullit të fundit, në formë të një teatri ku janë mbajtur shfaqjet e filmave dhe aktivitetet tjera. Megjithatë, e njehta është përdorur kryesisht për propagandë komuniste. Ndërtesa e teatrit ende ekziston me një shtesë që është ndërtuar më vonë.

Shoqëria kulturore artistike "Sharri" është themeluar në vitin 1974 dhe ka qenë pjesë e konsorciumit industrial "Sharri". Shoqëria është marrë kryesisht me muzikë popullore dhe e tërë jeta kulturore ishte e organizuar rreth saj. Aktivitetet janë mbajtur brenda ndërtesës së Kulturës (ndërtesa e vjetër e teatrit). Deri në vitin 1989 ka pasur shumë aktivitete dhe shumë individë u promovuan në këngëtarë, instrumentistë dhe aktivistë tjerë kulturorë. Për momentin kjo shoqëri është shumë aktive. Çdo vit ata mbajnë mesatarisht nëntë koncerte dhe aktivitete tjera me së paku një jashtë Kosovës. Vitin e kaluar ka pasur edhe një ekspozitë të artit figurativ që është mbajtur brenda ndërtesës së kulturës.

Sporti është gjithashtu një aktivitet i ri në Han të Elezit. Klubi i futbollit "Sharri" është themeluar në vitin 1973. Para kësaj nuk ka pasur fusha të futbollit dhe është luajtur në Kaçanik. Pas luftës është ndërtuar një fushë e re të futbollit në Han të Elezit. Aktualisht nuk është stadium, por përbëhet nga një fushë e thjeshtë e rrethuar dhe pa ulëse për spektatorë. Klubi bën pjesë në ligën e parë të Kosovës. Klubi i mundjes "Sharri" është themeluar në vitin 1989. Ky klub ka pasur sukseset e tij dhe ende e përfaqëson me dinjitet Hanin e Elezit. Në kampionatin e ish Jugosllavisë, ata fituan trembëdhjetë medalje (dy medalje ari, tetë argjendi dhe tre bronzi), në kampionatin e Kosovës, ata fituan 61 medalje (16 ari, 22 argjendi dhe 23 bronzi), dhe në kampionatin botëror nën moshën 18 ata fituan një medalje të argjendtë. Individë të këtij klubi u bënë katër herë kampionë të Kosovës.

Për momentin nuk ka stadium as salle sportive për aktivitete sportive. Ne përgjithësi vlerësohet mungesa e ambienteve dhe hapësirave sportive duke konsideruar numrin e popullsisë në Han të Elezit.

### 1.5.4 Hapësirat publike

Qyteti i Hanit të Elezit ka disa hapësira publike të cilat gjenden në zonën urbane; shumica e këtyre hapësirave nuk janë të përdorura si duhet. Ka edhe tokë të pa definuar publike (për shembull, prona ish-ushtarake). Këto toka janë menaxhuar nga ana e komunës, për më tepër, çështja e pronës në lidhje me këto toka të pa definuara ende nuk është përcaktuar. Ka disa hapësira publike në zonën kryesore urbane rreth ndërtesës së komunës. Këto hapësira publike janë një potencial për krijimin e hapësirave të gjelbra publike.

Në përgjithësi janë disa prona publike; megjithatë, është sfidë për komunën e Hanit të Elezit për të zgjidhur problemin e pronës në lidhje me çështjen e atyre pronave ish-ushtarake, të cilat janë të vendosura në tri sipërfaqe të veçanta brenda zonës urbane.

Gjatë procesit të hartimit të PZHK-së është identifikuar hapsira publike në qendër të qytetit dhe është hartuar projekti për rregullimin e hapësirave publike. I cili projekt është duke u implementuar me bashkëfinancim të Komunës së Hanit të Elezit dhe "MuSPP" (Programit për Mbeshtetje të Komunave në Planifikimin Hapësiror) i cili implementohet nga UN-HABITAT-I dhe financohet nga Sida suedeze.

## **1.6 Banimi dhe kushtet e jetesës**

### **1.6.1 Fondi i banesave dhe ambienti i jetës**

Sipas të dhënave në terren të mbledhura nga komuna dhe UN-HABITAT-i, komuna e Hanit të Elezit ka 4019 banorë. Në qytezen e Hanit të Elezit ka 973 ndërtesa.

Shtëpitë individuale dominojnë madje edhe në zonën urbane; 97.7% janë shtëpi individuale dhe vetëm 2.3% shtëpi kolektive. Madhësia mesatare e familjeve në zonën rurale është 6.77 anëtare për familje kurse në zonën urbane është 6.32 anëtare për familje. Kjo tregon një trend të zvogëlimit të familjeve shumë anëtaresh.

Pas vitit 1999, një numër i konsiderueshëm i banorëve ka migruar nga zonat rurale në zonat urbane me qëllim të gjetjes së kushteve më të mira për jetesë.

Në zonën urbane ka disa ndërtesa kolektive që gjenden në qendër dhe të cilat janë ndërtuar gjatë periudhës kur fabrika e çimentos kishte filluar veprimtarinë. Gjendja e këtyre ndërtesave kolektive nuk është e përshtatshme dhe të njëjtat nuk janë mirëmbajtur mirë.

Në përgjithësi, 97% e ndërtesave janë të ndërtuara me materiale të forta (kombinim i betonit të armuar dhe tullave); megjithatë, nuk ekziston ndonjë rregullore rigoroze e ndërtimit që aplikohet pasi që ndërtesat nuk janë ndërtuar në bazë të lejeve të ndërtimit. Kushtet e ndërtesave të ndërtuara së fundi janë pak a shumë të njëjta si në zonat rurale ashtu edhe në ato urbane. Një numër i konsiderueshëm i shtëpive janë duke u ndërtuar pa asnjë leje ndërtimi.

### **1.6.2 Vendbanimet joformale**

Pas analizave të bëra gjatë procesit të hartimit të Planit Zhvillimor Urban në qytezën e Hanit të Elezit nuk ka vendbanim joformal të identifikuar.

## **1.7. Analiza e gjendjes urbane**

### **1.7.1.a Morfologjia e terrenit**

Lokacioni gjeografik i cili përkon me zonën urbane të Hanit të Elezit është kryesisht sipërfaqe e rrafshët me përjashtim të një paralagje (pjesë e Lagjes së Re) që është sipërfaqe kodrinore. Pas përfundimit të Grykës së Kaçanikut te vendi i quajtur “Uji I Thartë”, lumi Lepenc vazhdon të rrjedh më në jug nëpër ultësirë. Në vendin e quajtur “Dheu i Bardhë” (pika fillestare e zonës urbane) kjo ultësirë fillon të bëhet më e gjerë dhe vazhdon në këtë mënyrë deri në kufi (pika përfundimtare e zonës urbane) dhe më tej në jug. Qyteti i Hanit të Elezit gjendet mu në këtë pjesë. Shikuar gjeografikisht, kjo ultësirë si pjesë e luginës së Lepencit, fillon të bëhet më e gjerë në vendin ku dy përrenjtë kryesore (Përroi i Rezhancës nga perëndimi dhe përroi i Dimcës nga lindja) derdhen në lumin Lepenc. Përrenjtë e tjerë më të vegjël si përroi i Seçishtës, përroi i Konopit dhe përroi i Dheut të Bardhë derdhen në Lepenc përfaqësisht në të njëjtin vend. Në parim një luginë e madhe lumi zgjerohet me bashkimin e luginave tjera të vogla duke krijuar kështu kushte për zhvillim të një vendbanimi\*.

Në përgjithësi të dy anët e luginës kanë pjerrtësi të lehtë në drejtim të lumit. Pjesa lindore e luginës ka sipërfaqe më të madhe. Kjo ndikoi në ndërtimin e rrugëve të rëndësishme, industrisë dhe më vonë edhe të vet qytetit. Pjesa perëndimore e luginës tradicionalisht është shfrytëzuar më shumë për bujqësi.

Në të dy anët perëndimore dhe lindore kemi Malet e larta të Sharrit respektivisht Malet e Karadakut.

\* Në librin “Vendbanimet e Kaçanikut” të Dr. Jusuf Selmanit shkruhet se fshati Seçishtë më herët ishte i vendosur ngjitur me Lumin në anën perëndimore të ultësirës (Lagjen e Re të sotme), por për arsye të sigurisë banorët u zhvendosën më në thellësi të luginës së përroit të Seçishtes.



### 1.7.1. b Tipologjia e hapësirave

Zona urbane e Hanit të Elezit karakterizohet nga disa tipe të hapësirave. Kjo larmi hapësirash është rezultat i zhvillimeve historike, lokacionit gjeografik si luginë lumi në mes të dy masiveve malore, infrastrukturave rrugore të ndryshme, ekzistenca e mineraleve dhe zhvillimit industrial, etj.

Qendra e Qytetit është në përgjithësi sipërfaqe e rrafshët më një pjerrtësi të lehtë në kah perëndimi drejt lumit. Me fillimin e aktiviteteve industriale kjo sipërfaqe filloi të popullohet së pari më ndërtesat shoqërore të banimit shumëkatësh e më vonë edhe me shtëpi të veçanta individuale. Duke pasur lidhje të mira me hekurudhën në perëndim dhe më rrugën kryesore në lindje, kjo sipërfaqe vazhdoi të popullohet dhe zhvillohet edhe më duke u bërë qendër për fshatrat përreth. Sot qendra e Qytetit karakterizohet më së shumti me hapësirë banimi me hapësira afariste në përdhës të ndërtesave rreth rrugëve kryesore ose me oborre të gjelbra në brendësi të lagjeve. Këto oborre janë zakonisht të vogla në formë të kopshteve (bashqeve) por nganjëherë janë më të mëdha dhe janë të organizuara në formë të livadheve. Oborret në të shumtën e rasteve janë të rrethuara me mure të larta. Kjo lloj rrethoje (muri i lartë) në të shumtën e rasteve është mbetje tradicionale që më herët kishte të bënte me nevojën për siguri më të lartë si dhe me traditën fetare. Dhe vetëm 2.2% e popullatës urbane jeton në banesat shumëkatëshe të vendosura në qendrën e qytetit. Përqindja tjetër e hapësirave banuese shfrytëzohet për banim individual. Janë gjithashtu edhe disa hapësira të gjelbra në pronën e ish ushtrisë dhe disa hapësira publike mu në qendër të Qytetit.

Hapësirat banuese në lindje të magjistrales dhe afër kufirit në jug kanë karakteristika të njëjta si në qendër të Qytetit duke qenë të organizuara si sipërfaqe të banimit individual me oborre të gjelbra dhe rrugë e nganjëherë edhe livadhe/ara rreth tyre. Kjo pjesë e Qytetit gjithashtu ka dy hapësira relativisht të mëdha, krahasuar me madhësinë e zonës urbane, mbuluar me lisa dhe elemente tjera gjelbëruese. Këto prona ishin të ushtrisë dhe sot kontrollohen përmes Rezolutës 1244 të Kombeve të Bashkuara.

Tipi tjetër i hapësirave brenda zonës urbane të Hanit të Elezit janë hapësirat industriale. Këto hapësira janë gjithashtu karakteristike sepse zhvillimet në këtë pjesë ndikuan drejtpërdrejtë në zhvillimin e Hanit të Elezit si vendbanim e më vonë si qendër për fshatrat përreth. Hapësirat industriale përfshijnë diku gjysmën e zonës urbane dhe ndahen në dy pjesë: prodhimi industrial dhe minierat. Përmbajtja e kësaj hapësire është cilësuar si zhvillues shumë i rëndësishëm ekonomik dhe në të njëjtën kohë si gjenerator i ndotjes dhe degradimit të ambientit në përgjithësi. Nënndarja e parë është më së shumti si sipërfaqe e ndërtuar industriale me sipërfaqet e tjera të domosdoshme si rrugë, parkingje, hapësira të gjelbra (jo të mirëmbajtura), etj. Kurse nënndarja e dytë është në tërësi e organizuar si mihje sipërfaqësore e mergeles, si lëndë e parë për prodhimin e çimentos. Përderisa sipërfaqet e prodhimit industrial janë tërësisht të mbuluara nga pluhuri i shtresuar nëpër shumë vite të ndotjes që pati ndikim në tërë vendbanimin dhe disa vendbanime përreth; hapësira e minierës paraqet shembullin më domethënës të degradimit të mjedisit natyror. Gjatë viteve të mihjes e tërë sipërfaqja perëndimore kodrës afër kufirit është shndërruar në një minierë të madhe sipërfaqësore dhe krejt kjo është bërë pa ndërmarrë asnjë hap drejt regjenerimit mjedisor të atyre hapësirave që nuk përdoren më. Përkundrazi disa sipërfaqe janë shitur dhe për momentin kemi hapësira të vogla të biznesit (stacion karburanti) dhe shtëpi private. Në përgjithësi këto hapësira të përkujtojnë shkretëtirat Meksikane në filmat western.

Ndotja e ajrit e cila u përmend më lart është një çështje mjedisore shumë esenciale në Han të Elezit. E gjithë hapësira e qendrës së Qytetit dhe matanë magjistrales është ndikuar nga ndotja gjashtëdhjetë e


pesë vjeçare e ajrit. Pullazet e shtëpive janë “ngjyrosur” me të hirtë përgjatë viteve. Edhe tani ndotja vazhdon (posaçërisht pas privatizimi të fabrikës së çimentos).

Disa pjesë të hapësirave industriale janë në shfrytëzim të terminalit doganor dhe nevojave tjera të pikës kufitare.

Tipi i tretë i hapësirave përfshin Lagjen e Re dhe Anëlum. Ky tip përfaqëson hapësirat që dikur ishin ekskluzivisht bujqësore të cilave më vonë iu ndryshua destinimi i shfrytëzimit të tyre në shfrytëzim të përzier bujqësor dhe banues. Hapësira tanimë karakterizohet me shtëpi të vogla afër arave ose në disa raste livadheve. Ky tip përfaqëson shembullin e zhvillimit të pakontrolluar të një hapësire të pastër bujqësore në hapësirë ku banimi (në disa raste me afarizëm) është shtuar më vonë. Është e rëndësishme të përmendet se ritmi i ndërrimit të shfrytëzimit të tokës nga bujqësia në shfrytëzim tjetër është në vazhdim e sipër në të njëjtin intensitet që ka ndodhur edhe më parë.

Madhësia e parcelave është e ndryshme pasi që Hani i Elezit ka qene një vendbanim rural dhe këto parcela janë shfrytëzuar dhe akoma shfrytëzohen për bujqësi. Dominojnë parcelat me madhësi 11-15, 16-20 dhe 21-30 ari. Shumica e tyre kane forme te parregullta dhe gjatësore. Nuk kane qasje te drejtpërdrejte ne rruge. Kjo është një sfidë për komunën për rregullimin e këtyre parcelave gjatë hartimit të planeve rregulluese urbane.

Harta 9



### 1.7.1.c Tipologjia e ndërtimeve

Në zonën urbane të Hanit të Elezit ekzistojnë lloje të ndryshme të ndërtesave në vareshmëri të materialit ndërtimor të përdorur dhe stilit të ndërtimit. Tipi më i vjetër përfaqëson grupin e shtëpive, stallave dhe të vet Hanit që ishin të ndërtuara nga guri. Këto objekte janë ndërtuar duke përdorur gurin e papërpunuar ose në disa raste të gjysmëpërpunuar (zakonisht të marrë afër lumit) të lidhur mes vete me baltë. Gurët janë zgjedhur ose përpunuar vetëm kur përdoreshin në kënde muresh ose për ndonjë qëllim tjetër të caktuar. Muret prej gurëve kishin gjithashtu edhe elemente horizontale druri në lartësi të caktuara. Kulmi ishte nga konstruksioni i drurit. Mbulesa e kulmeve bëhej me tjegullat e ashtuquajtura terakota (tjegullat e vjetra me një lug). Objekte si këto kanë qenë ndërtuar në qendrën e Qytetit dhe matanë magjistrales. Sot ekzistojnë vetëm disa raste të këtyre objekteve dhe fatkeqësisht Hani nuk përfshihet në këtë grup.

Tipi tjetër i objekteve janë ato të ndërtuara nga tullat e argjilës. Shembuj nga kjo kemi pjesën e vjetër të fabrikës së çimentos (ndërtesat me lartësi mesatare dhe oxhaqet e mëdhenj), të gjitha banesat shumëkatëshe dhe disa raste të shtëpive individuale. Materiali lidhës ishte llaçi i çimentos dhe llaçi vazhdues. Pllakat e ndërkatit ishin nga druri ose betoni. Kulmet ishin nga konstruksioni i drurit të mbuluara me tjegulla të zakonshme argjile. Fasadat ishin me llaç (çimentoje ose të vazhduar). Dyert dhe dritaret ishin nga druri.

Pjesa e vjetër e fabrikës së çimentos dhe banesat trekatëshe të banimit të ndërtuara me tulla përfaqësojnë identitetin e vërtetë të hapësirave të ndërtuara në Han të Elezit sepse këtu filloi ngritja dhe zhvillimi i këtij vendbanimi. Sot ky tip i ndërtesave mbetet vetëm 2% nga e tëra hapësirë e ndërtuar në zonën urbane të Hanit të Elezit.

Tipi më i përhapur i ndërtesave janë ato të ndërtuara nga struktura e betonit të armuar (vertikale dhe horizontale). Hapësira brenda ndërtesave rrethohet dhe ndahet me mure me blloka argjile. Pllakat në të shumtën e rasteve janë gjysëm-montazhë dhe përbëhen nga materiali mbushëses me blloka të argjilës dhe struktura e betonit të armuar. Janë edhe raste kur pllakat janë komplet nga betoni i armuar posaçërisht kur objekti nuk ka destinim banimin. Kulmet mbesin në të shumtën e rasteve nga konstruksioni i drurit të mbuluara me tjegulla të zakonshme argjile përveç në rastet e ndërtesave industriale apo publike të mbuluara me pllaka të llamarinës së valëzuar ose kulm të rrafshët të izoluar. Brenda grupit të këtyre ndërtesave përdoren materiale të ndryshme në fasadë, suvatim të brendshëm, strukturë dhe mbulesë kulmi, tipe të ndryshme të dyerve dhe dritareve, etj. Shembuj të këtij grupi janë shumica e shtëpive ekzistuese, objekteve të biznesit, objektet publike, e tërë pjesa e re industriale dhe ndërtesat speciale për nevoja të ushtrisë si bunkerët, depot e municionit, rezervuarët e karburantit, garazhet e automjeteve ushtarake, etj.

I gjithë varieteti i këtij grupi ndërtesash përbëjnë rreth 98 % të sipërfaqes së ndërtuar urbane.

Janë gjithashtu edhe disa shembuj të tipeve të tjera të ndërtesave për kërkesa speciale si barakat nga konstruksioni i drurit për nevoja të ushtrisë, barakat/depot nga konstruksioni metalik për nevoja të industrisë, etj.


Varësisht nga destinimi janë këto tipe të ndërtesave: shtëpi banim individual / ndërtesa banimi shumëkatësh, ndërtesa banimi përzier me afarizëm, ndërtesa afariste, ndërtesa publike, ndërtesa industriale dhe ndërtesa ushtarake.

#### **1.7.1.d Ndarja e tokës, nëndarja dhe standardet e shfrytëzuara për ndarje**

Varësisht nga lokacioni dhe elementet gjeografike, zhvillimeve historike, zhvillimeve ekonomike, lidhjet e infrastrukturës rrugore, ekzistenca e pikës kufitare, mundësitë e reja të biznesit, zgjerimi i mundshëm i zonës urbane, zonat kadastrale, menaxhimi më i lehtë i tokës, ofrimi i shërbimeve sa më të mira për qytetarët, etj; zona urbane e Hanit të Elezit ndahet në njësitë urbane të mëposhtme. Ndarja poashtu është bazuar edhe në ndarjet fizike të krijuara sikurse: Industria, Magjistranja, Hekurudha, Lumi Lepenc etj.




Harta 10






## Njësia 1 – Qendra e Qytetit

Kjo njësi paraqet bërthamën kryesore të vendbanimit. Përmban në vete ndërtesën komunale, sheshin e Qytetit me hapësirat publike, shkollën fillore dhe të mesme, qendrën kryesore të mjekësisë familjare, stacionin hekurudhor, stacionin policor, shërbimin e zjarrfikësve, xhaminë e re, shumë biznese, banimin (individual dhe shumëkatësh) dhe hapësirat e ish ushtrisë të cilat menaxhohen për momentin nga qeveria komunale. Hapësira e kësaj njësie shtrihet në mes të hekurudhës dhe magjistrales në perëndim dhe lindje, fillon në vendin ku këto dy elemente infrastrukturore gjarpërojnë ngjitur me njëra tjetrën në veri (vendi i quajtur “Dheu i Bardhë”), përderisa fabrika e çimentos paraqet kufirin jugor. Ka sipërfaqe prej 22 hektarësh. Janë gjithsej 16 ha sipërfaqe e ndërtuar dhe 6 ha sipërfaqe e lire. Dendësia e popullsisë është 69.31 banorë në ha. Qendra e Qytetit karakterizohet me zhvillime historike sepse këtu filluan edhe zhvillimet e para me Hanin, stacionin e trenit dhe më vonë edhe shtëpitë dhe bizneset e para. Është gjithashtu edhe pjesë e rëndësishme sepse si Qendër është e lidhur ngushtë me zhvillimet në të ardhmen si qendër urbane dhe komunale. Ndërtesat e para shumëkatëshe ngjitur me fabrikën e çimentos janë shumë elemente të rëndësishme të trashëgimisë industriale dhe traditave të banimit në Qytet. Pronat e ish ushtrisë janë gjithashtu pjesë të rëndësishme të qendrës së Qytetit. Këto janë hapësirat e vetme të mundshme që do të mundë të shfrytëzoheshin për zgjerimin dhe absorbimin nevojave tjera hapësinore drejt një zhvillimi të mirëfilltë urban.




Harta 11



## Njësia 2 – Lagja e Parkut

Kjo Lagje është e vendosur në lindje të magjistrales, në vendin ku kalojnë rrugët lokale për Pladenicë dhe Dimcë. Përroi i Dimcës kalon për midis të saj. Është në përgjithësi e organizuar në shtëpi individuale dhe përmban xhaminë e vjetër të Qytetit. Ka qenë pjesë përbërëse e njësisë së qendrës para se të ndërtohej magjistranja kështu që ka lidhje të forta infrastrukturore dhe shërbyese me të. Për arsye të nevojave dhe zhvillimeve të reja kësaj hapësire iu kanë bashkangjitur edhe dy sipërfaqe të ish ushtrisë si pjesë përbërëse urbane. Këto sipërfaqe mund të jenë si hapësira të reja të gjelbra urbane (park) si pjesë të domosdoshme të qendrës së ardhme urbane dhe njëherazi të ndikojë në neutralizimin e faktit se Hani i Elezit është vend me ndotje industriale. Hapësira ka 24 hektarë dhe nga ta 18 hektarë janë hapësirë e ndërtuar dhe 6 hektarë hapësirë e lire. Dendësia e popullsisë është 31.54 banorë në ha.




Harta 12




### Njësia 3 – Zona Industriale

Është e vendosur në jug të dy njësive të lartpërmendura dhe shtrihet deri në pikën kufitare. Hekurudha është kufi perëndimor përveç te hapësirat e fabrikës së stiroporit. Kjo fabrikë zgjatet edhe përtej lumit në perëndim. Hapësira përfshin 25 hektarë. 21 hektarë janë sipërfaqe e ndërtuar dhe miniera dhe 4 ha është sipërfaqe e lire. Përbëhet nga fabrika e çimentos me sipërfaqen industriale dhe të minierës, fabrika e stiroporti dhe terminali doganor. Kjo pjesë e Hani të Elezit ka luajtur rol vendimtarë në zhvillimin e tij deri më tani dhe është paraparë të ketë këtë rol edhe në të ardhmen. Të gjitha fabrikat ishin shoqërore por tashmë janë privatizuar. Pjesa e vjetër e fabrikës së çimentos do të mundë të shfrytëzohej si trashëgimi industriale bashkë me banesat trekatëshe afër saj, në mënyrë që Hani i Elezit të ketë më shumë hapësira shoqërore, banim kualitativ dhe krejt kjo do të ishte në të mirë të drejtpërdrejtë të qytetarëve. Por e tërë kjo është e lidhur ngushtë me përmirësimet në teknologjinë industriale dhe reduktimin e ndotjes që po ndodh për momentin.






Harta 13




#### Njësia 4 – Anëlumi

Kjo është sipërfaqja e populluar më së voni. Shtrihet në mes të hekurudhës dhe lumit Lepenc duke filluar nga “Ura e Fezës” në veri deri të fabrika e stiroporit në jug. Ka qenë shfrytëzuar për bujqësi/lavërtari por tani është e përzier me banim individual. Edhe sot ka shumë raste të veprimtarive bujqësore tradicionale familjare në formë të kopshteve (pemë ose perime), arave ose livadheve të vogla. Karakteristikë tjetër e kësaj hapësire është se autostrada e planifikuar Prishtinë – Shkup e cila është planifikuar të ndërtohet viteve të ardhshme do të kalojë përmes saj.

Hapësira e përgjithshme është 12 hektarë përderisa 8 hektarë janë hapësirë e ndërtuar dhe 4 hektarë hapësirë e lirë. Dendësia e popullsisë është 37.91 banorë në ha.



Harta 14



## Njësia 5 – Lagja e Re


Kjo nënndarje ka më shumë karakteristika të gërshetuara me njëra tjetrën. E gjitha sipërfaqja mbulon hapësirën urbane e cila shtrihet në perëndim të lumit Lepenc. Bashkë me Anëllumin, e gjithë hapësira është shfrytëzuar dhe ka qenë e njohur për toka dhe produkte bujqësore kualitative. Kushtet e përshtatshme klimatike bënin të mundur edhe mbjelljen e dy kulturave në vit. Kjo vazhdoi me shekuj deri në vitet e shtatëdhjeta dhe tetëdhjeta të shekullit të kaluar kur filluan të “mbijnë” shtëpitë individuale. Menaxhimi jo i mirë i tokës dhe mungesa e tokës ndërtimore ishin arsytet e paraqitjes së kësaj dukurie. Si njëra nga njësitë më të mëdha brenda zonës urbane sot kjo hapësirë është e organizuar me rrugë të ngushta, shtëpi individuale me kopshte, ara ose livadhe. Oborret janë zakonisht të rrethuar me mure të larta duke e bërë rigën edhe më të vështirë për tu kaluar në disa raste. Mes përmes Lagjen e përshkon përroi i Rezhancës i cili është futur në gypa, por ndonjëherë gjatë sezonës së vërshimeve sasia e ujit rritet dhe rrjedh nëpër rrugën kryesore të Lagjes.

Ekzistojnë ende disa hapësira të shfrytëzuara vetëm për bujqësi (ngjitur me lumin) që meritojnë trajtim më të mirë gjatë planifikimit.


E gjithë sipërfaqja ka nevojë për menaxhim më të mirë të tokës sepse ndërtimi ilegal në toka bujqësore dhe keq shfrytëzimi në forma tjera i këtyre tokave vazhdon ende. Programet e duhura që do ti mbështesnin bizneset e vogla bujqësore gjithashtu do të mundë ta ndryshonin gjendjen për të mirë.

Hapësira nuk ndikohet fare nga ndotja për shkak të rrymave të ajrit që e përshkojnë luginën e Lepencit.

Sipërfaqja totale është 35 hektarë përderisa sipërfaqja e ndërtuar është 21 hektarë dhe 14 hektarë hapësirë e lirë. Dendësia e popullsisë është 34.65 banorë në ha.



Harta 15






## Njësia 6 – Lagja e Kufirit

Kjo Lagje gjendet në mes të kufirit, terminalit doganor në veri dhe lumit Lepenc në perëndim. Është gjithashtu perzierje në mes të bujqësisë dhe banimit por ndotja është e evidentë. Tokë më e mirë bujqësore gjendet afër lumit.

Sipërfaqja e përgjithshme është 13 hektarë kurse 3 hektarë është sipërfaqe e ndërtuar dhe 11 hektarë është hapësirë e lirë. Dendësia e popullsisë është 4.92 banorë në ha.



Harta 16



### **1.7.1.e Sistemi i rrjetit rrugor dhe klasifikimi i tij**

Dy arteriet kryesore rrugore janë magjistranja Prishtinë – Shkup dhe hekurudha Fushë Kosovë – Shkup. Këto dy rrugë vijnë nga veriu përmes luginës së Lepencit, fillojnë të largohen nga njëra tjetra te “Dheu i Bradhë” dhe gati bashkohen përsëri në kufi. Stacioni hekurudhor dhe terminal doganor janë nje të rëndësishme infrastrukturore të cilat gjenden në zonën urbane. Në mes të ketër dy rrugëve gjendet qendra e Qyteti dhe zona industriale.

Nga magjistranja në lindje ndahen dy rrugë lokale për Paldenicë dhe Dimcë. Përreth këtyre dy rrugëve dhe ngjitur me magjistrale shtrihet Lagja e Parkut. Asnjëra nga rrugët nuk është e asfaltuar por që të dyja janë të shtruara me zhavorr.

Nga magjistranja në perëndim, afër pikës kufitare ndahet rruga lokale deri te Ura e Seçishtës. Nga kjo ure që njëherit edhe është udhëkryq shumë i rëndësishëm shpërndahen këto rrugë: rruga për Krivenik e cila është e asfaltuar si dhe rrugët për Gorancë dhe Pustenik që janë të shtruara me zhavorr.

Në anën e kundër të rrugës lokale për Pladenicë, nga magjistranja në perëndim ndahet rruga kryesore e qendrës së Qytetit e cila kalon përreth sheshit deri te stacioni hekurudhor. Ekziston edhe një rrugë tjetër kryesore nga shkolla e mesme në veri deri te banesat shumëkatëshe në jug. Këto dy rrugë përgjithësisht kanë trotuare të gjëra dhe janë të dyja të asfaltuara.

Ekzistojnë gjithashtu edhe rrugë të lagjeve në Lagjen e Re, qendrën e Qytetit (të dyja të asfaltuara), Lagjën e Kufirit dhe Anëllumin (rrugë në gjendje të dobët). Këto rrugë bëjnë lidhjen e lagjeve me rrugë lokale.

Rrugët e banimit (rrugicat e ngushta) janë zakonisht rrugë qorre dhe të paasfaltuara që ndahen nga rrugët e lagjeve deri te porta hyrëse e oborreve të shtëpive. Kësi shembujsh ka në të gjitha njësitë e zonës urbane.

Ka edhe rrugë për këmbësorë si rruga prej “Ujit të thartë” deri të pika kufitare që kalon ngjitur me magjistralen dhe rruga nga “Ura e Fejzës” deri te “Ura e Seçishtës” që kalon ngjitur me hekurudhën.

Brenda hapësirave industriale dhe të ish ushtrisë ka rrugë të pakategorizuara automobilistike dhe për këmbësorë të rregulluara për nevoja specifike.

## 1.7.2 Analiza përmes teknikes SWOT

### 1.7.2.a. Identifikimi i përparësive dhe mundësive

Përparësitë
<ul style="list-style-type: none"><li>• Pozite e mire gjeografike (lugine lumi ne mes te dy masiveve malore)</li></ul>
<ul style="list-style-type: none"><li>• Kushte te mira klimatike (përzjerje e klimave te ndryshueshme mesdhetare, kontinentale dhe e mesme kontinentale)</li></ul>
<ul style="list-style-type: none"><li>• Prezenca e lumit dhe përrenjve</li></ul>
<ul style="list-style-type: none"><li>• Prezenca e trashëgimisë natyrore dhe kulturore (parku ne pjesën lindore dhe trashëgimia industriale ngjitur me fabrikën e çimentos).</li></ul>
<ul style="list-style-type: none"><li>• Sipërfaqe e mjaftueshme për zgjerim urban (ish pronat e ushtrisë dhe pronat e shfrytëzuara për lende te pare-mergele)</li></ul>
<ul style="list-style-type: none"><li>• Popullatë relativisht e re</li></ul>
<ul style="list-style-type: none"><li>• Zhvillim industrial solid (punësimi)</li></ul>
<ul style="list-style-type: none"><li>• Zhvillim solid i bizneseve te lidhura me industri dhe terminalin doganor (transportuese, hoteliere-shërbyese, taxi, etj)</li></ul>
<ul style="list-style-type: none"><li>• Ekzistenca e terminalit doganor (punësimi, tregti te vogla, shpedicione, etj)</li></ul>
<ul style="list-style-type: none"><li>• Ekzistenca e kopshteve dhe traditave bujqësore familjare ne anën perëndimore te zonës urbane (Lagja e Re dhe Anëlumi)</li></ul>
<ul style="list-style-type: none"><li>• Ekzistenca e hekurudhës Fushe Kosove – Shkup (përfshire edhe stacionin hekurudhor) dhe magjistrales Prishtine –Shkup (lidhje e mirë me Shkupin)</li></ul>
<ul style="list-style-type: none"><li>• Struktura relativisht e mire e ndërtesave</li></ul>
<ul style="list-style-type: none"><li>• Tradite solide sportive (mundje dhe futboll)</li></ul>
<ul style="list-style-type: none"><li>• Zhvillim kompakt i zonës urbane</li></ul>

Mundësitë
<ul style="list-style-type: none"><li>• Zgjerim i kapaciteteve industriale (fabrika e çimentos dhe lokalet e Salonit-it)</li></ul>
<ul style="list-style-type: none"><li>• Ngritja e industrive te reja (industri ndërtimore)</li></ul>
<ul style="list-style-type: none"><li>• Krijimi i shanseve kompetitive për te gjitha llojet e bizneseve (krijimi i kushteve ne sensin e taksave dhe subvencioneve te favorshme te cilat mundësojnë loje fer dhe te barabarte ne kompeticionet për investime publiko-private)</li></ul>
<ul style="list-style-type: none"><li>• Vendosja e sistemit te monitorimit te ajrit</li></ul>
<ul style="list-style-type: none"><li>• Krijimi ose përmirësimi i mekanizmave ligjor qe te sigurojnë zbatim te ligjit (te ndaloje ndotjen e ajrit dhe ujit, te ndaloje degradimet e tjera te ambientit te çfarëdo lloje cofshin ato, te siguroje mbrojtjen e ambientit, te ndaloje keqpërdorimin e ujit te pijes, etj)</li></ul>
<ul style="list-style-type: none"><li>• Ndërtimi i impiantit për trajtim te ujërave fekale.</li></ul>
<ul style="list-style-type: none"><li>• Ndërtimi i shtratit te lumit dhe përrenjve si mase për ndalimin e vërshimeve, erozionit dhe ndotjes se ujit</li></ul>
<ul style="list-style-type: none"><li>• Krijimi ose ngritja e kapaciteteve (përmes trajnimit te stafit dhe mbështetje tjetër) te institucioneve te caktuara për mbledhjen e taksave dhe te ardhurave tjera (te gjitha taksat e aplikueshme komunale, tarifate tjera nga gjobot e vena ndotësve dhe degraduesve tjerë te ambientit, etj)</li></ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>• Trajnimi i stafit mësimor dhe mbështetja nga KEC për ngritjen e kualitetit të mësimin</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Trajnimi i stafit të emergjencës për VMRF (vlerësim dhe menaxhim të rreziqeve dhe fatkeqësive)</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ngritja e vetëdijes së qytetarëve për VMRF, mos keqpërdorim të ujit të pijes, etj.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Krijimi i kompanive lokale për përmirësim dhe menaxhim të sistemit të ujësjellësit, kanalizimit, mbledhjes së mbeturinave dhe mirëmbajtje/menaxhim të hapësirave publike.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shfrytëzimi i sipërfaqeve të ish ushtrisë dhe ish minierës për nevoja të domosdoshme hapësinore për zonë e re urbane</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rruge të re alternative që do të lidhë qendrën dhe magjistralen me pjesën e zonës urbane në përfundim të hekurudhës</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Autostrada e planifikuar</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Nije transportuese (vend me qasje të lehtë që njeherit mund të përdoret për transport lokal dhe ndërkomunal)</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rregullimi i hapësirave publike, trashëgimisë industriale, parkut si dhe shfrytëzimi i traditave hoteliere shërbyese (mikpritëse) për promovimin e turizmit dhe zhvillimit ekonomik</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndërtimi i aneksit të shkollës fillore/shkollës fillore në Lagjen e Re, aneksit të QKMF-se për emergjencë, hallës sportive, bibliotekës së qytetit dhe stadiumit të futbollit për të plotësuar nevojat e qytetarëve</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Hartimi i planeve rregulluese për zhvillim të mirëfilltë urban dhe kontrole të tij</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Hartimi i programeve qeveritare të financuara nga EU-IPA për bashkëpunim ndërkufitar</li> </ul>

#### 1.7.2.b. Identifikimi i dobësive dhe rreziqeve

Dobësitë
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shkalla e lartë e papunësisë</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shkalla e lartë e varfërisë</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Asociacioni i bizneseve nuk është i zhvilluar</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndotja nga industritë (ndotja e ajrit nga fabrika e çimentos, mbetjet e asbest çimentos në brigjet e lumit dhe përmes formave tjera neper tere qytetin (mbulesa pullazesh, gypa ujësjellësi dhe kanalizimi, etj)</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Nivel relativisht i ulët i mbledhjes së taksave dhe të hyrave tjera</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mungesa e stafit, trajnimeve dhe pajisjeve për shërbimin e zjarrfikësve</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mungesa e stafit, pajisjeve dhe hapësirave për QKMF-ne</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mungesa e trajnimeve për mësimdhënës dhe hapësirave në shkollën fillore dhe të mesme</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Probleme serioze me sistemin e ujësjellësit, kanalizimit dhe menaxhimit të mbeturinave. (kualiteti jo i kënaqshëm dhe sasi jo e mjaftueshme e ujit, keqpërdorimi është evident, nuk ka impiant për trajtimin e ujerave të zeza, nuk ka kompani zyrtare për menaxhim të këtyre shërbimeve, etj)</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Nuk ka rrugë alternative për hyrje dalje në qendër ose magjistrale (të gjitha rrugët janë qorre përveç rrugës kryesore)</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Nuk ka lidhje të drejtpërdrejta hapësinore në mes të qendrës së qytetit dhe pjesës përfundimtare të zonës urbane (Lagja e Re).</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mungesa e transportit ndërkomunal (nuk ka stacion autobusësh dhe Hani i Elezit nuk është i</li> </ul>



<b>përfshirë ne transportin regional)</b>
• <b>Mungese e trotuareve ne rrugët e lagjeve</b>
• <b>Mungese e shenjave te trafikut dhe barrierave tjera fizike ne rruge (veçanërisht lidhja me magjistralen nuk është e organizuar ne mënyrë te duhur)</b>
• <b>Shkalla e ulet e banimit kolektiv përkundrejt atij individual (rreth 2%/98%)</b>
• <b>Mungese kujdesi për trashëgiminë industriale</b>
• <b>Shfrytëzim jo racional i tokës</b>
• <b>Mungesa e haspirave institucionale dhe publike</b>

<b>Rreziqet</b>
• <b>Privatizimi i fabrikës së çimentos mund të ndikojë negativisht te të punësuarit sepse mund të ndryshohet statusi dhe numri i të punësuarve mund të ulët</b>
• <b>Ikja e profesionisteve të rinj jashtë komunës/shtetit</b>
• <b>Shkalla e papunësisë mund të ndikojë në parregullsi dhe protesta sociale</b>
• <b>Ndotje e vazhdueshme e ajrit dhe lumit</b>
• <b>Rreziku evident prej mbetjeve të azbest çimentos në brigjet e lumit Lepenc dhe nëpër cytet</b>
• <b>Keqpërdorimi dhe ndotja e vazhdueshme e ujit të pijes</b>
• <b>Degradim i vazhdueshëm i trashëgimisë industriale</b>
• <b>Vërshimi i lumit Lepenc dhe përroit te Rezhancës</b>
• <b>Rreziku nga rezervuarët e karburanteve ne ish pronat e ushtrisë</b>
• <b>Vazhdimësia e ndërtimeve te paligjshme</b>

## 1.8 Sfidat e zhvillimit urban

Sfidat kryesore janë identifikuar nga hulumtimet e bëra nga grupet tematike të punës. Këto sfida janë të bazuara në të dhënat dhe çështjet kyçe.

### Sfida 1

#### **Përmirësimi i shërbimeve shëndetësore dhe zhvillimi i më tejshëm i arsimit.**

Si mund të kontribuojë plani në përmirësimin e këtyre shërbimeve?

Ofrimi i trajnimit për sektorin e arsimit dhe shëndetësisë dhe përmirësimi i objekteve

### Sfida 2

#### **Zvogëlimi i papunësisë**

Si mund të kontribuojë plani zhvillimor në uljen e shkallës së papunësisë?

Promovimi i ngritjes se kapaciteteve industriale dhe organizimit te komunitetit të biznesit, tërheqja e bizneseve të reja, joshja e fshatarëve që të jenë më shumë të angazhuar në bujqësi, zhvillimi i turizmit, etj, është e rëndësishme në uljen e papunësisë.

Organizimi i trajnimeve profesionale për përmirësimin e aftësive të personave të papunë për tregun e punës.

### Sfida 3

#### **Ulja e shkallës varfërisë**

Shkalla e varfërisë është e lartë, si mund PZHU të udhëzojë zhvillimin në mënyrë që të zvogëlohet shkalla e varfërisë?

Reduktimi i shkalles se papunësisë është i lidhur drejtpërdrejtë me shkallen e varfërisë. Banimi social është gjithashtu një nga komponentët që do të ndihmojnë në uljen e varfërisë.

#### **Sfida 4**

##### **Zhvillimi ekonomik – zhvillimi industrial**

Si mund të ndihmojë plani në zhvillimin e ekonomisë?

Komuna duhet mbështetur krijimin e shoqatës së biznesit në Han të Elezit. Komuna duhet të kërkojë dhe iniciojë bashkëpunim më të mirë midis pushtetit qendror dhe vendor në procesin e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore. Ajo duhet të beje përmirësimin e qasjes ndaj investitorëve, në mënyrë që të tërheq investitorët e mundshëm për komunën. Ajo duhet të ofrojë mbështetje institucionale për zhvillimin e sektorit të bujqësisë dhe blegtorisë dhe të ofrojë trajnimet e nevojshme në kuadër të këtyre sektorëve.

#### **Sfida 5**

##### **Mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe natyrore dhe prezantimi i trashëgimisë industriale si vlerë lokale**

Si mund të ndihmojë plani në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, natyrore dhe industriale?

Përmes PZHK-së trashëgimia kulturore mund të trajtohet zyrtarisht si vlerë lokale nga niveli lokal dhe qendror.

#### **Sfida 6**

##### **Përmirësimi i infrastrukturës urbane dhe shërbimeve**

Si të përmirësohet infrastruktura urbane përmes implementimit të këtij plani?

Duke kontrolluar zhvillimin përmes hartimit të planeve rregulluese urbane duke planifikuar një zhvillim kompakt do të jetë më lehtë për të ofruar infrastrukturën urbane dhe shërbimet teknike.

#### **Sfida 7**

##### **Përmirësimi i infrastrukturës fizike dhe transportit**

Si mund të ndihmojë plani në përmirësimin e infrastrukturës?

Duke promovuar një zhvillim kompakt dhe me një planifikim të rrugëve të një standardi të lartë, plani do të ndihmojë në përmirësimin e infrastrukturës urbane dhe rrugore në të gjitha vendbanimet.

#### **Sfida 8**

##### **Mbrojtja e mjedisit**

Si mund të mbrohet mjedisi duke përdorur planin zhvillimor?

Krijimi i mekanizmave në mënyrë që të merren me mjedisin, në veçanti me ndotjen e ajrit dhe menaxhimin e mbeturinave. Zbatimi i ligjit për mjedisin.

#### **Sfida 9**

##### **Vlerësimi dhe menaxhimi i rrezikut dhe fatkeqësive (VMRF)**

Si mund të kontribuojë plani zhvillimor për t'u marrë me çështjet e VMRF-së?

Ngritja e kapaciteteve komunale në mënyrën e qasjes drejt çështjes së VMRF-së, trajnimi për departamentin e emergjencës dhe aplikimi i kodit të ndërtimit.

#### **Sfida 10**

##### **Ofrimi i strehimit për të gjithë qytetarët me theks të veçantë për shtresat sociale**

Si të zgjidhet problemi i banimit me standarde optimale në të gjithë zonën urbane dhe në veçanti për shtresat e popullsisë nën asistencë sociale

Komuna duhet shikuar mundësinë në bashkëpunim me nivelin qendror që të rrisë kualitetin e banimit si dhe të krijojë strehim për shtresat nën ndihmë sociale.

#### **Sfida 11**

## Prona e pa definuar e ish pronave ushtarake

Si të zgjidhet problemi i pronës së pa definuar?

Ne bashkëpunim me AKP pronat ushtarake nuk duhet të privatizohen por të kalojnë pronë komunale për shfrytëzim publik.

## Sfida 12

### Standardet, normat dhe parimet

Si mund të planifikohet zhvillimi në mënyrë që të arrihen standardet ndërkombëtare, transparencja, barazia gjinore dhe pjesëmarrja në vendimmarrje? Duke implemtuar planin me pjesëmarrje të qytetarëve dhe grupeve të interesit arrihet transparencja dhe standardet ndërkombëtare dhe fuqizimi i shoqërisë civile dhe barazia gjinore.

## 1.9 Vlerësimi i kapaciteteve investuese

Vlerësimi i kapacitetit investues kërkon përfshirjen e kontributeve të mundshme nga potencialet ekzistuese të sektorit publik dhe privat, si dhe mundësitë për tërheqjen e investimeve të huaja; që do të mundësojë zbatimin e planeve zhvillimore dhe udhëheqjen e investimeve publike nga sektori publik dhe privat.

Kapacitetet ekzistuese;

- Buxheti komunal, sektori privat, sektori publik, burimet natyrore, infrastruktura fizike, kapacitetet njerëzore.

Buxheti 2006-2014 MUNICIPALITY OF - HANI I ELEZIT									
Viti	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Buxheti Euro	219,000	722,000	914,119	1,190.30	1,254,704	1,537,638	1,686,727	1,707,575	1,720,882
Projektet e investimev e kapitale Euro	97,000	150,000	221,193	290,538	325,298	453,011	493,024	513,872	527,179

Buxheti per 2009	Total (Euro)	1,153,143
	Te hyrat nga taksat komunale (Euro)	73,400
	Te hyrat tjera (Euro)	1,079,743
Projektet e implementuara ne (2008) <sup>1</sup>	Total(Euro)	846,263 (87%)
	Investimet kapitale (Euro)	172,198 (62%)
	Shpenzimet tjera (Euro)	674,065 (97%)

Buxheti i Hanit të Elezit për vitin 2008 ka qenë 846,263; dhe 87% e buxhetit total ishte shpenzuar. Të ardhurat nga taksat e mbledhura në vitin 2008 ishin 108.29% nga taksat e parashikuara, që është dashur të mblidhen. Në vitin 2009 buxheti i përgjithshëm ishte 1,153,143 €; 6,3% e kësaj shume ishte nga të hyrat tatimore<sup>13</sup>

<sup>13</sup> Hani i Elezit – raporti komunal – w.w.institutigap.org

## Investimet kapitale

Kapacitetet financiare në Han të Elezit janë shumë të ulëta, si rrjedhim buxheti për investime kapitale është gjithashtu i ultë. Në vitin 2008 buxheti i ndarë për investime kapitale ishte vetëm 181.811 €; në 2009 ai ishte rritur deri në 343.678 €.

Tab.1.: Projektet e investimeve kapitale për vitet 2008 dhe 2009

Viti	Emri i projektit	Buxheti
2008	Asfaltimi i rrugës Hani I Elezit-Seqishtë-Krivenik.	€21,666
2008	Asfaltimi i rrugës Qendra-Banesa e re-Park	€10,000
2008	Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në Gorancë	€10,000
2009	Asfaltimi i rrugës Përroi i Rezanës	€45,000

- Sipas raportit të publikuar nga Instituti GAP, deri në fund të shtatorit 2008, 7% e buxhetit të përgjithshëm ishte ndare për investime kapitale. Ky 7% i buxhetit të ndare ishte vetëm për qëllime të hartimit të projekteve dhe për disa projekte të bashkë-financuara.
- Në vitin 2008 deri në fund të vitit, 62% e buxhetit ishte shpenzuar, ndërsa në vitin 2009, gjatë 6 muajve të parë ishte shpenzuar 12,8% të buxhetit të ndarë për investime kapitale.
- Kuvendi komunal kishte miratuar buxhetin për vitet 2010-2012 në fund të vitit 2009. Por si pasojë e rritjes së pagave për zyrtarët komunal dhe ndryshimeve buxhetore në disa kategori tjera, buxheti për vitet 2011-2013 i cili u aprovua me vonesë në prill të vitit 2012 pësoi disa ndryshime nga parashikimet e zakonshme. The kjo ndikoi edhe në projektimet buxhetore për 2012-2014. Pra sipas vlerësimeve, buxheti për investime kapitale për vitet 2012 - 2014 do të jetë gjithsej 1,534,075 €.
- Duke u bazuar në vlerësimin e buxhetit për vitet 2012-2014 dhe në bazë të supozimeve, është parashikuar që buxheti për investime kapitale për 4 vite të jetë rreth 2,1 milion €.

Kapacitetet e mundshme:

- Investimet e huaja, fondet ndërkombëtare, fondet e BE – IPA dhe donacionet tjera, kreditë dhe grandet, investime të mundshme nga qeveria
- Partneritetet publiko-private

## 2. Vizioni, parimet dhe caqet

### 2.1 DEKLARATA E VIZIONIT

Në vitin 2008, në kohën kur Komuna e Hanit të Elezit ishte në fazën e promovimit të saj si Komune me të drejtat e plotë dhe kur sapo kishte filluar të hyjë në proceset e planifikimit që janë normale dhe obligative për çdo Komunë, në Ohër të Maqedonisë ishte mbajtur Punëtorja e Vizionimit për Komunën e Hanit të Elezit. Kjo punëtori ishte organizuar nga Programi për Mbështetjen e Planifikimit Hapësinor Komunal i UN-HABITAT-it dhe Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHWB), të dyja të financuara nga Sida. Me vone, me fillimin e procesit të hartimit të Planit Zhvillimor Komunal, dhe për nevojën të drejtpërdrejtë të tij, në vitin 2009 në Han të Elezit gjithashtu është mbajtur edhe punëtorja e konfirmimit të vizionit, ku u hartua dhe u konfirmua deklarata e vizionit për zhvillimin e ardhshëm të komunës.

Vizioni për të ardhmen e zonës urbane, bazohet në Vizionin të PZHK-se së Hanit të Elezit dhe të Planit Hapësinor të Kosovës 2010-2020.

**Hani i Elezit - qytet portë, urë në mes dy shteteve Kosovë- Maqedoni, me një lidhje në mes të dy kufijve Hani i Elezit-Glloboqicë, me shërbime të zhvilluara të administratës; avancim të zhvillimeve industriale, tregtisë, transportit, bujqësisë, turizmit industrial, kulturor dhe transit; me zhvillim të balancuar me një vëmendje më të madhe ndaj mbrojtjes së mjedisit; me infrastrukturë të zhvilluar fizike, sociale dhe jetë të shëndetshme për të gjithë.**

### 2.2 Parimet e përgjithshme të zhvillimit

Parimet e përgjithshme të zhvillimit sigurojnë një kuadër të gjerë udhëzimesh, të cilat rrjedhin nga dokumentet e rëndësishme planifikuese dhe zhvillimore lokale, kombëtare, evropiane dhe ndërkombëtare:

- Ligji për Planifikim Hapësinor
- Parimet për zhvillim të qëndrueshëm hapësinor nga perspektiva evropiane e zhvillimit hapësinor BE-ESDP
- Parimet për zhvillim të qëndrueshëm – Agjenda 21
- Parimet e qeverisjes së mirë urbane – Agjenda e UN-HABITAT-it

#### 2.2.1 Parimet kryesore për zhvillimin e Hanit të Elezit

Zhvillim i planifikuar hapësinor	Zhvillimi i ardhshëm i Hanit të Elezit duhet të zhvillohet në bazë të planeve dhe vendimeve adekuate
Zhvillim i balancuar	Hani i Elezit duhet të ketë një qëllim për zhvillim të balancuar në të gjitha vendbanimet e komunës
Zhvillim kompakt	Me qëllim të mbrojtjes së tokës bujqësore dhe burimeve natyrore, Plani Zhvillimor duhet të nxis zhvillimin kompakt me dendësi më të madhe në tokën ndërtimore të zonës urbane
Zhvillim i qëndrueshëm	Duhet pasur në konsideratë përdorimi racional i burimeve kombëtare dhe ekuilibrimi i zhvillimit social, ekonomik-industrial me mjedisin



Simulimi i sinergjive dhe shmangia e konflikteve	Ky parim kërkon integrimin e zhvillimeve në sektorë, të cilat mund të veprojnë më lehtë së bashku, dhe të ekuilibrojnë konfliktet e mundshme të zhvillimit (d.m.th. me komunat përreth apo me nivelin qendror)
Subsidiariteti	Gjatë zbatimit të planit zhvillimor të komunës, komuna do të marrë përgjegjësinë për vendimet që janë marrë në nivelin qendror dhe do të jetë në gjendje të ndërmerr veprimet të cilat mund të merren në nivel lokal të qeverisjes
Integrimi në BE	Zhvillimet e parapara në Planin Zhvillimor Komunal duhet të kontribuojnë në procesin e integrit të Kosovës në BE
Zhvillimi plotësues	Funksioni kryesor i qendrës kryesore, nën qendrës është plotësuese për vendbanimet tjera.

## 2.3 Qëllimet zhvillimore afatgjata

### 2.3.1 Zhvillimi social

#### Qëllimi 12- Përmirësimi i shërbimeve dhe hapësirave shoqërore me qasje për të gjithë qytetarët

##### Objektivat

- Përmirësimi dhe përparimi i hapësirave të QKMF-së, ashtu që ato të ofrojnë kushte optimale për ofrimin e shërbimeve shëndetësore
- Përmirësimi dhe përparimi i hapësirave shkollore (dhe parashkollore) , ashtu që ato të ofrojnë kushte optimale për zhvillimin kualitativ të mësimin
- Rritja dhe zhvillimi i kapaciteteve profesionale për stafin shëndetësor dhe arsimor në mënyrë që të arrihet përmirësimi i cilësisë së shërbimeve në këto fusha
- Përmirësimi i institucioneve ekzistuese dhe planifikimi i institucioneve dhe përmbajtjeve të reja shërbyese-publike (administrative, kulturore, sportive, rekreative, etj) në zona me qasje të lehtë për të gjithë
- Ofrimi i përkujdesjes për fëmijë për të gjitha familjet nëse paraqitet nevoja, posaçërisht përkujdesjes për fëmijët me kërkesa të veçanta
- Ofrimi i shërbimeve për të moshuar, duke siguruar përkujdesje shëndetësore por edhe sigurimi i strehimit

### 2.3.2 Zhvillimi ekonomik

#### Qëllimi 2 –Zhvillimi ekonomik vibrant – Rritja e kapaciteteve industriale (sjellja e industrive të reja të lidhura me prodhimet ekzistuese të çimentos);

##### Objektivat

- Inkurajimi i industrive ekzistuese për mirëmbajtjen dhe zgjerimin e aktiviteteve të tyre
- Krijimi i mundësive për tërheqjen e industrive të lidhura me industrinë ekzistuese (industrinë që mund të shfrytëzojnë çimenton si lëndë të parë)
- Promovimi i mundësive për krijimin e industrisë së ndërtimit
- Përkrahja institucionale për zhvillimin firmave të transportit të mallrave dhe krijimi i hapësirave të parkimit për nevoja të tyre
- Promovimi i mundësive për zhvillimin e tregtisë (p.sh. me materiale ndërtimore) dhe zhvillimi i mëtejshëm i bizneseve tjera

#### Qëllimi 3- Të sigurohet se ka toka të mjaftueshme industriale në dispozicion për të tërhequr dhe akomoduar zhvillime të reja industriale në të ardhmen

##### Objektivat

- Mbajtja e tokës ekzistuese industriale dhe sigurimi i tokës për industrinë e reja
- Minimizimi i konfliktit në mes të shfrytëzuesve të tokës industriale dhe shfrytëzuesve tjerë të tokës

#### **Qëllimi 4- Zhvillimi i bujqësisë urbane**

##### **Objektivat**

- Riaktivizimi, mbrojtja dhe zhvillimi i tokës bujqësore
- Promovimi i bujqësisë intensive me serra, pemishteve, livadheve, etj; si dhe produkteve të tyre

#### **Qëllimi 5- Zhvillimi i turizmit transit dhe te qëndrueshëm**

##### **Objektivat**

- Krijimi i hapësirave dhe pikave adekuate për turizëm dhe promovimin e tij
- Rivitalizimi i vlerave të trashëgimisë industriale, banuese dhe kulturore
- Zhvillimi i mëtejshëm i firmave hoteliere-shërbyese (njësitë e akomodimit afatshkurtë dhe afatgjatë)

### **2.3.3 Infrastruktura urbane**

#### **Qëllimi 6- Ofrimi i shërbimeve publike kualitative në të gjithë zonën urbane**

##### **Objektivat**

- Furnizimi i rregullt me ujë të pijes i gjithë zonës urbane (me theks të veçantë në amvisëri dhe pikat turistike)
- Sigurimi i qasjes në sistem kanalizimi për të gjithë zonën urbane dhe trajtimi i ujërave të zeza (impianetet e ujërave të zeza)
- Rregullimi i kanalizimeve atmosferike dhe ndriçimit në rrugët e qytetit të Hanit të Elezit
- Menaxhimi adekuat i mbeturinave duke përfshirë edhe programet për reduktimin e mbeturinave (riciklimi)
- Përmirësimi i rrjetit elektrik në qytetin e Hanit të Elezit.
- Përmirësimi i shërbimeve të telekomunikacionit në qytetin e Hanit të Elezit

### **2.3.4 Zhvillimit i infrastrukturës rrugore dhe transportit (lëvizshmërisë)**

#### **Objektivi 7- Infrastrukturë funksionale dhe e integruar, me vëmendje në autostradën e planifikuar,**

##### **Objektivat**

- Sigurimi i infrastrukturës rrugore në të gjitha lagjet e qytetit
- Rregullimi i trotuarëve dhe shtigjeve për këmbësor dhe biçikleta
- Sigurimi i parkimit publik
- Sigurimi i qasjes në autostradë

#### **Qëllimi 8 - Sigurimi i lëvizjeve të sigurt dhe të efektshme të njerëzve dhe mallrave brenda dhe nëpërmjet Hanit të Elezit duke koordinuar përdorimin e planifikuar të tokës dhe sistemeve të transportit**

##### **Objektivat**

- Inkurajimi i përdorimit të formave jo të motorizuara të transportit
- Përmirësimi i qasjes në rrugë me një infrastrukturë rrugore të sigurtë dhe efektive, njëjtë edhe për çiklizëm dhe këmbësorë
- Reduktimi i kërkesave të udhëtimit dhe promovimi i alternativave tjera të udhëtimit përveç atij me automjete private.
- Koordinimi në planifikimin dhe ndërtimin e objekteve të transportit brenda qytetit me autoritetet e qeverisë qendrore përgjegjëse për lidhjen e rrugëve nëpër komuna (daljet e autostradës)
- Promovimi i zhvillimit dhe zgjerimit të objekteve të transportit rajonal

## **Qëllimi 9- Sistem i integruar dhe multi-modal i transportit**

### **Objektivat**

- Zhvillimi i një sistemi efikas të transportit (stacioni i autobusit me lidhje të drejtpërdrejta me stacionin e trenit), me qasje më të mirë dhe të sigurt për të gjithë qytetarët.
- Sigurimi i një transporti publik të sigurt, të arritshëm dhe të fokusuar te klienti
- Rritja e atraktivitetit dhe komoditetit si dhe e sigurisë e të gjitha llojeve të transportit

### **2.3.5 Mbrojtja e mjedisit**

## **Qëllimi 10 – Konservimi, mbrojtja dhe restaurimi i mjedisit natyror dhe biodiversitetit**

### **Objektivat**

- Reduktimi i ndikimit negativ të industrisë dhe trafikut rrugor në mjedis (ndotja e ajrit, ujit, tokës, ndotja nga zhurma, etj) si dhe të sigurohet që ndotësit do të respektojnë ligjin
- Identifikimi i zonave problematike, vlerësimi dhe pastrimi i tyre (ndotje nga asbesti apo ndotje tjetër)
- Rigjenerimi i zonave të kontaminuara në zonën qytezës
- Definimi dhe mbrojtja e zonave natyrore urbane me interes për komunën (të mbrohen këto zona nga zhvillimi i pakontrolluar)
- Mbrojtja e diversitetit të peizazhit natyror dhe biodiversitetit, integrimi dhe lidhja e rrjeteve ekologjike në të gjithë komunën
- Sigurimi dhe përmirësimi i sipërfaqeve të gjelbra në zonën urbane
- Lidhja e gjithë kësaj infrastrukture të gjelbër në të gjithë strukturën urbane

### **2.3.6 Reduktimi dhe zbutja e fatkeqësive**

## **Qëllimi 11- Rreziqe të reduktuara dhe menaxhim adekuat i ndikimeve negative në mjedis të shkaktuara nga natyra apo njeriu**

### **Objektivat**

- Minimizimi i rrezikut nga rrëshqitja e dheut dhe formimit të akujve në rrugën magjistrale
- Sigurimi se zonat e ish-bazave ushtarake janë të sigurta për rrizhvim
- Rritja e kapaciteteve në departamentin e zjarrfikësve
- Hartimi i planit të përbashkët kontingjent bashkërisht me komunën, doganat dhe industrinë për të reaguar në rast rreziku nga materialet e rrezikshme

### **2.3.7 Shfrytëzimi i tokës dhe banimi**

## **Qëllimi 12- Shfrytëzimi adekuat i tokës për një cilësi të përmirësuar e jetës dhe banimit për të gjithë qytetarët**

### **Objektivat**

- Sigurimi i tokës së nevojshme për hapësira dhe shërbime publike bashkë me rregullimin kadastral të saj
- Sigurimi i strehimit për të gjithë banorët e Hanit të Elezit me theks të posaçëm për grupet e cenushme (të moshuarit, personat me ndihmë sociale)
- Hartimi planeve rregulluese me qëllim të përmirësimit të banimit dhe ambienteve rrethuese.
- Densifikimi në zonën urbane nëpër të gjitha njësitë me qëllim të kufizimit të zgjerimit horizontal hapësinor, shfrytëzimit më të mirë të tokës urbane të ndërtuar dhe ruajtjes së tokës bujqësore
- Përmirësimi i standardit të banimit
- Implementimi i propozimeve të banimit dhe të tjera përmes partneritetit publiko privat

## **2.4 Prioritetet strategjike**

Si rezultat i diskutimeve të sfidave dhe objektivave zhvillimore të diskutuara nga grupet punuese të planifikimit dhe aleve tjera të interesit si dhe zyrtaret komunal kanë dalë prioritetet strategjike:

- Përmirësimi i infrastrukturës shoqërore, sistemit të arsimit dhe shërbimeve shëndetësore (rritja e kapaciteteve fizike dhe burimeve njerëzore)
- Rritja e kapaciteteve industriale (tërheqja/sjellja e bizneseve të reja)
- Konservimi, mbrojtja dhe përmirësimi i mjedisit natyror dhe biodiversitetit
- Kontrolli i Zhvillimit (hartimi i planeve rregulluese)
- Lidhja e pjesës vjetër të qytetit me lagjen e re
- Përmirësimi i infrastrukturës sociale, sistemit të arsimit dhe shërbimeve shëndetësore ( shtimi i resurseve fizike dhe humane)
- Përmirësimi i cilësisë së banimit

### 3. Korniza zhvillimore urbane

#### 3.1. Koncepti kryesor zhvillimor

Përderisa vizioni paraqet një perspektivë të realizimit të synimeve të planifikuara dhe orienton zhvillimin duke u bazuar edhe në kualitetet, pasuritë dhe mundësitë e Hanit të Elezit; **koncepti** përbën grupimin e aspekteve kryesore hapësinore që kanë të bëjnë me strukturën e planifikuar hapësinore.

Bazuar në të dhënat e paraqitura në kapitujt e mëparshëm të këtij materiali, analizat paraprake të Planit Zhvillimor Komunal, në Vizionin e përcaktuar nga Plani Hapësinor i Kosovës, pjesë e “Zonës së Verdhë” e së cilës është edhe Hani i Elezit, si dhe duke u nisur nga Vizioni ,synimet dhe objektivat afatgjata është arritur të një koncept përgjithshëm zhvillimor i qytetit të Hanit të Elezit.

##### 3.1.1. Skenarët zhvillimor dhe vlerësimi i tyre

Para zhvillimit të konceptit kryesor përmes takimeve dhe punëtorive të grupeve punuese dhe punëtorive të veçanta me qytetaret dhe grupet e ndryshme të interes janë zhvilluar, diskutuar dhe vlerësuar 3 skenarë zhvillimorë të ndryshëm të zhvillimit të Qytezës. Që të tre skenarët kanë modele të ndryshme dhe që paraqesin zhvillime të ndryshme të mundshme hapësinore të kësaj Qyteze. Në pjesët në vijim janë paraqitur përmbledhjet dhe vlerësimet skenarëve të ndryshëm që dolën gjatë procesit të planifikimit.

##### **Skenari A: HANI I ELEZIT “QYTEZË INDUSTRIALE”**

Hani i Elezit është i njohur në tërë regjionin si vend industrial bazuar kryesisht në zhvillimin solid të industrisë së çimentos dhe industrisë ndërtimore në përgjithësi. Në bazë të këtij skenari zhvillimit industrial do të jepet rëndësia bazë në zhvillimin e qytetit. Kjo do të thotë se me një shfrytëzim të planifikuar të resurseve të mergeles (rreth 39 milion ton mergele të verifikuar duke përfshirë të dy lokacionet e mihjes sipërfaqësore në Han të Elezit dhe Paldenicë) do të mundë të rritej niveli i këtij zhvillimi me prodhim më të madh të çimentos. Si veprimtari suplementare e zhvillimit primar industrial do të ishin industritë e reja të produkteve tjera ndërtimore që kanë për bazë çimenton. Shikuar në kontekstin hapësinor, i gjithë ky zhvillim, duke përfshirë industrinë, nxjerrjen e lëndës së parë, tregtinë dhe transportin me këto prodhime, si dhe hotelëritë e mundshme do të kishte ekspansionin e tij drejt jugut në kufi dhe drejt veriut përgjatë magjistrale, por gjithnjë brenda zonës urbane. Qyteza e Hanit të Elezit konsiderohet si e ndotur për momentin. Por duhet pasur parasysh që zhvillimi i mëtejshëm industrial (edhe pse ky skenar parasheh reduktimin e ndotjes si dhe promovimin e industrive të reja jo ndotëse) mund të ndikojë negativisht në ambientin natyror dhe banues, duke pasur parasysh afërsinë e qendrës së qytetit me industrinë. Ndotja është e ndryshme : ndotje e ajrit, akustike ( përmes zhurmës së shkaktuar


nga fabrika) pastaj, degradimit i mjedisit nga shfrytëzimi i mineraleve, etj. Për këtë arsye ky skenar parasheh bartjen graduale të funksioneve kryesore të Qytezës nga Qendra e tanishme në Lagjen e Re. Kjo pasi lumi Lepenc shërben si kufi natyral që kufizon ndotjen e ambientit në perëndim të tij. Pra Lagja e Re do të kishte dendësi më të lartë banimi (duke përfshirë edhe banimin me lartësi të mesme), funksionet shoqërore (shëndetësia, arsimi, kultura, sporti, rekreacioni), tregtia, parku, etj. Bartja do të bëhej paralelisht me ritmin e zhvillimit industrial. Në Qendrën e tanishme si dhe Lagjen e Parkut do të kufizohej vetëm me banim të ulët si dhe apartamentet ekzistuese to hiqeshin dhe hapësira e tyre do të shfrytëzohej për shtimin e sipërfaqeve gjelbëruese. Përfundim do të bënin vetëm dy ndërtesat ngjitur me fabrikën e vjetër të çimentos të cilat konsiderohen si trashëgimi industriale. Rrugët ekzistuese do të mbesnin dhe do të ndërtoheshin të tjera si autostrada, rruga lidhëse e Qendrës së ardhshme me magjistralen si dhe rrugët e nevojshme brenda kësaj Qendre.

*Siç u pa më lart, sipas këtij skenari, fokusi kryesor gjatë zhvillimit të qytezës do të ishte zhvillimi industrial me elementet e tij si dhe bartja e bërthamës së Qytezës në Lagjen e Re për arsye mjedisore. Gjatë analizave të mëtutjeshme kjo zhvendosje e Qytezës u vlerësua si e kushtueshme dhe jo me leverdi për qytetarët. Në esencë një pjesë e mirë e benefiteve nga ky zhvillim i paraparë industrial do të shpenzohej me atë rast. Gjithashtu do të kishim më shumë humbje të tokave bujqësore në Lagjen e Re. Si sfidë vështirë e tejkaleshme e formimit të bërthamës së Qytezës në Lagjen e Re si dhe mundësisë së ekspansionit në të ardhmen rreth saj është edhe fakti se pronat në Lagjen e Re janë në të shumtën private si dhe kufiri ekzistues natyral me kodrat përreth. Bazuar në këto që u thanë më lart ky skenar nuk do të merret parasysht me përjashtim të zhvillimit ekonomik industrial që është parë si esencial për zhvillimin e Qytezës dhe do të trajtohet më vonë.*

## **Harta 17**



# Skenari A Scenario



## Legjenda / Legend

	Kufiri urban / Urban border		Industria / Industry		Terminali doganor / Customs terminal
	Qendra / Centre		Mihja / Mining		Qendra e Qytezës / Town centre
	Lagja e Parkut / Park Neigh.		Lënda e parë - mergele / Raw material - mergele		Pika kufitare / Border point
	Z. industriale / Industrial z.		Hoteleritë dhe zgjerimi i tyre / Hotelier serv.& their expansion		Koridoret rrugore lokale / Local road corridors
	Lagja e Re / New neigh.		Banim i ultë me kopshte / Low housing with gardens		Magjistrailja / Highway
	Analumi / Riverside		Banim i mesëm me për. shoqërore / Medium housing with soc. functions		Hekurudha / Railway
	Lagja e kufirit / Border neigh.		Park, sport, rekreacion, bujqësi / Parc, sport recreation, agriculture		Autostrada / Motorway

**Skenari B: HANI I ELEZIT “PORTË NDËRKOMBËTARE-URË NË MES SHTETEVE”**

Hani i Elezit është gjithashtu i njohur si vend kufitar në tërë vendin tonë. Edhe në Planin Hapësinor të Kosovës është në Zonën e Verdhë të “urat e Kosovës”. Pika kufitare është më shfrytëzueshmja për momentin në Kosovë. Rreth 2/3 e importit në Kosovë bëhet nga kjo pikë kufitare. Sipas këtij skenari është paraparë që këtij fakti t’i jepet rëndësia kryesore gjatë planifikimit të zhvillimit të ardhshëm të Qytetit. Do të organizohet një bashkëpunim dhe lidhje me komunat e shtetit fqinj në mënyrë që të ofroje mundësi me të mira komunikimi për qytetaret dhe bizneset në përgjithësi. Shërbimet e hotelerive janë zhvilluar që nga hapja e pikës kufitare gjatë viteve të nëntëdhjeta të shekullit të kaluar. Këto shërbime do të mundë të zhvilloheshin edhe më tej me hapjen e restoranteve, kafeneve dhe hoteleve më kualitative rreth magjistrales dhe afër stacionit hekurudhor. Natyrisht se edhe në këtë rast do të kishim zhvillim të ndërtimit përreth magjistrales. Këtij zhvillimi të hotelerive rreth magjistrales si dhe tregtia për nevoja të konsumit të brendshëm të banorëve dhe të jashtëm për udhëtarët e rastit me expansionin e tij hapësinor do të mundë ta sfidonte edhe kufirin ekzistues urban në veri duke aspiruar për më tej deri te Uji i Thartë, por gjithmonë përgjatë magjistrales. Gjithashtu do të aspirohej në zhvillim të turizmit transit në Han të Elezit me pjesën e vjetër të fabrikës së çimentos, ndërtesat e para shumëkatëshe dhe rindërtimin e Hanit nga i cili ka marre edhe emrin komuna.

Zhvillimi industrial do të kufizohej me vazhdimin e nivelit të njëjtë të prodhueshmërisë. Kjo për arsye mjedisore dhe shfrytëzimit më racional të resurseve të mergeles.


Bërthama e Qytezës do të mbetet Qendrën ekzistuese me funksionet kryesore sociale si administrata komunale, shkollat, QKMF, sporti dhe rekreacioni, etj. Gjithashtu edhe banimi i mesëm do të stimulohej aty. Banimi me shtëpi të veçanta do të lejohej në të dyja anët e Qendrës (Lagja e Parkut dhe Lagja e Re) duke e sfiduar seriozisht kufirin urban me ndërtime stihike sikur që ndodhën deri tani.

*Pas analizës së këtij skenari është parapare që i tërë ky zhvillim mundë të rrezikohej nga ndërtimi i autostradës së planifikuar kur kihet parasysh se daljet nga autostrada janë afër kufirit dhe magjistralsja do ta humbë rëndësinë që e ka tani pas ndërtimit të autostradës. Shikuar në planin më afatgjatë, me hyrjen e Kosovës në Bashkimin Evropian dhe heqjen e pikës kufitare hyrje-daljet në Han të Elezit do të reduktoheshin edhe më tej. Gjithashtu anë negative e gjithë këtij zhvillimi të shërbimeve hotelerike dhe turistike është edhe fakti se Hani i Elezit perceptohet si një nga vendet më të ndotura në Kosovë.*

*Gjithashtu zgjerimi i qytetit në lindje të sillte ndërthurje jo të mira në mes të banimit dhe transportit të lëndës së parë deri në hapësirat prodhuese.*

*Sa i përket zhvillimit gjatësor edhe ky do i kishte anët e tij negative me shpenzime më të mëdha në infrastrukturë të të gjitha llojeve si dhe shfrytëzim irracional të tokës.*

# Skenari B Scenario



## Legjenda / Legend

- |   |                                 |   |   |   |   |
|---|---------------------------------|---|---|---|---|
|  | Kufiri urban / Urban border     |  | Industria / Industry  |  | Terminali doganor / Customs terminal            |
|  | Qendra / Centre                 |  | Mihja / Mining  |  | Qendra e Qytezës / Town centre                  |
|  | Lagja e Parkut / Park Neigh.    |  | Lënda e parë - mergele / Raw material - mergele                                 |  | Pika kufitare / Border point                    |
|  | Z. industriale / Industrial z.  |  | Turizmi dhe hoteleritë/zgjerimi / Tourism and hotelier serv./expansion          |  | Koridoret rrugore lokale / Local road corridors |
|  | Lagja e Re / New neigh.         |  | Banim i ultë/zgjerimi / Low housing/ the expansion                              |  | Magjistranja / Highway                          |
|  | Analumi / Riverside             |  | Banim i mesëm/për. shoqërore/biznese / Medium housing/soc. functions/businesses |  | Hekurudha / Railway                             |
|  | Lagja e kufirit / Border neigh. |  | Park, sport, rekreacion, bujqësi / Parc, sport recreation, agriculture          |  | Autostrada / Motorway                           |

### **Skenari C: HANI I ELEZIT “QYTEZË ME NJË ZHVILLIM KOMPAKT DHE TË BALANCUAR”**

Ky skenar tenton që të bëjë balancimin e dy skenarëve të para me një mbrojtje më efikase të mjedisit si dhe sigurim të ambientit optimal jetësor për qytetarët. Pra zhvillimi ekonomik i përqendruar në zhvillimin industrial, por edhe të tregtisë, turizmit dhe bujqësisë do të planifikohet të balancohet me ndikim sa më minimal në mjedis në kuadër të parametrave të lejuara të BE-së. Pra parashihet që të reduktohet ndotja nga industria ekzistuese si dhe promovimi i industrive jo ndotëse. Do të kushtohet rëndësi ndotjes nga grimcat materiale të emetuara në ajër, pluhurit, nga oksidi i nitrogjenit (NOX), dioksidi i nitrogjenit (NO<sub>2</sub>), dyoksidit të sulfurit (SO<sub>2</sub>) dhe emetimit të gazrave me efekt te seres.

Është planifikuar krijimi i një Qyteze kompakte dhe shumë funksionale që domosdoshmërisht duhet të kenë bashkëveprim në mes tyre në mënyrë që të arrihen qëllimet e ekzistimit të një entiteti urban. Funksionet kryesore të planifikuara do të përshkruhen me radhe në vijim:

Natyrisht se planifikohet të zhvillohet edhe më tej industria e çimentos me nxjerrjen e lëndës së parë në të dy minierat, si dhe industrinë e reja të lidhura me të. Kujdes i veçantë do të kushtohet edhe zhvillimit të transportit si suplement i industrisë dhe gjenerator i mundshëm i tregtisë me materiale ndërtimore. Për këtë qëllim do të shfrytëzohen hapësirat ekzistuese industriale, hapësirat në të cilat ka përfunduar nxjerrja e lëndës së parë, hapësirat dhe objektet e pashfrytëzuara të ish Salonitit, si dhe hapësirat në veri të Kosovoplastit të destinuara enkas për këtë lloj shfrytëzimi. Pra, sipas këtij skenari, shtrirja territoriale do të bëhet në hapësirat ekzistuese industriale dhe në jug të tyre.

Tregtia (ekzistuese dhe e re) e organizuar në qendër të qytetit, rreth magjistrales dhe në Lagjen e Re planifikohet të bëhet më e qëndrueshme. Kjo do të ketë ndikime të anasjella me shërbimet më të qëndrueshme (ekzistuese dhe të reja) hotelerie rreth magjistrales dhe në qendër të qytetit. Krejt këto (së bashku me produktin industrial, produktin bujqësor që do të promovohet në Lagjen e Re dhe Lagjen e Kufirit si dhe mjedisin natyror të përshtatshëm) do të veprojnë si një sinergji për zhvillimin e turizmit transit me qëllim tërheqjen e sa më shumë kalimtarëve nga magjistralla dhe autostrada e planifikuar dhe ndaljen e tyre për një kohë të caktuar në Han të Elezit. Pra ky zhvillim hapësinor do të promovohet rreth magjistrales, por vetëm brenda zonës urbane, duke e drejtuar atë në pikat e dëshirueshme brenda Qytezës së Hanit të Elezit dhe që njëherit do të shërbente si pikë ndalese për turizëm transit si dhe pikë promovuese dhe shpërndarëse për turizmin rural që është trajtuar në PZHK. Elementë të caktuar që do të përmirësohen dhe rregullohen për vizitorë janë pjesa e fabrikës së vjetër të çimentos, apartamentet më të vjetra në Han të Elezit ngjitur me të si dhe rikonstruimi i mundshëm i Hanit të vjetër si tregues i mikpritjes dhe traditës shërbyese hotelerie të Hanit të Elezit.

Qendra e Qytezës dhe Lagja e Parkut do të mbante dhe përmirësonte të gjitha funksionet si dhe do të krijonte të reja. Shërbimet shëndetësore, edukative, administrative (ekzistuese dhe të reja), sportive dhe rekreative si dhe parqet dhe hapësirat publike do të bëhen më të qëndrueshme. Shumë nga këto funksione do të shfrytëzohen hapësirat e ish ushtrisë që pas analizave të thukta janë destinuar për shfrytëzim më të mirë të mundshëm publik. Funksione të domosdoshme sociale planifikohen edhe në Lagjen e Re.

Për të arritur një kompaktësi hapësinore të Qytezës dhe si alternativë e zhvillimit horizontal stihik planifikohet një dendësim i banimit në të gjitha njësitë urbane me theks të veçantë në Qendër, Lagje e Re dhe Lagje e Parkut. Pra planifikohet ngritje e lartësisë së ndërtimit dhe shfrytëzim më racional i tokës në njësitë e përmendura.

Aspekti mjedisor dhe peisazhor gjithashtu është analizuar detalisht. Si parësore janë planifikuar reduktimi i ndotjes së ajrit, destinimi i hapësirës për parkun e Qytezës si dhe krijimi i shiritit të gjelbër kufizues në mes të njësive banuese dhe industrisë. Më vonë gradualisht do të procedohej edhe me zhvillime tjera si parqet e Lagjeve, hapësirave tjera publike, peisazhet urbane, sipërfaqeve sportive dhe rekreative, etj.

Edhe lidhjet rrugore do të jenë të domosdoshme si autostrada e re me hyrjen/daljen e saj, rruga lidhëse mes Qendrës dhe Lagjes së Re si dhe korridoret e tjera rrugore nëpër të gjitha njësitë.

*Përmes konsultimit me grupet e interesit të cilat ishin të përfshira në mënyrë thelbësore në proces, duke u bazuar në dokumentin e PZHK-së si dhe duke krahasuar variantet në aspektin e ndikimit social, ekonomik, mjedisor dhe të infrastrukturës në përgjithësi dhe lehtësinë e realizimit të atij zhvillimi, është analizuar dhe vlerësuar secili skenar dhe në fund është zgjedhur **Skenari C “HANI I ELEZIT “QYTEZË ME NJË ZHVILLIM***

***KOMPAKT DHE TË BALANCUAR***” si skenar në bazë të cilit do të zhvillohet plani. Siç u tha edhe më lart ky skenar ka kombinuar elemente të 2 skenarëve e tjerë (**skenari A dhe B**).


Modeli për zhvillimin hapësinor të Hani të Elezit është i bazuar në vlerësimin e analizës së gjendjes. Kjo analizë paraqet bazën për zhvillimin e ardhshëm hapësinor të Qytezës.

Hani i Elezit ka traditë në industri. Rezervat e lëndës së parë për prodhimin e çimentos janë baza kryesore për zhvillimin e ekonomik të komunës. Pasi është përcaktuar vendndodhja e këtij potenciali, zhvillimi i qytetit duhet të ndalohej në atë anë (lindore) dhe të promovohet në Qendrën ekzistuese të tij si dhe në anën perëndimore të lumit Lepenc pasi që mjedisi në anën perëndimore është më i pastër për shkak të rrymave të ajrit që krijohen nga lumi Lepenc. Zona e në të cilën ka përfunduar nxjerrja e lëndës së parë (dhe hapësirat që u përmendën më lart) duhet të përdoret për zhvillimin e industrive të reja. Do të promovohen industritë e reja të cilat mund të lidhen me industrinë ekzistuese (siç janë produktet me baza të çimentos). Duke marrë parasysh zonën kufitare, Hani i Elezit duhet të promovojë dhe mbështes bizneset e hotelarisë për turizmin transit – turizmin industrial dhe atë rural për të tërhequr njerëzit që të ndalen dhe të pushojnë aty. Zonat me resurse natyrore (lëndë të parë për çimento) do të konsiderohen për tu shfrytëzuar deri në një periudhë të caktuar; prandaj, zhvillimet tjera në atë zonë në të ardhmen duhet të kufizohen. Toka bujqësore urbane është paraparë të rigjenerohet edhe përkundër dendësimin të banimit si dhe është paraparë promovimi i produktit bujqësor. Zonat e trashëgimisë kulturore, natyrore dhe industriale do të mbrohen dhe promovohen për zhvillimin e turizmit.

## Harta 19



# Skenari C Scenario



## Legjenda / Legend

	Kufiri urban / Urban border		Industria/Transporti/Tregti me p.i / Industry/ Transport/Trade with Ip.		Terminali doganor / Customs terminal
	Qendra / Centre		Mihja / Mining		Qendra e Qytezës / Town centre
	Lagja e Parkut / Park Neigh.		Lënda e parë - mergele / Raw material - mergele		Pika kufitare / Border point
	Z. Industriale / Industrial z.		Turizmi dhe hotelieritë / Tourism and hotelier serv.		Koridoret rrugore lokale / Local road corridors
	Lagja e Re / New neigh.		Banim i ultë me kopshte / Low housing with gardens		Magjistralja / Highway
	Analumi / Riverside		Banim i mesëm/për. shoqërore/biznese / Medium housing/soc. functions/businesses		Hekurudha / Railway
	Lagja e kufirit / Border neigh.		Park, sport, rekreacion, bujqësi / Parc, sport recreation, agriculture		Autostrada / Motorway



### 3.1.2. Elementet kryesore strukturore

*Elementet kryesore strukturore që e përbëjnë konceptin e përgjithshëm të Hanit të Elezit janë:*

- *Struktura natyrore dhe peizazhi*
- *Infrastruktura*
- *Struktura fizike e ndërtuar (banimi, industrinë, bizneset, përmbajtjet publike)*

**Struktura natyrore dhe peizazhi**– përbëhet prej sipërfaqeve të gjelbra të cilat duhet të jenë të lidhura ngushtë njëra me tjetrën me qëllim të krijimit të një tërësie natyrore. Në këto sipërfaqe hyjnë : parqet, arteriet dhe korridoret gjelbëruese, bregu i lumit, dhe përrrenjve, tokat bujqësore, oborret e gjelbra, pemishtet dhe sheshi i qytetit. Pjesë përbërëse e kësaj tërësie janë edhe sipërfaqet e dedikuara për sport dhe rekreacion.

Për ta artikuluar këtë element, zbatimi i konceptit të tillë duhet të orientohet në zhvillimin e bujqësisë së vogël urbane dhe në shfrytëzimin e potencialeve natyrore dhe kulturore/industriale për turizëm transit. Promovimi, përmirësimi dhe përforcimi i këtyre sipërfaqeve ndikon në zhvillimin e konceptit të përgjithshëm.

Koncepti kryesor për **strukturën e ndërtuar**, është që të arrihet një strukturë sa më kompakte me qëllim të ndalimit të shpërndarjes. Zhvillimi duhet të kufizohet brenda sipërfaqes së planifikuar për ndërtim. Kompaktësia arrihet duke u kompletuar dhe përforcuar së pari struktura ekzistuese fizike. Densifikimi është koncepti me të cilin mund të arrihet synimi për qytetin kompakt, ndërsa funksionet e tyre duhet ta plotësojnë njëri-tjetrin në mënyrë koherente.

*Janë definuar katër lloje përmbajtje hapësirash të cilat kanë nevojë të trajtohen:*

- *Përqendrimi i objekteve të banimit*
- *Përqendrimi i përmbajtjeve administrative*
- *Përqendrimi i përmbajtjeve ekonomike/industriale*
- *Përqendrimi i përmbajtjeve ekonomike/bizneset tregtare, transportuese, të hotelerive, etj.*
- *Përqendrimi i përmbajtjeve rekreative*

Objektet administrative janë të përqendruara në qendër të qyteti dhe planifikohen të zgjerohen me tej në një pjesë të lagjes së parkut, por gjithmonë duke i kushtuar një kujdes të veçantë ruajtjes së Parkut. Parqet (hapësirat e gjelbra) me përmbajtjet e saj: bregu i lumit Lepenc; trashëgimia industriale me pjesën e vjetër të fabrikës së çimentos dhe banesat me apartamente afër saj; ndërtimi i Hanit, janë disa prej komponentëve të cilat ndikojnë në përforcimin e identitetit dhe karakterit të qytetit nga ai industrial ndotës në atë industrial mikpritës. Këto zona duhet të lidhen me qendrën në atë mënyrë që të plotësojnë njëra-tjetrën. Hapësira e qendrës duhet me doemos të përforcohet në pikat e saj strategjike, me qëllim të theksimit të kompaktësisë.

Përmbajtjet ekonomike në përgjithësi, si hapësira të punës të cilat gjenerojnë vende pune dhe zhvillim ekonomik, duke shfrytëzuar resurset financiare, njerëzore dhe teknike, ndikojnë në forcimin e strukturës kompakte dhe e gjallërojnë qytetin e Hanit të Elezit.

Sjellja e industrive të reja që janë të lidhura ngushtë me prodhimet e çimentos dhe materialeve ndërtimore në përgjithësi do të ndihmonë në ngjalljen e qytetit në aspektin ekonomik dhe me këtë Hani i Elezit do të konsolidonte karakterin e një qendre të zhvilluar ekonomike. Opsionet për hapësirat e kësaj nevojë mund të jenë sipërfaqet e mihjes sipërfaqësore në të cilat ka përfunduar marrja e xehes (në lindje të fabrikës së çimentos), sipërfaqet dhe objektet e ish fabrikës së "Salonitit" si dhe sipërfaqet në jug të fabrikës së stiroporit. Zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme është qenësor për përparimin e zhvillimit ekonomik të qytetit.

**Rrjeti i infrastrukturës**, si arterie e zhvillimit, bën lidhjen e strukturës natyrore dhe asaj fizike të ndërtuar. Krijimi i një rrjeti efikas të transportit dhe infrastrukturës teknike ndihmon në lidhjen e të gjitha funksioneve brenda dhe jashtë qytetit. Kjo arrihet me përmirësimin e rrugëve ekzistuese dhe krijimin e një sistemi efikas të rrugëve lokale në nivelin urban si dhe lidhje të mire me autostradën e planifikuar dhe mundësinë e një qasje sa më të mire në favor të qytetit të Hanit të Elezit..

### 3.1.3 Koncepti i formimit/zgjerimit urban dhe hapësinor

Mundësitë hapësinore të zgjerimit të zonës së ndërtuar urbane janë të kufizuara, nëse merren parasysh qëllimet për ruajtjen e tokës bujqësore dhe mungesën e infrastrukturës. Për krijimin e një koncepti të arsyeshëm në planifikimin e zgjerimit urban dhe hapësinor të Hanit të Elezit duhet të merren parasysh këta faktorë:

- *Kushtet natyrore (topografike, gjeologjike, hidrologjike, klimatike , pedologjike etj)*
- *Sipërfaqja aktuale e tokës së ndërtuar*
- *Sipërfaqja aktuale e tokës jo të ndërtuar ( toka bujqësore, hapësirat e gjelbra, etj)*
- *Parashikimet demografike*
- *Dendësia banuese e parashikuar*
- *Dendësia e ultë banuese sidomos në pjesët periferike të qytetit.*

Zgjerimi hapësinor varet edhe nga kualiteti ekzistues i sipërfaqeve tokësore, të cilat për shkak të karakteristikave topografike dhe të tjera (sipërfaqja e xehes së nxjerrë), dallojnë në mes vete edhe brenda Hanit të Elezit. Gjithashtu është marrë parasysh edhe kualiteti tokës bujqësore , ku brenda zonës urbane të gjitha tokat janë të kategorisë VI e më lart nga gjithsej 8 ekzistuese. Megjithatë është paraparë ruajtja e tokave bujqësore deri në një shkallë duke pasur parasysh traditën e bujqësive familjare si dhe kushtet e favorshme klimatike që mbretërojnë në këtë pjesë të Kosovës. Pra do të kufizohet ndërtimi i pakontrolluar me anë dendësie të planifikuar të banimit. Kjo vlen më së shumti për Lagjen e Re, Lagjen e Parkut, Analumin, dhe Lagjen e Kufirit. Aktiviteti në këto toka duhet të jetë aktivitet i natyrës bujqësore dhe banimit.

Toka e pandërtuar si potencial për zhvillim të mëtutjeshëm duhet të shfrytëzohet për qëllime bujqësore, industriale apo biznesi. Për këtë arsye është e nevojshme që shfrytëzimi i saj të jetë sa më racional që është e mundur. Duke u mbështetur edhe në deklaratën e vizionit “për një ambient të mirë dhe zhvillim të bujqësisë”, këto hapësira duhet të fuqizohen dhe zhvillohen. Hapësirat e gjelbra duhet të jenë pjesë përbërëse e qytetit me qëllim të mbajtjes dhe të krijimit të një ekosistemi të integruar brenda dhe jashtë qytetit.

Sipërfaqja e ndërtuar është rreth 75 ha me dendësi banuese prej 25 ban/ha, që konsiderohet si një dendësi mjaft e ulët. Nga kjo shihet qartë se qyteti i Hanit të Elezit karakterizohet me një strukturë hapësinore të shpërndarë dhe të zhvilluar në mënyrë horizontale.

Në Han të Elezit shtimi i popullsisë ka pasur një rritje të shtuar nga ajo normale me hapjen e fabrikës së çimentos. Ky normalitet u ndikua negativisht gjatë viteve të 90-ta të shekullit të kaluar me migrimin e të rinjve jashtë Kosovës . Gjithashtu pas vitit 1999 pati edhe një shtim të rritjes konstante të popullsisë. Marrë parasysh këto që u thanë më lart dhe të dhënat e prezantuara në pjesën e profilin ku thuhet se shtimi i popullsisë iu është kthyer normalitetit me trend minimal të zvogëlimit të këtij trendi, mundë të thuhet se në përgjithësi shtimi i popullsisë ka qenë dhe është konstant në Han të Elezit.

Gjatë planifikimit janë llogaritur nevojat e popullatës së lindur menjëherë pas 1999 për krijim të familjes. Meqenëse një pjesë e popullsisë jeton dhe punon jashtë Kosovës, kërkesat për ndërtim në sektorin e banimit janë më të vogla. Gjeneratat e reja të familjeve në diasporë të cilat zgjerohen, kanë kërkesa më të vogla për hapësirë banimi dhe në të shumtën e rasteve për apartamente. Prandaj, rritja e dendësisë së banimit mund të konsiderohet si strategji e cila ndihmon ruajtjen e tokës dhe zvogëlon koston e infrastrukturës.

Rritja e dendësisë ndihmon në ofrimin e kualitetit më të lartë jetësor. Përfitimet nga dendësia e lartë janë të aspektit social, ekonomik, dhe mjedisor. Këtu duhet përfshirë zvogëlimin e konsumit të burimeve bazike si: toka dhe uji, energjia, pastaj zvogëlimi i koston së infrastrukturës, zvogëlimit të transportit.

Dendësia banuese maksimale në Qendër, duke pasur afërsinë e industrisë dhe traditën jetësore të banorëve, duhet të kufizohet në 150-175 ban/ha, ndërsa ajo minimale duhet të jetë së paku 50 ban/ha duke përfshirë edhe hapësirat mikste banim- bujqësi të Lagjes së Re, Analumit, Lagjes së Parkut dhe Lagjes së Kufirit.

Duke marrë parasysh sipërfaqet që zënë apartamentet e vjetra shumëkatëshe si dhe sipërfaqet e zbrazëta shikuar në suaza të tokës së ndërtuar/të pandërtuar të brenda qytetit dhe kërkesat aktuale për ndërtim të lartë në qendër të qytetit dhe faktorë tjerë, është përcaktuar kufiri i zonës urbane të Hanit të Elezit.. Gjithashtu është një trend i ndërtimit të lartë përgjatë rrugëve kryesore të qytetit, kështu që tendenca

është që të balancohet zhvillimi duke zvogëluar zgjerimin në tokën bujqësore dhe në distanca të mëdha nga qyteti. Çdo zgjerim i theksuar hapësinor do të rezultonte me një dendësi të ultë banuese nën kriteret urbane që do të kishte për pasojnë shfrytëzimin joracional të tokës (sidomos asaj bujqësore) si dhe rritjen e kostos së infrastrukturës sociale dhe fizike.

Prandaj koncepti i zgjerimit hapësinor të qytetit të Hanit të Elezit për vitin 2025, parasheh zgjerimin në hapësirat e “zbrazëta” brenda zonës urbane duke përfshirë të gjitha Njësitë, stimulimin e zgjerimit të kontrolluar në anën perëndimore të Lumit Lepenc si dhe zgjerimin me anë të rritjes së dendësisë. Natyrisht se duhet shikuar mundësia e zgjerimit minimal përreth kufirit aktual të zonës urbane në rast të arritjes së dendësisë ndërtimore të planifikuar dhe pamundësisë se shfrytëzimi të atij ndërtimi duke u bazuar në traditën e ruajtjes së pronës për pasardhësit.

Si hapësirë potenciale për zhvillimin e jetës publike si dhe të turizmit në të ardhmen, duhet të merret parasysh zona e qendrës së qytetit si hapësirë përmbledhëse e trashëgimisë industriale (pjesa e vjetër e fabrikës dhe dy apartamentet e vjetra afër saj te cilat janë ndërtesat e para të këtij lloji në Han të Elezit), trashëgimisë kulturore (Hani) si dhe hapësirat e gjelbra (parku, bregu i lumit, arteriet e gjelbra, **përmbajtjet sportive**). Natyrisht se duhet bërë të gjitha lidhjet e duhura hapësinore me sipërfaqet e turizmit rural sipas PZHK-së. Në kuadër të kësaj propozohen hulumtimet e duhura për zonën në përgjithësi dhe potencialet e saj dhe mundësitë e rigjenerimit.

Koncepti i formimit urban dhe zhvillimit të mëtutjeshëm hapësinor për qytetin e Hanit të Elezit dhe përkrahja e modelit të qytetit kompakt është shqyrtuar më hollësisht në vijim.

Forma urbane e ndërtuar e Hanit të Elezit zë fill me ndërtimet e barakave për banim dhe apartamenteve 2-3 katërshe afër fabrikës së çimentos (tash zona e qendrës së qytetit) diku kah vitet e pesëdhjeta të shekullit të kaluar. Më vonë, me ndërtimin e pjesës së re të kësaj fabrike u vazhdua me ndërtimin e apartamenteve tjera që tani formojnë tërësinë e apartamenteve ekzistuese. Atëbotë këto ndërtesa ishin ndërtuar në një vijë ndërtimore të rregullt dhe të shpërndara nga magjistrallja deri te stacioni hekurudhor. Apartamentet u jepeshin në shfrytëzim punëtorëve të fabrikës. Me kohë u asfaltuan rrugët kryesore rreth tyre (diku 800 metra), u instalua sistemi i ujësjellësit dhe kanalizimit si pjesë e sistemit të fabrikës. Për nevoja të këtyre banorëve u ndërtua shtëpia e kulturës me kino e më vonë edhe shkolla fillore. Afërsia e Shkupit ndihmonte banorët në kryerjen e shërbimeve të tjera shoqërore dhe ekonomike që nuk i kishin në Han të Elezit.

Përveç ndotjes së ajrit si fenomen përcjellës i zhvillimit industrial, Hani i Elezit, shikuar në kontekstin e shtrirjes hapësinore me strukturat që u përmendëm më lart, kishte një bazë të mirë për zhvillim të mëtutjeshëm urban. Mirëpo ndërtimet e më pastajme të banimit të veçantë të cilat u bënë ad-hoc dhe të pakontrolluara dhe që përkonin me zhvillimin e hovshëm industrial të viteve të shtatëdhjeta dhe tetëdhjeta e dëmtuan këtë strukturë. Si pasojë pati uzurpim të tokave bujqësore, ngushtim të rrugëve, lidhje ilegale në sistemin ujësjellësit dhe kanalizimit dhe në përgjithësi rënje të standardit të banimor. Dendësia e banimit ishte e vështirë të kontrollohej. Ky trend vazhdoi deri në periudhën e pasluftës (pas 1999) ku tashmë kemi edhe dy apartamente tetëkatëshe si dhe banimin e veçantë të shpërndarë në të gjitha njësitë urbane, përveç zonës industriale.

Zhvillimi i mëtutjeshëm i formës së shpërndarë të zgjerimit të qytetit do të shkaktojë probleme me zënien e mëtejme të tokës bujqësore, do të ndikojë në shtrenjtimin e infrastrukturës, rritë distancat e qarkullimit. Prandaj duhet të gjenden zgjidhje emergjente për parandalimin e zgjerimit të tillë. Për arritjen e në forme urbane të qëndrueshme është i përshtatshëm modeli i qytetit “kompakt”. Kjo do të thotë aplikimi i strategjive të densifikimit, kompaktësisë, koncentrimit, llojllojshmërisë së funksioneve dhe llojeve të ndryshme të banimit.

Zhvillimi kompakt tenton shfrytëzim sa më racional të hapësirës përmes dendësimin të ndërtimit dhe zhvillimeve brenda një hapësire të kufizuar.

*Qyteti kompakt është vendbanim urban me dendësi të lartë që përfshinë këto koncepte:*

- *Revitalizimi i qendrës së qytetit*
- *Zhvillimi i densifikuar*
- *Zhvillimi i funksioneve të përziera*
- *Shërbime sociale dhe të tjera: qendra shëndetësore, parqe, shkolla, qendra kulturore etj.*

“Qyteti kompakt” fokusohet në dendësi të lartë dhe qasje më të mirë e cila redukton varësinë në shfrytëzimin e veturave për kokë banori, sidomos udhëtimin që është i nevojshëm për furnizim me ushqim dhe shërbime tjera. Përparësitë e qytetit kompakt janë: ruajtja e sipërfaqeve të gjelbra, nevoja më e vogël për të udhëtuar me automobil, niveli më i ulët i emisioneve nga djegia e karburanteve; mundësia e ecjes dhe çiklizmit; qasje më e mirë në shërbime dhe përmbajtje tjera sociale, shërbime komunale dhe pajisje infrastrukturore më efikase; revitalizmi dhe rigjenerimi i hapësirave të brendshme urbane.

Suksesi i zhvillimit kompakt nënkupton bashkëveprimin e zhvillimit të funksioneve të përziera dhe të infrastrukturës së transportit publik, kufinj të përcaktuar urban dhe koordinimin në mes të dy niveleve të qeverisë - qendror dhe lokal.

Duke u mbështetur në konceptin e një qyteti kompakt, koncepti i zgjerimit hapësinor duhet të bazohet në tri elemente kryesore:

**Shtimi i dendësisë përmes ngritjes së lartësisë së ndërtimit,** duhet të përqendrohet kryesisht në Qendrën e Qytetit, Lagjen e Parkut dhe Lagjen e Re me qëllim të krijimit të një zone urbane sa më kompakte. Kjo mund të arrihet me ngritjen në lartësi të ndërtesave në qendër, në pikat fokale të funksioneve me rëndësi të posaçme për qytetarët dhe në hapësira të tjera me ambient sa më të pastër, të cilat bazuar në normat dhe standardet e ngrisin kualitetin mjedisit jetësor.

Kjo dendësi mund të shkojë deri në 150-175 banorë për hektarë në qendër. Në pjesët periferike dendësia mund të jetë më e vogël dhe e kontrolluar deri në 100 banorë për hektarë në Lagjen e Re dhe të Parkut, por jo më pak se 50 banorë për hektarë në të gjitha njësitë tjera. Kjo dendësi në lagjen e Analumit do të ndikohet nga autostrada e planifikuar që do të kalojë pranë saj.

**Densifikimi apo zhvillimi në zbrazëtirat brenda qytetit,** është po ashtu një strategji për arritjen e qytetit kompakt. Këto zbrazëtira mund të shfrytëzohen kryesisht për plotësimin e qytetit me funksione të domosdoshme si banim i përzier, institucione sociale, publike, afarizëm dhe shërbime etj. Gjatë densifikimit,

duhet të respektohet skema e strukturës ekzistuese të qytetit e cila vlerësohet si njëri nga elementet e identitetit urban të Hanit të Elezit.

**Zgjerimi në hapësira periferike,** Marrë parasysh strukturën e tashme të ndërtuar të Hanit të Elezit dhe me qëllim të krijimit të një qyteti kompakt duhet të kufizohet zgjerimi në hapësirat periferike. Sipas nevojës këto hapësira periferike duhet të definohen dhe të rezervohen për zgjerim pas shfrytëzimit të të dy elementeve tjera të përmendura më lart.

### 3.1.4 Përkufizimi dhe ndarja e zonës urbane

Bazuar në Ligjin për Planifikim Hapësinor (nr.2003/14, neni 2), zona urbane është toka me kufijtë të përcaktuar brenda suazave të së cilës është planifikuar ndërtimi urbanistik.

Mënyra më e qartë për ta definuar zonën urbane është në suaza të kufirit të tij administrativ. Zona urbane e Hanit të Elezit është definuar dhe si e tillë është aprovuar në Asamblenë Komunale. Kjo ka për qëllim definimin e hapësirave dhe destinimin e sipërfaqeve ku përfshihen sipërfaqet e ndërtuara urbane, sipërfaqet e gjelbra të ashtuquajtura urbane si dhe sipërfaqet tjera (industriale, bujqësore, etj). Me këta kufij të definuar qartë dhe ligjërisht të detyrueshme, dhe më një vetëmohim të administratës së nivelit qendror dhe lokal, qyteti i Hanit të Elezit ka mundësi që të kufizojë shpërndarjen nëpër pjesët periferike dhe mos dëmtimin e tokës bujqësore, hapësirave natyrore dhe të trashëgimisë.

Zona urbane e Hanit të Elezit gjithnjë është trajtuar nga banorët vendas dhe të fshatrave përreth si qendër përmbledhëse e këtyre fshatrave. Mirëpo edhe pse Hani i Elezit ka qenë pjesë përbërëse e Komunës së Kaçanikut nuk ka pasur ndonjëherë ndonjë kufi urban. Kjo reflektohet me ndërtime të shumta të pakontrolluara në tokën bujqësore, afër brigjeve të lumit, përgjatë rrugëve kryesore etj. Kjo është si pasojë e presionit për ndërtim dhe mungesës së planeve dhe akteve rregulluese.

Ky plan nuk duhet vetëm të ofroj mundësi për zhvillim duke planifikuar tokën ndërtimore, por njëkohësisht duhet të kufizojë ndërtimin në zona të caktuara të ndërtimeve që degradojnë mjedisin, shkatërrojnë potencialet (tokën bujqësore) apo rrezikojnë jetën e njerëzve (erozioni, vërshimet,

rëshqitjet e dheut,etj). Përcaktimi i kufijve të qartë në mes të tokës ndërtimore dhe asaj jondërtimore konsiderohet si hap i parë drejt organizimit hapësinor të qëndrueshëm urban.

**Sipërfaqja banuese dhe publike** përkufizohet si hapësirë në të cilën lejohet ndërtimi brenda rregullave të përcaktuara. Këto hapësira janë të përbëra prej funksioneve të banimit, publike dhe të biznesit.

**Sipërfaqe administrative** dhe shërbimeve është e definuar si hapësirë e përbëra nga sipërfaqet administrative, edukative, fetare dhe shëndetësore.

**Sipërfaqja industriale** është e definuar si hapësirë e përbëra nga sipërfaqet industriale dhe sipërfaqet e lëndës së parë. Këtu do të lejohet ndërtimi vetëm për industri dhe nevojat përcjellëse të saj.

**Sipërfaqja e gjelbër** është sipërfaqja natyrore apo jo e ndërtuar brenda territorit urban, shfrytëzimi i së cilës është kryesisht i dedikuar për bujqësi, parqe, arterie dhe korridore të gjelbra, sport dhe rekreacion. Këtu po ashtu përfshihen dhe brigjet e sipërfaqeve ujore. Në shumicën e hapësirave ndërtimi nuk është i lejuar, vetëm ndërtime të cilat mbështesin aktivitetet e definuara me planin e shfrytëzimit të tokës.

**Sipërfaqja e transportit** është toka e rezervuar për korridore të transportit, ku përveç rrugëve janë edhe përmbajtjet tjera si: trotualet për këmbësor, çiklistët, parkingjet, pikat e stacioneve hekurudhor dhe të autobusëve, shiritat të gjelbërimit rreth rrugëve etj. Në të po ashtu hyjnë edhe instalimet teknike. Kjo sipërfaqe është e dedikuar vetëm për qarkullim të transportit dhe infrastrukturë teknike dhe në të ndalohet rreptësisht ndërtimi.

Gjatë analizave të mëtejme Zona Urbane e Hanit të Elezit është ndare në 6 njësi më të vogla bazuar në konfiguracionin e terrenit dhe ndarjet fizike/natyrore dhe infrastrukturore.

1. Qendra qytetit,
2. Parku I qytetit,
3. Industria
4. Ana lumit,
5. Lagja e re dhe
6. Lagja te kufiri

Lagjet e ndara në 6 tërësi fizikisht i ndanë hekurudha, magjstralja, lumi dhe industria. Këto lagje nuk kanë lidhje të mira si tërësi, kështu që në këtë plan është shqyrtuar mundësia e lidhjeve më të mira infrastrukturore që do të përmirësojë lidhjet dhe komunikimin sa më të mira ndërmjet këtyre lagjeve.

## 3.2 Struktura e zhvillimit hapësinor të Qytetit

### 3.2.1 Struktura e planifikuar hapësinore-zonimi i shfrytëzimit të tokës

Struktura e planifikuar hapësinore është pasqyrim i vizionit në aspektin hapësinor me anë të diagramit/skemës. Struktura e propozuar hapësinore nuk është riprodhim i realitetit por i synimeve/ koncepteve. Struktura funksionale dhe hapësinore e propozuar bazohet kryesisht në gjendjen ekzistuese strukturore e hapësinore, tendencat ekzistuese të zhvillimit, potencialet dhe qëllimet zhvillimore.

Plani i shfrytëzimit të tokës përfshinë tërë territorin e zonës urbane të Hanit të Elezit me sipërfaqe banuese /publike, sipërfaqet administrative/shërbimeve, sipërfaqe industriale, sipërfaqe të gjelbra dhe sipërfaqe të transportit.

Sipërfaqja banuese/publike përfshinë sipërfaqe prej 43.28 ha, sipërfaqja e gjelbër 57.49 ha, sipërfaqja industriale 33.13, ndërsa sipërfaqja e transportit përfshinë një sipërfaqe prej 25.64 ha.

Në periudhën 15 vjeçare të parashikuar me Planin zhvillimor Urban të gjitha funksionet ekzistuese të Hanit të Elezit duhet të përparohen dhe të përforcohen, ndërkaq me qëllim të plotësimit të nevojave të qytetit, duhet të krijohen funksione tjera .

Sipërfaqja e planifikuar për ndërtim do të arrijë deri 93.68 176.20 ha. Nga kjo sipërfaqe totale, funksioni i banimit do të arrijë në 74.40 87.90 ha ndërsa pjesa qendrore e qytetit me përbërje të banimit dhe funksioneve

të përziera– shërbime publike e administrative do të këtë sipërfaqe prej 31.88ha.

Sipërfaqet e gjelbra janë vlerësuar si të mjaftueshme për zhvillimin e aktiviteteve sportive, rekreative dhe bujqësore. Duhet cekur se pasi që sipërfaqja e tokës ndërtimore për zhvillimin e ardhshëm rritet, njëkohësisht sipërfaqe e gjelbër do të zvogëlohet (më së shumti sipërfaqja bujqësore).

Kryesisht zvogëlimi i sipërfaqes së gjelbër do të bëhet me dendësimin e planifikuar të banimit nëpër hapësira të lira (livadhe ose kopshte familjare), hapjen e rrugës së re që do të lidh qendrën me Lagjen e Re, ndërtimin e përmbajtjeve administrative në Lagjen e Parkut, ndërtimin e çerdhes, etj; ndërsa prej sipërfaqeve

të gjelbra që do të rriten janë parqet në kuadër të lagjeve të banimit, arteriet dhe korridoret e gjelbra, lokacionet e reja për sport dhe rekreacion.

Këtë rritje do ta bëjnë rrugët ndihmëse për kyçje në autostradë, hapja e rrugës lidhëse qendër-Lagja e Re, zgjerimi i rrugëve të ngushta ekzistuese, shtigjeve për këmbësorë, biçiklistë, etj.

#### Kategoritë kryesore të tokës urbane

<b>1.1 SIPËRFAQE BANUESE/PUBLIKE</b>	<b>%</b>	<b>ha</b>
<b>BANIM I LARTË/BIZNES</b>	<b>10</b>	<b>16.74</b>
a) Ndërtesat banuese me apartamente deri ne 5+nënkulm etazhe mbi nivelin e terrenit		
b) Objektet përcjellëse për nevojat e banorëve siç janë: garazhet, punëtoritë e shtëpiakut, etj		
c) Funksione tregtare-ndërmarrje duke përfshirë edhe ndërmarrjet bujqësore, të cilat nuk shkaktojnë ndotje të ajrit dhe zhurmë, ose pengesa tjera.		
d) Restorante dhe hotele deri 40 shtretër, nëse nuk influencojnë karakterin e zonës. Bizneset dhe ndërmarrjet e vendosura në zonat e banimit të përziera duhet të korrespondojnë me strukturën e banimit dhe nuk duhet të ndikojnë në kualitetin e jetës, mjedisin si dhe karakterin dhe identitetin e zonës banuese.		
e) Shërbime të cilat janë të rëndësishme për nevojat e banorëve si ato arsimore, shërbime kulturore e sociale, të administratës publike si dhe shërbime të tjera.		
f) Sipërfaqe të gjelbra rreth trotuareve, etj		
<b>BANIM I MESËM/COMMERCE</b>	<b>6</b>	<b>9.10</b>
a) Ndërtesat e banimit të veçantë deri ne 3+nën kulm etazhe mbi nivelin e terrenit		
b) Objektet përcjellëse për nevojat e banorëve siç janë: garazhet, punëtoritë e shtëpiakut, etj		
d) Turizëm dhe dhoma akomoduese, restorante, kafene, etj		
e) Sipërfaqe të gjelbra rreth trotuareve, etj		
<b>BANIM I ULTË/BIZNES</b>	<b>8</b>	<b>13.29</b>
a) Ndërtesat e banimit të veçantë deri ne 2+nën kulm etazhe mbi nivelin e terrenit		
b) Objektet përcjellëse për nevojat e banorëve siç janë: garazhet, shtëpizat e kopshtit, lulishtet dhe të ngjashme		
c) Ndërmarrje të vogla bujqësore, tregti dhe shitje me pakicë si ndërmarrje, qendra tregtare dhe zejtare, shitore dhe ndërtesa të ngjashme që janë nevoja të arsyeshme të qytetarëve dhe komunës.		
d) Turizmi dhe funksionet e akomodimit si dhoma, restorante dhe kafene		
e) Oborre të gjelbra, sipërfaqe të gjelbra rreth trotuareve, etj		
<b>BANIM I ULTË/KOPSHTE</b>	<b>17</b>	<b>26.55</b>
a) Ndërtesat e banimit të veçantë deri ne 2+nën kulm etazhe mbi nivelin e terrenit		
b) Objektet përcjellëse për nevojat e banorëve siç janë: garazhet, shtëpizat e kopshtit, lulishtet dhe të ngjashme		
c) Oborre të gjelbra, kopshte, pemishte, livadhe dhe ara të vogla, etj.		
c) Ndërmarrje të vogla bujqësore		



<b>PËRMBAJTJE PUBLIKE</b>	<b>4</b>	<b>6.22</b>
a) Funksionet arsimore si; institucionet parashkollore, shkollat fillore, shkolla e mesme dhe shkollat profesionale		
b) Funksionet e shëndetësisë dhe të mbrojtjes sociale– qendra kryesore e mjekësisë familjare, barnatoret, qendrat për punë sociale		
c) Funksionet kulturore– qendra kryesore kulturore, qendrat e komunitetit		
d) Funksionet tjera publike– stacioni i autobusëve, stacioni i zjarrfikësve, posta, banka, policia etj		
e) Funksionet administrative-ndërtesa e komunës dhe shërbimet lidhur me to, gjykata komunale, pika kufitare, terminali doganor, etj		
<b>BIZNES</b>	<b>2</b>	<b>2.50</b>
a) Funksione tregtare-ndërmarrje duke përfshirë edhe ndërmarrjet bujqësore, të cilat nuk shkaktojnë ndotje të ajrit dhe zhurmë, ose pengesa tjera.		
b) Restorante dhe hotele deri 40 shtretër, nëse nuk influencojnë karakterin e zonës. Bizneset dhe ndërmarrjet e duhet të korrespondojnë me strukturën e banimit dhe nuk duhet të ndikojnë në kualitetin e jetës, mjedisin si dhe karakterin dhe identitetin e zonës banuese.		
c) Pompa të Benzinës		

<b>1.2 SIPËRFAQE INDUSTRIALE</b>	<b>%</b>	<b>ha</b>
<b>INDUSTRIA</b>	<b>11</b>	<b>18.23</b>
a) Ndërmarrje me prodhim industrial (prodhim i çimentos dhe stiroporit) të cilat shkaktojnë ndikim të vogël në mjedis, por jo ndërmarrje të cilat mund të paraqesin rrezik potencial shpërthyes apo rrezatim në rrethinë		
b) Objekte të tjera përcjellëse si objekte administrative, banimi, kuzhina dhe mensa, etj.		
<b>LËNDA E PARË</b>	<b>7</b>	<b>11.83</b>
a) Sipërfaqe për nxjerrjen e lëndës së parë për prodhimin e çimentos (mergele dhe gurë gëlqeror)		
b) Objekte përcjellëse për nevoja të transportit të lëndës së parë dhe për nevoja të personelit që punon aty		
<b>INDUSTRI E RE</b>	<b>1</b>	<b>1.05</b>
a) Ndërmarrje me prodhim industrial (primare janë produktet nga lënda e parë e çimentos apo tjera lidhur me materialet ndërtimore, por nuk përjashtohen edhe tjerat) të cilat shkaktojnë ndikim të vogël në mjedis, por jo ndërmarrje të cilat mund të paraqesin rrezik potencial shpërthyes apo rrezatim në rrethinë		
b) Objekte të tjera përcjellëse si objekte administrative, banimi, kuzhina dhe mensa, etj.		


<b>1.3 SIPËRFAQE E GJELBËR</b>	<b>%</b>	<b>ha</b>
<b>SHESHI I QYTETIT</b>	<b>0.4</b>	<b>0.73</b>
a) Këtu përfshihet sheshi i qytetit me sipërfaqet e gjelbra publike, rrugët për këmbësorë, ulëset, etj		
<b>PARQET DHE HAPËSIRAT E TJERA TË GJELBRA</b>	<b>7</b>	<b>11.62</b>
a) Sipërfaqet e dedikuara për parqe dhe kopshte publike duke përfshi edhe sipërfaqet për pushim		
b) Sipërfaqe në mes të hapësirave me destinime të ndryshme dhe mbrojtëse ndaj ndotjes së ajrit dhe zhurmës. Këtu bëjnë pjesë edhe korridoret e gjelbërimit përgjatë rrugëve.		
c) Hapësira të gjelbra publike të lagjeve		
<b>SPORT DHE REKREACION</b>	<b>1</b>	<b>1.69</b>
a) Sipërfaqet e dedikuara për sport në zonat e gjelbra duke përfshirë, terrenet e e sportit, objektet e hapura dhe të mbyllura, basenet e hapura dhe sipërfaqet e nevojshme të parkimit.		
<b>SIPËRFAQET UJORE</b>	<b>7</b>	<b>11.68</b>
a) Janë të gjitha ujërat sipërfaqësor si lumi dhe përrenjtë bashkë me brigjet e tyre		
<b>TOKË BUJQËSORE</b>	<b>4</b>	<b>6.60</b>
a) Janë zonat të cilat shfrytëzohen për prodhimin e produkteve bujqësore, perimet, pemët apo ruajtjen e kafshëve shtëpiake		

<b>1.3 SIPËRFAQE E TRANSPORTIT</b>	<b>%</b>	<b>ha</b>
<b>RRUGËT</b>	<b>17</b>	<b>29.39*</b>
a) Janë të gjitha sipërfaqet e dedikuara për qarkullim të automjeteve		
b) Mundë të jenë të organizuara edhe trotualet për këmbësorë dhe shtigjet për çiklistë		
<b>SHTIGJET PËR KËMBËSORË DHE ÇIKLISTË</b>	<b>1</b>	<b>1.7</b>
a) Janë sipërfaqe publike të dedikuara ekskluzivisht për qarkullim të këmbësorëve dhe çiklistëve.		
<b>PARKINGJET PUBLIKE</b>	<b>0.7</b>	<b>1</b>
a) Janë sipërfaqe të rezervuara për trafikun në qetësi		
<b>GJITHSEJ ZONA URBANE</b>	<b>100</b>	<b>159.88</b>

**\*Autostrada e planifikuar kalon pjesërisht mbi shtratin e Lumit Lepenc (rreth 9.94 ha)**

## Harta 20

### Shfrytzimi i tokes



## 3.2.2 Zhvillimi social

### 3.2.2.1 Popullsia

Nga të dhënat e marra në terren për nevoja të PZHK/PZHU-së numri i banorëve në qytetin e Hanit të Elezit është 4016. Parashikimet për numrin e banorëve në të ardhmen në bazë të së cilës edhe vlerësohen kërkesat për njësi të reja banimi dhe për infrastrukturë të përgjithshme sociale dhe të tjera janë të bazuara në trendin e rritjes së popullsisë në tërë komunën dhe në zonën urbane në veçanti duke marrë parasysh edhe migrimin nga zonat rurale në zonën urbane, trendin e zvogëlimit të madhësisë së familjeve, nevojën e diasporës për banim , etj .

Në bazë të bazë të dhënave të marra nga Zyra e Regjistrimit Civil në Han të Elezit rreth indeksit të lindje/vdekjeve dhe bazuar në llogaritjet e PZHK-së është llogaritur shtimi me 1.1% në territorin e Hanit të Elezit. Bazuar në këtë llogaritjet tregojnë se qyteti i Hanit të Elezit pas 15 viteve do të ketë 717 banorë më shumë. Por sipas regjistrimit të popullsisë për nevoja të planifikimit gjatë vitit 2009 është vlerësuar se ka trend të migrimit të popullsisë nga zona rurale në zonën urbane.

Bazuar në tërë çka u tha më lart vlerësohet se në vitin 2025 numri i popullsisë së Hanit të Elezit brenda zonës urbane do të arrijë në rreth 4850 banorë. Prandaj për këto 15 vitet e ardhshme duhet të parashihet dhe të sigurohet strehimi dhe infrastruktura e përgjithshme edhe për rreth 800 banorë.

### 3.2.2.2 Infrastruktura sociale

Infrastruktura sociale është bazë për zhvillim të komunitetit, ajo para se gjithash ndihmon në ngritjen shpirtërore dhe intelektuale që në mënyrë të ndërsjellë pasqyron në ngritjen e kualitetit të jetës.

*Synimet e përgjithshme në aspektin social për një planifikim më të qëndrueshëm janë:*

- *Avancimi i Hanit të Elezit në një qendër më të përparuar lokale administrative, shëndetësore, arsimore e kulturore.*
- *Sigurimi i kushteve për krijimin e institucioneve të reja publike si dhe përmirësimin e gjendjes së institucioneve ekzistuese publike*

Gjatë planifikimit nuk janë paraparë ndryshime të mëdha në aspektin e vendosjes së këtyre shërbimeve. Kryesisht synohet pasurimi i përmbajtjeve, zgjerimi dhe përparimi i hapësirave ekzistuese për funksionim më të mirë.

Për zhvillim të shëndoshë të komunitetit duhet që secila lagje të këtë qasje në përmbajtjet e saj lokale të domosdoshme si: çerdhe-kopshtet, shkolla, qendra shëndetësore, shitoret, kafeneja, posta, banka dhe qendra lokale. Të gjitha këto përmbajtje duhet të përfshihen brenda një radiusi (shtëpi- përmbajtje lokale) deri në 600 m (7-8 minuta ecje në këmbë).

#### 3.2.2.2a Objektet e shëndetit publik

Institucionet shëndetësore në aspektin hapësinor dhe të funksionimit duhet të jenë të pajisura në atë mënyrë që të mund t'iu mundëson secilit individ të gjitha shërbimet jashtë nivelit të spitalit duke u bazuar në metodat bashkëkohore të punës.

Në Han të Elezit funksionin Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare. Në këtë Qendër graviton e gjithë popullata e Komunës së Hanit të Elezit. Raporti mjek për 1000 banorë është 0.59; kurse raporti shtretër për 1000 banorë është 0.69. Ky raport konsiderohet i ulët edhe për mesataren e Kosovës dhe vendeve fqinje

*Sipas kriterëve evropiane sipërfaqja e nevojshme e lokacionit duhet të arrijë 4-8 ha, ndërsa sipërfaqja e ndërtesës 1.2 m2/ban.*

Ndërtesa e QKMF-së në Han të Elezit ka vetëm 400m2 me rreth 0.14 ha sipërfaqe të parcelës; që do të thotë se as për së afërmi nuk i plotëson nevojat e qytetarëve.

Propozohet që në bazë të Ligjit për Shëndetësi nr. 2004/4 Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare të shtojë hapësirat fizike të nevojshme, shërbimet e emergjencës dhe shërbimet e nevojshme specialiste (pediatria, gjinekologjia, biokimia klinike) në mënyrë që të jetë në dispozicion të qytetarëve të Hanit të

Elezit. Me këto hapa parashihet edhe plotësimi i numrit të personelit të nevojshëm për funksionim normal.

### **3.2.2.2b      Institucionet shkollore**

**Institucionet parashkollore** duhet të kuptohen si nevojë sociale për kujdes të fëmijëve dhe me qëllim të përgatitjes së fëmijëve për shkollim të rregullt. Në kuadër të këtij plani janë paraparë lokacionet e përshtatshme për institucionet parashkollore.

*Kriteret për planifikimin e institucioneve parashkollore duhet të jenë:*

- 2000-2500 banorë për çerdhe/kopsht
- Qasshmëria me distancë prej 400m me dendësi 80-100 ban/ha dhe distancë 600 m me dendësi 40-60 ban/ha
- Sipërfaqja e lokacionit 0.25-0.3 ha (25m<sup>2</sup>/fëmijë)
- Sipërfaqja e ndërtesës bruto 4.5-6.5 m<sup>2</sup>/fëmijë
- Ndërtesa duhet të ketë maksimum 120 fëmijë

Në Han të Elezit nuk fare Institucion parashkollor. Duke u bazuar në numrin aktual dhe të projektuar të banorëve (rreth 4850 banorë) dhe karakterin deri vonë rural të vendbanimit, Hani i Elezit në planin afatshkurtër duhet të ketë 1 çerdhe. Ajo është paraparë të ndërtohet në mes të shkollës fillore dhe asaj të mesme. Në planin afatgjatë, në bazë të zhvillimit të përgjithshëm të planifikuar mundë të lindë nevoja edhe për një çerdhe në Lagjen e Re.

### **Institucionet e arsimit fillor dhe të mesëm të ulët**

Sigurimi i shkollave, qasja e lehtë e tyre është esenciale për shërbimin dhe rigjallërimin e komunitetit.

*Kriteret për planifikimin e institucioneve të edukimit fillor janë:*

- *Institucionet e edukimit fillor duhet të mbulojnë një numër prej 4000 banorë*
- *Distanca shtëpi-shkollë duhet të jetë prej 500 deri në 800m, varësisht prej dendësisë banuese*
- *Sipërfaqja e nevojshme e lokacionit duhet të arrijë prej 1-2 ha*
- *Hapësira e nevojshme shkollore me standarde kosovare është minimum 2m<sup>2</sup>/nxënës (standarde evropiane 3-5 m<sup>2</sup>/nxënës)*
- *Raporti nxënës-arsimtarë duhet të jetë maksimum 22nx/arsimtarë,*
- *Numri i nxënësve për shkollë duhet të jetë prej 200-500*
- *Mësimi shkolror duhet të mbahet në një turn*

Standardet një dhe tre janë të plotësuara në Han të Elezit me objektin dhe institucionin e vetëm ekzistues të shkollës fillore "Ilaz Thaçi". Parcela në të cilën është vendosur objekti ka 1.6ha. Standardet tjera nuk janë të plotësuara. Shkollë nuk ka hapësira të mjaftueshme mësimore, nuk ka fare hapësira të brendshme sportive, hapësirat e jashtme sportive dhe të gjelbra nuk janë të rregulluara. Parashihet ndërtimi i fazës së dytë të kësaj shkolle që do të përfshijë më shumë hapësira mësimore (duke përfshirë edhe klasat për parashkollore dhe kabinetet e ndryshme), hapësirën për shumë qëllime, sallën e arsimitarëve, bodrumin me kaldajën, etj. Klasa për fëmijë me nevoja të veçanta është paraparë të hapet në atë rast. Gjithashtu është paraparë edhe ndërtimi i palestrës së shkollës si faza përfundimtare e projektit.

Për numrin e planifikuar të banorëve për 15 vitet e ardhshme (rreth 4850 banorë), bazuar në normat dhe kriteret për planifikim si dhe standardet që u përmendën më herët (distanca shtëpi-shkollë, numri i nxënësve për një shkollë), qyteti i hanit të Elezit do të ketë nevojë për shkollë të re që do të përfshinte arsimin fillor dhe të mesëm të ulët. Shkollë është planifikuar të ndërtohet në Lagjen e Re.

### **Institucionet e arsimit të mesëm të lartë**

*Kriteret për planifikimin e institucioneve të edukimit të mesëm duhet të jenë:*

- *Institucionet e arsimit të mesëm duhet të mbulojnë një numër prej 8000-16000 banorëve*
- *Distance shkollë-shtëpi, preferohet të jetë prej 1000-1500m, varësisht prej dendësisë banuese*
- *Sipërfaqja e nevojshme e lokacionit duhet të jetë prej 4-6 ha*

- *Numri i nxënësve duhet të jetë prej 500-750*
- *mesatarja 32 nxënës në një klasë gjimnaz dhe 17 nxënës në klasë në shkollat profesionale*
- *2 m2/për nxënës në klasë*

Shkolla e Mesme e Hanit të Elezit “Dardania” plotëson vetëm standardin e parë. Të tjerat duhet përpikur që të plotësohen. Pra planifikohen të shtohen hapësirat mësimore, sportive dhe të tjera. Edhe parcela e kësaj shkolle është shumë e vogël me vetëm 0.3 ha. Nuk ka vende të mjaftueshme për terrene sportive të hapura, sipërfaqe të gjelbra, për sheshin para shkollës, etj.

Është me rëndësi të thuhet se është paraparë shtimi i disa klasave profesionale ekonomike të bujqësisë, industrisë dhe turizmit.

### **3.2.2.2c Institucionet kulturore**

Kultura si veprimtari luan një rol mjaft të rëndësishëm si për nga funksioni poashtu edhe nga ndikimi i i saj në ngritjen shpirtërore si dhe në socializmin e njerëzve.

Sipas kriterëve një qendër e komunitetit duhet të shërbej për 4000-5000 banorë andaj Hani i Elezit si zone urbane ka nevojë vetëm për një të tillë. Me PZHK është paraparë edhe një qendër më e vogël në Gorancë. Në Han të Elezit ekziston Shtëpia e Kulturës, në kuadër të së cilës bën pjesë edhe hapësira e teatrit/kinos me rreth 200 ulëse e cila shfrytëzohet vetëm për manifestime dhe tubime të ndryshme; por nuk ka hapësira/shërbime tjera. Objekti i saj, i ndërtuar në vitet e pesëdhjeta, përveç sallës së teatrit, përbëhet vetëm nga disa zyre. Objekti gjithashtu vlerësohet si i vjetër dhe i pashfrytëzuar sa duhet.

Duke marrë parasysh pozitën e tij (gjendet ngjitur me sheshin e Qytetit) është planifikuar të demolohet i tëri (të shikohet mundësia të ruhet pjesa e teatrit) dhe në të njëjtën parcelë të ndërtohet Shtëpia e re e Kulturës. Në kuadër të njëjtë objekt është planifikuar të jetë edhe Biblioteka e Qytetit që do të themelohej si institucion paraprakisht. Duhet planifikuar edhe për një fond optimal të librave.

Gjithashtu është propozuar edhe Muzeu i Qytetit. Natyrisht se zhvillimi historik dhe industrial do të mundë të tregohet përmes mjeteve të punës apo diçka tjetër të mbetura nga koha më e vjetër. Dhe Hani i Elezit ka një zhvillim të tillë ndryshe nga rastet tjera. Lokacioni planifikohet të jetë në Qendër të Qytetit.

### **3.2.2.2d Gjelbërimi, sporti dhe rekreacioni**

Format e gjelbërimit në Han të Elezit shtrihen si rezultat i lidhjeve të tyre me masivet malore si dhe Lumit dhe përrenjve. Shtrirja hapësinore e këtyre sipërfaqeve gjithashtu duhet të bazohet edhe në nevojën për gjelbërim në qytet—zonat e banimit dhe hapësirat publike në zonën urbane..

Në zonën urbane, gjegjësisht në Lagjen e Parkut, është paraparë parku i qytetit me sipërfaqe rreth 4.5 ha. Kjo sipërfaqe është e gjelbëruar dhe me pak intervenime (rregullimi i shtigjeve për këmbësore dhe çiklistë, ulëseve, ndriçimit, etj) mundë të shfrytëzohet si e tillë. Në të njëjtën Lagje është edhe sipërfaqja tjetër e gjelbër (6.7 ha) e planifikuar që të mbesë e tillë edhe pas zgjidhjes së pronësisë.

Në Qendër është paraparë sheshi i qytetit i cili do të ketë edhe sipërfaqe të gjelbra deri diku të mjaftueshme për një qendër urbane si Hani i Elezit. Planifikohet të bëhet edhe një park më i vogël në Lagjen e Re që se bashku me karakterin e banimit miks me bujqësi do të plotësohen nevojat e banorëve. Analumi dhe Lagja e Kufirit vlerësohet se kanë mjaftueshëm sipërfaqe të gjelbra duke marrë parasysh kopshtet e gjelbra apo përmbajtjet bujqësore në to. Zona industriale ka hapësira te lira që duhet të përmirsohen si hapsira të gjelbra dhe të krijojnë breza të gjelbra si ndarje me zonën e banimit.

Kujdes të veçantë i duhet kushtuar disa sipërfaqeve të vogla publike të ashtuquajtura të zbrazëta të cilat pas një rregullimi mundë të ndikojnë vërtetë në shtimin e sipërfaqes së gjelbër totale. Këto sipërfaqe të vogla janë zakonisht ngjitur me ndërtesat me apartamente, ngjitur me muret rrethuese të oborreve, mes trotuareve/rrugëve dhe objekteve, etj.

Përveç gjelbërimit si hapësirë në të cilën mund të zhvillohen aktivitete rekreative sportive, qyteti ka nevojë edhe për **terrenet e sportit dhe fushat e lojës** të cilat mund të jenë të hapura ose të mbyllura. Përveç lojës, të gjitha kategoritë e banorëve, fëmijët, rinia dhe të moshuarit duhet të kenë mundësi për zhvillimin e aktiviteteve rekreative sportive, siç janë ecja, çiklizmi dhe një varg i aktiviteteve në hapësirat e hapura.



Hapësira e nevojshme për lojë duhet të jenë 3 m<sup>2</sup> për banorë të hapësirës së shfrytëzueshme, nga e cila 0.25 m<sup>2</sup>-0.3 m<sup>2</sup> të jetë e mbuluar.

*Kriteret lidhur me distancat ndaj hapësirave të lira janë:*

- *Hapësirat për lojë në kuadër të lagjes me sipërfaqe prej 0.2-0.3 ha dhe distancë 400-600m*
- *Gjelbërimi në kuadër të lagjes-parku i lagjes me sipërfaqe prej 0.5 ha dhe distancë 400-800 m*
- *Parku i qytetit me sipërfaqe prej 2ha dhe mbulueshmëri prej 600-1000m*
- *Hapësira për sport dhe rekreacion në kuadër të qytetit me sipërfaqe prej 2.5 ha dhe hapësirë të mbuluar prej 1000-1500 m*
- *Qasja në hapësirat e gjelbra natyrore mbi 20 ha dhe distancë deri në 2 km.*

Në Han të Elezit planifikohet ndërtimi i Palestrës Sportive në sipërfaqet e ish ushtrisë në Qendër. Gjithashtu parashihet që koncentrimi i aktiviteteve sportive dhe rekreative të bëhet në këtë lokacion, me përjashtim të Fushës së Futbollit e cila parashihet të ndërtohet në periferi të zonës urbane.

*Rekomandime për tipet e hapësirave për sport dhe rekreacion:*

- *Hapësira për lojë në institucionet parashkollore-*
  - *hapësira e mbyllur*
  - *hapësira e hapur—loja për fëmijë*
- *Hapësira për lojë në kuadër të shkollës*
  - *hapësira e mbyllur—salla e edukatës fizike ( 1 sallë/1 shkollë), pishina*
  - *hapësira e hapur— terrenet sportive (fushë basketbolli, fushë volejboli, fushë tenisi, fushë futbollit),pishina*
- *Hapësira për lojë në kuadër të lagjes*
  - *Terrene të hapura— loja për fëmijë dhe terrene sportive (fushë basketbolli, fushë volejboli, fushë tenisi)*
- *Hapësira për lojë në kuadër të qytetit*
  - *Terrene të mbuluara— salla për sporte të vogla dhe pishina e mbyllur*
  - *Terrenet e hapura-fusha futbollit me shtigje të atletikës, terrenet sportive, pishina*

### **3.2.2.2e Institucionet e shërbimeve administrative dhe publike**

*Standardet për planifikim të shërbimeve administrative dhe publike*

- *Qeveria dhe administrate komunale në kuadër të qytetit ( 1lokacion/qytet)*
- *Qendra e administratës lokale përmban shërbimet e zyrës së vendit dhe standardet e qasshmërisë për 4000-6000 banorë*
- *Gjykata komunale në kuadër të pjesës qendrore të qytetit (1 lokacion/qytet)*
- *Shërbimi policor në kuadër të pjesës qendrore të qytetit (1 stacion policie/25000 banorë)*
- *Shërbimet komunale (PTK, KEK, menaxhimi i mbeturinave, etj) në kuadër të pjesës qendrore të qytetit apo edhe në pjesë tjera të qytetit*
- *Shërbimi bankier në kuadër të pjesës qendrore të qytetit (1 lokacion/15000 banorë)*
- *Tregu i qytetit në pjesën qendrore të qytetit që shërben për nevojat e përditshme të banorëve për furnizim (1lokacion/qytet)*
- *Pika kufitare me terminalin doganor*

Plani Zhvillimor Urban parasheh përmirësimin e objekteve ekzistuese apo ndërtimet e objekteve të reja për të gjitha shërbimet e domosdoshme apo të parapara që ti ketë një komunë kosovare.

## **3.2.3 Ekonomia**

Hani i Elezit ka vizion që kryesisht përmes shfrytëzimit të resurseve natyrore dhe njëzore dhe avancimit ekonomik të ndikohet në zhvillim të përgjithshëm të Komunës dhe Qytetit në veçanti.

*Vizioni për zonën urbane në vetvete tenton të promovojë dhe fuqizojë zhvillimin e:*

- *Industrisë*
- *Bizneseve të lidhura industrinë dhe pikën kufitare*
- *Bizneset hoteliere dhe bizneset e tjera të vogla*

- Turizmit (industrial/kulturor/transit)
- Bujqësisë– si një aktivitet edhe për zonën urbane

Hani i Elezit me pozitën e vet gjeografike shërben si portë hyrëse dhe urë lidhëse mes dy shteteve. Gjithashtu shquhet edhe për traditë industriale dhe mikpritëse. Në kuadër të kësaj është planifikuar koncepti i qytetit dinamik ndërlidhës i shumë funksioneve. Me avancimin e industrisë, shërbimeve hoteliere, dhe produkteve bujqësore dhe përmes prezantimit së trashëgimisë industriale dhe kulturore, Qyteti i Hanit të Elezit do të shndërrohet si një qytet promovues i aktiviteteve dhe produkteve industriale dhe bujqësore. Në të njëjtën kohë përmes marketingut dhe aktiviteteve promovuese (java e ditëve të hapura për në industri, festivale, punëtori dhe të tjera), Hani i Elezit mund të veprojë si qytet promovues në fuqizimin e turizmit përbrenda zonës së qytetit dhe në tërë territorin e komunës.

Duke pasur parasysh faktorët në nivelin lokal si: resurset natyrore dhe njerëzore, interesimin nga komuniteti ndërkombëtar, interesimi nga diaspora, përmirësimin e sistemit kreditor dhe politikave fiskale etj, Hani i Elezit e konsideron sektorin privat si një nga bartësit kryesor për rritjen dhe zhvillimin e ardhshëm. Ky sektor do të ketë rolin kryesor në ngritjen e të hyrave në buxhetin komunal.

*Aktualisht , bartësit kryesor të zhvillimit ekonomik të qytetit të Hanit të Elezitt janë:*

- Fabrika e çimentos/gurëthyesit
- Bizneset transportuese, të hotelerive dhe bizneset tjera të vogla dhe të mesme
- Terminali Doganor

## **Industria**

Marrë parasysh ekzistencën resurseve natyrore të verifikuara të mergeles me rreth 38 milion ton (duke përfshirë edhe sipërfaqen e mihjes në Paldenicë) dhe kërkesat në rritje për çimento nga fabrika e vetme në Kosovë “Sharrcem”; **industria e çimentos** në Han të Elezit planifikohet të zhvillohet edhe më tej. Në vitin 2009 është prodhuar rreth 600.000 ton çimento dhe kjo sasi ka përmbushur vetëm 60% të nevojave të Kosovës. Me privatizimin e kësaj fabrike në fund të 2010 pritet të ndodhin investime të reja në vijën e prodhimit, zvogëlimin e ndotjes, etj. Planifikohet që me kohë gjithashtu të intensifikohet aktiviteti industrial dhe të rritet prodhimi i çimentos që së paku të plotësohen nevojat e Kosovës.

Sipërfaqet për prodhim parashihen të jenë ato ekzistuese, kurset sipërfaqja e mihjes sipërfaqësore planifikohet të zgjerohet nga ajo ekzistuese më në jug nga kufiri dhe më në veri në zonën kadastrale të Dimcës. Hapësira tjetër e mihjes në Paldenicë planifikohet që gjithashtu të zgjerohet. Guri gëlqeror nxirret përmes gurëthyesve lokal. Edhe për këtë lëndë të parë janë paraparë që në të ardhmen të shfrytëzohen edhe disa sipërfaqe tjera të zonës kadastrale në Seçishtë.

**Fabrika e stiroporit** për momentin po kalon një krizë prodhuese. Planifikohet që në të ardhmen, me përfundimin e disa procedurave ekonomike, të prodhohet me kapacitet të plotë. Hapësira e kësaj fabrike parashihet që të mbetet e njëjtë.

**Bizneset transportuese** janë të lidhura drejtpërdrejtë me prodhimin e çimentos. Ata bëjnë shpërndarjen e këtij produkti nëpër Kosovë. Bëjnë gjithashtu edhe importin e mallrave tjera ndërtimore në Kosovë. Planifikohet përkrahje institucionale në krijim të shoqatave të tyre. Gjithashtu është planifikuar hapësira për parkim të kamionëve në sipërfaqen ku është bërë përfundimi i nxjerrjes së lëndës së parë të çimentos, ngjitur me rrugën magjistrale. Këto biznese (apo ndonjë investitor tjetër), duke pasur raporte të mira me prodhuesit regional të mallrave ndërtimore dhe Sharrcem-in pasi që transportojnë mallrat e tyre, do të kishin mundësi të fillonin me aktivitet prodhuese të elementeve konstruktive ndërtimore nga betoni apo material tjetër. Tashmë ndërtimtaria përdor gjithnjë e më shumë elementë gjysmë montazh për të shpejtuar procesin e ndërtimit. Dhe elementet gjysmë montazh të pllakave të ndërkatit, mureve apo të ndonjë elementi tjetër konstruktiv janë relativisht lehtë të prodhueshme duke pasur parasysh afërsinë e lëndës së parë dhe traditën punuese në këtë lëmi. Prodhimet e kubëzave të betonit për rrugë dhe trotuare, elementeve dekorative urbane nga betoni, etj; gjithashtu mundë të ishin pjesë e llojlojshmërisë së produkteve. Më vonë mundë aspirohej në prodhimet më të komplikuar të elementeve konstruktive si p.sh. prodhimet më të ndërlikuara të elementeve tërësisht montazh të objekteve me destinime të ndryshme, elementet nga betonarmeja për konstruksionet më të ndërlikuara si urat apo konstruksionet tjera hapësinore, punët profesionale të armaturës për objekte të ndryshme, etj. Si rezultat i kësaj

planifikohet të ketë zhvillim të tregtisë me këto produkte dhe produkte tjera ndërtimore të prodhuara në regjion dhe më gjerë.

Sipërfaqja ku lënda e mergeles ka përfunduar së shfrytëzuar, plotëson të gjitha kushtet edhe për zhvillimin e këtyre **industrive të reja** të lidhura ngushtë me prodhimet çimentos dhe materiale tjera ndërtimore. Siç u tha tradita e zhvillimit industrial në prodhimin e materialeve ndërtimore në Han të Elezit dhe regjion e favorizon këtë zhvillim. Infrastruktura e përgjithshme është gjithashtu ekzistuese duke përfshirë qasjen e lehtë nga magjistralla, ekzistencën e infrastrukturës urbane, afërsia e kufirit në rast eksporti si dhe autostrada e planifikuar që do të shërbente për distribuimin e produkteve nëpër Kosovë dhe pjesën tjetër të regjionit. Për favorizimin e këtij zhvillimi industrial nëpërmes bizneseve të vogla dhe të mesme do të mundë të shfrytëzohej edhe hapësira si dhe disa halla prodhuese të ish Salonit-it. Disa pjesë të kësaj hapësire shfrytëzohen si terminal doganor për nevoja të pikës kufitare. Pjesa që nuk shfrytëzohet për asnjë qëllim mundë të jetë alternativë e mirë për këtë industri.

Alternativë tjetër është për këtë lloj zhvillimi është edhe sipërfaqja në veri të fabrikës së stiroporit.

Hapja e një klase profesionale në kuadër të shkollës së mesme ekzistuese për arsimimin e të rinjve apo të interesuarve tjerë në përdorimin e makinerive të teknologjisë së lartë prodhuese dhe të mënyrës së prodhimit të materialeve ndërtimore do të jetë një tjetër hap në vazhden e këtyre zhvillimeve.

Industritë e tjera të lehta gjithashtu duhet stimuluar. Industritë ushqimore, sikurse ajo ekzistuese e produkteve të mishit në Lagje të Re mundë të ndikojnë pozitivisht në krijimin e vendeve të punës dhe zhvillimin ekonomik në përgjithësi. Hapësira për këtë lloj industrie duhet kërkuar vetëm në perëndim të lumit Lepenc për arsye të kushteve mjedisore më të mira.

### **Bujqësia**

Zhvillimi i bujqësisë moderne dhe efikase është në linjë me mbrojtjen e mjedisit natyror duke u përpjekur për një të ardhme më të qëndrueshme. Bujqësia në përgjithësi në Kosovë konsiderohet si sektori më i rëndësishëm nga aktivitetet e përgjithshme ekonomike. Kushtet jo të favorshme dëshmojnë për një zhvillim të ulët të bujqësisë siç janë: huadhëniet jo të favorshme, politika fiskale jo e favorshme, importi i pakufizuar, mungesa e subvencionimit të eksportit, etj. Humbja e tokës bujqësore e cila shkaktohet nga ndërtimet e pakontrolluara janë si rezultat i mungesës së planeve dhe nevojës për ndërtime të reja. Plani Zhvillimor Urban ka për qëllim mbrojtjen e tokës bujqësore nga ndërtimet e pakontrolluara duke e theksuar në të njëjtën kohë potencialin për ringjalljen e ekonomisë në përgjithësi.

*Veprimet që do të ndërmerren në kuadër të kësaj janë:*

- *Regjenerimi dhe shfrytëzimi aktiv i tokës ekzistuese bujqësore në zonën urbane*
- *Krijimi i një qendre të aftësimin në kuadër të shkollës së mesme për profesionet specifike (bujqësi intensive me serra, blegtori, pylltari, peshkatori, bletari)*
- *Zhvillimi i marketingut aktiv për të gjitha produktet lokale*

Realizimi i potencialeve bujqësore kërkon së pari intensifikimin e strukturave organizative– operative, mbrojtjen e tokës bujqësore ekzistuese, njohuri shtesë për prodhim dhe marketing të përkrahura nga shoqata e fermerëve. Natyrisht se bujqësia urbane është pjesë integrale e zhvillimit të tërësishëm komunal të bujqësisë.

Definimi i zonës për ndërtim dhe zhvillim me PZHU, mundëson përcaktimin e zonave të cilat duhet patjetër të mbrohen si toka bujqësore me kualitet të lartë, peizazhet me vlerë, rrjedhat e ujit. Zona urbane përfshinë edhe një sipërfaqe të gjerë të tokës së punueshme dhe kjo duket të jetë bazë e për zhvillimin e aktiviteteve të agrikulturës urbane.

Punimi i sistemit të ujitjes mundëson kultivimin e produkteve kualitative të pemëve dhe perimeve. Zonat e dedikuara për banim në pjesët periferike ku mund të zhvillohen aktivitete bujqësore kanë për qëllim stimulimin e zhvillimit të agrikulturës urbane si veprimtari profitabile ekonomike, sidomos të bioprodukteve të cilave janë gjithnjë e më të kërkuara në tregun e gjerë rajonal.

Ngritja e kualitetit të produkteve bujqësore është e lidhur edhe me arsimimin adekuat profesional në të gjitha aspektet të cilat ndikojnë në prodhimin e produkteve kualitative bujqësore, përpunimit të tyre dhe

marketingut në Kosovë dhe më gjerë në rajon. Hapja e një klase profesionale të bujqësisë si qendër për aftësimin e të rinjve dhe të rriturve të cilët dëshirojnë t'i përparojnë njohuritë për bujqësinë bashkëkohore, është esenciale. Në kuadër të kësaj klase do të jetë edhe krijimi sipërfaqeve bujqësore eksperimentale (bën edhe në pjesët rurale, por preferohet të jetë afër shkollës së mesme) në të cilat mund të praktikohen aktivitete të ndryshme të bujqësisë urbane.

Produktet kualitative bujqësore kërkojnë hapësira të përshtatshme dhe teknologji bashkëkohore. Plasimi i tyre si pjesë e shportës prodhuese lokale në kuadër të turizmit transit urban dhe atij rural apo në kuadër të mini fermave në zonën urbane krijon mundësi edhe për zhvillimin e marketingut dhe tregtisë direkte të këtyre produkteve në kuadër të hapësirave prodhuese, e që mund të shërbejnë edhe si motive turistike shtesë të Hanin e Elezit.

## **Turizmi**

Trashëgimia industriale është një baze e mire për zhvillimin e turizmit—turizmit transit. Komuna ne përgjithësi ka edhe potenciale tjera turistike natyrore e kulturore të cilat krijojnë bazën e zhvillimit të turizmit. Natyrisht se te gjitha këto elemente , si bazë për një zhvillim te turizmit, duhet të trajtohen së bashku për të arritur një lidhshmëri të duhur dhe për të arritur një zhvillim sa më solid turistik. E tërë kjo është trajtuar në PZHK. Këtu do të shkoqiten vetëm ato aspekte hapësinore dhe elemente tjera bazë për zhvillim të turizmit që koincidojnë me zonën urbane të Hanit te Elezit.

Hani i Elezit është i njohur për një zhvillim relativisht të mirë industrial. Planifikohet që pjesa e vjetër e fabrikës së çimentos bashkë me apartamentet afër tyre të rikonstruktohen dhe rivitalizohen në mënyrë që të shfrytëzohen sa më mirë në kuadër të shërbimit të tyre primar industrial por njeherit të jenë edhe pika të mundshme për turizëm transit. Rikonstruktimi i Hanit është gjithashtu një nga aspektet shumë domethënëse të traditës së mikpritjes dhe identitetit të Hanit të Elezit. Këto hapësira në përgjithësi dhe strukturat ndërtimore të tyre paraqesin pikat identifikuese të Hanit te Elezit.

Me reduktimin e planifikuar të ndotjes në kuadër të parametrave të lejuar brenda BE-se, një mjedis i tillë në të njëjtën kohë mund të paraqesë pikë fokale informative dhe akomoduese për aktivitetet turistike që lidhen me qytetin dhe resurset e tij e po ashtu edhe si pikë promovuese e të gjitha aktiviteteve që ndodhin jashtë zonës urbane. Për këtë qëllim, planifikimi i nevojshëm për infrastrukturën turistike duhet të shkojë paralel me tendencat e zhvillimit të qytetit dhe strukturës se tij natyrore (parqet, sheshi i qytetit, kopshtet e gjelbra dhe elementeve tjera natyrore), trajtimit të çështjeve mjedisore si reduktimin e ndotjes dhe dekontaminimin e zonave te rrezikshme; dhe natyrisht kjo mund të krijojë pozicionin e Hanit te Elezit si qytet industrial mikpritës për ata që duan të dinë me shumë për traditën dhe përvojën industriale si dhe bukuritë natyrore e kulturore të këtij këtij rajoni.

*Për të arritur një zhvillim turistik duhet të zhvillohen këto shërbime dhe të merren këto masa për krijimin e klimës pozitive turistike:*

- *Reduktimi i ndotjes sipas parametrave të lejuara*
- *Rikonstruktimi i objekteve relevante turistike*
- *Përgatitja e pikave të hotelerive për akomodimi transit e më vonë edhe akomodim më të gjatë*
- *Përgatitja dhe promovimi pikave relevante natyrore turistike bashkë me aktivitetet e kohës së lirë të orientuara në natyrë*
- *Përgatitja e pikave kulturore rekreative dhe aktivitet ne to*
- *Lëvizshmëria miqësore*
- *Promovimi i fuqishëm i këtij zhvillimi*

*Në këtë kontekst qyteti i Hanit te Elezit e luan rolin e dyfish në aktivitetet turistike*

- *Ofron hapësirë për aktivitete turistike te lidhura me ato ekonomike (si një udhëkryq i rëndësishëm—java e dyerve te hapura ne fabrikën e çimentos dhe aktivitetet tjera ditore dhe me te gjata që promovojnë vlera të rëndësishme ekonomike dhe kulturore qe mund të organizohen)*
- *Peizazhi, rrjedhat ujore, janë hapësira qe ofrojnë mundësi për zhvillimin e turizmit rural të kombinuar me infrastrukturë për rekreacion (jeta e natës me klube te ndryshme)*

- *Informimi në përkrahje të turizmit rural (informata e parë që marrin vizitorët apo udhëtarët e rastit është peizazhi, për këtë është i rëndësishëm informimi). Qyteti duhet të fuqizojë turizmin rural duke e ndërtuar një sistem efikas informativ dhe rrjet të lëvizjeve (transporti në harmoni me natyrën) për të lehtësuar dhe mundësuar qasje të mira drejt zonave të caktuara turistike brenda komunës.*

*Për të drejtuar zhvillimin e turizmit në të ardhmen, duhet që*

- *çdo pronar i restorantit, çdo hotelier dhe çdo tregtare duhet t'i përgatitë planet për zhvillimin e ardhshëm dhe planet për operim. Investitorët e rinj duhet të hulumtojnë lokacionet e përshtatshme. Faktorët të cilët kanë lidhje me biznesin si madhësia, kostoja e tokës dhe vendi sa me ideal për ti shërbyer arsyes se destinimit të objekteve në fjalë janë vetëm disa faktorë të cilat e influencojnë lokacionin për biznesin në të ardhmen. Bizneset artizanale përfshihen në këtë vazhde. Turizmi në vetvete nuk prodhon një produkt të vetëm, por ai nënkupton një llojllojshmëri të "produkteve". Një fakt që është shumë i rëndësishëm është se produktet e turizmit, përjetimet e kënaqshme të vizitorëve, janë në një kontrast ndaj të mirave dhe shërbimeve të prodhuara nga industria. Andaj sistemi distributiv turistik i shërbimit të transportit i shpien turistet në pikat e dëshiruara turistike. E aty duhet të jete i pranishëm tregu bashkë me shumëllojshmërinë e produkteve lokale. Për shkak të pozitës gjeografike, llojllojshmërisë mjedisore, traditës industriale dhe mikpritëse, bën që vendet për vizitë në Han të Elezit të jenë shumë unike dhe ti nxit njerëzit t'i vizitojnë. Për këtë arsye duhet të hulumtohen kualitetet specifike të cilat e bëjnë që Hani i Elezit të ketë shumëllojshmëri të atraksioneve turistike, të cilin e bën atë me të vërtete ndryshe.*
- *Pasi që zhvillimi i turizmit është një nga sektorët e zhvillimit të përgjithshëm ekonomik, promovimi i turizmit behet nga qeveria lokale dhe qendrore si institucione që janë në shërbim të qytetareve dhe përmirësimit të jetës së tyre në çdo nivel. Qeveria, pra, duhet të merr rrolin menaxhues në infrastrukturë prej së cilës zhvillimi i turizmit varet shumë. Kjo në të shumtën e rasteve përfshinë ujësjellësin, kanalizimin, niveli i lartë i sigurisë dhe mbrojtja nga fatkeqësitë natyrore dhe të shkaktuara nga njeriu, rrugët dhe ndriçimi, komunikimi, etj.*
- *Organizatave vullnetare mund të ndikojnë në ngritjen e zhvillimit të turizmit. Shumë organizata të shoqërisë civile dhe ato profesionale në fushat e ndryshme: shëndetësia, sporti dhe rekreacioni, religjioni, kultura, si dhe aktivitetet e rinisë, mund të ndihmojnë zhvillimin dhe menaxhimin e turizmit si dhe shërbejnë vizitorët me rastin e organizimit të manifestimeve të ndryshme. Atraksionet kulturore dhe natyrore janë rritur pikërisht për shkak të mbështetjes së organizatave të ndryshme. Kështu psh. Organizata ChwB është e interesuar për mbrojtjen trashëgimisë industriale dhe trashëgimisë së ndërtuar në Han të Elezit (shtëpitë e vjetra të banimit) me ane të zhvillimit të projekteve të rivitalizimit dhe konservimit të monumenteve. Sektori familjar dhe joformal, duke marrë parasysh traditën individuale të bujqësive familjare, mund gjithashtu të luajë një rol vendimtar për zgjerimin e turizmit posaçërisht në zhvillimin e tokës për ndërtimin e objekteve hotelierike.*

## **Bizneset tjera**


Përveç ndërmarrjeve ekzistuese dhe ato të mundshme në kuadër të zhvillimeve të lartpërmendura të planifikuara, në Han të Elezit ekzistojnë edhe ndërmarrje të cilat kanë fushëveprim tjetër.

Ndërtimet e objekteve dhe infrastrukturës në Han të Elezit kryesisht realizohet nga ndërmarrje vendore. E ardhmja e këtyre bizneseve parashihet që të jete e ndritur duke marrë parasysh afërsinë e produkteve të materiale ndërtimore. Këto ndërmarrje mund të luajnë rol të rëndësishëm edhe me gjere në rajon. Qeveria lokale është e obliguar që t'i gjeje format e përshtatshme të partneritetit publik privat që gjithashtu mund të involvojë edhe shoqërinë civile e cila do të jetë një mbështetës parimor edhe i sektorit publik edhe atij privat. Me ane të këtij partneriteti mund të arrihen disa qëllime të përbashkëta në sektorin e ndërtimeve në kuadër të banimit, turizmit, etj.

Në kuadër të bizneseve të lidhura drejtpërdrejte me piken kufitare (shpedicionet), duhet shikuar mundësia që bizneset e Hanit të Elezit të jene me të inkuadruara.

Bizneset tregtare, përveç rolit të tyre në kuadër të zhvillimit të turizmit, duhet kryer shërbime sa me kualitative edhe për qytetaret vendas.

Harta 21





### 3.2.4 Infrastruktura urbane

Infrastruktura urbane është shumë e rëndësishme në zhvillimin dhe funksionimin e një qyteti. Në rastin e Hanit të Elezit, si një qendër e re urbane, kjo infrastrukturë nuk është e rregulluar si duhet dhe manifestohet me mungesë të ujit të pijes gjatë verës, ndotje të ujit, mostrajtim të ujërave të zeza, deponi ilegale mbeturinash, etj. Kjo është si pasoje e mosmenaxhimit fare të kësaj infrastrukture dhe këtyre shërbimeve. Pra për të pasur një infrastrukturë sa më të mirë urbane (ujësjellësi, kanalizimi dhe mbledhja e mbeturinave) në mënyrë që këto shërbime të jenë sa më nivel rekomandohet krijimi i kompanisë publike për menaxhimin e kësaj infrastrukture dhe shërbimeve lidhur me to.

#### Rrjeti i ujësjellësit dhe kanalizimit

Aktualisht zona urbane e Hanit të Elezit është e përfshirë e gjitha brenda sistemit shpërndarës të rrjetit të ujësjellësit. I njëjti rrjet bën furnizimin me ujë edhe të disa lagjeve të zonave rurale në afërsi të zonës urbane (fshati Seçishtë, Lagja Maliç, Lagja Brav, Lagja e Ranave dhe Uji i Thartë). Ky rrjet perbehet nga dy burime të ndara për furnizim me ujë të pijes: nga uji i burimeve të Globocices dhe uji i përroit të Dimces. Te dy sistemet bashke janë të projektuar të bëjnë furnizimin me gjithsej 28litra për sekondë ujë të pijes për territorin e përmendur. Është vlerësuar se gjatë periudhës verore nganjëherë nuk arrihet ky nivel i furnizimit me ujë.

Duke marrë parasysh shtimin e banoreve për 15 vitet e ardhshme në zonën urbane në rreth 4850 banore (ose numrin e përgjithshëm në rreth 7200 banore për zonën urbane dhe lagjet përreth), atëherë del se sasia e ujit të planifikuar nga të dy burimet është e mjaftueshme për këto vite të projektuara. Nga të dhënat teknike dhe ato në terren është vlerësuar se për numrin e planifikuar të banorëve sasia e tanishme është në nivelin e mbi 350 litra ujë/banorë në ditë nga shifra e 150 litra ujë/për banorë në ditë që mirret gjatë projektimit.

Në anën tjetër qysh tani ka probleme me furnizim me ujë për qytetaret. Por kjo besohet të jetë karakterizuar nga keqpërdorimi i ujit të pijes për ujitje të përmbajtjeve bujqësore urbane, larjes së oborreve, etj.

*Në mënyrë që të zgjidhet problemi i furnizimit me ujë rekomandohen:*

- *Përmirësimi i sistemit ekzistues të furnizimit me ujë në mënyrë që të arrihet sasia e cilësia e projektuar e furnizimit me ujë*
- *Ndalimi i keqpërdorimeve dhe detyrimi për përdorimin racional të ujit të pijshëm*
- *Analizimi i ujit të pijshëm nga rrjeti ekzistues dhe nga pusët private*
- *Themelimi i një kompanie për mirëmbajtjen e ujësjellësit dhe kanalizimit*

#### Rrjeti i kanalizimit

Ekzistojnë dy sisteme kryesore të kanalizimit në zonën urbane të Hanit të Elezit. Ai i Qendrës dhe ai i Lagjes së Re. Njësitë tjera urbane lidhen në këto sisteme ose derdhen ujerat e zeza në lumin Lepenc apo përrrenjtë e afërt pa asnjë lloj trajtimi, sikur edhe arteriet kryesore të këtij sistemi të përgjithshëm të kanalizimit.

Rrjeti i kanalizimeve në komunë është ndërtuar pjese pjese dhe pa planifikim të duhur. Komuna në përgjithësi nuk ka impiant për trajtimin e ujerave të zeza. Ai planifikohet të ndërtohet ngjitur me Lumin në vendin ku ky i fundit i afrohet kufirit me IRJM-në

*Rekomandime:*

- *Analizimi dhe rregullimi i rrjetit aktual të kanalizimeve*
- *Planifikimi i duhur i rrjetit të ardhshëm të ujërave të zeza dhe i ujërave atmosferike*

Rrjeti i kanalizimeve rekomandohet që të planifikohet në mënyrë të tillë që t'i grumbullojë të gjitha daljet në një impiant të centralizuar të ujërave të zeza për zonën urbane dhe disa pjesë rurale relevante. Vendi

për ndërtimin e impiantit të trajtimit të ujërave të zeza duhet të rezervohet për trajtimin e ardhshëm të ujërave të zeza. Po ashtu rekomandohet që të shikohen mundësitë për impiante të decentralizuara të ujërave të zeza nëse këto nuk janë më të kushtueshme se impianti i centralizuar.

### **Menaxhimi i mbeturinave**

Komuna do të ndërmerr masat dhe veprimet e nevojshme për trajtimin e mbeturinave në bazë të kompetencave të garantuara për entitetet qeverisëse lokale me Kushtetutën e Republikës së Kosovës në menaxhimin e mbeturinave. Pra planifikohet që me krijimin e Kompanisë Lokale për menaxhim të mbeturinave është i mundur përmirësimi i situatës aktuale në këtë fushë.

Krijimi i një rrjeti funksional të mbledhjes së mbeturinave është bazë për menaxhimin efikas të tyre. Planifikohet që të shfrytëzohet deponia regionale në Gjilan.

Komuna duhet të shqyrtojë politikat e ndarjes së mbeturinave dhe riciklimit. Kjo mund të ndikojë në krijimin e vendeve të reja të punës kurse riciklimi mund të zhvillohet si një veprimtari ekonomike.

Secili rast i deponimit ilegal duhet të trajtohet ndaras dhe duhet të ndërmerren masat për mbylljen, spastrimin dhe konsolidimin e tokës. Këto veprime duhet të ndërmerren së bashku me Agjensinë për Mbrojtjen e Mjedisit në MMPH.

### **3.2.5 Rrugët dhe transporti**

Rrjeti rrugor i planifikuar dhe sistemi efikas i transportit është bazë për një zhvillim të qëndrueshëm dhe funksionalitet të qytetit dhe shoqërisë. Rrjeti rrugor në Han të Elezit në përgjithësi dominohet nga magjistralja Prishtinë-Shkup, hekurudha Fushë Kosovë-Shkup si dhe autostrada e planifikuar. Të gjitha arteriet tjera rrugore janë hyrje/dalje në këto rrugë ose kanë funksion shërbyes apo janë të organizuara në kontekstin e strukturës hapësinore që iu përshatet atyre. Ka mungesa në lidhje rrugore mes Qendrës dhe Lagjes të Re, mungojnë trotuarët për këmbësor në shumicën e rrugëve ekzistuese, nuk ka shtigje për çiklistë, mungojnë shtigje rrugësh jomotorike rreth lumit, etj. Në anën tjetër autostrada e planifikuar perceptohet edhe si ndarje e mëtejme e zonës urbane në dy pjesë (Qendra-Lagja e Re), kyçjet në magjistrale nuk janë mirë të rregulluara, etj.

Me anë të përmirësimit të këtij rrjeti të trafikut planifikohet të ndikohet në lëvizshmërinë e lehtë të komunitetit, qasjen më të lehtë në njësi dhe përmbajtje, zvogëlimin e ndotjes së ajrit dhe zhurmës si dhe mundë të ndikojë në përmirësimin e kualitetit të jetës në përgjithësi.

*Për planifikim të qëndrueshëm të transportit rrugor preferohen:*

- *Mbajtja e trafikut të rëndë jashtë zonës qendrore urbane dhe njërive tjera*
- *Përmirësimi i rrjetit të qarkullimit për të përkrahur zhvillimin social dhe ekonomik*
- *Përmirësimi i infrastrukturës dhe menaxhimit të transportit lokal*
- *Dizajnimi i rrugëve të cilat i adaptohen kërkesave të këmbësorëve, duke qetësuar trafikun, zgjeruar trotuarët apo kufizuar qarkullimin e automjeteve*
- *Planifikimi i vend parkimeve për një numër optimal të veturave*
- *Sigurimi i një sistemi ambientalisht të qëndrueshëm të lëvizjes duke dekurajuar përdorimin e automjeteve private dhe duke inkurajuar ecjen dhe çiklizmin*
- *Përkrahja e transportit lokal apo ndër urban me autobus apo me minibus, me qëllim të përparimit dhe forcimit të tij si formë kryesore e lëvizjes*
- *Largimi i ndotjes dhe zhurmës nga zonat e banimit posaçërisht nga zonat e ndjeshme urbane, me qëllim të rritjes së kualitetit të jetesës por edhe zvogëlimin të ndikimit të gazrave të rrezikshme në mjedis*
- *Përkrahja e përdorimit të biçikletave si mjet transporti, sigurimi i hapësirës së nevojshme dhe dhënia e përparësisë në trafik*

### **Trafiku rrugor**

Për të krijuar një rrjet funksional rrugor, duhet që sistemi i trafikut dhe transportit në periudhën e ardhshme 15 vjeçare të përmirësohet dhe plotësohet. Në periudhën deri në vitin 2025 në komunën e Hanit të Elezit, duke e përfshirë edhe zonë urbane do të vijë deri të rritja e numrit të automjeteve e cila do të jetë e kushtëzuar nga rritja e numrit të banorëve dhe zhvillimi socio-ekonomik, që ndikon drejtpërdrejtë në shtimin e lëvizshmërisë së banorëve.


Siç u përmend edhe më herët rrjeti rrugor i Hanit të Elezit është pothuajse i definuar. Shikuar në kontekstin hapësinor dhe historik ai është i organizuar duke marrë për bazë vijën hekurudhore dhe lumin Lepenc që gjarpërojnë afër njëri tjetrit; rrugës së vjetër që lidhte Kosovën me regjionin si dhe rrugën magjistrale e ndërtuar në fund të viteve gjashtëdhjeta të shekullit të kaluar. Brenda këtyre elementeve infrastrukturore është e zhvilluar bërthama urbane e Hanit të Elezit ndër vite. Si pasojë e kësaj kjo njësi urbane që tash është Qendra ka lidhje të mira fizike me magjistralen dhe hekurudhën. Në kuadër të planifikimit i është kushtuar kujdes më i madh lidhja e njësive tjera me Qendrën dhe me infrastrukturën rrugore kryesore. Gjithashtu kujdes i veçantë i është kushtuar lidhja e njësive urbane në mes vete si dhe organizimi i rrugëve të lagjeve që të kryejnë sa më mirë rolin e tyre komunikativ dhe social në kuadër të zhvillimit të përgjithshëm të Qytetit të Hanit të Elezit.

**Autostrada e planifikuar** do të kalojë nëpër zonën urbane të Hanit të Elezit. Do e përshkojë atë përgjatë lumit Lepenc deri në afërsi të terminalit doganor në jug. Hyrje/daljet në autostradë do të jenë në afërsi të kësaj pike me anë të një mbikalimi nëpër terminalin doganor deri në pikën kufitare ekzistuese. Në gjatësinë e saj të planifikuar brenda zonës urbane do të ketë një urë mbi lumin Lepenc. Do të ndërtohen dy kalime mbi autostradë (te ura e Secishtes dhe te ura e Fejzës). Brenda zonës urbane kjo autostradë do të ketë gjithsej 4 kors.

Pjesa tjetër e rrjetit rrugor të zonës urbane të Hanit të Elezit është pothuajse e definuar.


**Rruga hekurudhore** që kalon nëpër qytet si segment i hekurudhës Fushë Kosovë – Hani i Elezit është pronë e Hekurudhave të Kosovës. Në kuadër të këtij segmenti përfshihet edhe stacioni hekurudhor me pikën kufitare hekurudhore dhe linjat anësore hekurudhore në kuadër të këtyre shërbimeve. Kemi gjithashtu edhe segmentet hekurudhore që hyjnë nëpër përmbajtjet industriale. Të gjitha këto segmente hekurudhore planifikohen të mirëmbahen në mënyrë që të mbahen funksionet e deritanishme dhe të përmirësohen për t'iu përshtatur nevoja të reja transportuese të paraqitura në kuadër të transportit.

**Magjistralla** Prishtinë-Hani i Elezit, që gjithashtu kalon përmes zonës urbane të Hanit të Elezit, është një lidhje rrugore e rëndësishme për Hanin e Elezit dhe Kosovën në përgjithësi. Aktualisht është rruga më e frekuentuar në Kosovë. Është e rëndësishme sepse lidh njësitë urbane mes tyre, me komunat fqinje, me pikën kufitare dhe autostradën e planifikuar. Vlerësohet që do të ulet rëndësia me ndërtimin e kësaj autostrade. Megjithatë është paraparë që edhe më tej të mirëmbahet në mënyrë që të shërbejë për lidhje regjionale dhe lokale. Planifikohet që në të ardhmen të gjitha njësitë urbane të vazhdojnë të kenë qasje në të si alternative e vetme e trafikut të rëndë. Do të rregullohen hyrje/daljet në të, posaçërisht hyrja në qendër të qytetit. Me poshtë do e gjeni një prerje tërthore të propozuar të magjistrales me hapësirat e nevojshme:



**Korridori kryesor lokal** Hani i Elezit-Gorancë-Globoçicë planifikohet të ngrihet në rangun e **korridorit regional (rrugës regionale)** për arsye se është lidhja më e afërt e dy pikave kufitare me IRJM-në (Hani i Elezit dhe Globoçicë). Kjo rrugë është projektuar të jetë e gjerë dhe me trotuare ne zonën urbane në të dy anët. Përndryshe kjo rrugë planifikohet ta mbajë trasenë e saj në ndarjen nga magjistralja dhe deri në kalimin mbi hekurudhë. Nga aty do të shkohet me kalim mbi autostradë dhe do të vazhdojë nëpër Lagjen e Re me një trase tjetër derisa sa të bashkohet me atë ekzistuese në afërsi të kufirit urban.


**Korridoret kryesore lokale** për Paldenicë, Dimcë dhe Seçishte kaloje brenda zonës urbane. Pra këto korridore duke përfshirë edhe korridurin regional ne te vërtete lidhin fshatrat me Qytetin, me rrugët kryesore (magjistralen dhe hekurudhën) dhe regionet ne mes tyre, por pasi qe kalojnë neper zonen urbane, ato njeherit shërbejnë edhe si **rruge kryesore te lagjeve** si dhe ne raste te caktuara do te lidhin njësitë urbane ne mes tyre. Të treguar më poshtë do e gjeni një prerje tërthore shembull (korridor kryesor lokal apo rrugë kryesore e lagjeve) me sipërfaqe dhe elemente të nevojshme:




Gjate analizave te bëra ne kuadër te procesit te planifikimit është pare shume e nevojshme një lidhje fizike alternative ne mes te Qendres dhe Lagjes se Re, si dy njësitë me te mëdha te zonës urbane. Kjo **rrugë kryesore e lagjes** është planifikuar te jete nga magjistralja dhe do te kaloje saktësisht neper rrugën e ish ushtrisë dhe me një kalim mbi autostrade dhe lum te Ura e Fejzes do kaloje neper Lagjen Brav dhe Melic duke arritur përsëri ne zonën urbane (Lagjen e Re) nga ana perëndimore. Kjo rruge vlerësohet te jete arterie kyçe për një lidhje me te mire ne mes njësiteve te zonës urbane, gjë qe nuk ekziston për momentin. Përveç se do te ndikojë ne ngritjen e rëndësisë ekonomike dhe sociale se Qendrës duke e


shndërruar atë ne një pike fokale te kësaj zone edhe njësitë tjera do te kenë qasje me te lehte ne te gjitha shërbimet qe ne rastin e Hanit te Elezit janë aktualisht te organizuara dhe pritet te promovohen ne te ardhmen ne Qendër. Kjo rruge gjithashtu do lehtësoje komunikacionin nga Qendra ne magjistrale qe për momentin behet vetëm përmes rrugës kryesore te saj. Rruga do te ketë gjerësi minimum 6m' me trotuare ne te dy anët minimum me nga 2m'.

**Rrugët e tjera te Lagjeve (njësive urbane)** gjithashtu planifikohen te kenë gjerësi prej 6m' me trotuare dhe sipërfaqe tjera të treguara në tabela dhe prerjen shembull të mëposhtme:





Bulevardi Kryesor i Qendrës është më reprezentativ dhe ka gjerësi 6.7m'. Së bashku me Bulevardin tjetër të Qytezës kanë trotuare dhe sipërfaqe tjera si më poshtë:






Prerjet tërthore të Bulevardit nga shkolla e mesme deri në industri është treguar më poshtë:





**Rrugët pa fund** në Han te Elezit janë rruge te tipit te mbyllur (rruge qorr). Ato duhet planifikuar te zgjerohen ne minimum 4m'. Nëse ka mundësi te jenë një kahëshe do te organizoheshin me mire. Edhe këto rruge duhet te kenë trotuare.



#### GJERËSITË E NEVOJSHME TË PROPOZUARA PËR RRUGËT E HANIT TË ELEZIT

Rruga	Gjerësia e trasesë (brenda zonës urbane*)	Gjerësia e rrugës	Gjerësia e trotuarit (brenda zonës urbane*)	Gjerësia e shtegut të çiklistëve
1. Autostrada	përafërt 66m	33m	p/a	p/a
2. Hekurudha	përafërt 18.5m	p/a	p/a	p/a
3. Magjistralja	përafërt 19.5m	7.5m	(min 2m-pref 3m)*	min 2m
4. Korridori regional	p/a*	min 6.5m	(min 2m-pref 3m)*	min 2m
5. Bulevardi i Qytetit	p/a	6.7m	(min 3m-pref 4m)	min 2m
6. Korridoret kryesore lokale dhe rrugët kryesore të lagjeve	p/a*	min 6m	(min 2m-pref 3m)*	min 2m
7. Rrugët e lagjeve	p/a	min 6m	(min 2m-pref 3m)	p/a
8. Rrugët pa fund	p/a	min 4m	min 2m	p/a

#### DISTANCA E PROPOZUAR E VIJËS NDËRTIMORE NGA AKSI I SKAJSHËM I RRUGOR

Rruga	Distanca e vijës ndërtimore	Rruga	Distanca e vijës ndërtimore
Magjistralja	10m (të dy anët)	Bulevardi i qytetit 1.1	9m/deri te apart. ekz. (majtas)-12m (djathtas)
Korridori regional	7m (të dy anët)	Bulevardi i qytetit 1.2	deri te apart. ekz./komuna (majtas)-5m (djathtas)
Korridoret kryesore lokale dhe rrugët (kryesore) të lagjeve	5m (të dy anët)	Bulevardi i qytetit 2.1	5m (majtas) – 5m (djathtas)
8. Rrugët pa fund	3m (të dy anët)	Bulevardi i qytetit 2.1	deri te apartamenti ekzistues (majtas)

\*Bulevardi i qytetit 1.1 është segmenti prej magjistrales deri në sheshin e qytetit, përderisa 1.2 është segmenti nga sheshi i qytetit deri te stacioni hekurudhor.

\* Bulevardi i qytetit 2.1 është segmenti prej shkollës së mesme deri në sheshin e qytetit, përderisa 2.2 është segmenti nga sheshi i qytetit deri te rrethoja e industrisë.

#### Transporti publik

Rëndësia e transportit publik për një qytet është e madhe. Ai ndihmon në qarkullimin efikas dhe më të lirë, ndihmon në zvogëlimin e qarkullimit të automjeteve që rezultojnë me rritjen e sigurisë në rrugë dhe njëkohësisht mbrojtjen e mjedisit nga ndotja.

I vetmi transport zyrtar ndërshtetëror dhe nder urban ne Han te Elezit është ai **hekurudhor**. I gjithë ky transport organizohet përmes vijës hekurudhore dhe stacionit hekurudhor ne zonën urbane Hanit te

Elezit. Nëpër to kalon treni i lëvizjes së lirë (TLL, Fushë Kosovë-Hani i Elezit-Fushë Kosovë) dy herë në ditë dhe i ashtuquajturit treni i shpejtë (IC, Prishtinë-Shkup-Prishtinë) një herë në ditë. Orari i sakte është dhënë më poshtë:

Orari i trenit në Han të Elezit					
Arritjet	05.30	08.41		16.55	20.16
Nisjet	04.48	09.00	10.50	18.00	20.35

\*I hijezuar në të portokalltë është i ashtuquajturit treni i shpejtë IC që shkon në Shkup në mëngjes dhe kthen për Fushë Kosovë pasdite

\*I hijezuar në të zezë është treni i lëvizjes së lirë TLL

**Misioni** i Hekurudhave të Kosovës është që të operoj rrjetin hekurudhor të Kosovës, ti rris dhe mirëmbajë vijat hekurudhore për operim (shërbime për transportin e mallrave dhe sipas mundësive edhe për pasagjerë) bazuar në standardet e Unionit Evropian.

**Vizioni:** Ne dëshirojmë që transportin hekurudhorë ta bëjmë transportin më të preferuar modern në këto vija relevante, siç vijojnë:

Shërbime Kargo (transportin e mallrave) në regjion dhe internacional

Shërbime publike për pasagjer në trafikun lokal dhe regjional

Të jemi operator udhëheqës të kontejnerëve në Kosovë

Të operojmë dhe të mirëmbajmë në baza komerciale

*\*përmbajtja është marre nga ueb faqja zyrtare e Hekurudhave te Kosovës*

Sic shihet nga misioni dhe vizioni i HK planifikohet mirëmbajtja e segmenteve hekurudhore e me këtë parashihen edhe shërbimet publike të transportit të udhëtareve të jete me kualitative dhe me të shpeshta.

Kurse ne kuadër të përmirësimeve të shërbimeve të transportit të mallrave, kjo munde të ndikojnë pozitivisht në punësimin e qytetareve të HiE në kuadër të këtij shërbimi. Sic u përmend edhe me herët transporti i mallrave në Han të Elezit planifikohet të behet me kamione.

**Transporti automobilistik nderurban dhe regjional** nuk është zyrtarisht i organizuar, por qyteti është ngjitur linjës ekzistuese regjionale dhe ndërshtetërore (Magjistrale) dhe autobusët e këtyre linjave ndalen në orar të pacaktuar për të marre udhëtarët e rastit. Për një të ardhme afatshkurtër është destinuar një vend ndalje për autobusët e rastit. Natyrisht se ky vend është ngjitur me magjistralen. Gjithashtu në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës duhet arritur marrëveshjet me këto firma transportuese të udhëtareve që të zyrtarizohet orari i ndaljes së tyre në Han të Elezit. Për t'i plotësuar këto nevoja, në planin afatgjatë është parapare ndërtimi i stacionit të autobusëve ngjitur me stacionin e zjarrfikësve.

Planifikimi i rrjetit të **transportit urban** është i lidhur ngushtë me planifikimin e rrjetit rrugor. Për shkak të madhësisë së qytetit dhe distancave relativisht të vogla për lëvizje, linja e transportit publik urban propozohet të jete e përbashkët me atë lokal. Pra minibusët dhe kombibuset e transportit lokal propozohet që të kalojnë neper rrugët përmbledhëse të lagjeve urbane (në veçanti Qendres dhe Lagjes së Re) me qëllim të mbulimit sa më horizontal të zonave. Duhet kalkuluar në zona të mbulimit prej jetë 400m deri 600m.

Nevoja për **parkim** në qytet është mjaft e shprehur. Mënyra se si është i rregulluar parkimi i automjeteve ndikon në kualitetin e mjedisit të ndërtuar urban. Nuk duhet lejuar që automjetet të dominojnë hapësirën ose të bezdisin këmbësorët dhe çiklistët. Vendi më i mirë për parkim është jashtë rrugës dhe në oborret e pasme të ndërtesave të banimit me apartamente dhe ndërtesave publike. Duhet shikuar mundësia e mënjanimit të parkimit në pjesët ballore të ndërtesave. Kjo ndërpre në komunikimin e këmbësorëve me përdhesen dhe i ndërpret vizurat e joformale.

Parkimi në zonën qendrore të qytetit, e cila është më aktive dhe me përmbajtje të përziera duhet të trajtohet me kujdes të posaçëm. Parkimi aktualisht është i organizuar përgjatë rrugëve kryesore, është pa pagese dhe me kohë të pa limituar. Në të shumtën e rasteve është hapësire e destinuar por e pa

shenjezuar. Nëse rrugët mund të bëhen një kahesh atëherë sipërfaqja anash rrugëve mund të shfrytëzohet për parkim.

Në sipërfaqet ku planifikohen ndërtime të reja duhet të sigurohet parkimi si për shfrytëzuesit e përhershëm ashtu edhe atyre të përkohshëm. Në hapësirat e veçanta si ato pranë qendrës sportive dhe rekreative, duhet të parashihen hapësirat për parkimin e automjeteve, duke pasur parasysh periudhat me ngarkesat më të mëdha gjatë ditës, javës dhe vitit.


Ka edhe raste ku parkimi behet në trotuare nëpër trotuare dhe vende tjera të lira. Me zgjidhjen e këtyre problemeve atëherë do të mund të kishte me shumë sipërfaqe për këmbësorë, çiklistë apo sipërfaqe të gjelbër.

**Trotuaret për këmbësorë** janë element i domosdoshëm për rrjetin e rrugëve urbane. Në qendër janë të organizuara relativisht mire. Në rrugët e brendshme dhe ato periferike të qytetit ato nuk kanë gjerësi të mjaftueshme apo mungojnë në tërësi. Ato duhet të definojnë si hapësira për këmbësorë dhe të sigurojnë se kërcënimi nga lëvizja e automjeteve është evituar. Përgjatë rrugëve kryesore shtigjet për këmbësorë duhet të ndahen me shiritin gjelbërues dhe ku është e mundur edhe me shtegun për çiklistë.

Në disa pika karakteristike të zonës urbane ku qarkullimi është i madh (rasti i ditës së tregut), këmbësorëve duhet t'u jepet prioritet për qasje dhe shfrytëzim të hapësirës. Pika të grumbullimit dhe qarkullimit aktiv janë hapësirat publike të tregut, afër shitoreve apo objekteve me përmbajtje tregtare, prej parkut deri në qendër, përmbajtjet hoteliere si pika strategjike në qytet, etj. Mund të përmendim rregullimin e një trotuari të pandërprerë nga parku deri në qendër anash rrugës dhe anash përroit të Dimces; zgjerimi i trotuarit verior të rruges kryesore në minimum 2m', rregullimi i një trotuari rreth Lumit Lepenc, në rrugët e lagjeve dhe ato rezidenciale, etj.

**Çiklizmi** mund të jetë njëra ndër format alternative të transportit e cila është shumë e preferuar në Evropën perëndimore për shkak të mos ndotjes së ambientit dhe mbajtjes së shëndetit për qytetaret. Zhvillimi industrial mund të ndihmojë pozitivisht këtë lloj transporti. Duke marrë parasysh terrenin e rrafshet të zonës urbane të Hanit të Elezit duhet shikuar mundësia e rregullimit të këtyre shtigjeve se paku nëpër rrugët e lagjeve e deri të zona industriale. Gjithashtu rreth bregut të lumit do të ishte një shteg i mire rekreativ.

Infrastuktura/transporti/mobiliteti



### 3.2.6 Mjedisi, peizazhi urban dhe trashëgimia

#### Mjedisi

Si pasojë e zhvillimit industrial në Qytetin e Hanit të Elezit ndotja është e evidente. Siç është thënë më lart ka më së shumti ndotje të ajrit, tokës, ujit të Lumit dhe përrrenjve, si dhe ndotja nga zhurma e shkaktuar nga trafiku dhe industrinë, degradimi i ambientit nga nxjerrja e lëndës së parë, etj. Natyrisht se i gjithë ky zhvillim i industrisë së materialeve ndërtimore dhe zhvillimet tjera të planifikuara kanë karakteristikat e veçanta të ndotjes. Është e domosdoshme që ky zhvillim të balancohet me ndotje sa më minimale të mjedisit në kuadër të parametrave të lejuara të EU-së.

*Do ti kushtohet rëndësi:*

- *Grimcat materiale të emetuara në ajër (madhësia e lejuar e tyre),*
- *Ndotjes nga pluhuri,*
- *Ndotjes nga oksidi i nitrogjenit (NOX),*
- *Ndotjes nga dioksidi i nitrogjenit (NO2),*
- *Ndotjes nga dioksidit të sulfurit (SO2) dhe*
- *Emetimit të gazrave me efekt të serres.*

Mjedisi i Hanit të Elezit, veçanërisht në qytet, është shumë i rëndësishëm. Prandaj fokusi kryesor duhet të jetë në zvogëlimin e ndotjes së ajrit.

*Rekomandimet*

- *Në bashkëpunim me MMPH-në të themelohet sistemi i monitorimit dhe të monitorohet ndotja e ajrit*
- *Bashkëpunimi ndër komunal dhe veprimet tjera brenda komunale për zvogëlimin e ndotjes së lumit Lepenc dhe përrrenjve të Dimces dhe Rezhancës*
- *Dekontaminimi i zonës ku toka është e ndotur (nga mbetjet e azbest çimentos) në bashkëpunim me MMPH-në*
- *Krijimi i kompanisë lokale për mbledhjen e mbeturinave si dhe mbështetja për përmirësimin kualitativ të këtij sistemi.*
- *Kufizimi i ndotjes nga zhurma duke marrë parasysh edhe autostradën e planifikuar*

#### Peizazhi urban

Zona urbane e Hanit të Elezit shtrihet në luginën në mes të Maleve të Sharrit dhe të Karadakut. Rrjedha e lumit Lepenc është si vijë ndarëse gjeografike ndërmjet këtyre dy maleve e cila gjithashtu e përshkon zonën urbane në mes të saj. Vlerat natyrore të peizazhit të Hanit të Elezit janë parakushte që ofrojnë mundësi për investime në fushën e mbrojtjes dhe zhvillimit të natyrës si dhe në zhvillimin e turizmit transit dhe rural.

Duke e analizuar natyrën dhe peizazhin e qytetit të Hanit të Elezit, vërehet prezenca e elementeve të rëndësishme natyrore që janë shumë domethënëse për zhvillimin e qytetit (parku, bregu i lumit, toka bujqësore, etj). Meqenëse këto elemente natyrore kanë vlerat e caktuara, qëllimi për të ardhmen e Hanit të Elezit është kërkimi i masave për mbrojtjen e tyre dhe të shërbejnë për përmirësimin e jetës së qytetarëve duke krijuar një mjedis të balancuar dhe të shëndoshë për të gjithë.

Është planifikuar parku i qytetit dhe hapësirat e tjera të gjelbra në pronat e ish ushtrisë, sheshi i qytetit me sipërfaqet e gjelbra, sipërfaqet e gjelbra të lagjeve, korridoret e gjelbra ngjitur objekteve dhe rreth rrugëve, kopshtet e gjelbra, etj. E gjithë kjo infrastrukturë e gjelbër duhet të përforcohet duke krijuar korridore të reja të gjelbërimit të cilat do të lidhen me shiritat me zonat e gjelbra të përmendura më lart e më pas të lidhen me zonën rurale (Pustenik dhe Dremjak). Krijimi i këtij rrjeti bën integrimin e të gjitha "elementeve të gjelbra" e cila më pas ndihmon në funksionimin e tyre si një tërësi. Natyrisht se për të arritur këtë është shumë esenciale kufizimi i mureve rrethuese të oborreve apo kopshteve të gjelbra në lartësi maksimale 1m'

Autostrada e planifikuar, shikuar në kontekstin lokal, është vlerësuar se do të dëmtojë peizazhin e Hanit të Elezit me vet faktin se ajo do të kalojë paralel me lumit Lepenc nëpër tërë zonën urbane. Kjo gjithashtu do të rezultojë në zënien e tokave bujqësore si dhe pritjet të jap edhe efektin e ndarjes së mëtejme të zonës

urbane pa marrë parasysh mbikalimet e parapara. Por natyrisht se bregu i Lumit dhe përroit Dimca, si potenciale natyrore, duhet të kenë shiritin e gjelbër, të jenë të hapur për banorët dhe në të njëjtën kohë të jenë të mbrojtur. Brigjet duhen pastruar dhe trajtuar me qëllim të krijimit të një hapësire për relaksim dhe rekreacion.

Ndërtimet në hapësirat e parapara për gjelbërim nuk lejohen por vetëm intervenime të lehta të cilat sigurojnë infrastrukturë bazike për qytetarët dhe të huajt në mbështetje të turizmit të transit si shtigje për këmbësorë dhe çiklistë, ulëse, ndriçim dhe disa pika shërbyese më konstruksion të lehtë.

Parku i planifikuar dhe hapësirat e propozuara për sport dhe rekreacion duhen të lidhen ngushtë me sheshin e qytetit dhe rrjetin e gjelbër që e shoqëron bregun e lumit. Kjo poashtu duhet të plotësohet me shtigje për këmbësor dhe çiklistë dhe me infrastrukturë tjetër të nevojshme urbane duke ofruar hapësirë për aktivitete të ndryshme.

### **Trashëgimia**

Pjesa e vjetër e fabrikës së çimentos si dhe apartamentet e vjetra ngjitur saj, të ndërtuara në kohën e fillimit të zhvillimit industrial, janë vlerësuar si fundament i rëndësishëm që tregon identitetin e vërtetë të Hanit të Elezit. Ato duhen revitalizuar dhe shfrytëzuar si trashëgimi industriale.

Gjithashtu është propozuar të rindërtohet Hani i Elez Dimces nga i cili ka marrë emrin vetë Qyteti. Hapësira e objektit të Hanit duhet të lidhet me rrjetin e trashëgimisë industriale dhe me trashëgiminë kulturore në zonat rurale dhe të shërbejnë si pikë orientimi për zhvillimin e turizmit.

### **3.2.7 Fatkeqësitë natyrore dhe të shkaktuara nga njerëzit**

Zona urbane e Hanit të Elezit Hanin e Elezit është e cënueshme më së shumti nga vërshimet dhe tërmetet. Zonat e identifikuar që janë të rrezikuara nga vërshimet janë Lagja e Re dhe Analumi. Në Lagjen e Re gjendja është më problematike sepse rrjedha e ujit (përroi) është futur në kanale nëntokësore. Nganjëherë në stinët e shirave gypat nuk kanë kapacitetet e duhura për të absorbuar sasinë e ujit duke shkaktuar kështu vërshimin e pronave të banimit. Por të dy zonat vërshohen edhe nga Lumi Lepenc. Ka edhe rrëshqitje të rralla të dheut të cilat ndodhin përgjatë magjistrales në vendin e quajtur “dheu i bardhë”.

Akujt në periudhën e dimrit përbëjnë rrezik në magjistrale, përafërsisht në të njëjtin vend. Kjo rezulton nga mungesa e kanalizimeve të ujërave sipërfaqësor në këtë rrugë.

Disa objekte janë ndërtuar para se të hynte në fuqi ligji për ndërtimin në zonat sizmike. Por problemi bëhet edhe më i rëndë kur dihet fakti se shumica e ndërtimeve ekzistues janë ilegale.

*Rekomandimet:*

- *Rregullimi i shtratit të Lumit Lepenc dhe përroit Dimca*
- *Në Lagjen e Re rekomandohet që të ndërmerren masa dhe të bëhen analizat e nevojshme se si të zgjidhet problemi i përroit të Rezhancës para se të bëhen zhvillimet e mëtejshme në këtë zonë.*
- *Përgjatë rrugës kryesore Prishtinë – Shkup do të ndërmerren masa në bashkëpunim me pushtetin qendror për të zvogëluar rrëshqitjet e dheut dhe rregullimin e kanaleve kulluese të ujit (Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit është duke e menaxhuar rrugën kryesore).*
- *Ligji i ndërtimit në zona sizmike do të aplikohet për ndërtimet e reja. Objektet e vjetra, me prioritet ato publike, do të analizohen dhe vlerësohen dhe nëse është e nevojshme disa prej tyre do të forcohen për t'i rezistuar tërmeteve.*
- *Spektori i emergjencës në komunë, në bashkëpunim me nivelin qendror do të përgatis planin e emergjencës.*

Gjatë procesit të planifikimit në Han të Elezit, në vazhden e punëtorive dhe diskutimeve publike, kishte pasur propozime që, siç u përmend edhe më herët, sipërfaqet ku është përfunduar procesi i nxjerrjes së lëndës së parë për çimentos të shfrytëzohen për industrinë e reja. Natyrisht se ky propozim ishte mirëpritur nga shumica e pjesëmarrësve nëpër këto aktivitete si dhe nga grupi i planifikimit. Më vonë kur PZHK-ja ishte prezantuar për shqyrtim publik ka përmbytur edhe këtë komponent.



Pas privatizimit të fabrikës së çimentos në dhjetor të vitit 2010, pronari i ri i sipërfaqes së lartpërmendur ka filluar të ndërrojë prona me qytetarët vëndës duke iu ofruar atyre saktësisht një pjesë të kësaj sipërfaqe për ndonjë sipërfaqe që ishte me interes te veçantë për lëndën e parë. Në këtë mënyrë Komuna ka ardhur para faktit të kryer sepse marrëveshjet janë para përfundimit, kurse PZHK-ja nuk është aprovuar ende.

Në anën tjetër sipërfaqja e lartpërmendur nuk është e përshtatshme farë për banim duke qenë shume afër mihjes sipërfaqësore dhe pa kurrfarë ndarjeje fizike. Gjithashtu mundë të jenë prezentë rreziqet nga rrëshqitjet e dheut, rreziqet nga afërsia e makinerive punuese, ndotja e ajrit, ndotja nga zhurma ,etj.

Nëse kjo sipërfaqe lejohet për banim atëherë duhet që së paku të:

- Bëhen analizat gjeomekanike të sipërfaqeve nëse ato i plotësojnë kushtet për ndërtim
- Të bëhet ndarja e kësaj sipërfaqe nga zona industriale me anë të një ndarje natyrore të gjelbër
- Të kërkohet rregullimi i të gjithë infrastrukturës fizike dhe urbane dhe mundësisht plani rregullues i asaj hapësire

## Harta 23

Mjedisi/reduktimi i ndotjes dhe vershimeve



Legjenda

Kufiri urban	Objektet
Kufiri shtetror	Objektet doganore
Autostrada e planifikuar	Objektet industriale
Hekurudhe	Rregullimi aktual i kullit
Lumi/apenc	Reduktimi yershimeve/rregullimi gupave
Hingjetrale	Shteti gjelbert
Rruge shpërndarësi të presionit	Rritja e mirënjohjes së shprehshme
Rruget	Rregullimi i kullit dhe shprehja e pengesave për ndërtimin e autostradave
Rruge për këmbësorë	Rregullimi i parkut
Rruge për veturë	Dekontaminimi i llogaritjes së kullit nga kullat e detyrueshme
Rruget të llojshme	

Skalë: 1:4.000

### 3.2.8 Banimi

Banimi, si funksion kryesor i çdo vendbanimi është vendimtar për stabilitetin social, ambient të shëndoshë, shëndet të mirë dhe për një mirëqenie njerëzore në përgjithësi. Duke qenë shfrytëzuesi më i madh i hapësirës dhe aktiviteti themelor i vendbanimeve, ai ndikon në rrjedhën e zhvillimit të gjithmbarshëm të shoqërisë dhe është njëri ndër komponentët më të rëndësishëm të zhvillimit ekonomik-social, përkatësisht të standardit jetësor të qytetarëve në përgjithësi.

*Në këtë kontekst synimet specifike që duhet arrirë janë:*

- *Inkurajimi i shfrytëzimit të fondit banues të pabanuar*
- *Ripërtëritja e ndërtesave ekzistuese përmes revitalizimit urban (ndërtesat me apartamente afër fabrikës së çimentos).*
- *Ndërtimi i ndërtesave të reja me apartamente në kryesisht në vend të atyre ekzistuese të vjetra dhe të pashfrytëzueshme*
- *Ndërtimi i ndërtesave të reja me apartamente në kryesisht në Qendër të Qytetit dhe Lagje e Re*
- *Përparimi i jetës sociale të banorëve të qytetit, përmes planifikimit të hapësirave të lira, të gjelbëruara, të lojës për fëmijë, fushave të sportit etj*
- *Përparimi i kushteve të banimit që nënkupton qasje të lehtë nga të gjithë, sigurim i parkimit i bazuar në standarde*
- *Sigurimi i një banimi atraktiv, duke e bërë reduktimin e trafikut (zhurmës, ndotjes) në zonat e banimit dhe duhet përforcuar elementet e gjelbërimit.*

Kërkesat aktuale për banim në qytetin e Hanit të Elezit janë mesatare. Ato pasqyrohen me ndërtime sporadike në qendër të qytetit, në Lagje të Re dhe njësitë tjera, por më së shumti rreth magjistrales si shfrytëzim i përzier (banim me biznes).

#### **Dendësia banuese dhe lartësia**

Zona urbane e Hanit të Elezit, siç është përmendur edhe më herët, karakterizohet me dendësi të ultë banuese dhe kjo dendësi është 25 banorë/ha. Sigurimi i tokës për banim është çështje e lidhur ngushtë me planifikimin e dendësisë banuese. Krejt kjo bëhet duke pasur parasysh shtimin e popullsisë me mbi 800 banorë për 15 vitet e ardhshme (kalkulim i cili është bërë duke marrë parasysh indeksin e lindje/vdekjeve dhe migrimin. Kjo është bërë në pjesën e zhvillimit social). Natyrisht se është i rëndësishëm edhe trendi i zvogëlimit të madhësisë së familjeve drejt vlerës mesatare prej 5 banorë/familje nga ajo ekzistuese prej 7.12 banorë/familje; si dhe kërkesat e diasporës për banesa që në të shumtën e rasteve janë për apartamente.

*Përparësitë e densifikimit janë:*

- *Shfrytëzimi racional i tokës në zonat e ndërtimit*
- *Shfrytëzimi racional i infrastrukturës ekzistuese dhe asaj të re*
- *Shfrytëzimi racional i shërbimeve publike*

<b>Përfitimet nga dendësia e lartë:</b>
<b>SOCIALE</b>
• <i>Afërsia sociale inkurajon shumëllojshmërinë dhe bashkëveprimin pozitiv në mes të banorëve</i>
• <i>Përmirëson mundësitë për shërbimet e komunitetit</i>
• <i>Mundëson banim social më të integruar</i>
<b>EKONOMIK</b>
• <i>Rritë dendësinë e aktiviteteve afariste tregtare të cilat ndikojnë në zhvillimin ekonomik</i>
• <i>Siguron përmirësimin e infrastrukturës</i>
<b>MJEDISOR</b>
• <i>Zvogëlon udhëtimin me veturë dhe kërkesat për parkim</i>
• <i>Përkrahë transportin publik</i>
• <i>Rrit efikasitetin energjetik</i>

• *Zvogëlon konsumimin e resurseve*

• *Zvogëlon nivelin e ndotjes*

• *Ruan dhe ndihmon mirëmbajtjen e hapësirave publike*

Propozimi për zhvillimin e ardhshëm të zonës urbane sugjeron densifikimin strukturës ekzistuese të ndërtuar sidomos asaj në Qendër, Lagje të Parkut dhe Lagje të Re; në mënyrë që qyteti të jetë më funksional dhe banorët të kenë qasje më të lehtë në të gjitha shërbimet e nevojshme publike në një distance optimale të ecjes.

*Qëllimet kryesore janë:*

- *Rritja e dendësisë banuese deri në 75 banorë/ha si dendësi optimale në tërë territorin e qytetit*
- *Rritja e dendësisë optimale të jetë 150 banorë/ha në njësinë e Qendrës*
- *Rritja e dendësisë optimale të jetë 100 banorë/ha në Lagjen e Re dhe të Parkut*
- *Rritja e dendësisë kryesisht përmes planifikimit të objekteve më një lartësi optimal P+4+NK në Qendër*
- *Rritja e dendësisë kryesisht përmes planifikimit të objekteve më një lartësi optimal P+3+NK në Lagjen e Re dhe të Parkut*
- *Rritja e dendësisë minimum 50 banorë/ha, por e kontrolluar në njësitë tjera të qytetit të qytetit*

Lidhur me parashikimet demografike të bëra për nevoja të planifikimit dhe që u përmendën më lart, është vlerësuar se toka e destinuar për zgjerimin e sipërfaqes së tokës ndërtimore brenda kufijve të përcaktuar të zonës urbane është e mjaftueshme. Zhvillimi i nevojshëm mund të plotësohet në hapësirat e zbrazëta brenda kufijve të përcaktuar urban dhe me rritjen e dendësisë në lartësi.

*. Lartësia e propozuar definohet në 3 nivele:*

- *Ndërtesat me apartamente me minimum 3 dhe maksimum 5+ nënkulm kate (minimum një kat afarizëm)*
- *Ndërtesat me apartamente me minimum 2 dhe maksimum 4+nënkulm kate (minimum një kat afarizëm)*
- *Ndërtesat banimi me minimum 1 dhe maksimum 2+nënkulm kate*

Këto komponentë të kompaktësisë planifikohen në atë mënyrë që të krijohet kontinuitet i strukturës fizike urbane.

### **Lloji i banimit**

Siç është përmendur edhe më lartë në këtë dokument në qytetin e Hanit të Elezit dominon banim i ulët, i cili në pjesën më të madhe përbëhet prej shtëpive të veçanta individuale. Kjo sipërfaqe përbën 97.5% të banimit të përgjithshëm.

Plani Zhvillimor Urban parasheh rritjen e sipërfaqen së banimit të mesëm me tendencë që raporti i sipërfaqeve banim i ulët/banimin e mesëm të jetë së paku 80% /20%.

### **Trajtimi i hapësirave brenda njërive urbane**

Bazuar në konceptin e densifikimit është e natyrshme që një pjesë e madhe e qytetit duhet t'i nënshtrohet procesit të rigjenerimit urban. Brenda qytetit, nëpër njësitë e planifikuara, duhet të identifikohen sipërfaqet prioritare për rigjenerim, duke i dhënë përparësi pjesëve të rëndësishme me interes të përgjithshëm.

Meqenëse njësitë urbane veçohen me tipare të ndryshme sociale dhe mjedisore, edhe mënyra e trajtimit të tyre është e ndryshme.


Janë rekomanduar këto forma të trajtimit që duhet të elaborohen më detalisht në Planet Rregulluese Urbane:

- *Rigjenerimi urban— që parasheh tërësinë e intervenimeve në zonën ekzistuese, rindërtimi, ndërtimi i ri dhe përparimi i hapësirës publike/private me qëllim të nxitjes së zhvillimit ekonomik dhe social*

- Rikonstruktimi si formë e trajtimit kryesisht për Qendrën: rivitalizimi apo rrënimi i strukturave ekzistuese të paqëndrueshme dhe planifikimi i strukturave të reja të banimit
- Densifikimi i hapësirave urbane – që parasheh interpolimin e strukturave të reja të banimit në mjedisin e ndërtuar, me qëllim të rritjes së dendësisë së banimit dhe shfrytëzimit më efikas të hapësirës.

## **Harta 24**

Lartesia e objekteve/Etazhiteti





### **3.3. Zona ekzistuese urbane dhe zgjerimi i propozuar i zonës ndërtimore jashtë zonës urbane**

Plani propozon zgjerimin e sipërfaqes urbane në pjesën veriore të Qytezës në rast të mos arritjes së qëllimeve të propozuara të densifikimit. Sipërfaqet ekzistuese urbane janë definuar dhe vendimi është marrë nga Asambleja Komunale për arsye se Hani i Elezit nuk ka pasur më herët zonë urbane.

Popullsia e Hanit të Elezit deri më 2025 është vlerësuar të jetë 11,850 banorë. Koncepti i zhvillimit hapësinor propozon densifikimin e zonës ekzistuese urbane me banim dhe ndërtim në përgjithësi duke përfshirë edhe Lagjen e Re.

Për sipërfaqet jashtë zonës urbane është punuar harta e zonimit e cila definon zonat e banimit dhe ndërtimet për të gjitha vendbanimet.

### **3.4. SHENJIMI I NDËRTIMEVE TE RËNDËSISHME, PROJEKTEVE STRATEGJIKE OSE ZONËS SË VECANTË E CILA VEQ ËSHTË APROVUAR NË PLANIN HAPËSINOR TË KOSOVËS OSE PLANET E ZONAVE TË VECANTA**

Plani Hapësinor i Kosovës për zonën në të cilën ndodhet Hani i Elezit ka paraparë:

- Zhvillimin e stacionit hekurudhor,
- Autostradën e re
- Piken kufitare Hani i Elezit
- Ndërtimin e impiantit
- Zonën industriale
- Reduktimin e ndotjes në lumin Lepenc
- Themelimin e stacionit të përhershëm për monitorimin e ajrit

### **3.5 VLERËSIMI I NDIKIMIT SOCIO-EKONOMIK DHE MJEDISOR I KORNIZËS SË PROPOZUAR**

Plani Zhvillimor Urban i Hanit të Elezit është dokumenti i planifikimit urban për gjithë territorin e zonës urbane deri në vitin 2025. Plani Zhvillimor Urban ka për qëllim të përmirësojë jetën e qytetarëve, por planifikimi është shumë-disiplinor dhe nganjëherë planifikimi pa vlerësimin e duhur të ndikimit mund të ketë ndikim negativ për shoqërinë, ekonominë dhe mjedisin. Gjatë përgatitjes së Planit Zhvillimor Urban të Hanit të Elezit, kriteri kryesor për zhvillimin e skenarit ishte zhvillimi i ekuilibruar duke treguar vëmendje të veçantë për zhvillimet socio-ekonomike dhe për mbrojtjen e mjedisit. Hani i Elezit është krijuar nga zhvillimet industriale dhe si rezultat është e vështirë që të shmanget ndikimi i industrive, megjithatë Plani Zhvillimor Urban ka vlerësuar dhe zgjedhur kornizën më të mirë të mundshme të zhvillimit me ndikim minimal socio-ekonomik dhe mjedisor.

Autoritetet komunale janë të detyruara t'i përkthejnë në veprime propozimet e bëra në këtë plan. Veprimet kanë karakteristika të ndryshme si për shembull institucionale, ekonomike, sociale, hapësinore dhe mjedisore. Për implementimin e këtyre aktiviteteve të gjera kërkohet një gamë e gjerë bashkëpunimi mes palëve të ndryshme me interes dhe institucioneve.

- **Ndikimi i mundshëm në mjedis i procesit të implementimit të Planit Zhvillimor Urban**

Ndikimet mund të jenë të pranishme në zvogëlimin e një pjese të tokës bujqësore në zonat urbane. Autostrada e planifikuar dhe hapësira tjetër e planifikuar për akse rrugore dhe industri mund të ketë ndikim negativ në mjedis.

Propozimi për zhvillim ekonomik – zhvillimin e ardhshëm të propozuar industrial - do të përmirësojë ekonominë e përgjithshme të Hanit të Elezit, do të kontribuojë në rritjen ekonomike dhe reduktimin e shkallës së papunësisë me qëllim të përmirësimit të cilësisë së jetës për të gjithë qytetarët. Industrinë do të monitorohen për të ulur ndikimin e tyre në mjedis. Përveç zhvillimit industrial, në Hanin e Elezit

propozohet edhe zhvillimi i bujqësisë urbane (kopshte dhe përpunim i prodhimeve bujqësore) dhe turizmit transit dhe industrial.

Cilësia e përmirësuar e menaxhimit do të përmirësojë cilësinë dhe sasinë e prodhimit. Plani Zhvillimor Urban, gjatë marrjes në konsiderim të zhvillimit hapësinor, jep hapësirën e nevojshme për aktivitetet shoqërore, kulturore dhe sportive, për shërbime dhe aktivitete ekonomike në fushat e dhëna. Plani synon që të stimulojë zhvillimin ekonomik duke tërhequr investime për biznese të sigurt.

Koncepti për përmirësimin e zonave të banimit ka për qëllim që të përmirësojë mjedisin e jetesës për qytetarët duke inkurajuar përmirësime të rëndësishme në sigurimin e hapësirës me karakter rekreativ. Përveç këtyre, zonat e propozuara si hapësira të gjelbëruara dhe për funksione të reja me karakter sportiv dhe rekreativ kanë për synim që të përmirësojnë jetesën e qytetarëve.

Koncepti i propozuar i rrjetit rrugor ka për synim të krijojë një strukturë të qartë të lëvizjes së njerëzve, mallrave dhe shërbimeve, duke stimuluar me anë të kësaj iniciativat ekonomike, lidhjet më të mira me zonat e qytetit dhe zonat përreth, duke stimuluar rrjedhën e shkëmbimeve të Hanit të Elezit, në veçanti përgjatë akseve rrugore.

Ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve dhe impiantit të trajtimit të ujërave të zeza do të ndikojë në uljen e ndotjes së ujërave sipërfaqësore që derdhen në përrrenj , lumin Lepenc dhe ujërat nëntokësore.

Lokacioni i propozuar për zgjerimin urban do të reduktojë nivelet e zhurmës nga transporti dhe ndotjen e qytetit. Mbajtja e aksit rrugor të magjistrales Prishtinë-Shkup si një korridor i lirë, duke planifikuar qasje të drejtpërdrejta minimale, do të reduktojë ndjeshëm nivelin e ndotjes të shkaktuar nga trafiku shumë i ngadalshëm rajonal.

Rregullimi i të zonave të gjelbëruara, pyllëzimi dhe ruajtja e hapësirave të gjelbëruara do të rrisë diversitetin biologjik dhe konservimin e peizazhit natyror të komunës.

Zonat e gjelbëruara të propozuara në zonat banimit do të ndihmojnë në rritjen e cilësisë së këtyre lagjeve dhe objekteve banesore.


Propozimi i zhvillimit në anën perëndimore të qytetit (zgjerim urban) do të përmirësojë cilësinë e jetës së qytetarëve sepse ndotja e ajrit dhe ndotja nga zhurma janë më të vogla në atë zonë. Zhvillimi nuk do të ndërpresë trafikun në rrugën kryesore Prishtinë-Shkup. Zhvillimet industriale nuk do të ndërpresin zhvillimin e qytetit.

Koncepti i propozuar i shfrytëzimit të tokës do të bëjë mbrojtjen nga degradimi i mjedisit në përgjithësi dhe do të përkrahë përdorimin racional të tokës. Kjo po ashtu është financiarisht më e pranueshme për zhvillimin dhe menaxhimin e infrastrukturës. Zona do të jetë kompakte dhe do të rrisë mundësitë për zhvillime komerciale brenda komuniteteve.

Kufizimi i zhvillimit në anën lindore të qytezës në zonën e resurseve natyror ka për synim që të shmangë ndikimin social në fazat e mëvonshme kur zhvilluesit industrialë të kërkojnë zhvendosjen e vendbanimeve për të eksploruar (përdorur) resurset për prodhimin e çimentos.

## **Harta 25**

# Harta integruar



**Legjenda**

Kufiri urban	Stacioni trenit	Hapsire shëndetësore	Hapsire turistike dhe shërbimesh të ndërshtetërisht të përbashkëta
Hekurudhe_Railroad	Nisqatini për kembësore	Hapsire religjioze/hani	Hapsire banimi reo dëndesë të lartë
Lumi_River Lepenc	Pike kalitare	Hapsire shkollore	Hapsire komerciale
Pencojet_streams	Mëkallime tërë autostrade	Hapsire administrative	Hapsire banimi reo dëndesë të ulët
Rruge fundore	Stacioni monitorimi ajrit	Hapsire e rezervuar për administrative	Hapsire banimi reo dëndesë të rezeime
Autostrada e planifikuar	Dekontaminimi/eliminimi i çaterrave	Hapsire e shërbimit të zjarrit/kasino	Hapsire për barim e rezervuar faza 2
Rruge të propozuara	Ridentimi i Hanit	Hapsire e shërbimit paçkor	
Rruge të propozuara për kembësore	Konservimi i fabrikës së vjetër	Hapsire për sport dhe rekreacion	
Bulevard	Tregu i gjelbër	Hapsire parku i qytetit	
Rruge lidhëse	Konservimi i ndërtesave të vjetra	Hapsire e gjelbër	
Korridore kryesore	Rregullimi i ndërtimit të vjetër	Hapsire publike/sheshi i qytetit	
Magjistralja	Rregullimi i shtratit përroit Dimca	Hapsire lumi	
Tranzit i propozuar	Reduktimi i veshimeve/rregullimi i gypave	Hapsire bujqësore	
Rruge kryesore në lagje	Brez i gjelbër	Planned motorway area	
	Dekontaminimi i brezit lumit nga asbesti	Road and railroad area	
	Rehabilitimi i pjesës së llaport/minires	Industrial area	
	Reduktimi i zhurmes në autostradën e propozuar	Mining area	
	Rregullimi i shtratit të lumit Lepenc		

Shkalla: 1:4,000

0 0.05 0.1 0.2 0.3 0.4 Kilometers

## 4. Strategjitë dhe veprimet

### 4.1 Zbatimi i strategjive dhe veprimeve për zbatim

#### 4.1.1 Strategjitë dhe veprimet për shfrytëzimin e tokës

##### Strategjia 1- Sigurimi, rregullimi dhe mbrojtja e tokës së destinuar për shfrytëzim publik

##### Veprimet

- Zgjidhja e kontestit të pronësisë së pronave të ish ushtrisë (kalimi i tyre në pronë publike komunale) në bashkëpunim me Agjencitë e nivelit qendror
- Sigurimi i tokës për shfrytëzim publik sipas planit të shfrytëzimit të tokës
- Inkorporimi i planit të shfrytëzimit të tokës në regjistrat dhe planet kadastrale
- Hartimi i politikave aktive komunale për mbrojtjen e tokave publike

##### Vlerësimi:

Kjo strategji ka për qëllim të rregullojë dhe sigurojë përdorim racional të tokës. Gjithashtu synon të mbrojë sipërfaqet e gjelbra dhe rritjen e hapësirave publike.

#### 4.1.2 Strategjitë dhe veprimet për zhvillimin social

##### 4.1.2a. Shëndetësia

##### Strategjia 2 – Përmirësimi i shërbimeve shëndetësore

##### Veprimet

- Zgjerimi i parcelës së Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare
- Ndërtimi i aneksit të QKMF-së
- Hapja e shërbimeve specialitike të parapara me ligj në kuadër të QKMF-së (pediatria, gjinekologjia, biokimia klinike)
- Pajisjet për “Qendrës Kryesore Mjekësisë Familjarë” në Han të Elezit
- Trajnime të vazhdueshme për stafin

##### 4.1.2b Arsimi

##### Strategjia 3 – Rritja e cilësisë në sektorin e arsimit

##### Veprimet

- Themelimi i klasave për fëmijët me nevoja të veçanta
- Themelimi i sistemit parashkollor (çerdheve të fëmijëve)
- Ndërtimi i çerdhes për fëmijë në Qendër
- Ndërtimi i çerdhes për fëmijë në Lagjen e Re
- Ndërtimi i fazës II dhe III (hapësira të reja mësimore dhe sportive) të shkollës fillore “Iliaz Thaqi”
- Hapja e klasave profesionale ekonomike (industri, makineri, turizëm) dhe bujqësore në kuadër të shkollës së mesme
- Zgjerimi i parcelës së shkollës së mesme
- Rregullimi i kulmit të ndërtesës së shkollës së mesme
- Ndërtimi i palestrës sportive të shkollës së mesme
- Ndërtimi/përmirësimi i hapësirave sportive të jashtme ne oborret e shkollës fillore dhe të mesme

<ul style="list-style-type: none"> <li>• Trajime të vazhdueshme për staf dhe ekskursione me qëllim edukimi për nxënës</li> </ul>
<b>4.1.2c Kultura, sporti dhe rekreacioni</b>
<b>Strategjia 4 – Krijimi i kushteve për aktivitete shoqërore, kulturore dhe sportive</b>
<b>Veprimet</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndërtimi i Shtëpisë së Kulturës</li> <li>• Themelimi i Bibliotekës së Qytetit dhe sigurimi i një fondi librash (institucioni parashihet te veproje brenda SHK)</li> <li>• Themelimi/ndërtimi i objektit të Muzeut të Qytetit</li> <li>• Rregullimi i hapësirave të jashtme (të hapura) për aktivitete shoqërore dhe kulturore</li> <li>• Rregullimi i hapësirave të jashtme për aktivitete sportive dhe rekreative (Qendër dhe Lagja e Re)</li> <li>• Ndërtimi i fushës sportive/stadiumit</li> <li>• Ndërtimi i palestrës sportive të qytetit</li> <li>• Rregullimi i parkut të qytetit (duke përfshirë të dy sipërfaqet e ish ushtrisë në lindje të magjistrales) me të gjithë infrastrukturën e nevojshme</li> <li>• Sigurimi dhe rregullimi i hapësirës për zonat e gjelbra (parqet e vogla) në Qendër dhe Lagja e Re</li> </ul>

#### **Vlerësimi:**

Qëllimi i këtyre strategjive është të përmirësojnë cilësinë e shkollimit, të ketë komunitet të sigurtë dhe të shëndoshë dhe të ofrojë shërbime më të mira për qytetarët.

Gjithashtu mëton të krijojë hapësira të hapura për të gjithë si dhe sisteme parqesh me qasje mirë të planifikuar dhe të integruar e cila do ti rrishte mundësitë e ofruara nga shumëllojshmëria natyrore e Hanit të Elezit. Kjo nënkupton mundësi të ndryshme sportive, kulturore dhe rekreative për njerëzit e të gjitha moshave, gjinive si dhe të ardhurave dhe mundësive të ndryshme.

#### **4.1.3 Strategjitë dhe veprimet për zhvillim ekonomik**

##### **4.1.3a Industria**

**Strategjia 5- Krijimi i kushteve për zhvillim të ri industrial dhe mbështetje të industrive aktuale**

##### **Veprimet**

- Identifikimi i saktë, ndarja sipas nevojës dhe përpilimi i regjistrave të tokës për industri të reja të propozuara me PZHU
- Krijimi i infrastrukturës fizike për industrinë e reja dhe shërbimet lidhur me to
- Promovimi dhe inkurajimi i bizneseve industriale që lidhen me lenden e pare të çimentos apo materialeve tjera ndërtimore

##### **4.1.3b Tregtia dhe transportimi i mallrave**

**Strategjia 6 – Promovimi i zhvillimit të mëtejshëm të bizneseve tregtare, transportuese të mallrave dhe shërbyese-hoteliere**

##### **Veprimet**

- Përkrahje në themelimin e shoqatës së bizneseve për transportimin e mallrave dhe bizneseve tjera tregtare, hoteliere, etj
- Sigurimi i hapësirës për parkim te automjeteve për transport mallrash

<ul style="list-style-type: none"> <li>Analiza e trendëve të reja të zhvillimit për shfrytëzimin e tokës për qëllime të tregtisë me pakicë dhe bizneseve komerciale.</li> <li>Organizimi i trajnimeve profesionale për bizneset lokale (hartimin e planeve të biznesit)</li> </ul>
<b>4.1.3c Bujqësia</b>
<b>Strategjia 7 – Promovimi dhe zhvillimi i bujqësisë urbane</b>
<b>Veprimet</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>Identifikimi detal dhe klasifikimi i tokave bujqësore bazuar në propozimet e PZHU</li> <li>Rigjenerimi i tokave ekzistuese bujqësore (me theks të veçantë për kultivim të kulturave me serra)</li> <li>Përkrahja e prodhimit bujqësor me kuadro të reja dhe ndihmë për bizneset nga shkolla e propozuar profesionale për bujqësi</li> <li>Promovimi dhe marketingu i bujqësisë urbane dhe produkteve të saj</li> </ul>
<b>4.1.3 d- Turizmi</b>
<b>Strategjia 8 – Krimi i infrastrukturës për zhvillimin e turizmit</b>
<b>Veprimet</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>Krijimi i një platforme lokale (nga një bord i përhershëm lokal) për zhvillimin e aktiviteteve turistike në zonë urbane</li> <li>Fushatë për vetëdijësim për ruajtjen e vlerave të trashëgimisë së përgjithshme</li> <li>Hartimi i planit për konservimin e trashëgimisë kulturore dhe industriale</li> <li>Negocimi me pronarin e fabrikës për ruajtjen dhe shfrytëzimin fabrikës së vjetër të çimentos apo një pjese të saj edhe për turizëm (ndonjë marrëveshje për shfrytëzim të herëpashershëm, një javë në muaj, apo në ndonjë mënyrë tjetër)</li> <li>Konservimi i veglave të vjetra të fabrikës së vjetër</li> <li>Vlerësimi dhe intervenimet e mundshme në rigjenerimin e objekteve të vjetra të ndërtuara për punëtorët e fabrikës</li> <li>Rregullimi i infrastrukturës rrugore (shtigjet për këmbësorë në zonat e trashëgimisë)</li> <li>Mbështetja për shërbimet hoteliere</li> <li>Krijimi i një sistemi informativ gjithëpërfshirës për promovimi i produktit turistik (përmes hartave, broshurave, udhëzuesve, publikimeve, webfaqes, etj)</li> <li>Rindërtimi objektit të Hanit nga i cili ka marrë emrin komuna Hani i Elezit</li> </ul>

#### **Vlerësimi-**

Këto strategji kanë për qëllim të krijojnë një komunë konkurruese që përkrahë ekonominë lokale të qëndrueshme, të llojlojshme dhe të përshtatshme. Synon të ruajë industrinë ekzistuese dhe të nxirë industrinë e reja, zhvillimin bujqësor dhe turistik në mënyrë që të krijojë mundësi të reja punësimi për qytetarët dhe të kontribuojë në uljen e shkallës së varfërisë.

#### **4.1.4 Strategjitë dhe veprimet për zhvillimin e infrastrukturës urbane**

##### **4.1.4 a. Ujësjellësi dhe kanalizimi**

**Strategjia 9- Përmirësimi i rrjetit të ujësjellësit, kanalizimit të ujërave të zeza dhe atmosferike**

#### **Veprimet**

- Themelimi i një kompanie publike për menaxhimin e sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimit
- Rehabilitimi i rrjetit ekzistues të ujësjellësit për Hanin e Elezit në mënyrë që të arrihet sasia dhe cilësia e projektuar e furnizimit me ujë.



<ul style="list-style-type: none"> <li>• Reduktimi i nivelit të keqpërdorimeve dhe detyrimi i për përdorim racional të ujit të pijes bazuar në Rregulloren a aprovuar komunale për mbrojtjen e mjedisit.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Analizat permanente dhe klorifikimi sipas nevojës i ujit të rrjetit ekzistues dhe puseve private</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Hartimi i skemave të kanalizimit fekal bazuar në sistemet ekzistuese në terren, analizat e tyre si dhe rregullimi i këtij sistemi.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndërtimi i rrjeteve të ndara për kanalizim atmosferik në qytet</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave te zeza</li> </ul>
<b>4.1.4b. Rryma elektrike dhe telekomunikacioni</b>
<b>Strategjia 10 – Përmirësimi i infrastrukturës së energjisë elektrike dhe telekomunikacionit</b>
<b>Veprimet</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rregullimi (përmirësimi) i rrjetit shpërndarës të furnizimit me energji elektrike në të gjitha zonat e qytezës</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shpërndarja e rrjetit te telekomunikimit në të gjitha zonat e qytezës</li> </ul>
<b>4.1.4c. Menaxhimi i mbeturinave</b>
<b>Strategjia 11 - Krijimi i një sistemi për menaxhimin e mbeturinave</b>
<b>Veprimet</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Themelimi i një kompanie publike për menaxhimin të mbeturinave</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Në bashkëpunim me komunitetin të zvogëlohet sasia e mbeturinave (selektimi/riciklimi)</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Hartimi i planit për menaxhimin e mbeturinave</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mbështetja e OJQ-ve për organizimin e fushatave për ngritjen e vetëdijes rreth selektimit/riciklimit</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ofrimi i kontejnerëve për mbeturina ne të gjitha lagjet</li> </ul>

#### **Assessment:**

Qëllimi i këtyre strategjive është të sigurojë qasje në shërbimet publike për të gjithë qytetarët si dhe të mbrojë ambientin.

### **4.1.5 Strategjitë dhe veprimet për zhvillimin e infrastrukturës rrugore dhe transportit**

#### **4.1.5.a Infrastruktura rrugore**

##### **Strategjia 12 – Përmirësimi i infrastrukturës rrugore në zonën urbane**

##### **Veprimet**

- Sigurimi i të gjitha korridoreve të komunikimit sipas PZHU-së
- Mirëmbajtja dhe plotësimi i magjistrals me infrastrukturë shtesë (shtigje çiklistësh, ndriçim, shenja trafiku, etj)
- Asfaltimi dhe mirëmbajtja e rrugës regionale (brenda zonës urbane) HiE-GII duke përfshirë edhe profilin dhe infrastrukturën e duhur (trotuare, shtigje çiklistësh, ndriçim, shenja, etj)
- Asfaltimi apo rregullimi nëse janë të asfaltuara si dhe mirëmbajtja e rrugëve të lagjeve

(duke përfshirë edhe rrugën Qendër-Lagja e Re) dhe rrugëve lokale (brenda zonës urbane) duke përfshirë profilin dhe infrastrukturën e duhur (trotuare, shtigje çiklistësh, ndriçim, shenja, etj)

- Asfaltimi dhe mirëmbajtja e rrugëve rezidenciale duke përfshirë edhe profilin dhe infrastrukturën e duhur (trotuare, ndriçim, shenja, etj)
- Destinimi i hapësirave pas ndërtesave ekzistuese dhe të propozuara për parkim
- Planifikimi i hapësirave për parkim të kufizuar kohor rreth rrugëve kryesore dhe në qendër
- Krijimi i pjerrinave për PAK në çdo vendkalim për këmbësorë dhe hyrje të objekteve publike

#### 4.1.5.b Infrastruktura rrugore për komunikacion jomotorik

##### Strategjia 13 – Hapja dhe rregullimi i shtigjeve për këmbësorë dhe çiklistë

###### Veprimet

- Krijimi apo zgjerimi i shtigjeve të këmbësorëve rreth rrugëve; magjistrale, regjionale, lokale (brenda zonës urbane), rrugëve të lagjeve si dhe ato rezidenciale
- Zgjerimi i hapësirave për këmbësorë në vendet ku qarkullimi është më i madh si p.sh. afër përmbytjeve industriale, tregtare, komunikatave (stacioni i trenit dhe i autobusëve), qendrat rekreative-sportive, etj.
- Krijimi i rrugëve për këmbësorë në koridoret dhe zonat e gjelbra me qëllim të rekreacionit dhe mundësisë së lëvizjes nëpër mjedisin natyror
- Vetëdijësimi i banorëve për biçikletën si mjet efikas i qarkullimit (posaçërisht në vendet industriale) si dhe përparësitë që bartë ajo për shëndetin e tyre
- Krijimi i shtigjeve për biçikleta nëpër rrugët që qojnë në industri apo qendër

#### 4.1.5.c Transporti dhe mobiliteti

##### Strategjia 14- Themelimi i sistemit të transportit publik

###### Veprimet

- Hartimi i planit për zhvillimi të një sistemi efikas të transportit (stacioni i autobusëve me lidhje të drejtpërdrejtë me stacionin e trenit dhe vendndaljet e transportit lokal) me qasje më të mirë për të gjithë qytetarët.
- Caktimi i një vend ndalje dhe orarit që autobusët që qarkullojnë nga Shkupi në komunat e tjera të Kosovës të ndalen në Han të Elezit
- Inkurajimi i shfrytëzimit të gjitha mënyrave të transportit përmirësimi i rrugicave, shtigjeve për këmbësorë dhe biçikleta
- Ndërtimi i stacionit të autobusëve

#### Vlerësimi:

Strategjitë kanë për qëllim të përmirësojnë qasjen në të gjitha zonat urbane dhe të sigurojnë lëvizje efikase dhe të sigurtë të njerëzve dhe mallrave si dhe të nxis transportin jo motorik.

#### 4.1.6 Strategjitë dhe veprimet për mbrojtjen e mjedisit, trashëgimisë dhe pisazhit urban

##### Strategjia 15 – Mbrojtja e mjedisit

###### Veprimet

<ul style="list-style-type: none"> <li>• Themelimi i sistemit për monitorim të ajrit</li> <li>• Bashkëpunimi me Komunën e Kaçanikut për reduktimin e ndotjes së lumit Lepenc</li> <li>• Reduktimi i ndotjes nga zhurma duke marrë parasysh edhe autostradën e planifikuar</li> </ul>
<b>Strategjia 16 –Dekontaminimi në zonat e kontaminuar</b>
<b>Veprimet</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Vlerësimi i zonave që konsiderohen të kontaminuar</li> <li>• Dekontaminimi i zonave të identifikuara problematike (asbesti)</li> <li>• Heqja e cisternave të mbetura ne zonën e ish armatës mbi magjistrale</li> </ul>
<b>Strategjia 17 –Përmirësimi, krijimi dhe mbrojtja e hapësirave të gjelbra (biodiversitetit) dhe peizazhit urban</b>
<b>Veprimet</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Krijimi i brezit të gjelbër kufizues mes qendrës dhe industrisë</li> <li>• Krijimi i brezit të gjelbër përgjatë lumit Lepenc</li> <li>• Pastrimi dhe rregullimi i shtratit të lumit Lepenc dhe përroit Dimca</li> <li>• Krijimi i korridoreve të gjelbra përgjatë rrugëve kryesore</li> <li>• Rrethimi i hapësirave shkollore me gjelbërim</li> <li>• Përmirësimi i peizazhit urban rreth rrugëve kryesore dhe pikave urbane promovuese turistike</li> </ul>

#### Vlerësimi:

Strategjitë kanë për qëllim të ruajnë hapësirat natyrore, të krijojnë hapësira të reja dhe të mirëmbajnë një mjedis natyral dhe të ndërtuar sa më pastër dhe atraktiv. Gjithashtu synon të krijojë mjedis të pastër dhe të shëndoshë.

#### 4.1.7 Strategjitë dhe veprimet për vlerësimin, zvogëlimin dhe zbutjen e fatkeqësive

**Strategjia 18- Reduktimi i rreziqeve dhe menaxhimi i ndikimeve negative në mjedis të shkaktuara nga natyra apo nga njeriu**

##### **Veprimet**

- Ndërmarrja e masave dhe analizat e nevojshme se si të zgjidhet problemi i përroit të Rezhancës para se të bëhen zhvillimet e mëtejshme në Lagjen e Re.
- Intervenimi së bashku me MTPT-në në zonën e magjistrale ku ka rrezik nga rrëshqitja e dheut dhe krijimi i akujve gjatë dimrit
- Vlerësimi i rrezikut në zonat ku përpara kanë qenë bazat ushtarake (eliminimi i rrezikut)
- Shtimi i kapaciteteve në departamentin e zjarfikësve (trajnimi dhe pajisje me mjete)
- Hartimi i planit të përbashkët të veprimit Komuna ne bashkëpunim me doganën dhe fabrikat
- Ndërtimi i kapaciteteve për të reaguar në rast rreziku nga zjarret apo fatkeqësitë e ndryshme (trajnime dhe pajisje te nevojshme)

#### Vlerësimi:

Qëllimi i kësaj strategjie është ndërmarrja e masave për reduktimin e fatkeqësive dhe rreziqeve. Duke

**marrë masat e nevojshme qytetarët e Hanit të Elezit do të kishin ambient jetese më të sigurtë si dhe dëmet do të ishin më të vogla.**

#### **4.1.8 Strategjitë dhe veprimet për zhvillimin e banimit**

##### **Strategjia 19-Rritja e dendësisë së banimit**

###### **Veprimet**

- **Promovimi i banimit të mesëm(më së larti 5+NK etazhe) në Qendër, Lagja e Parkut dhe Lagja e Re**
- **Kufizimi i ndërtimeve të tjera në sipërfaqet e identifikuar për densifikim në të ardhmen**
- **Promovimi i fuqishëm i trajtimit të strukturës ekzistuese urbane apo disa elementeve të saj përmes: rekonstruktimit, rigjenerimit, revitalizimit , etj.**

##### **Strategjia 20-Promovimi i partneritetit publiko privat**

###### **Veprimet**

- **Krijimi i një platforme nga Komuna për të qenë e hapur për forma të ndryshme të partneritetit publiko-privat**
- **Udhëheqja e zhvillimit të përgjithshëm nga Komuna edhe përmes partneriteti publiko-privat përmes dhënies së tokës me koncesion dhe investimit të përbashkët**

##### **Strategjia 21-Rritja e mundësive për strehim të përballueshëm dhe banim social; dhe trajtimi i ndërtimeve ilegale**

###### **Veprimet**

- **Hartimi i planeve rregulluese-kontrollim i zhvillimit**
- **Hartimi i programeve të banimit duke përfshirë edhe banimin social**
- **Komuna së bashku me nivelin qendror do të shikojë mundësinë për sigurimin e tokës dhe mjeteve materiale për ndërtimin e objektit për banim social**
- **Trajtimi i ndërtimeve pa leje sipas ligjeve/rregulloreve në fuqi**

##### **Vlerësimi:**

Këto strategji kanë për qëllim të krijojnë një standard optimal banimi përmes përdorimit racional të tokës ndërtimore, ruajtjes së tokës bujqësore si dhe qasjes më të mirë në shërbime (densifikim i banimit); përpiqet të zbatojë politika dhe të arrijë standarde banimi përmes platformës e cila u tregua efikase në vendet në zhvillim dhe ato të zhvilluara (partneriteti publiko-privat) si dhe të lehtësojë çështjen e banimit për rastet e veçanta sociale.

## 4.2. Vlerësimi i strategjive

Fushat tematike	Strategjitë	Vlerësimi i ndikimit socio ekonomik dhe mjedisor		
		Mjedisi	Social	Ekonomik
<b>Shfrytëzimi tokës</b>	Sigurimi, rregullimi dhe mbrojtja e tokës së destinuar për shfrytëzim publik	+	+	+
<b>Zhvillimi social</b>	<b>Përmirësimi i shërbimeve shëndetësore</b>	n/a	+	+
	<b>Rritja e cilësisë në sektorin e arsimit</b>	n/a	+	+
	<b>Krijimi i kushteve për aktivitete shoqërore, kulturore dhe sportive</b>	+	+	+
<b>Banimi</b>	Përmirësimi i shërbimeve shëndetësore	+	+	+
<b>Zhvillimi ekonomik</b>	Krijimi i kushteve për aktivitete shoqërore, kulturore dhe sportive Rritja e dendësisë sipas PZHU-së	-	+	+
	Krijimi i kushteve për zhvillim të ri industrial dhe mbështetje të industrive aktuale	-	+	+
	Promovimi i zhvillimit të mëtejshëm të bizneseve tregtare, transportuese të mallrave dhe shërbyese-hoteliere	+	+	+
<b>Infrastruktura urbane</b>	Promovimi dhe zhvillimi i bujqësisë urbane	+	+	+
	Krimi i infrastrukturës për zhvillimin e turizmit	+	+	+
	Përmirësimi i rrjetit të ujësjellësit dhe përmirësimi i rrjetit të kanalizimit të ujërave të zeza dhe atmosferike	-	+	+
<b>Infrastruktura rrugore dhe transporti</b>	Përmirësimi i infrastrukturës së energjisë elektrike dhe telekomunikacionit	-	+	+
	Krijimi i një sistemi për menaxhimin e mbeturinave	-	+	+

	Përmirësimi i infrastrukturës rrugore në zonën urbane	+	+	+
Mjedisi, trashëgimia dhe peizazhi urban	Hapja dhe rregullimi i shtigjeve për këmbësorë dhe çiklistë	+	+	+
	Sigurimi, rregullimi dhe mbrojtja e tokës së destinuar për shfrytëzim publik	+	+	+
	Përmirësimi, krijimi dhe mbrojtja e hapësirave të gjelbra (biodiversitetit) dhe peizazhit urban	+	+	+
		+	+	+
Vlersimi, zvoglimi dhe zbutja e fatkeqsive	Reduktimi i rreziqeve dhe menaxhimi i ndikimeve negative në mjedis të shkaktuara nga natyra apo nga njeriu	+	+	+
		+	+	+



### 4.3. Afatet kohore, implikimet financiare dhe korniza institucionale

\*Kosto e projekteve: U-ulet, M-mesëm, L-lartë.

\*\*Prioriteti: 1- Prioritet i lartë, 2- Prioritet i mesëm dhe 3- Prioritet i lartë.

\*\*\*Afati kohor: ASH-Afat shkurtër (1-3 vj) AM-Afat mesëm (mbi 3-6 vj) AGJ-afat gjatë (mbi 6 vj)

Fushat tematike	Strategjitë	Objektivi	Veprimet	Korniza institucionale	Afati kohor	Kosto	Prioriteti
Shfrytëzimi i tokës	Sigurimi, rregullimi dhe mbrojtja e tokës së destinuar për shfrytëzim publik	Sigurimi i tokës së nevojshme për hapësira dhe shërbime publike bashkë me rregullimin kadastral të saj	Zgjidhja e kontestit të pronësisë së pronave të ish ushtrisë (kalimi i tyre në pronë publike komunale) në bashkëpunim me Agjencitë e nivelit qendror	Komuna, AKP, Agjencitë tjera relevante qendrore	ASh	U	1
			Sigurimi i tokës për shfrytëzim publik sipas planit të shfrytëzimit të tokës	Komuna, Agjencioni i pylltarisë	ASH-AGJ	L	2
			Inkorporimi i planit të shfrytëzimit të tokës në regjistrat dhe planet kadastrale	Komuna, Agjencioni Kadastral	ASH-AM	U	2

Fushat tematike	Strategjitë	Objektivi	Veprimet	Korniza institucionale	Afati kohor	Kosto	Prioritet i	
Zhvillimi social	Përmirësimi i shërbimeve shëndetësore	Përmirësimi i shërbimeve dhe hapësirave shoqërore me qasje për të gjithë qytetarët	Zgjerimi i parcelës së Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare	Komuna, Ministria e Shëndetësisë, Donatorët	AGJ	L	2	
			Ndërtimi i aneksit të QKMF-së	Komuna, Ministria e Shëndetësisë, Donatorët	ASh	M	1	
			Hapja e shërbimeve specialitike të parapara me ligj në kuadër të QKMF-së (pediatria, gjinekologjia, biokimia klinike)	Komuna, Ministria e Shëndetësisë	AM	M	2	
			Pajisjet për “Qendrës Kryesore Mjekësisë Familjarë” në Han të Elezit	Komuna, Ministria e Shëndetësisë, Donatorët	ASH-AGJ	M	1	
			Trajnime të vazhdueshme për stafin	Komuna, Ministria e Shëndetësisë	ASH-AGJ	M	1	
			Themelimi i klasave për fëmijët me nevoja të veçanta	Komuna, Ministria e Arsimit	ASh	M	1	
	Rritja e cilësisë në sektorin e arsimit			Themelimi i sistemit parashkollor (çerdheve të fëmijëve)	Komuna, Ministria e Arsimit	ASH	U	
				Ndërtimi i çerdhes për fëmijë në Qendër	Komuna, Ministria e Arsimit, Komuniteti	ASH	L	1
				Ndërtimi i çerdhes për fëmijë në Lagjen e Re	Komuna, Ministria e Arsimit, Komuniteti	AGJ	L	3
				Ndërtimi i fazës II dhe III (hapësira të reja mësimore dhe sportive) të shkollës fillore “Iliaz Thaqi”	Komuna, Ministria e Arsimit, Donatorët	ASH	L	1
				Hapja e klasave profesionale ekonomike (industri, makineri, turizëm) dhe bujqësore në kuadër të shkollës së mesme	Komuna, Ministria e Arsimit	ASH	M	1
				Zgjerimi i parcelës së shkollës së mesme	Komuna, Ministria e Arsimit, Komuniteti	AGJ	L	2

<b>Krijimi i kushteve për aktivitete shoqërore, kulturore dhe sportive</b>	<b>Rregullimi i kulmit të ndërtesës së shkollës së mesme</b>	Komuna, Ministria e Arsimit	ASH	M	1
	<b>Ndërtimi i palestrës sportive të shkollës së mesme</b>	Komuna, Ministria e Arsimit	AGJ	L	3
	<b>Ndërtimi/përmirësimi i hapësirave sportive të jashtme ne oborret e shkollës fillore dhe të mesme</b>	Komuna, Ministria e Arsimit, Komuniteti	ASH-AM	M	1
	<b>Trajnime të vazhdueshme për staf dhe ekskursione me qëllim edukimi për nxënës</b>	Komuna, Ministria e Arsimit, .....	ASh-AGJ	U	1
	<b>Ndërtimi i Shtëpisë së Kulturës</b>	Komuna, Ministria e Kulturës	AM	L	3
	<b>Themelimi i Bibliotekës së Qytetit dhe sigurimi i një fondi librash (institucioni parashihet te veproje brenda SHK)</b>	Komuna, Ministria e Kulturës, ministria e Arsimit	AM	M	3
	<b>Themelimi/ndërtimi i objektit të Muzeut të Qytetit</b>	Komuna, Ministria e Kulturës	AGJ	L	3
	<b>Rregullimi i hapësirave të jashtme (të hapura) për aktivitete shoqërore dhe kulturore</b>	Komuna, Ministria e Kulturës	ASH-AGJ	M	2
	<b>Rregullimi i hapësirave të jashtme për aktivitete sportive dhe rekreative (Qendër dhe Lagja e Re)</b>	Komuna, Ministria e Kulturës, Komuniteti	ASH-AGJ	M	2
	<b>Ndërtimi i palestrës sportive të qytetit</b>	Komuna, Ministria e Kulturës, Donatorët	AGJ	L	3
	<b>Ndërtimi i fushës sportive/stadiumit</b>	Komuna, Ministria e Kulturës, Donatorët	AGJ	L	3
	<b>Rregullimi i parkut të qytetit (duke përfshirë të dy sipërfaqet e ish ushtrisë në lindje të magjistrales) me të gjithë infrastrukturën e nevojshme</b>	Komuna, Qeveria, Donatorët, Komuniteti	ASH	L	2

			<b>Sigurimi i hapësirës për zonat e gjelbra (parqet e vogla) në Qendër dhe Lagja e Re</b>	Komuna, Qeveria, Donatorët, Komuniteti	AGJ	L	2
--	--	--	---	--	-----	---	---

Fushat tematike areas	Strategjitë	Objektivi	Veprimet	Korniza institucionale	Afati kohor	Kosto	Prioriteti
Zhvillimi ekonomik	Krijimi i kushteve për zhvillim të ri industrial dhe mbështetje të industrive aktuale	Krijimi i mundësive për tërheqjen e industrive të lidhura me industrinë ekzistuese (industritë që mund të shfrytëzojnë çimenton si lëndë të parë)	Identifikimi i saktë, ndarja sipas nevojës dhe përpilimi i regjistrave të tokës për industri të reja të propozuara me PZHU	Komuna, AKP	ASh	U	2
			Krijimi i infrastrukturës fizike për industritë e reja dhe shërbimet lidhur me to	Komuna, MTPT	ASh-AGJ	M	1
			Promovimi dhe inkurajimi i bizneseve industriale që lidhen me lenden e parë të çimentos apo materialeve tjera ndërtimore	Komuna	ASH-AGJ	U	1
	Promovimi i zhvillimit të mëtejshëm të bizneseve tregtare, transportuese të mallrave dhe shërbyese-hoteliere	Përkrahja institucionale për zhvillimin e bizneseve	Përkrahje në themelimin e shoqatës së bizneseve për transportimin e mallrave dhe bizneseve tjera tregtare, hoteliere, etj	Komuna	ASh	U	1
			Sigurimi i hapësirës për parkim të automjeteve për transport mallrash	Komuna, Sipërmarrësit e transportit	ASh	U	1
			Analiza e trendëve të reja të zhvillimit për shfrytëzimin e tokës për qëllime të tregtisë me pakicë dhe bizneseve komerciale.	Komuna	ASH	M	1

	<b>Promovimi dhe zhvillimi i bujqësisë urbane</b>	Zhvillimi i bujqësisë urbane	<b>Organizimi i trajnimeve profesionale për bizneset lokale (hartimin e planeve të biznesit)</b>	Komuna, Ministria e Kulturës	ASH-AGJ	M	1
			<b>Identifikimi detal dhe klasifikimi i tokave bujqësore</b>	Komuna	ASH	U	1
			<b>Rigjenerimi i tokave ekzistuese bujqësore (me theks të veçantë për kultivim të kulturave me serra)</b>	Komuna, Komuniteti	ASH-AGJ	M	2
			<b>Përkrahja e prodhimit bujqësor me kuadro të reja dhe ndihmë për bizneset nga shkolla e propozuar profesionale për bujqësi</b>	Komuna, Ministria e Bujqësisë, Ministria e Arsimit	AM-AGJ	M	2
			<b>Promovimi dhe marketingu i bujqësisë urbane dhe produkteve të saj</b>	Komuna/Privat biznes	ASH-AGJ	M	2
	<b>Krimi i infrastrukturës për zhvillimin e turizmit</b>	Zhvillimi i turizmit transit	<b>Krijimi i një platforme lokale për zhvillimin e aktiviteteve turistike në zonë urbane</b>	Komuna	ASH-AGJ	M	2
			<b>Fushatë për vetëdijesim për ruajtjen e vlerave të trashëgimisë së përgjithshme</b>	Komuna, Ministria e Kulturës	ASH-AGJ	U	1
			<b>Hartimi i planit për konservimin e trashëgimisë kulturore dhe industriale</b>	Komuna, MMPH	ASH	M	1
			<b>Negocimi me pronarin e fabrikës për ruajtjen dhe shfrytëzimin fabrikës së vjetër të çimentos apo një pjese të saj edhe për turizëm (ndonjë marrëveshje për shfrytëzim të herëpashershëm, një javë në muaj, apo në ndonjë mënyrë tjetër)</b>	Komuna, AKP, Fabrika e Çimentos	ASH	U	1

			<b>Konservimi i veglave të vjetra të fabrikës së vjetër</b>	Komuna, Shoqëria Civile, Qytetarët	ASH-AGJ	U	1
			<b>Vlerësimi dhe intervenimet e mundshme në rigjenerimin e objekteve të vjetra të ndërtuara për punëtorët e fabrikës</b>	Komuna, MMPH, CHËB	ASH-AM	L	2
			<b>Rregullimi i infrastrukturës rrugore (shtigjet për këmbësorë në zonat e trashëgimisë)</b>	Komuna, Fabrika e Çimentos, MTPT	ASH-AGJ	M	2
			<b>Krijimi i një sistemi informativ gjithëpërfshirës për promovimi i produktit turistik (përmes hartave, broshurave, udhëzuesve, publikimeve, webfaqes, etj)</b>	Komuna, Shoqëria Civile, Ministria e Transportit	ASH	M	2
			<b>Rindërtimi objektit të Hanit nga i cili ka marrë emrin komuna Hani i Elezit</b>	Komuna, MMPH, Komuniteti	AM-AGJ	L	3

Fushat tematike	Strategjitë	Objektivi	Veprimet	Korniza institucionale	Afati kohor	Kosto	Prioriteti
<b>Infrastruktura Urbane</b>	<b>Përmirësimi i rrjetit të ujësjellësit, kanalizimit të ujërave të zeza dhe atmosferike</b>	Furnizimi me ujë të pijes i gjithë zonës urbane (me theks të veçantë në amvisëri dhe pikat turistike) Sigurimi i qasjes në	<b>Themelimi i një kompanie publike për menaxhimin e sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimit</b>	Komuna, Qeveria	ASH	U	1
			<b>Rehabilitimi i rrjetit ekzistues të ujësjellësit për Hanin e Elezit në mënyrë që të arrihet sasia dhe cilësia e projektuar e furnizimit me ujë.</b>	Komuna, Donatorë, Komuniteti	ASH	L	1



	sistem kanalizimi për të gjithë zonën urbane dhe trajtimi i ujërave të zeza (impiantet e ujërave të zeza)	<b>Reduktimi i nivelit të keqpërdorimeve dhe detyrimi i për përdorim racional të ujit të pijes bazuar në Rregulloren a aprovuar komunale për mbrojtjen e ambientit.</b>	Komuna, MPB, MMPH	ASH	U	1
		<b>Analizat permanente dhe klorifikimi sipas nevojës i ujit të rrjetit ekzistues dhe puseve private</b>	Komuna, Instituti.....	ASH-AGJ	U	1
		<b>Hartimi i skemave të kanalizimit fekal bazuar në sistemet ekzistuese në terren, analizat e tyre si dhe rregullimi i këtij sistemi.</b>	Komuna, Komuniteti	AM	M	1
		<b>Ndërtimi i rrjeteve të ndara për kanalizim atmosferik në qytet</b>	Komuna	AM	L	1-3
		<b>Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza</b>	Komuna, Qeveria	ShT	L	2
<b>Përmirësimi i infrastrukturës së energjisë elektrike dhe telekomunikacionit</b>	Përmirësimi i rrjetit elektrik në qytetin e Hanit të Elezit.	<b>Rregullimi (përmirësimi) i rrjetit shpërndarës të furnizimit me energji elektrike në të gjitha zonat e qytezës</b>	KEK, Ministria e Energjisë	AM	M	2
	Shtimi i numrit të kompanive dhe shërbimeve të telekomunikacionit në qytetin e Hanit të Elezit	<b>Shperdarja e rrjetit te telekomunikimit në të gjitha zonat e qytezës</b>	MTPT	AM	M	3
	<b>Krijimi i një sistemi për menaxhimin e mbeturinave</b>	Menaxhimi adekuat i mbeturinave duke	<b>Themelimi i një kompanie publike për menaxhimin të mbeturinave</b>	Komuna, Qeveria	ASh	M
		<b>Në bashkëpunim me komunitetin</b>	Komuna, Kompania	ASH-	M	2

	përfshirë edhe programet për reduktimin e mbeturinave (riciklimi)	të zvogëlohet sasia e mbeturinave (selektimi/riciklimi)	Komunale, Komuniteti	AGJ		
		Hartimi i planit për menaxhimin e mbeturinave	Kompania Komunale	ASH	M	1
		Mbështetja e OJQ-ve për organizimin e fushatave për ngritjen e vetëdijes rreth selektimit/riciklimit	Komuna, Komuniteti bizneseve, Qeveria qendrore	ASH-AGJ	U	1

Fushat tematike	Strategjitë	Objektivi	Veprimet	Korniza institucionale	Afati kohor	Kosto	Prioriteti
Infrastruktura rrugore dhe transporti (lëvizshmëria)	Përmirësimi i infrastrukturës rrugore në zonën urbane	Sigurimi i infrastrukturës rrugore në të gjitha lagjet e qytetit  Sigurimi i parkimit publik	Sigurimi i të gjitha korridoreve të komunikimit sipas PZHU-së	Komuna, Ministria e Transportit dhe Komuniteti	ASH-AGJ	L	1-3
			Mirëmbajtja, rregullimi i kyçjeve dhe plotësimi i magjstrales me infrastrukturë shtesë (shtigje çiklistësh, ndriçim, shenja trafiku, etj)	Komuna, Ministria e Transportit dhe Komuniteti	ASH-AGJ	L	1-2
			Asfaltimi dhe mirëmbajtja e rrugës regjionale HiE-GII (brenda zonës urbane) duke përfshirë edhe profilin dhe infrastrukturën e duhur (trotuare, shtigje çiklistësh, ndriçim, shenja, etj)	Komuna, Ministria e Transportit dhe Komuniteti	ASH-AGJ	L	1-3
			Asfaltimi apo rregullimi nëse janë të asfaltuara si dhe mirëmbajtja e rrugëve të lagjeve dhe rrugëve lokale (brenda zonës urbane) duke përfshirë profilin dhe infrastrukturën e duhur (trotuare, shtigje çiklistësh, ndriçim, shenja,	Komuna, Ministria e Transportit dhe Komuniteti	ASH-AGJ	L	1-3

			etj)				
			<b>Hapja e trasesë, asfaltimi dhe mirëmbajtja e rrugës së lagjes nga Qendra në Lagje të Re, duke përfshirë profilin dhe infrastrukturën e duhur (trotuare, shtigje çiklistësh, ndriçim, shenja, etj)</b>	Komuna, Ministria e Transportit dhe Komuniteti	ASH-AGJ	L	2-3
			<b>Asfaltimi dhe mirëmbajtja e rrugëve rezidenciale duke përfshirë edhe profilin dhe infrastrukturën e duhur (trotuare, ndriçim, shenja, etj)</b>	Komuna, Komuniteti	ASH-AGJ	L	2-3
			<b>Destinimi i hapësirave pas ndërtesave ekzistuese dhe të propozuara për parkim</b>	Komuna, Komuniteti	AM	M	2
			<b>Planifikimi i hapësirave për parkim te kufizuar kohor rreth rrugëve kryesore dhe në qendër</b>	Komuna, Komuniteti	ASh	U	1-2
			<b>Krijimi i pjerrinave për PAK në çdo vendkalim për këmbësorë dhe hyrje të objekteve publike</b>	Komuna, Komuniteti	ASH	U	1
	<b>Hapja dhe rregullimi i shtigjeve për këmbësorë dhe çiklistë</b>	Rregullimi i trotuareve dhe shtigjeve për këmbësor dhe biçikleta	<b>Krijimi apo zgjerimi i shtigjeve të këmbësorëve rreth rrugëve; magjistrale, regjionale, lokale (brenda zonës urbane), rrugëve të lagjeve si dhe ato rezidenciale</b>	Komuna, Ministria e Transportit dhe Komuniteti	ASH-AGJ	L	2
			<b>Zgjerimi i hapësirave për këmbësorë në vendet ku qarkullimi është më i madh si p.sh. afër përmbajtjeve industriale,</b>	Komuna, Komuniteti	ASH-AM	M	2

		<b>tregtare, komunikimi (stacioni i trenit dhe i autobusëve), qendrat rekreative-sportive, etj.</b>				
		<b>Krijimi i rrugëve për këmbësorë në koridoret dhe zonat e gjelbra me qëllim të rekreacionit dhe mundësisë së lëvizjes nëpër mjedisin natyror</b>	Komuna, Komuniteti	ASH-AM	L	1
		<b>Vetëdijesimi i banorëve për biçikletën si mjet efikas i qarkullimit (posaçërisht në vendet industriale) si dhe përparësitë që bartë ajo për shëndetin e tyre</b>	Komuna, Shoqëria Civile	ASH	U	1
		<b>Krijimi i shtigjeve për bicikleta nëpër rrugët që qojnë në industri apo qendër</b>	Komuna, Komuniteti	AGJ	M	2
<b>Themelimi i sistemit të transportit publik</b>	Sigurimi i lëvizjeve të sigurta dhe të efektshme të njerëzve dhe mallrave brenda dhe nëpërmjet Hanit të Elezit duke koordinuar përdorimin e planifikuar të tokës dhe sistemeve të transportit  Sistem i integruar, multi-	<b>Hartimi i planit për zhvillimi të një sistemi efikas të transportit (stacioni i autobusëve me lidhje të drejtpërdrejtë me stacionin e trenit dhe vendndaljet e transportit lokal) me qasje më të mirë për të gjithë qytetarët.</b>	Komuna	ASH	M	1
		<b>Caktimi i një vend ndalje dhe orarit që autobusët që qarkullojnë nga Shkupi në komunat e tjera të Kosovës të ndalen në Han të Elezit</b>	Komuna	ASH	U	1
		<b>Inkurajimi i shfrytëzimit të gjitha mënyrave të transportit duke përmirësuar rrugicat, shtigjet për këmbësorë dhe biçikleta</b>	Komuna, Shoqëria Civile	ASH	U	2
		<b>Ndërtimi i stacionit të autobusëve</b>	Komuna, Ministria e	AGJ	L	3

		modal i transportit	<b>Ndërtimi i nënkalimit te stacioni hekurudhor</b>	Transportit Komuna, Ministria e Transportit	AGJ	L	1
--	--	---------------------	---	--	-----	---	---

Fushat tematike	Strategjitë	Objektivi	Veprimet	Korniza institucionale	Afati kohor	Kosto	Prioriteti
Mjedisi, trashëgimia dhe peizazhi urban	Mbrojtja e mjedisit	Konservimi, mbrojtja dhe restaurimi i mjedisit natyror dhe biodiversitetit	Themelimi i sistemit për monitorim të ajrit	Komuna, Ministria e Mjedisit	ASH	L	1
			Bashkëpunimi me Komunën e Kaçanikut për reduktimin e ndotjes së lumit Lepenc	Komuna e HiE, Komuna e Kaçanikut, ministria e Mjedisit	ASH	U	1
			Reduktimi i ndotjes nga zhurma duke marrë parasysh edhe autostradën e planifikuar	Komuna, Ministria e Mjedisit, Ministria e Transportit	AM	L	1
	Dekontaminimi në zonat e kontaminuar		Vlerësimi i zonave që konsiderohen të kontaminuar	Komuna, Ministria e Mjedisit	ASH	L	1
			Dekontaminimi i zonave të identifikuara problematike (të kontaminuara nga asbesti dhe materiale tjera)	Komuna, Ministria e Mjedisit	AM	L	1
			Heqja e cisternave të mbetura ne zonën e ish armatës mbi magjistrale	Komuna, Ministria e Mjedisit	AM	L	2
	Përmirësimi, krijimi dhe mbrojtja e hapësirave të gjelbra (biodiversitetit) dhe peizazhit urban		Krijimi i brezit të gjelbër kufizues mes qendrës dhe industrisë	Komuna, Industritë, Ministria e Mjedisit	ASH	L	1
			Krijimi i brezit të gjelbër përgjatë lumit Lepenc (pastrimi dhe rregullimi i shtratit)	Komuna, Komuniteti, Ministria e Mjedisit	ASH	M	3
			Pastrimi dhe rregullimi i shtratit të lumit Lepenc dhe përroit Dimca	Komuna, Ministria e Mjedisit	ASH-AGJ	L	1-3

			<b>Krijimi i korridoreve të gjelbra përgjatë rrugëve kryesore</b>	Komuna, Ministria e Mjedisit, Ministria e transportit	ASH-AM	M	1-2
			<b>Rrethimi i hapësirave shkollore me gjelbërim</b>	Komuna,	AM	M	2
			<b>Përmirësimi i peizazhit urban rreth rrugëve kryesore dhe pikave urbane promovuese turistike</b>	Komuna, Ministria e Mjedisit, Ministria e transportit	AGJ	H	2-3

Fushat tematike	Strategjitë	Objektivi	Veprimet	Korniza institucionale	Afati kohor	Kosto	Prioriteti
<b>Vlerësimi, zvogëlimi dhe zbutja e fatkeqësive</b>	<b>Reduktimi i rreziqeve dhe menaxhimi i ndikimeve negative në mjedis të shkaktuara nga natyra apo nga njeriu</b>	Rreziqe të reduktuara dhe menaxhim adekuat i ndikimeve negative në mjedis të shkaktuara nga natyra apo njeriu	<b>Ndërmarrja e masave dhe analizat e nevojshme se si të zgjidhet problemi i përroit të Rezhancës para se të bëhen zhvillimet e mëtejshme në Lagjen e Re.</b>	Komuna, Komuniteti	ASH	L	1-2
			<b>Intervenimi së bashku me MTPT-në në zonën e magjistrale ku ka rrezik nga rrëshqitja e dheut dhe krijimi i akujve gjatë dimrit</b>	Komuna, Ministria e Transportit	ASH	M	1
			<b>Vlerësimi i rrezikut në zonat ku përpara kanë qenë bazat ushtarake (eliminimi i rrezikut)</b>	Komuna, Ministria e Mjedisit	ASH	M	1
			<b>Shtimi i kapaciteteve në departamentin e zjarrfikësve (trajnimi dhe pajisje me mjete)</b>	Komuna, Ministria e Punëve të Brendshme	ASH	M	1-2
			<b>Hartimi i planit të përbashkët të veprimit Komuna ne</b>	Komuna, Dogana, Industrinë, Shërbimi	ASH	U	1



			<b>bashkëpunim me doganën dhe fabrikat</b>	Policor, Komuniteti, etj			
			<b>Ndërtimi i kapaciteteve për të reaguar në rast rreziku nga zjarret apo fatkeqësitë e ndryshme (trajnime dhe pajisje te nevojshme)</b>	Komuna, Ministria e Punëve të Brendshme	ASH-AM	M	2

Fushat tematike	Strategjitë	Objektivi	Veprimet	Korniza institucionale	Afati kohor	Kosto	Prioriteti
<b>Banimi</b>	<b>Rritja e dendësisë së banimit</b>	Densifikimi në zonën urbane nëpër të gjitha njësitë me qëllim të kufizimit të zgjerimit horizontal hapësinor, shfrytëzimit më të mirë të tokës urbane të ndërtuar dhe ruajtjes së tokës bujqësore	<b>Promovimi i banimit të mesëm(më së larti 5+NK etazhe) në Qendër, Lagja e Parkut dhe Lagja e Re</b>	Komuna, Sektori Privat	ASh-AGJ	U	1
			<b>Kufizimi i ndërtimeve të tjera në sipërfaqet e identifikuara për densifikim në të ardhmen</b>	Komuna,	ASh-AGJ	M	2
			<b>Promovimi i fuqishëm i trajtimit të strukturës ekzistuese urbane apo disa elementeve të saj përmes: rekonstruktimit, rigjenerimit, revitalizimit , etj. (rekonstruimi dhe rivitalizimi i apartamenteve ngjitur me fabrikën e çimentos dhe tjera nëse konsiderohet mundësia e tillë)</b>	Komuna, Sektori Privat, Qytetarët	ASh-AGJ	H	2
	<b>Promovimi i partneritetit publiko privat</b>		<b>Krijimi i një platforme nga Komuna për të qenë e hapur për forma të ndryshme të partneritetit publiko-privat</b>	Komuna	ASh	U	1
			<b>Udhëheqja e zhvillimit të përgjithshëm nga Komuna edhe përmes partneritetit publiko-privat</b>	Komuna	ASH-AGJ	U	3

	<b>Rritja e mundësive për strehim të përballueshëm dhe banim social; dhe trajtimi i ndërtimeve ilegale</b>	Sigurimi i strehimit për të gjithë banorët e Hanit të Elezit me theks të posaçëm për grupet e cenueshme (të moshuarit, personat me ndihmë sociale)	<b>përmes dhënjes së tokës me koncesion dhe investimit të përbashkët</b>				
			<b>Hartimi i planeve rregulluese-kontrollim i zhvillimit</b>	Komuna, UN HABITAT, MMPH	ASh	L	1
			<b>Hartimi i programeve të banimit duke përfshirë edhe banimin social</b>	Komuna, MMPH, Donatorët	ASH	U	1
			<b>Komuna së bashku me MMPH-në shikon mundësinë për sigurimin e tokës dhe mjeteve materiale për ndërtimin e objektit për banim social</b>	Komuna, MMPH	AGJ	L	2
			<b>Trajtimi ndërtimeve pa leje sipas ligjeve/rregulloreve ne fuqi</b>	Komuna, MMPH	ASH-AGJ	U	1

\*Kosto e projekteve: U-ulet, M-mesëm, L-lartë.

\*\*Prioriteti: 1- Prioritet i lartë, 2- Prioritet i mesëm dhe 3- Prioritet i lartë.

\*\*\*Afati kohor: ASH-Afat shkurtër (1-3 vj) AM-Afat mesëm (mbi 3-6 vj) AGJ-afat gjatë (mbi 6 vj)

## 5. DISPOZITAT PËR ZBATIM

### 5.1. Udhëzime mbi çështjet e interpretimit të Planit zhvillimor urban gjatë hartimit të planeve rregulluese dhe planeve tjera;

Plani Zhvillimor Urban i Hanit të Elezit është dokumenti kryesor i territorit urban të komunës në 15 vitet e ardhshme. Si i tillë, autoritetet vendore të hanit të Elezit kanë për detyrë të bazohen në propozimet e Planit duke i përkthyer ato në veprime dhe iniciativa me karakter institucional, ekonomik, social, hapësinor dhe mjedisorë, për vënien në zbatim të të cilave është i nevojshëm bashkëpunimi i të gjithë aktorëve kryesorë në komunë.

- PZHU bazohet në draft Planin Hapësinor të Kosovës dhe Planin Zhvillimor Komunal të Hanit të Elezit duhet të jetë në përputhje me propozimet e dala nga këto dokumente; Vendimet për zhvillimet me rëndësi për nivelin e Kosovën të parapara me PHK në territorin e komunës duhet të respektohen;
- PZHU do të jete baze për hartimin e PRrU-ve te parapara brenda zonës urbane. Këto plane nuk duhet te cenojnë dispozitat e PZHU-së.
- Çdo propozim apo vendim në lidhje me PRU qe është në konflikt me dispozitat e PZHU duhet të kalojnë nëpër procesin e rishikimit dhe shqyrtimit publik (ashtu siç është paraparë me dispozitat e ligjit për planifikim hapësinor) dhe marrin aprovimin në Kuvend.
- PZHU duhet të shërbejë për interpretimin e çështjeve të caktuara si ato të pronësisë, zhvillimeve dhe ndërtimeve të parapara ne zonën urbane .

### 5.2 Kushtet e përcaktuara nga qeveria lokale mbi çështje të rëndësisë për zhvillimin dhe shfrytëzimin e tokës në zona urbane:

Toka urbane do të rregullohet sipas udhëzimit të PZHU-së si dhe më detajisht sipas PRrU që do të hartohen në të ardhmen. Deri në hartimin e PRrU-ve, zhvillimi dhe shfrytëzimi i tokës urbane do të bazohet në PZHU.

#### 5.2.1 Kushtet për përkufizimin e sipërfaqeve publike si dhe atyre me destinime te tjera

Bazë për përcaktimin e destinimit të sipërfaqeve në territorin e zonës urbane të Hanit të Elezit janë kushtet dhe karakteristikat gjeografike dhe morfologjike si dhe vizioni dhe qëllimet e planit të cilat japin orientimet e ardhshme të zhvillimit.

- Hapsirat publike duhet te definohen me PRrU
- Hapsirat përgjatë lumit Lepenc dhe përrrenjve duhet të shfrytëzohet si hapësirë publike siç është përcaktuar me PZHU dhe ne përputhje me ligjin për ujërat.
- Shtrati i lumit duhet rregulluar duke konsideruar mundësinë e qasjes në të dy anët të sigurohet hapësirë për gjelbërim dhe shtigje për këmbësorë dhe biçikleta.
- Në çdo zonë, duhet nevoja dhe mundësia e vendosjes së përmbajtjeve publike sikur janë fushë lojërës, zonat e gjelbëruara dhe hapësira për parkim do të vlerësohet.
- Çdo PRrU ashtu si është përcaktuar me Ligj, duhet të trajtojë me hollësi përkufizimin e sipërfaqeve publike duke caktuar edhe rregullat e organizimit dhe shfrytëzimit.

**5.2.2 Kushtet për rregullimin e hapësirës për objektet me rëndësi për Kosovën dhe Komunën e Hani i Elezit**  
Ndërtesat e rëndësishme për Kosovën që ndodhen në territorin e Hanit të Elezit janë:

- Kompleksi ndërtimor industrial.
- Komuna do të vejë në kontroll zhvillimet e mundshme rreth këtij kompleksi konform standardeve të përcaktuara nga Institucionet qeveritare.
- Komuna do të bashkëpunojë ngushtë me pronarët për ruajtjen e dy objekteve të vjetra të ndërtuar për punëtoret e fabrikës. Lirimi nga tatimi në pronë është një masë që komuna ndërmerr për ruajtjen e kësaj trashëgimie.
- Komuna do të bashkëpunojë me Institucionet qendrore për inventarizimin, restaurimin dhe vënien nën mbrojtje të këtyre objekteve.
- Komuna merr përgjegjësi përmes inspektionit që të mbaj kontrollin e zhvillimeve rreth këtyre ndërtesave.

**- b. Kushtet për rregullimin e ndërtimeve në zonat ndërtimore për vendbanime;**

- PZHU ka përcaktuar zonën ndërtimore të cilat janë të dhëna në hartën e shfrytëzimit të tokës dhe densifikimit.
- Ndërtimet do të lejohen vetëm në zonat e përcaktuara me plan
- PZHU i Hanit të Elezit ka përcaktuar kufijtë e ndërtimit brenda të cilave do të lejohen ndërtimet. Kriteri kryesor për shfrytëzim racional të tokës do të jetë ai i rritjes së dendësisë.
- Infrastruktura fizike dhe sociale do të ofrohet vetëm në zonat e destinuar për ndërtim.
- Në tokën bujqësore kualitative e përcaktuar për mbrojtje me plan, nuk do të lejohen ndërtimet me përjashtim të objekteve të karakterit bujqësor.
- Në hapësira ku lejohet zhvillimi, kushtet e lokacionit, kushtet tekniko-urbanistike dhe ato të ndërtimit përcaktojnë me sa vijon:

**i) Kushtet e lokacionit-** përfshin shënimet mbi lokacionin-

- Karakteristikat hidrologjike dhe gjeologjike ku parashihen hulumtime gjeomekanike dhe dheut për të përcaktuar përbërjen e tokës/kualitetin e dheut për llojin e caktuar të ndërtimit dhe kultivimit, prania e ujërave tokësor dhe nëntokësor, mënyra natyrore e drenazhimit; vegjetacioni dhe fauna; aspekti i rrezikshmërisë ndaj rreziqeve dhe fatkeqësive tjera (vërshimet, erozioni, tërmetet), pjerrtësia e terrenit, etj), Shfrytëzimi i tokës në zonat ku ka vërshime, është i lejueshëm për:
  - Veprimtaritë publike: ato që doemos për shkak të funksionit të tyre duhet të vendosen në afërsi të ujit (ndërtesat e ujësjellësit, pastrimit të ujit të cilat duhet të kenë struktura të qëndrueshme ndaj ujit);
  - Funksione publike/aktivitete të rekreacionit- parqe, fusha tenisit, staza për gara automobilistike, parqe botanike etj;
  - Aktivitete bujqësore- fermat, objekte në shërbim të veprimtarive bujqësore, blegtorale, pyjore
- Kushtet makro-mikroklimatike duke përfshirë këndin e rrezeve të diellit gjatë stinëve të ndryshme të vitit, mbizotërimin e erërave në kohë të ndryshme të vitit, vendet e ngrirjes, mundësia e përdorimit të energjisë diellore me c'rast duhet të analizohet grafiku i lëvizjes së diellit, orët dhe e diellosjes si dhe mesatarja e ditëve me diell gjatë vitit etj. Gjatë planifikimit të ndërtesave/strukturave të reja në raport me ato ekzistuese është me rëndësi të analizohet struktura dritë/hije në stinë të ndryshme të vitit në ndërtesat përreth si dhe në hapësirat publike.
- Të dhënat mbi zonën e zhvillimit dhe ngastrën kadastrale (pozita, orientimi, forma dhe madhësia e zonës së zhvillimit dhe ngastrës ndërtimore). Këtu duhet analizuar edhe përshtatshmëria respektivisht shfrytëzimi i tokës në zonat përreth/në afërsi, përgatitja e lokacionit siç janë: largimi i ndërtesave dhe rehabilitimi i dheut (tokës),

- Shënimet mbi linjën rregulluese dhe atë ndërtimore

#### **ii) Kushtet teknike-urbanistike**

- Shënimet mbi llojin e objektit, përmbajtjen dhe kapacitetin, pozitën e objektit në ngastrën ndërtimore,
- Rregullat për kyçjen e ndërtesës në rrjetin e infrastrukturës rrugor dhe instalimet tjera (rrugët e mundshme për qasjen në zonë, duke përfshirë konfliktet me sistemin e rrugëve dhe instalimeve ekzistuese).
- Kushtet për ofrimin e parkingjeve dhe sipërfaqeve gjelbëruese në kuadër të ngastrës ndërtimore-
- Kushtet dhe masat për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe mbrojtje civile
  - mbrojtja nga burimet potenciale të zhurmës, posaçërisht zhurma nga trafiku e cila mund të bëhet me përdorimin e gjelbërimit, drunjtëve apo mureve si dhe mundësia e ndarjes nga gjeneruesi i zhurmës dhe pranuesi i saj.
  - aplikimi i standardeve të sigurisë për mbrojtje civile (hapësirat për evakuim-strehimoret, sigurimin e qasjes dhe manovrimit të kamionëve të zjarrfikësve dhe ambulantëve shëndetësore etj)
- kushtet për mbrojtjen nga fatkeqësitë
- kushtet për mbrojtjen e tërësive të trashëgimisë natyrore dhe kulturore
- kushtet për lëvizjen pa pengesa të personave me aftësi të kufizuara

#### **iii) kërkesat e përgjithshme të ndërtimit (referoju më gjerësisht ligjit të ndërtimit)**

- Ndërtesa duhet të vendosen, ndërtohen, ndryshohen, rrënohen dhe mirëmbahen në mënyrë që të mos rrezikojnë sigurinë dhe rendin publik, veçanërisht jetën dhe shëndetin e njerëzve, mjedisin, qëndrueshmërinë e objekteve fqinje, instalimeve publike. Ndërtimi duhet të arrijë nivel optimal të qëndrueshmërisë, stabilitetit, mbrojtjes nga zjarri, higjienë sanitare, siguri përdorimi, izolim zhurme dhe temperature.

#### **iv) kërkesat themelore për ndërtim: Gjatë projektimit të objekteve merren parasysh këto kërkesa themelore (më gjerësisht referoju më gjerësisht ligjit të ndërtimit):**

- Qëndrueshmëria mekanike dhe stabiliteti
- Mbrojtja nga zjarri
- Mbrojtja e higjienës, shëndetit dhe mjedisit (nenet përkatëse: 3, 5, 6, 7, 8,9)
- Izolimi nga temperatura, zhurma dhe mbrojtja kundër vibrimeve
- Distancat në mes objekteve
- Përdorimi i ndërtesës, siguria dhe qëndrueshmëria
- Përjashtimet- vlejnjë për objektet me vlera historike-kulturore
- Specifikimi me rregulla teknike- vlen sidomos për përcaktimin e kushteve teknike për përdorimin e objekteve ndërtimore nga personave me nevoja të veçanta.
- Komuna jep lejen e ndërtimit për të gjitha ndërtimet, përvec atyre që janë të përcaktuara me nenin 35 të ligjit të ndërtimit. Për këto objekte leja e ndërtimit jepet nga MMPH:
  - Ndërtimet e ndërlidhjeve dhe telekomunikacionit (referoju më detajisht ligjit)
  - Objektet energjetike
  - Objektet hidroteknike
  - Objektet industriale
  - Objekte për qëllime të veçanta
- Objektet/strukturat të cilat nuk kanë nevojë për leje ndërtimit janë të përcaktuara me nenin 41 të ligjit për ndërtim.

#### **c. Kushtet për rregullimin e strukturave të ndërtuara jashtë vendbanimeve;**

Jashtë zonës ndërtimore mund të ndërtohen këto ndërtesat e parapara me nenin 17.3 të Ligjit për Planifikim Hapësinor:

- Ndërtesat publike për mbrojtje ose mbrojtje civile
- Ndërtesa për mbrojtje nga zjarri dhe materialet të dëmshme – eksploziv etj
- Ndërtesat për menaxhimin e resurseve ujore
- Infrastruktura
- Ndërtesa për hulumtimin dhe shfrytëzimin e materialit mineral të eksploatuar

Leja urbanistike dhe leja ndërtimore për objektet e listuara më lart jepet nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

### **5.2.3. Kushtet për vendosjen e veprimtarive ekonomike;**

- Komuna do të ofroj infrastrukturën, kushtet dhe hapësirën për stimulimin e investitorëve serioz të cilët paraqesin ofertën e përshtatshme për zhvillim ekonomik dhe angazhimin e fuqisë punëtore lokale
- Komuna do të përkrahë dhe mundësojë ngritjen e kapitalit njerëzor përmes arsimimit dhe trajnimit të fuqisë punëtore sidomos në fushat ekonomike prioritare të përcaktuara me plan. Në këtë aspekt komuna do të përkrah hapjen e shkollave profesionale
- Komuna do të përkrahë punën e Agjencionit për Zhvillim Regional (AZhR) duke siguruar bashkëpunim të plotë me ta dhe komunat fqinje në realizimin e projekteve me interes të përbashkët

#### **Kushtet për vendosjen e veprimtarive ekonomike industriale**

- PZHU ka përcaktuar zonën ekonomike ku do të lejohen veprimtari të caktuara industriale të propozuara me plan. Shpallja e zonës si zonë ekonomike, duhet të bëhet sipas kritereve të parapara me ligjin për veprimtaritë ekonomike dhe përfshin: statusin e zonës-p.sh zonë ekonomike ose industriale, park industrial ose teknologjik etj, kufijtë e zonës, llojet e veprimtarive që do të zhvillohen në zonë etj.
  - PZHU mban zonën ekonomike me industrinë e çimentos dhe veprimtaritë përcjellëse të saj. Do të krijohen mundësitë për zhvillimin e bizneseve të reja industriale si prodhimi i produkteve të betonit. Bizneset industriale dhe komerciale me ndotje të shprehur nuk do të lejohen fare. Çdo zhvillim në këtë zonë duhet t'i paraprijë përpilimi i vlerësimit të ndikimit në mjedis.

#### **Kushtet për vendosjen e veprimtarive të bizneseve prodhuese, tregtare dhe komerciale**

- Zonat e destinuar me plan për biznese tregtare dhe komerciale mund të zgjerohen vetëm nëse komuna e sheh atë veprim si progresiv dhe me interes afatgjatë.
- Do të stimulohen subjektet tregtare-komerciale të cilat ofrojnë programe të qëndrueshme të bizneseve të tyre të cilat do të shfrytëzojnë energjinë elektrike nga burimet e ripërtërishe
- Bizneset prodhuese do të stimulohen dhe lejohen nëse ato janë konform kushteve për shfrytëzim të tokës, dhe dispozitave tjera mbi ruajtjen e mjedisit.
- Në zonën ku është paraparë ndërtimi i tregut të gjelbër, duhet marrë parasysh kushtet e përgjithshme si: qasja (me transport publik, shtigjeve këmbësorie, parkingjeve), kushtet e lokacionit, kushtet tekniko-urbanistike si dhe rregullat e ndërtimit dhe distancat me ndërtesat në afërsi, masat për siguri, mbrojtja mjedisore, kushtet për mirëmbajtjen e zonës etj. Kushtet më detaje jepen me detyrën projektuese.

#### **Kushtet për ruajtjen dhe vendosjen e veprimtarive të bujqësisë:**

- Korniza e zhvillimit hapësinor, ka përcaktuar tokën bujqësore e cila duhet të mbrohet nga çdo ndërtim pos atyre që kanë të bëjnë me veprimtari bujqësore.
- Komuna duhet të vendos për mbrojtjen dhe merr masa për parandalimin e ndërtimeve në këto zona.

#### **Kushtet për vendosjen e veprimtarive të turizmit-hotelet, motele, restaurantet, etj**

- PZHU ka përcaktuar lokalitetet turistike



- Komuna do të sigurojë edhe zhvillimin e infrastrukturës dhe lëmenjve përcjellëse turistike si gastronomia, aktivitetet kulturore, zhvillimi i artizanaleve etj.
- Komuna do të përkrah projektet e OJQ që merren me promovimin e vlerave tradicionale.

#### 5.2.4 Kushtet për vendosjen e objekteve të veprimtarive publike

- Veprimtaritë publike do të zhvillohen në zonat të parapara me PZHU.
- Nëse gjatë hartimit të PZHU nuk është arritur të përcaktohet saktësisht hapësira për veprimtaritë e tilla (për shkak të çështjeve pronësore-juridike në lidhje me tokën komunale, apo arsye tjetër), komuna do të kujdeset që gjatë periudhës së zhvillimit të planit të alokojë tokë për këto veprimtari.
- Gjatë trajtimit të hapësirave publike, është me rëndësi të mbahen dhe përdoren elementet e ndërtimi që janë karakteristike për zonën. Arkitektura e lokalitetit duhet të analizohet dhe të tentohet të respektohet. Strukturat historike dhe ato të trashëgimisë duhet të mbrohen duke i modifikuar ato, dhe propozuar destinim të ri për shfrytëzimin e atij objekti (dy objektet e vjetra dhe një pjesë objektit të vjetër të fabrikës)
- Duhet të i kushtet kujdes i veçantë vizuarve. P.sh pamjet drejt shesheve, ndërtesave të veçanta ose dukurive/bukurive natyrore sikurse janë: hapësirat pranë lumenjve ose në përgjithësi sipërfaqeve ujore.

#### Kriteret e përgjithshme për planifikimin e hapësirave të objekteve të veprimtarive publike:

**Institucione shkollore** do të ndërtohen sipas parametrave:

- Institucione parashkollore- sipërfaqe e përgjithshme 20-40 m<sup>2</sup>/fëmijë
- Shkolla fillore- sipërfaqe e përgjithshme 20-50 m<sup>2</sup>/fëmijë
- Distanca nga shtëpia deri në shkollë dhe anasjelltas për nxënësit e ciklit të ulët të jetë:
  - jo më e madhe se 250 m (nxënësit e shkollës fillore)
  - prej 110-230 m (fëmijët parashkollor)
- Raporti mësimdhënës/ nxënës (sipas UA-18/9 i MASHT) dhe numri i nxënësve në klasë
  - arsimin parashkollor(5-6 vjec)- raporti 1 mësimdhënës/12 fëmijë
  - shkollimin fillor (prej klasës I-IX)- raporti 1 mësimdhënës/ 21.3 nxënës
  - shkollimin e mesëm (klasa X-XII)- raporti 1 mësimdhënës/ 21.3 nxënës; numri i nx. në klasë 32
  - shkollimin i mesëm profesional (X-XIII)- raporti 1 mësimdhënës/ 17.2 nxënës; numri i nxënësve në klasë 17
  - nxënësit e shkollave në vise malore në lartësinë mbidetare mbi 700 m- raporti 1 mësimdhënës/ 14.3 nxënës
- Hapësira e nevojshme për nxënës në kuadër të klasës është 2m<sup>2</sup>/nxënës
- Të sigurohet hapësirë e gjelbërimit dhe terrenet e hapura sportive në kuadër të oborrit shkollor
- Komuna duhet të sigurojë që gjatë zhvillimit të hapësirave shkollore, të jetë marrë parasysh aspekti i sigurisë së fëmijëve në trafik. Komuna siguron transportin publik deri në shkollë.
- Kushtet e lokacionit, kushtet e tekniko-urbanistike përcaktohen me hollësisht me detyrë projektuese

#### **Objektet për kulturë (muzetë, shtëpia e kulturës, biblioteka):**

- PZHK ka përcaktuar nevojën për sigurimin e objekteve për kulturë.
- Me qëllim të shfrytëzimit maksimal të tokës, komuna merr parasysh adaptimin e ndërtesave ekzistuese (**pjesën e vjetër të fabrikës si muze industrial**) si dhe do të favorizojë ndërtimet multi-funksionale.
- Komuna lidh marrëveshje të PPP për shfrytëzimin e objekteve për qëllime kulturore nëse ato janë në pronësi private (kjo sidomos vlen për ato objekte që kanë vlera të trashëgimisë kulturore)
- Kushtet e lokacionit, kushtet e tekniko-urbanistike përcaktohen me detyrë projektuese

### **Objektet për rini, sport e rekreacion si dhe terrenet e hapura për sport e rekreacion**

- PZHU ka dhënë propozimet për sigurimin e objekteve dhe hapësirave për rini, sport e rekreacion (**qendra rinore, halla sportive, terrenet për sport e rekreacion**). Planifikimi i këtyre hapësirave do të bëhet sipas standardeve.
- Komuna do të maksimizojë shfrytëzimin e terreneve sportive shkollore të cilat do të mund të shfrytëzohen edhe për publikun e gjerë.
- Komuna përkrah projektet që promovojnë dhe stimulojnë angazhimin e të rinjve sidomos, në aktivitetet sportive
- Kushtet e lokacionit, kushtet e tekniko-urbanistike dhe ato të ndërtimit përcaktohen me detyrë projektuese

### **Sipërfaqet publike të gjelbëruara, hapësirat e lira, parqet:**

- PZHU ka identifikuar hapësirat e tilla
- Sipërfaqet publike të gjelbëruara ndërtohen dhe mirëmbahen në mënyrën e cila mundëson ruajtjen dhe avancimin e vlerave natyrore dhe të krijuara.
- Nëse për shkak të ndërtimit të objektit, dëmtohet sipërfaqja publike e gjelbëruar, ajo duhet të kompensohet sipas kushteve dhe mënyrës së përcaktuar nga komuna.
- Planifikimi i hapësirave publike me destinim parqe, gjelbërim duhet të bëhet konform dendësisë së banimit.
- Gjatë trajtimit të parqeve të qytetit nuk lejohet pllakosje më shumë se 10% e sipërfaqes së përgjithshme të parkut.
- Gjatë trajtimit të parqeve, duhet të analizohen me kujdes kushtet makro-mikroklmatike. Lëvizja e ajrit, mbrojtja nga erërat të cilat janë karakteristike për një regjion mund të modifikohen me struktura të larta urbane. Ky element duhet të analizohet me kujdes në rast të planifikimit të parqeve, hapësirave publike dhe tarracave të cilat shfrytëzohen nga publiku
- Kushtet më detaje për rregullimin e këtyre hapësirave përcaktohen me detyrë projektuese

#### **5.2.5 Kushtet dhe mënyrat për ndërtimin e objekteve të banimit**

Dendësimi në zonat ekzistuese të banimit, pas përcaktimit të hapësirës për kënde lojërash , hapësirave publike dhe parkimi do të jetë i stimuluar. Gjate hartimit të PRRU-ve do te bëhet një vlerësim më specifik ne zonat ku PZHU ka paraparë dendësim.

#### **5.2.6 Kushtet për përcaktimin e rrjeteve të sipërfaqeve të korridoreve apo traseve te telekomunikimit dhe rrjetit të infrastrukturës komunale**

- Përgatitja e një Plani të politikave për Mobilitet. Sfidat kryesore në të cilat duhet bazuar politika e mobilitetit janë: Korridoret rrugore duhet të përcaktohen në harmoni me standardet rajonale dhe ndërkombëtare, duke pasur parasysh harmonizimin funksional te kërkesave kombëtare.
- Ndërtimi duhet të merr në konsideratë koston e ulët për ndërtim dhe mirëmbajtje. Duhet të respektohen rregullat dhe normat për qëndrueshmërinë e ndërtimit dhe kushtet klimatike.
- Ministria e Infrastrukturës është përgjegjëse për magjistralen Prishtinë-Shkup dhe autostradën e planifikuar; çdo zhvillim për gjate atyre zonave duhet te behet konsultim me Ministrinë e infrastrukturës dhe ne harmoni me gjitha rregulloret ne fuqi
- Komuna Hanit të Elezit është përgjegjëse për rrugët lokale, prandaj të gjitha rrugët duhet të jenë të dizajnuara me standard të duhur në mënyrë që të ketë rrjedhje të patrazuar të trafikut

### 5.2.7 Kushtet për rregullimin e zonave dhe tërësive me vlera të veçanta për komunën

-Planet hapësinore për zonat e veçanta

Komuna e Hani i Elezit duhet të bashkëpunojë me institucionet relevante komunitetin e biznesit dhe qytetarët për:

- Hyrja nën mbrojtje e objekteve 2 objekteve të vjetra të ish-punëtorëve të ndërtuar për punëtorët e fabrikës dhe restaurimi i tyre,
- Mbrojtja dhe rehabilitimi i shtratit të Lumit Lepenc, dhe përroit të Dimces
- Mbrojtja dhe rehabilitimi i Parkut të qytetit.

### 5.2.8 Masat për mbrojtjen e peizazheve, vlerave natyrore dhe tërësive kulturore-historike

- Komuna bashkëpunon me Ministrinë përkatëse, institucionet dhe organizatat tjera për përgatitjen e planit të menaxhimit me të mirat e natyrës, planit të veprimit lokal për mbrojtjen e mjedisit, planit operacional për menaxhimin e pyjeve për të siguruar harmonizimin me planet dhe strategjitë e Qeverisë
- Komuna zhvillon dhe merr pjesë në hartimin e politikave dhe programeve që kanë të bëjnë me ruajtjen e resurseve natyrore si dhe trashëgimisë kulturore-historike, si dhe në zhvillimin e projekteve e parapara me plan për mbrojtjen e mjedisit dhe vlerave natyrore e kulturore.
- Komuna siguron pjesëmarrjen edhe të publikut, OJQ-të, organizatave profesionale, komunitetit të biznesit etj në procesin e hartimit të planeve, programeve e projekteve të lartpërmendura
- Komuna në kuadër të kompetencave të saj ndërmerr këto masa dhe aktivitete:
  - kujdeset për ruajtjen e larmisë biologjike dhe peizazhore për territorin e vet;
  - shpall zonat e mbrojtura për të cilat është kompetente dhe merr pjesë në procedurën e shpalljes të zonave të mbrojtura të cilat i shpallë Qeveria ose Kuvendi;
  - siguron kushtet për mbrojtjen dhe ruajtjen e zonave të mbrojtura për të cilat është kompetente;
  - kujdeset për promovimin e mbrojtjes së natyrës dhe mbështet shoqatat, veprimtaria e të cilave është mbrojtja e natyrës;
  - përcjell gjendjen e ruajtjes së natyrës dhe për atë Ministrisë dhe Institutit i paraqesin raport; mbajnë regjistrat për shënimet të rëndësishme për mbrojtjen e natyrës;
  - informon publikun për gjendjen e natyrës në territorin e vetë dhe për masat e ndërmarra për mbrojtjen dhe ruajtjen e saj;
- Komuna bashkëpunon me komunat fqinje për të siguruar mbrojtjen e peizazheve dhe vlerave natyrore e kulturore-historike. Dy ose më shumë komuna mund të hartojnë dhe miratojnë së bashku plane ose programe të përbashkëta të veprimit për mbrojtjen e mjedisit për zvogëlimin e efekteve negative në mjedis.

**Zonat e mbrojtura:** Komuna me PZHU ka përcaktuar vlerat natyrore dhe ato kulturore të cilat duhet mbrohen dhe në të cilat duhet marrë masa për të penguar degradimin.

Në Han të Elezit-

- Me qëllim të ruajtjes së vlerave peizazhore hidrografike, komuna në bashkëpunim me MMPH do të hartojnë planin rregullues për mbrojtjen e brigjeve të lumit Lepenc në kuadër të zonës urbane.
- Komuna duhet të mbrojtë si zonë e mbrojtur e llojit Park natyror, Parku te kazerma të propozuar në PZHK, komuna harton PRrU për këtë zonë.
- Administrimi me zonën e mbrojtur: Me zonat e mbrojtura të shpallura nga komuna, administron komuna; me atë të shpallura nga Qeveria administron Qeveria.

- **Ndërhyrjet në zonën e mbrojtur:** Në zonën e mbrojtur lejohen ato ndërhyrje dhe punë të cilat nuk i dëmtojnë dhe nuk i ndryshojnë veçoritë për shkak të cilave zona është shpallur e mbrojtur. Me detajisht rreth kufizimeve në zonën e mbrojtur shih nenet 129-134 të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës.
- **Dispozitat të përgjithshme** për mbrojtjen dhe ruajtjen e natyrës dhe vlerave të saj të mbrojtura:
- Në zonat me vlera natyrore përfshirë edhe ato të mbrojtura të natyrës, pronarët dhe përdoruesit e ligjshëm të përbërësve të natyrës janë të detyruar t`ju lejojnë përfaqësuesve të organeve për kryerjen e punëve administrative dhe/ose profesionale në mbrojtjen e natyrës
- Në zonën e mbrojtur ndalohet ndërrimi i destinimit të tokës, e cila nuk është në pajtim me dispozitat e PZHK dhe Ligjit për Tokën Bujqësore.
- Në zonat e mbrojtura (sipas ligjit mbi mbrojtjen e natyrës) ndalohen edhe:
  - Kryerja e ushtrimeve dhe aktiviteteve të tjera ushtarake të cilat mund t`i rrezikojnë vlerat e natyrës;
  - Aktivitete nënujore pa lejen e komunës;
  - Peshkimi rekreativ pa leje ose në kundërshtim me kushtet e dhëna në leje;
  - Ndezja e zjarrit jashtë vendbanimeve dhe/ose vendeve që për këtë qëllim janë të shënuara dhe të caktuara;
  - Xhirimi ose fotografimi për qëllime komerciale pa lejen e Ministrisë/komunës;
  - Vendosja e pllakave informative, panove reklamuese ose tjera pa lejen e Ministrisë/komunës;
  - Hedhja e mbeturinave jashtë vendit të paraparë për këtë; etj

**Ruajtja e tokave bujqësore:** Ruajtja e peizazheve bujqësore të tokave të punueshme bëhet duke ruajtur skajet e vlefshme të vendbanimeve, gardhiqet, trungjet individuale, grup trungjet, skajet e livadheve etj. Komuna merr masa për të siguruar ruajtjen e veçorive karakteristike të peizazheve si dhe mirëmbajtjen e vlerave biologjike, gjeologjike dhe kulturore të cilat e përcaktojnë rëndësinë dhe përjetimin estetik të tij.

**Mbrojtja e ujërave (nëntokësor dhe mbitokësor):** Komuna nuk duhet të lejojë shkarkime të mëtutjeshme të ujërave te zeza në lumenjtë përreth, ndërsa shkarkimet ekzistuese duhet të trajtohen përmes impiantit për trajtimin e tyre.

### **Mbrojtja e trashëgimisë kulturo-historike**

Dispozita të përgjithshme:

- PZHU ka identifikuar dhe lokalizuar vlerat e trashëgimisë kulturore arkitekturale, të luajshme dhe të asaj shpirtërore.
- Komuna bashkëpunon me Ministrinë e Kulturës dhe institucionet e saj në inventarizimin e vlerave të trashëgimisë, hartimin e listës së trashëgimisë për përfshirjen e vlerave të caktuara në mbrojtje të përkohshme apo të përhershme, krijimin dhe azhurnimin e bazës së të dhënave mbi gjendjen e trashëgimisë kulturore, si dhe në realizimin e projekteve të restaurimit dhe funksionalizimit të trashëgimisë kulturore.
- Në momentin që ndonjë vlerë e trashëgimisë kulturore hyn në listën për mbrojtje të përkohshme apo të përhershme (shih në ligj procedurat për shpalljen e vlerës në mbrojtje të përkohshme apo të përhershme), ajo regjistrohet në Kadastër. Trashëgimia kulturore nën mbrojtje të përkohshme apo të përhershme lirohet nga tatimi në pronë. Dhënia e lejes për ndërtim në objektet nën mbrojtje të përkohshme apo përhershme, mënyra e përdorimit me qëllim përfitimi ekonomik dhe kulturor, çështjet e kompensimit, financimit, shitjes, të drejtave pronësore të trashëgimisë kulturore nën kontrollin e shtetit apo pronësi apo trashëgimisë kulturore në pronësi private janë të rregulluara me ligjin për mbrojtjen e trashëgimisë.

- Komuna në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës harton planin për Konservimin të trashëgimisë kulturore.

#### Trashëgimia arkitekturale:

- Monumentet arkitekturale në han të Elezit përfshijnë dy ndërtesat e vjetra të ndërtuara për punëtorët e fabrikës si dhe vlerat e trashëgimisë industriale-fabrika e vjetër e çimentos.
- Monumentet arkitekturale të përcaktuara në listën për mbrojtje të përkohshme ose të përhershme kanë një zonë të mbrojtjes, që është 50 metra nga perimetri i monumentit. Kjo zonë e mbrojtjes mund të zgjerohet ose ngushtohet dhe përcaktohet në planin e Institucionit kompetent dhe në planet hapësinore relevante në pajtueshmëri me nenin 2 të Ligjit nr. 2003/14 për planifikim hapësinor.
- Komuna merr masa për të ndaluar lëvizjen apo zhvendosjen e pjesshme ose complete të ndonjë pjese të trashëgimisë së mbrojtur arkitekturale
- Komuna kryen inspektim të rregullt dhe merr masa për mbrojtjen e vlerave të trashëgimisë
- Komuna ndërmerr aktivitete ndërgjegjësimi për mbrojtjen e vlerave të trashëgimisë dhe promovimin e saj në favor të zhvillimit të komunës
- Komuna lidh marrëveshje të formës së Partneritetit publiko-privat në favor të ruajtjes së trashëgimisë dhe shfrytëzimit të saj.

#### • Trashëgimi e luajtshme

- Komuna bashkëpunon me Ministrinë në krijimin e regjistrit të kësaj trashëgimie.
- Sipas ligjit, objektet e kësaj trashëgimie më të vjetra se 100 vjet vendosen automatikisht nën mbrojtje.
- Trashëgimia e luajtshme që daton para vitit 1453 është pronë publike e Kosovës. Muzetë publike janë institucione kompetente për menaxhimin e koleksioneve publike të trashëgimisë së luajtshme.
- Objektet e luajtshme, pjesët përbërëse të trashëgimisë kulturore, komplekset historike, ndërtesat fetare janë nën mbrojtje dhe ato nuk mund të lëvizin nga konteksti natyror i vendit, ku janë të vendosura, pa leje.
- Masat për konservimin, mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë së luajtshme nën mbrojtje, qarkullimi i trashëgimisë, tjetërsimi, etj janë të rregulluara me ligjin për Trashëgimi.

#### • Trashëgimi kulturore shpirtërore:

- Komuna krijon regjistrin dhe merr masa për të dokumentuar, ruajtur dhe promovuar, në pajtim me Ligjin për Trashëgiminë Kulturore dhe parimet ndërkombëtare, standardet dhe praktikat gjyqësore, trashëgimia kulturore shpirtërore.
- Komuna përkrah projektet e OJQ dhe shoqatave të ndryshme që promovojnë këto vlera.

#### **Obligimet e personave juridik dhe fizik për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore**

- Secili person juridik dhe fizik ka për detyrë që të kujdeset për mbrojtjen e tërësisë së trashëgimisë kulturore nëse ai/ajo është pronar, posedues ose shfrytëzues i saj.
- Cilido person fizik apo juridik që dëmton trashëgiminë kulturore, pavarësisht nga marrëdhëniet e tyre pronësore me të, dënohet ose sanksionohet në bazë të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, Ligjit për kundërvajtje dhe në pajtim me nenin 11 të ligjit për mbrojtjen e trashëgimisë.

#### **Konservimi dhe restaurimi i trashëgimisë kulturore**

- Ndërhyrjet në tërësinë ose vlerat e trashëgimisë kulturore duhet të kenë lejen e shkruar nga Institucioni kompetent. Nuk lejohen punët e paautorizuar në vlerat e trashëgimisë kulturore.
- Veprimet konservuese dhe restauruese, projektet dhe proceset e ndërhyrjeve konservuese dhe restauruese duhet të bëhen nga organe të licencuara nga Ministria për këtë punë, të kenë marrë paraprakisht aprovimin si dhe mbikëqyren nga Institucioni kompetent.

#### **5.2.9 Mënyra e trajtimit të mbeturinave (përpunimi, deponimi dhe bartja)**

- Komuna është përgjegjëse për trajtimin e mbeturinave komunale. Komuna harton planin lokal për administrimin e mbeturinave konform Planit strategjik të Kosovës për administrimin e mbeturinave i hartuar nga MMPH. Plani lokal për administrimin e mbeturinave përfshin periudhën së paku prej 5 vitesh dhe duhet të marrë aprovimin nga MMPH. Dy apo më shumë komuna, mund të hartojnë planin e përbashkët. Përmbajtja dhe mënyra e hartimit të planit duhet të jetë konform dispozitave të parapara të ligjit për mbeturina, Nr.02/l-30.
- Komuna rregullon veprimtaritë për menaxhimin e mbeturinave mjedisore dhe organizon menaxhimin brenda territorit të tyre përmes lëshimit të lejeve për menaxhim mbeturinash. Detyrimet e zotëruesve të mbeturinave, prodhuesve të mbeturinave, transportuesve, operatorëve për trajtimin e mbeturinave si dhe detyrimet e operatorit në deponi janë të rregulluara me ligj.
- Komuna organizon, grumbullon, trajton dhe rregullon organizimin dhe mënyrën e veçimit të mbeturinave për riciklim sipas dispozitave ligjore (neni28) si dhe në përputhje me planin lokal të saj. Mbeturinat e rrezikshme (eksplozive, oksiduese, shumë të ndezshme dhe ato të ndezshme, toksike, etj) dhe ato speciale grumbullohen dhe transportohen si të veçuara; transporti bëhet me mjete adekuate.
- Meqenëse komuna e Hanit të Elezit është komunë e vogël dhe për hir të mbrojtjes së mjedisit si dhe duke marrë parasysh faktin që komuna nuk ka mjaft tokë komunale në dispozicion, PZHK rekomandon ngritjen e deponisë së mbeturinave në marrëveshje me dy apo më shumë komuna fqinje. Në kuadër të territorit të saj, komuna mund të ndërtojë një stacion transferimi (objekt për administrim të mbeturinave) nga i cili mbeturinat mund të kompresohen dhe vendosen në traktorë që kanë volume të mëdha për procedim në destinacionin tjetër. Ndërtimi i objekteve dhe pajisjeve për administrimin e mbeturinave bëhet konform dispozitave ligjore për trajtim të mbeturinave (neni 22). Mbledhja, magazinimi (vendet ku magazinohen-stacionet e transferimit duhet të jenë teknikisht të përgatitura për ruajtjen e përkohshme; afati për ruajtje të përkohshme nuk mund të jetë më i gjatë se 3 vjet), trajtimi dhe ripërdorimi e përpunimi i mbeturinave bëhet në pajtim me dispozitat ligjore të dhëna nga MMPH. Mbeturinat, pasi të jenë trajtuar dhe shfrytëzuar më parë, deponohen në deponi (objekte të licencuara). Kriteret për zgjedhjen e lokacionit të deponive duhet të jenë konform Udhëzimit administrativ të MMPH.
- Komuna ndërmerr aktivitete të ndryshme dhe bashkëpunon për së afërmit me OJQ mjedisore, në rritjen e vetëdijes qytetare për mbrojtjen e mjedisit nga mbeturinat.
- Me qëllim të mbrojtjes së mjedisit, komuna merr masa për parandalimin e ndotjes nga hedhurinat.

#### *Trajtimi i ujërave të zeza:*

- Komuna merr masa për ndalimin e shkarkimit të ujërave të zeza në lumenj.
- Komuna do të hartojë programin për trajtimin e ujërave të zeza dhe atmosferik i cili duhet të shikohet në tri dimensione:
  - ndërtimin e kolektorit kryesor (impiantit) për trajtimin e ujërave të zeza (që duhet të ketë një qasje regjionale dhe bashkëpunim ndër komunal për përzgjedhjen e lokacionit)
  - rehabilitimin e rrjetit ekzistues të kanalizimit (përgjegjësi e komunës për realizimin e projekteve për mirëmbajtjen e këtij rrjeti)
  - zgjerimin e rrjetit të kanalizimit në zonat ku mungon (përgjegjësi e komunës për realizimin e projekteve të parapara me plan).

#### **5.2.10 Masat për pengimin e ndikimeve të dëmshme në mjedis**

#### **5.2.8 (1) Masat për mbrojtjen mjedisit nga ndotja**

Dispozita të përgjithshme: PZHU ka identifikuar zonat ku ka ndotje dhe degradim të mjedisit dhe propozon veprimet e përgjithshme si:

- Komuna bashkëpunon me Ministrinë përkatëse, institucionet e organizatat tjera në përgatitjen e planeve (planit për veprim lokal për mbrojtje të mjedisit, planet e sanimit, planit operacional për menaxhimin e

pyjeve, planin për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë etj), programeve dhe projekteve si dhe ligjeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit.

- Komuna, në kuadër të përgjegjësisë të veta të përcaktuara me ligj siguron kontroll të vazhdueshëm dhe bën monitorimin e gjendjes së mjedisit në përputhje me ligjet dhe veçanta dhe programet e monitorimit. Monitorimi i mjedisit kryhet përmes matjeve sistematike, hulumtimit dhe vlerësimit të indikatorëve të gjendjes dhe ndotjes së mjedisit të cilat përfshijnë përcjelljen e faktorëve natyror, monitorimit të ajrit, ujit, tokës, pyjeve, llojlojshmërisë biologjike dhe peizazhore florën dhe faunën, mbështjellësit të ozonit, rrezatimit, zhurmës, mbeturinave; merr parasysh detyrimet dhe përgjegjësitë e marra nga marrëveshjet ndërkombëtare. Të dhënat e grumbulluara nga monitorimi i gjendjes së mjedisit, përbëjnë informacion publik dhe përfshihen në Sistemin Informativ të Mbrojtjes së Mjedisit. Detyrimet e subjekteve që me aktivitetet e tyre shkaktojnë ndotje në mjedis janë të rregulluara me ligjin për mbrojtjen e mjedisit.

#### Dispozita të veçanta:

- Komuna ndërmerr këto masa për të parandaluar apo/dhe përmirësuar gjendjen mjedisore:

#### **a) Masat për mbrojtjen e ajrit nga ndotja:**

- Komuna, në bashkëpunim me MMPH, vendos sistemin e monitorimit për të monitoruar cilësinë e ajrit të ndotur nga aktivitetet industriale dhe ndërmerr masa për të zvogëluar atë.

#### **b) Masat për mbrojtjen e ujit nga ndotja:**

- Komuna merr pjesë dhe bashkëpunon me Ministrinë përkatëse në realizimin e projekteve dhe përpilimin e planeve e programeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e ujërave
- Komuna merr një sërë masash për mbrojtjen e ujërave:
- Ndalon shkarkimin e ujërave të zeza në shtretërit e lumenjve. Rrjeti i derdhjes së ujërave të zeza duhet të kompletohet dhe të ketë trajtimin primar në nënstacion. Komuna bashkëpunon me komunat tjera në aktivitetet për mbrojtjen e lumenjve nga ndotja si dhe projekte si ndërtimi i impiantit për trajtimin sekondar të ujërave të zeza.
- Merr masa për të ndaluar/parandaluar përdorimin e substancave organike e inorganike për plehërimin e tokës; mbrojtjen e bimëve në resurset ujore në brigje në largësi prej 15 metrash nga kufiri i bregut të ujit të klasit të parë dhe 5 metra largësi të bregut të ujit të klasit të dytë.
- Ndalon larjen e mjeteve lundruese, mjeteve motorike dhe pajisjeve tjera në ujërat sipërfaqësor dhe në brigje të tyre;
- Ndalon hedhjen e substancave dhe mbeturinave të cilat për shkak të vetive fizike, kimike e biologjike mund të rrezikojnë shëndetin publik, organizmat ujor, vështirësojnë rrjedhjen e ujërave, rrezikojnë pajisjet ose instalimet ujore. Ndalon hedhja dhe transportimi i substancave dhe mbeturinave të rrezikshme.
- Ndalohet ndërtimi i objekteve dhe pajisjeve të dedikuara për prodhimin e substancave të rrezikshme në afërsi të resurseve ujore, përderisa nuk është fituar e drejta ujore si dhe lejet e tjera të kërkuara me ligj.
- Komuna në bashkëpunim me Ministrinë dhe sipas ligjit për ujërat ndërmerr masa për:
  - mbrojtjen e ujërave sipas dispozitave të ligjit për ujërat (masat mbi peshkimin; ruajtjen e mjedisit; masat që sigurojnë cilësi të qëndrueshme të ujit për pije; masat e parapara për rekreacion dhe larje) etj
  - rregullimin e ujërave (masat për mbrojtjen dhe balancimin e sasisë së ujërave; masat për mbrojtjen nga efektet e dëmshme të ujërave; masat e zbatuara për mirëmbajtjen e ujërave; përcaktimi i hapësirës për ndërtimin e infrastrukturës ujore);
  - shfrytëzimin e ujërave (masat e zbatuara për lejimin e shfrytëzimit të ujërave; masat e zbatuara për kompensim të kostos së shfrytëzimit të ujërave; masat për afirmimin e shfrytëzimit të qëndrueshëm të ujërave).
- Komuna respekton dispozitat ligjore mbi kufizimet për përdorim publik të ujit; detyrime lidhur me kërkimet ujore; financimin e ndërtimit të infrastrukturës ujore; përdorimin e infrastrukturës ujore;



ndërtimin e digave dhe akumulimeve; alarmimi në rast rreziku; marrjen e masave për mbrojtjen nga efektet e dëmshme dhe rregullimi i ujërave; klasifikimin e trupave ujq sipërfaqësor dhe nëntokësor etj janë të rregulluara me ligjin për ujërat.

**c) Masat për mbrojtjen e tokës nga ndotja:**

- Komuna në bashkëpunim me Ministrinë, ndërmerr masa për dekontaminimin e dheut në zonën rreth Lumit Lepec dhe te pronave të ish Armatës ku gjendet cisternat.

Mbrojtja e tokës bujqësore dhe kullosave nga ndotja bëhet me masat si:

- Ndalim, kufizim dhe parandalim nga bartja drejtpërdrejt bartja përmes ujit dhe ajrit e materieve të dëmshme dhe ndërmarrja e masave për ruajtje dhe përmirësim të plleshemërisë së tokës
- Ndalohet lirimi i lëndëve të dëmshme dhe të rrezikshme, të cilat e dëmtojnë dhe ndryshojnë aftësinë prodhuese të tokës bujqësore apo kualitetin e kulturave bujqësore dhe përdorimi jo i drejt i plehrave minerale, organike dhe mjeteve për mbrojtjen e bimëve.
- Nëse vjen deri tek ndotja e tokës bujqësore me lirimin e lëndëve të dëmshme dhe të rrezikshme në sasi më të madhe se sa është e lejuar, ndotësi i tokës bujqësore i bartë shpenzimet e veprimeve për dekontaminim, përkatësisht për sanim të tokës bujqësore. Shpenzimet e dekontaminimit, apo sanimit nuk e përjashtojnë shkaktuesin e dëmit nga përgjegjësia sipas dispozitave ligjore (shi ligjin për mbrojtjen e mjedisit)

**5.2.8 (2) Masat për mbrojtje e parandalim të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera:**

Dispozita të përgjithshme:

- PZHU ka lokalizuar zonat e rrezikuara nga fatkeqësitë
- Komuna harton planin për mbrojtje dhe shpëtim, në përputhje me atë të Qeverisë
- Komuna në suaza të kompetencave të saj ndërmerr këto masa:
  - vështron, lajmëron dhe alarmon popullsinë për kërcënim rreziku;
  - organizon, mirëmban mjetet për alarmi;
  - organizon funksionimin e ndërlihdjeve për nevoja të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës;
  - bën planifikimin dhe realizimin e masave për mbrojtje dhe shpëtim;
  - vlerëson rrezikun dhe harton planin për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera;
  - themelon komitetin për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, organizon komitetet, njësitë dhe shërbimet e forcave për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, si dhe i forcave të tjera për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë;
  - siguron mjetet urgjente për strehim të përkohshëm në rast të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera;
  - realizon programet e aftësimimit;
  - harmonizon planet dhe përgatitjet tjera për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë me komunitat fqinje;
  - organizimi, zhvillimi dhe udhëheqja e mbrojtjes personale dhe reciproke,
- Komuna, gjatë realizimit të detyrave të mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera bashkëpunon me komunitat tjera dhe mund t'i bashkojë mjetet dhe shërbimet për realizimin e çështjeve të përbashkëta në mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera.
- Të gjitha planet në nivelet komunale për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, nuk mund të jenë në kundërshtim me planet qeveritare.

Dispozita të veçanta:

**a) Masat për mbrojtje nga përmbytja:** PZHU ka përcaktuar zonat e rrezikuara nga përmbytja: Komuna ndërmerr masa për parandalimin e kësaj dukurie si dhe merr pjesë në hartimin e Planit për administrimin e përmbytjeve të cilin e harton Ministria. Masat përfshijnë:

- Rregullimin e shtratit të lumit Lepenc dhe përroit të Rezhancës dhe Dimcës.

**b) Masat për mbrojtje nga zjarri:** PZHU ka identifikuar lokalitetet ku ka pasur paraqitje më të shpeshtë të zjarreve. Për të parandaluar këtë dukur ndërmerrn masat si vijojnë:

- Asnjë person pa leje paraprake s'mund të ndezë zjarr të hapur në pyjet ose tokat pyjore (kjo nuk nënkupton zjarret përbrenda një ndërtese ose oxhaku, apo pajisjeve të tjera të dizajnuara për mbajtjen e sigurt të zjarrit). Leja për ndezjen e hapur të zjarreve, kur një veprim i tillë është në përputhshmëri me shfrytëzimin e qëndrueshëm të pyllit dhe rregullat e përcaktuara me ligj, e lëshon Agjencia Pyjore.
- Komuna ndërmerr fushatë për ndërgjegjësim për mbrojtje nga zjarri dhe parandalim

**c) Masat për mbrojtje nga tërmetet:** PZHU ka identifikuar zonat me aktivitet seizmik dhe propozon masat si vijon:

- **Ndërtimet duhet të jenë në përputhje me kodet sizmike në fuqi kjo bëhet gjatë fazës së projektimit për objektet banesore, publike, komerciale, industriale në këto zona.**
- Në ndërtesat ekzistuese në fushat me ndikim të lartë sizmik dhe rrëshqitje toke komuna ndërmerr veprime për përforsim;
- Në ndërtimet e reja komuna aplikon normat e stabilitetit dhe siguron inspektim të rregullt dhe rigoroz në punimet e ndërtimit

**d) Masat për mbrojtje nga erozioni:** PZHU ka identifikuar zonat erozive. Komuna me vendim mund të shpall zonat më erozion të lartë (shih gjerësisht ligjin mbi ujërat) në të cilat komuna merr urgjentisht masa si vijon:

- Kufizon ose ndalon prerjen e drunjve, përveç në rastet kur kjo është masë agroteknike;
- Bën kufizimin ose shfrytëzimin e kullotave duke përcaktuar llojin, kohën, numrin e kafshëve që mund të kullosin, si dhe mënyrën e shfrytëzimit të tyre;
- Ndalon lëvrimin e livadheve, kullotave dhe sipërfaqeve të pashfrytëzuara të tokave të pjerrëta për qëllime të shndërrimit të tyre në tokë të lëvrueshme me kultura njëvjeçare;
- Bën ndalimin e largimit të shtresës humusore ose shtresës së punueshme nga toka bujqësore;
- Detyron mbjelljen e barit të llojit të veçantë në tokat e pjerrëta;
- Obligon ndërmarrjen e masave mbrojtëse për parandalimin e dëmeve që mund të shkaktohen nga erërat.
- Ndalon nxjerrjen e rërës nga lumenjtë
- Ndërmerr veprime për rregullimin e shtretërve të lumenjve dhe brigjeve të tyre
- Komuna do të merr masa për të penguar rrëshqitjen e dheut në lagjen Bravet dhe te Dheu i Bardhë
- Komuna ndalon ndërtimet në zonat ku ka erozion të lartë, përderisa aty nuk përmbushen kushtet sipas kushtet sipas nenit 42.4 të ligjit mbi fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera

Shpenzimet e zbatimit të masave kundër erozionit i mbulon pronari apo shfrytëzuesi i tokës. Nëse ndërmarrja e masave kundër erozionit është me interes të përgjithshëm, Qeveria mund të caktojë institucionet publike si pjesëmarrës në shpenzimet për zbatimin e këtyre masave.

### **5.2.8 (3) Masat për mbrojtje nga zhurma dhe vibracioni:**

- Shfrytëzuesi i pajisjeve të cilat prodhojnë zhurmë dhe vibracion, mund të vë në qarkullim ose të përdor pajisjet sipas kushteve të parapara për aplikimin e masave mbrojtëse për zvogëlimin e zhurmës dhe vibracionit, respektivisht të bënë përdorimin e impianteve, pajisjeve, makinave, mjeteve transportuese dhe aparateve të cilat lirojnë zhurmë deri në nivelin e paraparë me ligj të veçantë.

- Mbrojtja e vendbanimeve nga zhurma bëhet duke ndërtuar pengesa, si dhe përmes brezave gjelbërues.

#### **5.2.8 (4) Mbrojtja nga ndryshime klimatike:**

- Masat në paragrafët e lartpërmendur, ndikojnë në zvogëlimin e ndryshimeve klimatike
- Komuna do të stimulojë dhe favorizojë ndërtimet të cilat përdorin energjinë alternative
- Komuna, do të përkrah projektet që kanë të bëjnë me rritjen e efikasitetit të energjisë si në veprimtaritë publike po ashtu edhe private

#### **5.2.8 (5) Masat e rehabilitimit**

- Komuna merr masa për rehabilitimin e dëmeve në mjedis të shkaktuara nga personi juridik ose fizik, autoriteti publik apo ato të shkaktuara nga fatkeqësitë
- Subjektet që shkaktojnë dëme të tilla janë të detyruara ta kthejnë pjesën e dëmtuar në kushtet që nuk paraqesin rrezik për mjedisin dhe shëndetin e njeriut duke respektuar dispozitat ligjore mbi mbrojtjen e mjedisit.
- Në rast se personi juridik ose fizik, apo autoriteti publik që merr pjesë në një aktivitet të vazhdueshëm që mund të sjell dëm të madh apo kritik mjedisor ose aksident mjedisor, ai ka obligim që në afat të caktuar të ndërmarr masa dhe me aktivitetin e tij në të ardhmen: të zvogëlojë emisionin dhe cilësinë e mjedisit në nivelin e lejuar si dhe të minimizoj rrezikun për një aksident mjedisor në pajtim me ligjin.
- Në rastet kur dëmet paraqesin rrezik permanent dhe subjektet e lartpërmendura nuk arrijnë të sigurojnë masa për rehabilitim të rrezikut, Qeveria mund të aprovojë, zbatojë një program të arsyeshëm për sanimin e dëmit.

#### **5.2.8 (6) Masat për objektet e sigurisë publike:**

- Projektet për ndërtimin e objekteve të përcaktuara me ligj nga Qeveria, të destinuara për shfrytëzim kolektiv, furnizimin e qytetarëve, të transportit publik, si dhe deponimin, prodhimin, përdorimin e materieve të rrezikshme, të naftës dhe të derivateve të saj, duhet të përmbajnë elaborate të sigurimit nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera.
- Komuna do të bashkëpunojë me komunitat fqinje për të përcaktuar lokacionin për të ndërtuar strehimore publike të cilat mund të subvencionohen nga Qeveria apo adaptimin e objekteve për strehim sipas normave teknike të përcaktuara me ligj.
- PZHU ka paraparë Planin e Përbashkët të Veprimit (Komuna, Policia, Dogana, Fabrika, Zjarrfikësit) i cili do të mundësojë realizimin e detyrave operative nga fusha e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës.
- Ndërtimet në zonat erozive lejohen nëse janë përmbushur kushtet sipas nenin 42.4 të ligjit mbi fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.
- Komuna, gjatë procedurës të dhënies së lejes së lokacionit për ndërtim dhe kryerje të punëve ndërtimore dhe ndërhyrjeve në territorin e vlerave natyrore të mbrojtura, përcakton kushte e veçanta për mbrojtjen e mjedisit;

#### **5.2.8 (7) Lejet , pëlqimet mjedisore dhe pëlqimet tjera:**

- **Vlerësimi strategjik mjedisor:** Komuna duhet të arrijnë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe të harmonizojnë çështjet mjedisore në përgatitjen dhe miratimin e planeve dhe programeve, duke siguruar se vlerësimi strategjik mjedisor bëhet për planet dhe programet të cilat kanë mundësi të kenë ndikim të theksueshëm në mjedis. (shih më gjerësisht Ligjin për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, Nr.03/L-230)
- **Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis:** Vlerësimi i ndikimit të projekteve në mjedis bëhet për projekte të cilat planifikohen të realizohen në hapësirë të caktuar, duke përfshirë edhe ndryshimet e teknologjisë,

rekonstruimin, zgjerimin e kapaciteteve ose ndërprerjen e punës, gjë që mund të sjell deri te ndotja e mjedisit ose mund të paraqesin rrezik për shëndetin e njeriut. Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Nr.03/L-024, përcakton projektet të cilat i nënshtrohen VNM-se. Rekomandimet për hartimin e VNM të projekteve të propozuara me plan, janë dhënë edhe me raportin e vlerësimit të ndikimit socio-ekonomik-mjedisor të PZHK (bashkangjitur si dokument aneks i planit).

- **Pëlqimi mjedisor për shfrytëzim:** Asnjë institucion nuk mund ta lëshojë lejen për shfrytëzimin e resurseve natyrore pa pëlqimin mjedisor për projektin i cili duhet të përmban masat e mbrojtjes dhe rehabilitimit mjedisor.
- **Leja Mjedisore:** Lëshimi në punë i objektit të ndërtuar apo i stabilimenteve dhe pajisjeve që kanë qenë objekt i vlerësimit të ndikimit në mjedis, nuk mund të fillojë veprimtarinë pa marrjen e lejes mjedisore sipas procedurave ligjore të Ministrisë.
- **Leja mjedisore komunale:** Për të gjitha llojet e aktiviteteve dhe projekteve të cilat nuk janë të përfshira në nenet 29, 30, 31 dhe 33 të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit, të cilat mund të shkaktojnë çrregullime në mjedis, komuna lëshon Leje Mjedisore Komunale Kjo leje është pjesë përbërëse e dokumentacionit teknik; aplikimi për këtë leje bëhet gjatë procedurës së marrjes së lejes ndërtimore. Aplikimi përmban raportin e shkurtër për ndikimet e aktiviteteve apo projekteve në mjedis në përputhje me metodologjinë për vlerësimin e ndikimit në mjedis
- **Leja e integruar mjedisore:** Për punën e impianteve të reja të cilat mund të kenë ndikim negativ në mjedis dhe shëndetin e njeriut duhet të sigurohet leja e integruar mjedisore me të cilën sigurohet parandalimi dhe kontrolli i ndotjes së mjedisit. Llojet e aktiviteteve dhe impianteve, kushtet dhe procedura e dhënies së lejes, mbikëqyrja dhe çështjet tjera të rëndësishme për parandalimin e integruar dhe kontrollin e ndotjes të mjedisit, rregullohen me Ligjin për Parandalimin e Integruar dhe Kontrollin e Ndotjes Nr. 03/L-043
- **Autorizimi mjedisor:** Për të gjitha llojet e aktiviteteve dhe projekteve të cilat nuk janë të përfshirë në listën e Ministrisë mbi veprimtaritë që kërkojnë autorizim mjedisor askush nuk ka të drejtë të kryejë apo ndërmarrë ndonjë veprimtari që mund të shkaktojë çrregullim në mjedis nëse për këtë veprimtari nuk është marrë autorizim mjedisor nga Ministria.

#### 5.2.11. Masat për parandalimin e ndikimit negativ social;

- Për t'iu shmangur ndikimit negativ social, komuna do të sigurojë infrastrukturën e nevojshme sociale sipas projekteve të parapara me plan (ndërtimi i shkollave, qendrës rinore, muzeut, bibliotekë, shtëpi kulture, zyre për kujdes ndaj pleqve, salla sportive dhe rregullim të hapësirave për sport e rekreacion, etj) si dhe harton programeve dhe aktiviteteve që gjenerojnë dhe krijojnë kushte për mirëqenie sociale
- Komuna harton programin për punësim si dhe kujdeset që të ndërmerr aktivitete që gjenerojnë vende të reja pune duke marrë parasysh interesat e grupeve të ndryshme të shoqërisë varësisht nga mosha, gjinia, aftësitë, edukimi, etj.
- Gjatë zhvillimit të projekteve të ndryshme, komuna duhet të favorizojë potencialin lokal (vendor) të Hani i Elezit në kryerjen e punëve, normal në kushtet kur ata janë të barabartë me pjesëmarrësit tjerë që aplikojnë për projekt.
- Komuna në bashkëpunim me OJQ, bizneset, donatorë etj harton projekte dhe ndërmerr aktivitete që masivizojnë aktivitetet kulturo-sportive me qëllimin për të angazhuar të rinjtë në këto aktivitete duke parandaluar kështu mundësinë e përfshirjes së të rinjve në dukuri negative.
- Komuna përmes projekteve të parapara me plan, duhet të sigurojë kushte për të ofruar sigurinë publike. P.sh.
  - Për qarkullim të sigurve edhe gjatë natës është me rëndësi që projektet e ndërtimit të rrugëve gjithnjë të përcillen me ofrimin e ndriçimit publik;

- Komuna nuk do të lëshojë asnjë leje ndërtimi për objektet të cilat nuk kanë marrë parasysh aplikimin e normave të projektimit për ofrimin e infrastrukturës së nevojshme për qarkullimin e personave me nevoja të veçanta (rampat në objekte, parkingjet, vendkalimet, trotuare të projektuara në formën që lehtësojnë lëvizjen e lirshme të kësaj kategorie, hyrjet dhe qarkullimin e lehtë në lokale etj). Këto masa do të parandalojnë segregim social.
- Trajtimit të hapësirave publike duhet t'i kushtohet rëndësi e vecantë. Në zhvillimin e projekteve për rregullimin e hapësirave të tilla, komuna duhet të sigurojë pjesëmarrjen e palëve me interes në procesin e dizajnit urban të hapësirës.
- Gjatë hartimit të PRRU të propozuara, komuna duhet të sigurohet që gjatë trajtimit të hapësirës në ato lagje, banorët janë të përfshirë në këtë proces dhe kërkesat e tyre janë marrë parasysh. Komuna nuk duhet të lejojë të tilla rregullime të cilat favorizojnë një kategori të caktuar shoqërie dhe krijojnë geto-shoqëri.
- Komuna gjatë përpilimi dhe zhvillimit të projekteve të ndryshme të propozuara me plan, duhet të sigurojë proces transparent ndaj publikut. Në lidhje me këtë komuna duhet t'i kushtojë rëndësi informimit dhe mënyrës se si bëhet informimi për të eliminuar cdo mundësi eventuale për paraqitjen e pakënaqësive të palëve që kanë interes në atë projekt.

#### **5.2.12. Masat për zbatimin e planit:**

##### **5.2.12.a Detyrimi për hartimin e planit;**

- Pas hartimit të Planit Zhvillimor Urban pason hartimi i Planeve Rregulluese Urbane
- Komuna merr parasyh dispozitat ligjore për lejet urbanistike dhe ndërtimore për objektet e përcaktuara me UA të Ligjit për planifikim hapësinor respektivisht dhe ligjit për ndërtim si dhe ligjeve tjera përkatëse.

##### **5.2.12.b. Aplikimi i masave zhvillimore dhe i masave tjera;**

- Në zonat e përcaktuara me interes special dhe tyre të mbrojtura duhet të ndërmerren masa të veçanta për mbrojtjen e tyre
- Pas miratimit të planit, komuna ndërmerr veprime për ndërlidhjen e planit me regjistrin kadastral përfshirë veprimet për krijimin e kadastrit të ri nëse me plan është bërë shndërrimi i destinimit të tokës në destinim tjetër.
- Zbatimi i riparcelimit dhe eksproprijimit mund të jetë i domosdoshëm për arritjen e synimeve hapësinore.
- Komuna themelon dhe mirëmban sistemin e të dhënave të planit (në referencë të ligjit për planifikim hapësinor) i cili duhet të jetë në harmoni me atë të Ministrisë
- Komuna gjatë hartimit të PRRU duhet marrë parasysh të gjitha dispozitat e dala nga ky plan për të siguruar përputhshmërinë e PRRU me PZHU.

##### **5.2.12.c. Rekonstruimi i ndërtesës destinimi i së cilës është në kundërshtim me destinimin e planifikuar.**

- PZHU parasheh hartimin e rregullores komunale apo dhe programit (në përputhshmëri me dispozitat ligjore) për trajtimin e ndërtimeve pa leje.
- Ndërtesat ekzistuese cilat nuk mund të rregullohen, rikonstruohen dhe adaptohen sipas planeve të miratuara apo dispozitave ligjore duhet të rrënohen.
- Komuna duhet të siguroj banim për banorët e zhvendosur prej këtyre ndërtesave, lokacion tjetër për ndërtim apo shpronësim adekuat.
- Komuna nuk do të lejojë zgjerimin apo mbindërtimin në ndërtesat ekzistuese që janë në zona me peizazhe të bukura natyrore, nëse me plan kjo nuk është e lejuar
- Komuna merr masa për parandalimin e ndërtimeve në zonat ku ndërtimet nuk janë të lejuara

### **5.3. Dispozitat lidhur me bashkëpunim;**

- Komuna informon, bashkëpunon apo/dhe arrin marrëveshje bashkëpunimi dhe bashkëfinancimi me Ministrinë dhe Agjencionet përkatëse për projektet e propozuara në PZHU që kërkojnë pjesëmarrjen e këtyre institucioneve
- Komuna informon, bashkëpunon apo/dhe lidh marrëveshje bashkëfinancimi me komunitat fqinje për projektet me interes të përbashkët. Komuna bashkëpunon me Agjencionin për Zhvillim Regional në realizimin e projekteve të tilla.
- Komuna informon, bashkëpunon dhe arrin marrëveshje partneriteti me ndërmarrjet publike për shërbimet publike në kompetencat e këtyre ndërmarrjeve (çështjet e ujësjellësit, kanalizimit, energjisë elektrike, menaxhimit të mbeturinave, etj)
- Komuna bashkëpunon dhe krijon marrëveshje partneriteti (PPP) me sektorin privat në projektet që të dy palët kanë interes të përbashkët
- Komuna krijon marrëdhënie bashkëpunimi ndërkufitar me komunitat e shteteve fqinje, për projektet me interes të përbashkët
- Komuna bashkëpunon me donatorët e ndryshëm në projektet e parapara me plan realizimi i të cilave mund të ndihmohet nga programet e ndryshme të donatorëve
- Komuna përkrah dhe bashkëpunon me OJQ në një sërë projektesh të parapara me plan, e sidomos në ato që kanë të bëjnë me fushata ndërgjegjësimi, promovimin e vlerave të komunës
- Komuna gjatë hartimit të planeve tjera që rrjedhin nga PZHU, duhet të sigurojë pjesëmarrjen dhe përfshirjen e publikut (qytetarëve dhe grupeve të ndryshme të interesit) qysh në fazat e fillimit dhe gjatë gjithë procesit dhe ndërmerr fushatë informimi ashtu siç është parapa me dispozitat e ligjit për planifikim hapësinor.

### **5.4. Dispozitat mbi rendin kronologjik apo etapat e implementimit;**

Plani Zhvillimor Urban ka paraparë këto faza të zhvillimit të veprimeve:

- Komuna themelon njësinë për planifikim e cila do të merret me revidimin, përcjelljen e zbatimit të planit dhe projekteve të dala nga ai, harton raportet vjetore për monitorim dhe vlerësim të planit si dhe jep sugjerimet për ndryshimet eventuale etj
- Komuna (njësia për planifikim) harton programin për zbatimin e planit zhvillimor komunal.
- Veprimet/projektet e propozuara në PZHU janë grupuar në tri faza të zhvillimit:
  - faza I: periudhën 2011-2013 ku kryesisht janë të përfshira projektet /veprimet afatshkurta të cilat edhe janë të ndërlidhura me kornizën afatmesme të planifikimit buxhetor komunal
  - faza II: periudhën 2014-2016 dhe i përfshin veprimet/projektet afatmesme
  - faza III: periudhën 2017-2025+ dhe përfshin veprimet/projektet afatgjata
- Të gjitha investimet në komunë që kanë karakter hapësinor duhet të jenë në harmoni me propozimet dhe prioritetet e përcaktuara me Planin zhvillimor komunal
- Pas miratimit të planit dhe hyrjes së tij në fuqi, komuna duhet të analizojë planin aktual buxhetor (kornizën buxhetore) dhe gjatë rishikimit të saj, komuna inkorporon projektet e parapara në kornizën buxhetore të rishikuar.

### **5.5. Elementet dhe udhëzimet për hulumtim të mëtutjeshëm**

- Plani Zhvillimor Komunal i Hanit të Elezit ofron një kornizë për zhvillimin e studimeve dhe hulumtimeve në fusha të caktuara si:
  - Studim fizibiliteti për shfrytëzimin e energjisë alternative në përgjithësi dhe “energjisë së humbur” të fabrikës së çimentos dhe mundësinë e shfrytëzimit të saj për ngrohje qendrore
  - analizë për vendodhjen e bimëve endemike dhe ruajtjen e tyre

- inventarizim i objekteve me trashëgimi kulturore

## 5.6 Dispozitat përfundimtare

### *Vlefshmëria:*

- Ky plan do të jetë vlefshëm deri në vitin 2025 (për Hanin e Elezit deri 2025). Rishikimi/revidimi i i planit do të bëhet cdo 5 vjet.

### *Vlerësimi dhe ndryshimet e planit:*

- Rishikimi profesional i PZHU-së nënkupton ndryshimet apo plotësimet duhet të bëhet sipas mënyrës dhe procedurës së përcaktuar për miratimin e tyre fillestar (*Ligji për Planifikim Hapësinor, 2003/14, neni 20*). Çdo propozim ndryshim, amandamentim apo shfuqizim (abrogimit) i planit duhet të kalojë nëpër procesin e shqyrtimit publik i cili zgjat së paku 15 ditë, dhe jo më shumë se 30 ditë (*Udhëzimi Administrativ për zbatimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor mbi procedurën e shqyrtimit publik për planet hapësinore dhe urbanistike 54/2005, neni 5.4*)